

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË
14 DHE 17 SHTATOR 2007

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
14. I 17. SEPTEMBRA 2007. GODINE

SHTATOR – SEPTEMBAR
2007

R E N D I I D I T Ë S:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 27 gushtit 2007;
2. Koha për pyetje parlamentare;
3. Interpelanca e ministrit të Arsimit, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën jokentestimore;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbartuese;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën kontestimore;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit;
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin;
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë organike;
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor;
12. Shqyrtimi i propozimit të partive parlamentare për anëtarë në Komisionin ad - hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së;
13. Shqyrtimi i propozimit të partive parlamentare për anëtarë në Komisionin ad - hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur për Media;
14. Shqyrtimi i Rekomandimit për transferin e mjeteve buxhetore të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (MBPZHR)
15. Shqyrtimi i Rekomandimit për transferin e mjeteve buxhetore të Ministrisë për Energji dhe Miniera (MEM) në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit;
16. Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me Raportin fiskal për gjashtëmuorin e parë të vitit 2007;
17. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të Bordit Drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

D N E V N I R E D:

1. Usvajanje Zapisnika sa plenarne sednice od 27. avgusta 2007. godine;
2. Vreme za poslanička pitanja;
3. Interpelacija ministra za obrazovanje, g. Agim Veliu, po zahtevu Parlamentarne grupe ORA;
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o strateškoj proceni životne sredine;
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o vanparničnom postupku;
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izvršnom postupku;
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o parničnom postupku;
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o pravima i odgovornostima poslanika;
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o hrani;
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o organskoj poljoprivredi;
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o drumskom saobraćaju;
12. Razmatranje predloga parlamentarnih stranaka za članove Ad-hoc Skupštinske komisije za imenovanje članova Borda RTK;
13. Razmatranje predloga parlamentarnih stranaka za članove Ad-hoc Skupštinske komisije za imenovanje članova Nezavisnog odbora za medije;
14. Razmatranje Preporuke za transfer budžetskih sredstava Ministarstva za poljoprivredu, šumarstvo i ruralni razvoj (MPŠRR);

15. Razmatranje Preporuke za transfer budžetskih sredstava Ministarstva za energiju i rudnike (MER) u Kosovskoj poverilačkoj agenciji;
16. Razmatranje Preporuke u vezi sa Fiskalnim izveštajem za prvo šestomesečje 2007. godine;
17. Razmatranje predloga Vlade Kosova o imenovanju člana Upravnog borda Centralnog bankarskog autoriteta Kosova.

A G E N D A

1. Approval of the minutes of the plenary session of 27 August 2007;
2. Time for parliamentary questions;
3. Interpellation of the Minister of Education, Mr. Agim Veliu, requested by the Parliamentary Group ORA;
4. The first reading of the Draft Law for strategically environmental assessment;
5. The first reading of the Draft Law of the non contestable procedure;
6. The first reading of the Draft Law for executing procedure;
7. The first reading of the Draft Law on contestable procedure;
8. The first reading of the Draft Law on Rights and Responsibilities of the Deputies;
9. The second reading of the Draft Law for nutrition;
10. The second reading of the Draft Law for organic agriculture;
11. The second reading of the Draft Law for amendment and supplement for road transport;
12. The discussion of the proposal of the parliamentary groups for members of Ad Hoc Committee of the Assembly for appointment of the members of RTK board;
13. The discussion of the proposal of the parliamentary groups for members in the Ad Hoc Committee of the Assembly for appointment of the members for the Independent Committee for Media;
14. The discussion of the recommendation for the transfer of the budgetary means of the Ministry for Agriculture, Forestry and Rural Development (MAFRD)
15. The discussion of the recommendation for the transfer of the budgetary means of the Ministry for Energy and Mines (MEM) in Kosovo Trust Agency (KTA);
16. The discussion of the recommendation regarding the fiscal report for the first six months of the year 2007;
17. The discussion of the proposal of the Kosovo Government for appointment of a member of the Managing Board of the Central Bank Authority of Kosovo.

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 14 DHE 17 SHTATOR 2007

Seancën plenare e kryesoi Kolë Berisha, Kryetar i Kuvendit.
Seanca filloi punën në orën 10,00.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, i nderuar Kryeministër, ministra në Kabinetin qeveritar, mirëserdhët në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 73 deputetë, që do të thotë se mund të fillojmë punën. Që në fillim ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Meqë, në ndërkohë, nuk ka arritur asnjë propozim me shkrim për plotësimin e agjendës, mund të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës, është:

- Miratimi i Procesverbalit nga Seanca plenare, e mbajtur më 27 gusht 2007.

Procesverbali nga Seanca plenare e 27 gushtit 2007 iu është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Pyes deputetët, a ka vërejtje ndokush në të? Nuk ka.

Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin nga Seanca plenare e mbajtur më 27 gusht 2007.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- Koha për pyetjet parlamentare.

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së punës të Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Në afatin e paraparë, janë parashtruar 20 pyetje parlamentare.

Pyetjet, të cilat nuk mund të procedohen sot, do të radhiten për seancën e ardhshme.

Fillojmë me pyetjet.

Deputeti Xhelal Canziba, ka pyetje për Ministrin Blerim Kuçi.

A dëshironi të sqaroni diç lidhur me këtë, zoti deputet?

XHELAL CANZIBA: Duke parë se Policia e Kosovës po ballafaqohet dhe vazhdon të ballafaqohet me probleme serioze për çështje të sigurisë në Kosovë, sikur që kemi rastin e fundit me shkëmbim të zjarrit të SHPK-ës dhe grupeve të armatosura në Radishevë të Drenicës dhe se Policia nuk ka kushte të mjaftueshme për përgjigje të nevojshme ndaj rasteve të tilla.

Në këtë rast, nuk ka armë të përshtatshme për mbrojtje në situata që paraqesin shkallë të lartë të rrezikshmërisë për pjesëtarët e SHPK.

Pyetja:

- A posedon SHPK armë me tyte të gjata, të nevojshme për mbrojtjen nga sulmet e tilla dhe, nëse kanë, pse nuk i bartin, dhe nëse nuk i kanë – pse nuk iu sigurohen.

Faleminderit.

KRYETARI: Zoti Ministër, urdhëroni, e keni fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuar deputetë, i nderuar zoti deputet Canziba,

Shërbimi Policor i Kosovës posedon armë me tyta të gjata, siç janë armët e gjata të tipit HK MP-5, AK-47 dhe Shotgun.

Këto armë, në kuadër të SHPK-ës, i posedojnë njësitë e specializuara dhe Policia kufitare.

Njësitë e specializuara të SHPK-ës që posedojnë me armë të gjata, janë:

- Njësia e mbrojtjes së afërt, ose CPU-a siç i thomë, që kujdeset për mbrojtjen dhe sigurimin e personaliteteve me rëndësi të veçantë;
- Njësia e parë intervenuese, ose FIT, e cila, ndër të tjera kryen intervenime me rastin e rrezikshmërisë së lartë;
- Njësia operative – mbështetëse e regjioneve ose ROSU, e cila kryen detyrat e kontrollimit të masës dhe intervenimit të rrezikshmërisë së nivelit të mesëm;

Këto njësi veprojnë në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan.

Armët e gjata, njësitë i bartin sipas nevojës, në raste të intervenimit apo edhe gjatë patrullimeve ditore.

Shumica e pjesëtarëve të SHPK-ës, janë të trajnuar për t'i përdorur këto armë të gjata.

Sa i përket çështjes së sigurimit të armëve, Departamenti i njësive të specializuara, me datë 08.06.2007 e ka bërë një kërkesë, që ka të bëjë me furnizimin me armë për të gjitha njësitë operative mbështetëse të regjionit:

- Njësinë e parë intervenuese, ose FIT;
- Njësinë e mbrojtjes së afërt, dhe
- Njësinë me qentë, apo K-9-shin.

Në përgjithësi, totali i armëve të gjata, zoti deputet, njësitet e specializuara kanë 92 copë armë të gjata dhe Policia kufitare ka 35 armë të gjata.

Duhet cekur edhe një herë, se kemi bërë në kërkesë që të gjitha njësitë e specializuara, njësitë mbështetëse dhe njësitë kufitare të furnizohen me armë të gjata. Për këtë, ende s'kemi përgjigje. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. A keni pyetje shtesë? Jo.

Deputeti Nait Hasani, ka bërë pyetje për Ministrin Gërbiq, por ai sot mungon. Pyetja do të publikohet në Buletinin e Kuvendit.

Pyetja pra, ka të bëjë me zotin Hasani. Nait, është dashtë të vijë. Ta shtyjmë për seancën tjetër, ose edhe botohet në Buletinin e Kuvendit. Ky është rregull, s'kemi tjetër mundësi.

Deputetja Sala Ahmetaj, ka pyetje për Ministrin Agim Veliu. Urdhëroni, zonjë deputete.

SALA AHMETAJ: I nderuari Kryetar i Kuvendit, i nderuari Kryeministër, ministra dhe ju deputetë.

Në Kosovë, ende ka shkolla të cilat punojnë në kontejnerë. Për shembull, në disa fshatra të Skenderajt, si në Radishevë e diku tjetër dhe në komunën e Obiliqit. Dihet se komunat nuk kanë buxhet të mjaftueshëm për ndërtimin e shkollave.

Pyetja:

- A ka projekt Ministria që t'i ndihmojë komunat për ndërtimin e shkollave në vendet ku mësimi zhvillohet në kontejnerë; dhe
- A do të investojë Ministria për ndërtimin e shkollës në Radishevë?

KRYETARI: Ju faleminderit. Zoti Ministër, e keni fjalën.

AGIM VELIU: Faleminderit. I nderuari Kryetar, të nderuar deputetë, Është e vërtetë se ndonjë shkollë, në Kosovë, ende punon në kontejner. Arsyet pse punon në kontejner, i kemi dhënë disa herë. Janë mungesat buxhetore.

Ministria e Arsimit, ka një plan të investimeve nëpër komuna të Kosovës. Kërkesat për investime, Ministria e Arsimit i merr nga komunat përkatëse për prioritetet dhe në bazë të kërkesave të komunave, Ministria i vendos prioritetet.

Ne, e kemi si prioritet me investimet në vitin 2007 që t'i heqim nxënësit nga kontejnerët e po ashtu edhe ta eliminojmë ndërrimin e tretë dhe të katërt. Është fjala për shkolla që punojnë me tri apo katër ndërrime ende në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. A ka pyetje shtesë? Urdhëroni.

SALA AHMETAJ: Unë e bëra pyetjen: A do ta ndërtoni shkollën në fshatin Radishevë?

KRYETARI: A keni përgjigje, zoti Ministër?

AGIM VELIU: Do ta kemi parasysh edhe shkollën në Radishevë. Ne do ta vizitojmë edhe Radishevën, do t'i shohim kërkesat sa janë për atë fshat dhe sigurisht se do ta bëjmë një investim për Radishevën.

KRYETARI: Ju faleminderit. Meqenëse Zëvendëskryeministri Haziri nuk është prezent, për shkaqe familjare, pyetja e deputetit Hydajet Hyseni, tash për tash mbetet pa përgjigje. Urdhëroni zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit zoti Kryetar.

Unë dua, megjithatë, të sqaroj së pari se pyetjen ua kam drejtuar Qeverisë dhe ministrive përkatëse. Pyetja edhe ka të bëjë jo vetëm me një ministri.

Megjithatë, më lejoni që ta shfrytëzoj të drejtën time për ta lexuar pyetjen dhe do të dëshiroja që të mos detyrohemi – ne deputetët – kush të zgjedhet, që ta përsërisë pyetjen shumë herë derisa të vijë ministrat.

Pyetja është kjo:

- Çka ka bërë Qeveria, ministrat dhe drejtoritë përkatëse për krijimin e parakushteve të nevojshme për adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të shumta, të shtrura nga banorët e cepit jugor të Kosovës – Restelicës me rrethinë, siç janë: mungesa

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, u ndërpretë sepse e zgjatët diskutimin. Megjithatë, vazhdoni.

HYDAJET HYSENI: Po, kryetar! Por, pjesa e parë, nuk ishte pyetje, ju lutem. Ishte sqarim lidhur me atë se ministrit Haziri, në fund të fundit, kjo pyetje as që i është shtruar dhe mungesa e tij nuk është arsyetim që të mos lexohet pyetja.

Prandaj, po vazhdoj. Problemet, siç janë:

- mungesa e sinjalit televiziv të televizionit publik dhe repetitorëve të nevojshëm;
- mungesa e lidhjeve telefonike;
- rruga e dëmtuar, dhe pjesërisht vetëm e arnuar;
- pamundësia e qarkullimit automobilistik tejkufitar me fshatrat fqinje në Shqipëri;
- pamundësia e shitjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale;
- si dhe mungesa e kushteve për mësim edhe të gjuhës shqipe në shkollë, megjithë kërkesat e qytetarëve për të mësuar edhe në gjuhën shqipe.

Pres përgjigjen!

KRYETARI: Ju faleminderit. Pyetja i është drejtuar Zëvendëskryeministrit dhe Zëvendëskryeministri nuk është sot prezent këtu për shkak se e ka babanë të sëmurë.

Pyetja me radhë. Deputeti Hydajet Hyseni, ka pyetjen për Ministrin Gërbiq. Ministri Gërbiq, nuk është prezent. Urdhëroni, zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit zoti Kryetar.

Urojmë shërim të shpejtë familjarëve të ministrit të mëparshëm. Pyetja që unë i kam shtruar përsëri Qeverisë dhe ministrisë përkatëse, ka të bëjë me gjendjen e të shpërngulurve me dhunë nga komunat e Preshevës, Bujanovcit e Medvegjës, pyetje që është shtruar edhe më parë, edhe nga qytetarët edhe nga deputetët dhe pyetja është:

- Çka ka bërë Qeveria, ministritë dhe drejtoritë përkatëse për krijimin e parakushteve të nevojshme për kthimin në vatrën e tyre, si dhe adresimin dhe zgjidhjen e problemeve të shumta me të cilat përballen ata në vijimësi?

Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. E ka fjalën deputeti Januz Kastrati, që ka pyetje për Ministrin Agim Veliu.

JANUZ KASTRATI: Ju faleminderit. I nderuar Kryetar, i nderuar Kryeministër me Kabinetin qeveritar, të nderuar deputetë, i nderuar Ministër Veliu,

Në Malishevë, në vitin shkollor 2006/07 në klasët e nënta kishte 1.348 nxënës, ndërsa në klasët e dhjeta – në të dy shkollat e mesme ka mundësi të regjistrohesh vetëm 640 nxënës, apo 20 paralele. Kjo do të thotë se pa u regjistruar mbeshin 708 nxënës apo 52.5%. Pra, është shumë vështirë që, në shekullin 21, të mbeshin pa u regjistruar në shkollat e mesme mbi gjysma e numrit të nxënësve.

- A është ndërmarrë diçka në sigurimin e hapësirës më të madhe shkollore, në mënyrë që sadopak të zbutet kjo gjendje kaq e palakmueshme, kuptohet në bashkëpunim me institucionet komunale se jemi të vetëdijshëm se përgjegjësia, në radhë të parë për sigurimin e hapësirës, u bie atyre komunale.

KRYETARI: Ju faleminderit. Zoti Ministër, e keni fjalën.

AGIM VELIU: Faleminderit. Shifrat edhe mund të jenë të sakta, mirëpo këto shifra janë para afatit të dytë të regjistrimit. Prandaj, pas afatit të dytë të regjistrimit, gjendja ka ndryshuar në komunat e Kosovës. Mirëpo, edhe përkundër kësaj, ne ende kemi nxënës që ka mbaruar shkollën fillore dhe nuk kanë mundësi të regjistrohen në shkollimin e mesëm. Shkollimi i mesëm, fundja, nuk është i obligueshëm, por ne bëjmë përpjekje që ta kemi një gjithpërfshirje.

Është e vërtetë se në disa komuna të Kosovës ka mungesë të hapësirave shkollore, për çka folëm edhe pak më herët, dhe Ministria e Arsimit i bënë të gjitha përpjekjet me komunat që ta zgjidhë edhe këtë problem.

Nga komuna e Malishevës, në Ministrinë e Kulturës, nuk ka pasur kërkesë për rritjen e numrit të paraleleve. Me rastin, kur marrim kërkesat nga komunat, kërkesat që janë të bazuara, Ministria e Arsimit do t'i shqyrtojë. Po them – të bazuara, sepse aty duhet të shihet a ka lokal, a ka personel, a ka buxhet. Domethënë, Ministria do t'i shqyrtojë dhe sigurisht do të japë leje për rritjen e paraleleve.

Mirëpo, duke u bazuar në kërkesat e të gjitha komunave të Kosovës për gjithpërfshirje, Ministria e Arsimit, para dy-tri ditësh, ka marrë një vendim për rritjen e numrit të nxënësve nëpër paralele. Nga numri 32, është lejuar rritja e numrit në 37, kështu që besojmë se ky vendim pak do të zbusë problemet që kemi nëpër komuna. Faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. A keni pyetje shtesë? Urdhëroni zoti Kastrati.

JANUZ KASTRATI: Faleminderit Ministër. Desha vetëm një sqarim, sepse në afat të dytë s'kemi pasur edhe konkurs, sepse natyrisht, në konkursin e parë ka përfunduar gjithçka. Flas për të paktën në shkollën e mesme – Gjimnazin "Abdyl Frashri" në Malishevë. Kjo ishte, vetëm për sqarim. Faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Deputetja Safete Hadërgjonaj, ka pyetje për Kryeministrin Agim Çeku. A dëshironi ta shtroni pyetjen?

SAFETE HADËRGJONAJ: Po, po. Faleminderit zoti Kryetar.

Keqmenaxhimi dhe keqpërdorimi i theksuar i parasë publike, sipas raportit të auditorit për vitin 2006, është shqetësim për tatimpaguesit që mbushin buxhetin e Kosovës.

Në kuadër të Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, është Departamenti i auditimit të brendshëm, që ka për detyrë të bëjë kontrollimin e brendshëm në të gjitha institucionet.

Pyetja ime është kjo:

- A keni qenë të njoftuar më parë për këto shkelje që po iu bëhen tri ligjeve kryesore, Ligjit për financat publike dhe përgjegjësitë, Ligjit të prokurimit publik dhe Rregullores së shërbimit civil?

Nëse po, çfarë keni ndërmarrë?

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën.

AGIM ÇEKU: I nderuar zoti Kryetar, të nderuar deputetë, ministra, e nderuar deputete,

Një ndër objektivat kryesore të Qeverisë, që drejtoj, ka qenë ngritja e përgjegjësisë, transparencës, ngritja e kapaciteteve gjithashtu dhe menaxhimin e financave në institucionet tona publike, në radhë të parë në Qeveri.

Për këtë arsye, nga Zyra e auditorit të përgjithshëm, kam kërkuar realizimin e auditimit nëpër të gjitha ministritë e Qeverisë dhe në Zyrën e Kryeministrit.

Si rezultat i kësaj pune, ne kemi raportet e Zyrës së auditorit publik, të cilat të gjitha janë publikuar. Mund të ceku, se të drejtë për publikimin e raporteve ka vetëm Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm dhe këtë publikim ai e ka bërë me kërkesën time që të publikohen për hirë të transparencës të gjitha publikimet. Mirëpo, janë publikuar kryesisht të gjeturat e auditorit publik dhe nuk janë publikuar, apo shumë pak iu ka dhënë hapësirë përgjigjeve të ministrive përkatëse për të gjeturat e auditorit publik.

Sidoqoftë, mendoj se gjetjet e publikuara të auditorit të përgjithshëm të Kosovës janë kryesisht, kryesisht – jo të tëra, të natyrës së shkeljes procedurale dhe jo të keqpërdorimit apo të dëmtimit material të parasë publike.

Sido që të jetë, ju siguroj se konstatimeve të publikuara në raport është duke i kushtuar një vëmendje shumë serioze. Të gjitha raportet, në radhët e parë, i janë dërguar prokurorit publik, por edhe në të gjitha ministritë apo në organizatat buxhetore janë duke u shqyrtuar dhe marrë masat për përmirësimin e gjendjes faktike.

Qeveria, në këtë rast, me seriozitet të veçantë është duke bërë përpjekje të realizojë një plan të implementimit të rekomandimeve të dhëna. Si rezultat i kësaj, në javën e ardhshme, ne planifikojmë ta miratojmë strategjinë për auditimin e brendshëm në nivel të institucioneve të Qeverisë për periudhën 2008-2010, strategji kjo e hartuar në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Duke iu referuar çështjes që shtruat lidhur me Departamentin e auditimit të brendshëm, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, mund të themi se ky Departament, është themeluar me një rol të kontrollit të brendshëm financiar dhe ngritjen e kapaciteteve të auditorëve të brendshëm. Në këtë rast, në të gjitha organet buxhetore për momentin janë duke u realizuar projekte të shumta dhe shumë të rëndësishme profesionale në fushën e auditimit.

Në këto momente, me ndihmën e Agjencionit Evropian për Rindërtim, është duke u realizuar një Projekt ambicioz për trajnimin e auditorëve të brendshëm brenda të gjitha agjencioneve shpenzuese të Kosovës. Po ashtu, një tjetër Projekt i rëndësishëm në këtë fushë është Senter for Exelenc në Francë është duke realizuar një Projekt të mbështetur nga Banka botërore për certifikimin e kontabilistëve publik. Padyshim se do të bëjmë përpjekje edhe më të mëdha në realizimin e projekteve dhe strategjive shtesë në ngritjen e kapaciteteve dhe mekanizmave për përmirësimin dhe respektimin e mirëfilltë të të gjitha rregulloreve procedurale të menaxhimit financiar.

I rëndësishëm për të potencuar në këtë kontekst, është edhe Ligji i saposhpallur nga PSPP që nga qershori i këtij viti. Bëhet fjalë për auditimin e brendshëm dhe është Ligj i cili synon vendosjen e një sistemi funksional të auditimit të brendshëm me qëllim të realizimit të një disipline më të madhe fiskale, respektimin e rregullave nga të gjitha njësitë e sektorit publik dhe kontrollit të financave publike.

Veprimet dhe angazhimet e lartcekura, janë vetëm disa nga masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes së konstatuar në raportet e auditorit të përgjithshëm.

Në fund, më lejoni të theksoj edhe një herë se rekomandimet e dhëna nga auditori i përgjithshëm, do të trajtohen

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Mund t'ia mundësoni vazhdimin e diskutimit.

AGIM ÇEKU: ...me një vëmendje të veçantë në mënyrë që në të ardhmen të mos ketë përsëritje shkeljeje procedurash të natyrës së tillë dhe gjithsesi të bëhen përpjekje të vazhdueshme në realizimin e kontrollit të efektshëm financiar me qëllim që tatimpaguesve tanë t'iu garantojmë menaxhim të mirëfilltë të buxhetit tonë.

KRYETARI: Ju faleminderit. A keni ndonjë pyetje shtesë?

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit zoti Kryetar.

Në fakt, unë nuk kam marrë përgjigjen në pyetjen të cilën e kam bërë, sepse unë s'i kam bërë pyetjen se cilat janë planet e tyre në të ardhmen, por çfarë masash kanë ndërmarrë për t'i dhënë fund keqpërdorimit dhe keqmenaxhimit të madh të buxhetit.

Zoti Kryeministër, më duhet të them se në Qeverinë tuaj s'ka pasur transparencë dhe s'keni bërë ngritje të kapaciteteve edhe pse keni shpenzuar me miliona euro për ngritjen e kapaciteteve.

Thoni se, nuk ka shkelje të natyrës materiale! Unë do ta kisha bërë një pyetje plotësuese:

- Çfarë masash keni ndërmarrë ndaj atyre të cilët i kanë shkelur ligjet, rregulloret dhe udhëzimet, të cilat faktikisht janë në fuqi?

A ka përgjegjësi në punë këtu? Ka përgjegjësi morale apo ia keni lënë të gjitha prokurorisë që në një të ardhme – me hapa të breshkës, siç veprohet, ndoshta mund të zgjidhen.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojmë punën. Deputeti Ramadan Kelmendi ka pyetje për Ministrin Bujar Dugolli, por ai mungon. Nëse doni, mund ta lexoni pyetjen.

RAMADAN KELMENDI: Pyetja është:

- Procesi i privatizimit, tani është në fazën përfundimtare. Në këtë proces, një ndër kriteret ka qenë që ndërmarrjet ta ruajnë e vazhdojnë veprimtarinë e mëparshme dhe të punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve nga ato ndërmarrje;
- Sa ndërmarrje shoqërore, gjegjësisht shtetërore, pas privatizimit kanë vazhduar veprimtarinë e mëparshme dhe sa punëtorë kanë mbetur në punë nga ata punëtorë që kanë punuar më parë.

Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Deputeti Xhevat Bislimi, ka pyetje për Ministrin Qemajl Ahmeti.

Ministri mungon, dhe kjo pyetje radhitet për seancë të ardhshme. Mund ta lexoni pyetjen.

XHEVAT BISLIMI: Po e lexoj pra, meqë u bë rregull t'i lexojmë pyetjet edhe kur s'janë ministrat!

Fjala është për gjendjen e rrugëve në komunën e Vitisë. Gjatë mandatit tuaj, zoti Ministër, janë lejuar shumë pak para për meremetimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve në komunën e Vitisë.

Rruga e fshatit Beguncë, për shembull, është bërë pothuaj e papërdorshme. Pastaj, rruga e fshatit Skifteraj, ajo e fshatit Smirë, Vërban e tjera. Në komunën tonë, është edhe një rrugë rajonale, që lidhë komunën e Vitisë me atë të Kaçanikut, e që nuk është asfaltuar deri më sot. Kjo rrugë, që kalon nëpër fshatin e bukur Kërbliç, është me interes të veçantë për zhvillimin e këtyre dy komunave. Fshati Kërbliç, i ka të gjitha kushtet edhe për zhvillim të turizmit.

Prandaj, pyetja është:

- Sa para keni dhënë gjatë mandatit tuaj për komunën e Vitisë dhe cilat janë kriteret për dhënien e këtyre parave, sepse dihet që nga komuna e Vitisë, gjatë mandatit të tij, ky Kryeministër ka marrë diku mbi një milion euro nga taksa vetëm për veturat.

KRYETARI: Ju faleminderit. Deputeti Xhevat Bislimi ka pyetje për Kryeministrin Agim Çeku.

XHEVAT BISLIMI: Zoti Kryeministër, fjala është për lirinë, sigurinë, mbrojtjen e tërësisë tokësore të Kosovës. Qeveria serbe dhe zyrtarë të lartë të Serbisë përditë bëjnë be e rrëfe s'e nuk do ta lejojnë dhe njohin shkëputjen ose pavarësimin e Kosovës. Deklarata të njëjta, që kërcënojnë lirinë, sigurinë dhe tërësinë tokësore të Kosovës, dëgjojmë çdo ditë edhe nga Moska dhe Qeveria Ruse.

Ju keni deklaruar se, pas 10 dhjetorit nuk do të kërkojmë nga qytetarët që të durojnë më. Pastaj, keni deklaruar se 10 dhjetori është vija e kuqe, se do ta shpallim pavarësinë, e tjera – e tjera. Pyetja:

- A është e zonja dhe a po bën përgatitje të nevojshme Qeveria juaj që, në bashkëpunim edhe me miqtë tanë, ta garantojë dhe mbrojë lirinë, sigurinë dhe tërësinë tokësore të kësaj Kosove?

Faleminderit.

KRYETARI: Urdhëroni, zoti Kryeministër!

AGIM ÇEKU: I nderuar zoti Xhevat, është e vërtetë dhe tanimë e njohur se Grupi i unitetit i ka bërë të qarta tri vija të kuqe, apo tri parime mbi të cilat ka ndërtuar platformën e bisedimeve në këtë periudhë shtesë e ato janë:

- pavarësia është e panegociueshme;
- është e papranueshme ndarja territoriale e Kosovës dhe se,
- “Pakoja e Ahtisarit” për ne është e mbyllur.

Është e vërtetë se deklaramet publike, duke u nisur se ndaj plotësisht mendimin e Grupit të unitetit, t'juajin deputetë, por edhe të opinionit që duhet ta kemi edhe një vijë të kuqe, e ajo është, sikur që edhe ju e përmendët:

Kjo periudhë e bisedimeve 120-ditëshe nuk është një proces i ri, edhe pse udhëhiqet tash nga ndokush tjetër, por është vazhdimësi e të njëjtit proces dhe njëkohësisht është edhe fazë përmbyllëse e këtij procesi për definimin e statusit të Kosovës.

Kjo do të thotë se, ne nuk jemi të gatshëm dhe nuk do të pranojmë biseda shtesë, vonesa, zvarritje. Kërkesë e jona është që menjëherë, pas këtyre 120 ditëve, të zgjidhet statusi i Kosovës apo të njihet pavarësia e Kosovës.

E dimë se përmes Këshillit të Sigurimit do të ketë vështirësi, do të kërkohet kohë. Jemi të gjithë të vendosur që kjo çështje të përmbyllet dhe gjithnjë e më e qartë është se përmbyllja e statusit të Kosovës do të bëhet vetëm me shpalljen e pavarësisë së Kosovës nga ky Kuvend.

Po ashtu, jemi të vetëdijshëm se një vendim apo një zhvillim i tillë do t'na përballë me sfida të ndryshme, si me sfida ekonomike, me sfida politike dhe mund të sfidohet po ashtu edhe integriteti territorial apo paqja dhe stabiliteti në Kosovë.

Ne, në bashkëpunim, siç thatë edhe ju, me miqtë tanë – jemi duke i shqyrtuar të gjithë skenarët e mundshëm, të gjitha sfidat me të cilat mund të ballafaqohemi me rastin e zhvillimeve të tilla, dhe mund t'ju them që, aq sa jemi ne të vendosur të ruhet paqja, stabiliteti dhe integriteti territorial, aq janë të vendosur ata të cilët e kanë përgjegjësinë për një gjë të tillë dhe në radhë të parë NATO, por edhe institucionet e Kosovës.

Në qoftë se ne, e unë besoj dhe fuqimisht shpresoj se kjo do të ndodhë, kur ta shpallim pavarësinë do të jemi shtet. Do të jemi shtet dhe, jam i sigurt, të njëjtën ditë i njohur ndërkombëtarisht dhe problemet tona do t'i zgjidhim si shtet me mekanizmat e shtetit. Dhe, gjatë zgjidhjes së këtyre problemeve, në qoftë se ballafaqohemi me to, ne nuk do të jemi të vetëm. Për këtë, kemi garanca.

KRYETARI: Ju faleminderit! I njëjti deputet ka pyetje, prapë për Kryeministrin Çeku.

XHEVAT BISLIMI: Zoti Kryeministër, sipas të gjitha gjasave dhe sipas skenarëve që janë menduar, më 10 dhjetor Kosova s'do ta ketë as Kuvendin që ta shpallë pavarësinë!

Por, të paktën, ju si Kryeministër dhe si Qeveri - çfarë keni ndërmarrë që të mbrohet kjo Kosovë, të mbrohet liria e këtij vendi, qytetarët e këtij vendi?

Dhe, sipas asaj që edhe ju shumëherë keni deklaruar se TMK do të jetë ushtri e Kosovës, a keni ndërmarrë diçka gjatë mandatit tuaj që të bëhet TMK ushtri e Kosovës dhe jo të udhëhiqemi me logjikën e zëdhënësit tuaj që fliste sikur të ishte Bushi – se ka kaluar koha e luftërave. Sepse, vetëm duke u përgatitur për mbrojtje, mund të kalojë koha e luftërave dhe t'i shuhet oreksi Serbisë. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. I njëjti deputetë, prapë ka pyetje për Kryeministrin Çeku.

XHEVAT BISLIMI: Zoti Kryeministër,
Kësaj radhe fjala është për dhunën dhe vandalizmin ndaj Institutit Albanologjik dhe ndaj akademik Rexhep Qosja.

Dhuna dhe vandalizmi ndaj Institutit Albanologjik dhe akademik Rexhep Qosja, ka shkaktuar pakënaqësi dhe indinjatë të përgjithshme në Kosovë dhe mbarë hapësirën shqiptare. Përpjekjet e Ministrisë së Arsimit për ta rrënuar këtë tempull të kulturës shqiptare, po dënohen kudo dhe nga të gjithë shqiptarët.

Sulmi ndaj monumentit të diturisë, të kulturës shqiptare dhe akademik Rexhep Qosjes, Qeverinë tuaj e radhitë përkrah qeverive antidemokratike dhe antiqytetëruese.

- Çfarë keni ndërmarrë, ose çfarë do të ndërmerrni ju personalisht për ta ndaluar dhunën dhe vandalizmin qeveritar ndaj Institutit Albanologjik, ndaj akademik Rexhep Qosjes dhe ndaj shkencës shqiptare përgjithësisht, sepse të njëjtën gjë e kemi pasur edhe me Universitetin, dikur publik, siç e dini.

KRYETARI: Ju faleminderit. Urdhëroni, zoti Kryeministër!

AGIM ÇEKU: Në komentin tuaj, në përgjigjen e pyetjes së parë, të gjitha ato pyetje që i bëtë, përgjigja ime është: Po.

Pyetja e dytë: As Ministria e Arsimit, as unë si Kryeministër, as Qeveria nuk e ka pasur për qëllim rrënimin, vandalizmin dhe dhunën në Institutin Albanologjik të Kosovës.

Qëllimi ynë ka qenë të mbështetet ky institucion, shumë i rëndësishëm për Kosovën, dhe të mbështetet në përputhje me ligjin - Ligjin e aprovuar nga ky Kuvend – për hulumtime dhe kërkime shkencore.

Në vazhden e këtyre përpjekjeve, Ministria e Arsimit, ka emëruar një ushtrues detyre – drejtorin e këtij Instituti, i cili, fatkeqësisht, nuk ka arritur ta fitojë mbështetjen e gjithë personelit apo kuadrit aty dhe janë marrë disa veprime që kanë shkaktuar shqetësime të

opinionit të gjerë, por edhe të miat, e gjithashtu edhe të Ministrit – sidomos ndaj akademik Rexhep Qosjes, për të cilin të gjithë kemi respekt të veçantë.

Ne kemi përcjellur këtë situatë. Ushtruesi i detyrës ka përcjell situatën, është përballë me pasojat e veprimeve të tilla, është larguar nga kjo detyrë dhe gjendja është duke u normalizuar në këtë Institut.

Është e qartë se gjendja mund të normalizohet vetëm në përputhje me ligjin – Ligjin për hulumtime dhe kërkime shkencore. Ministria do ta përcjellë implementimin e këtij Ligji, kuptohet edhe në bashkëpunim, besoj, me të punësuarit në këtë Institut dhe në bashkëpunim edhe me figura tona të shquara të shkencës e letërsisë sonë, siç është Rexhep Qosja dhe akademikë tjerë të nderuar.

KRYETARI: Ju faleminderit. I njëjti deputet, ka pyetje për Ministren Tërmkolli. Meqë ajo s'është këtu, le të përcillet për seancën e ardhshme.

Prapë, i njëjti deputet ka pyetje për Ministrin Blerim Kuçi. Urdhëroni zoti Bislimi.

XHEVAT BISLIMI: Zoti Kuçi, fjala është për vulën apostile, që është bërë e famshme tash në krejt Kosovën dhe veçmas për mërgimtarët tanë.

Jemi dëshmitarë të njëmijë e një peripecive të mërgimtarëve tanë gjatë nxjerrjes së dokumenteve apo realizimit të të drejtave të tyre në Kosovë. Njëra prej këtyre peripecive të shumta, është edhe vula apostile. Mërgimtari ynë, është i detyruar të udhëtojë deri në Prishtinë dy a tri herë për ta marrë një vulë apostile në dokumentin e tij. Përveç kësaj, mërgimtarët janë të detyruar të paguajnë 21 euro për një vulosje. Zakonisht duhen dy vulosje, pra 42 euro për ta nxjerrë një dokument. Vërtetë shumë dhe e padrejtë.

- Pse nuk lejoni përdorimin e kësaj vule në çdo komunë dhe pse nuk minimizoni pagesën për këtë vulë apostile?

Faleminderit.

KRYETARI: Zoti Ministër, e keni fjalën.

BLERIM KUÇI: I nderuar zoti deputetë,

Aplikimi i vulës verifikuese ka filluar të përdoret në shtator të vitit 2002 bazuar në Udhëzimin administrativ të datës 16 tetor 2001 për verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve civile të UNMIK-ut, të nënshkruar nga zoti Peter Schuman. Ndërsa, me Udhëzimin administrativ të Ministrisë së Shërbimeve Publike për procedurën e verifikimit dhe vulosjen me vulë verifikuese legalizuese të dokumenteve të gjendjes civile, është përcaktuar rregullimi i procedurës së verifikimit dhe përdorimit të vulës verifikuese legalizuese si vulë që garanton autorësinë, vërtetësinë e të dhënave, besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë që përmban dokumenti dhe njëherit pranimin e përgjegjësisë nga institucionet për dokumentet e lëshuara nga to për nevojat e qytetarëve me qëllim të përdorimit para autoriteteve të huaja. Do të thotë, kjo vulë vlen për dokumentet të cilat kanë nevojë qytetarët t'i përdorin në shtete të huaja.

Sa i përket caktimit të tarifës, e cila është përcaktuar me nenin 7, pika 7.1 të Udhëzimit administrativ për procedurën e verifikimit dhe legalizimit të dokumenteve civile, ku thuhet se çdo dokument i gjendjes civile kur vulolet me vulë verifikuese e legalizuese duhet të paguhet 20 euro. Lartësia e pagesës është përcaktuar për arsye të shpenzimeve administrative dhe të tjera. Domethënë, nevojitet verifikimi në vende të lëshimit të dokumentit civil, pastaj transporti i këtij dokumenti. Pagesa bëhet pasi që të jetë njoftuar pala se është kryer procedura e verifikimit. Procedura e verifikimit dhe vulosja e dokumentit me vulë verifikuese do të bëhet në afatin prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të dokumentit në Departamentin e gjendjes civile.

Përsheptimi i procedurës së verifikimit bëhet në raste kur dëshmohet nevoja për shpejtim, duke u bazuar në nenin 8, pika 1 të këtij Udhëzimi administrativ.

Sa i përket verifikimit të dokumenteve civile vetëm në qendër në Prishtinë, kjo është vendosur nga UNMIK-u dhe bëhet për shkak të një sigurie dhe besueshmërie më të lartë, sepse bëhet fjalë me dokumente për të cilët qytetarët kanë nevojë t'i paraqesin te organet përkatëse të shteteve tjera. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Deputetja Teuta Hadri ka pyetje për deputetin Sadik Idriz. Ministri nuk është këtu. Pyetjen, mund ta lexoni.

TEUTA HADRI: Faleminderit.

Një numër i madh i ekzaminimeve mjekësore të cilat, për shkak të mungesës së mjeteve, nuk kryhen në spitalet publike të Kosovës, e ato mund të kryhen në spitale private të Kosovës me pajisje dhe teknologji moderne.

Pyetja është:

- Pse Ministria e Shëndetësisë po lejon e paguan shuma parash me kosto të lartë, duke dërguar pacientë jashtë vendit, e nuk i dërgon në klinikat private të pajisura me pajisje moderne?

KRYETARI: Ju faleminderit. Urdhëroni, zoti Bislimi.

XHEVAT BISLIMI: Kërkoj falje zoti Kryetar.

Kam edhe një pyetje shtesë për Ministrin.

Zoti Ministër, ne e dimë, edhe ju e dini, që nuk i bën të gjitha UNMIK-u, por në marrëveshje me UNMIK-un dhe - kur ua do interesi - gjithmonë fshihen ose fshihen pas UNMIK-ut.

Është vërtet absurde të paguhet një vulë 21 euro dhe të vihet në Prishtinë – një herë për të bërë termin, një herë tjetër për të vulosur dokumentin e për t'u kthyer prapë nëpër komuna për të marrë nënshkrimin, e tjera – e tjera. Për garanci, e dimë çfarë garancishë kemi!

Nuk është ndonjë kiamet i madh që vula të kthehet në komunë, qytetarët të shërbejnë aty ku janë, sepse me decentralizimin e dimë çka kemi bërë. Ta decentralizojmë edhe këtë vulë, sepse nuk është ndonjëfarë kushedi çfarë vule që na rrezikon sigurinë a tërësinë territoriale, siç na ka rrezikuar dokumenti i Ahtisarit. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit!

BLERIM KUÇI: Kam nevojë edhe një sqarim, zoti deputet.

Kjo vulë, fillimisht është përdorë nga gjykatat. Për shkak të disa keqpërdorimeve dhe mosbesueshmërisë së madhe nga ana e disa shteteve në të cilat punëtorët tanë punojnë, UNMIK-u ka vendosë ta centralizojë këtë vulë.

Kjo vulë është përdorur në kuadër të një departamenti të menaxhuar nga Ministria e Shërbimeve Publike.

Në qershor të këtij viti, ky Departament bartet në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ne jemi duke shikuar që përdorimi i kësaj vule të përdoret nëpër regjione, assesi nëpër komuna, sepse nëpër komuna është një staf i madh i punëtorëve që nuk na mundëson të kemi buxhet për këtë staf, nuk kemi mundësi ta rrisim numrin e punëtorëve. Jemi duke shikuar që kjo vulë, paralel me besueshmërinë që ka fituar si institucion, të përdoret nëpër regjione, por jo edhe nëpër komuna. Faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Pyetja e deputetit Fetah Berisha, shtyhet për seancën e ardhshme.

Deputeti Nait Hasani, ka pyetje për Ministrin Jonuz Salihaj. Urdhëroni zoti Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit Kryetar.

Pyetjen e parë nuk më latë ta lexoj, të gjithëve iu dhatë të drejtën dhe bëtë një diskriminim – negativ, jo pozitiv sepse s'ka pozitiv më.

KRYETARI: Por, ne mund ta korrigjojmë atë lëshim! Urdhëroni.

NAIT HASANI: Urdhëroni!? Megjithatë, unë kam pyetje për Ministrin. Më intereson çështja në Burgun e Dubravës. Në të qëndrojnë të gjykuar, por pa argumente – rasti i Kiçinajve, rasti i zonës së Pashtrikut Bedri Zyberaj. Në të dy rastet, prokurori nuk ka gjetur prova. Ndërsa, në rastin Kiçina, prokurori Tomas Hickman deklaroi se provat janë zhdukur në Britani apo në Bullgari.

Të gjitha këto, kanë qenë prova të rrejshme, ose thashethëna dhe pse edhe pas pesë viteve, vazhdojnë të mbesin në burg me prova të rrejshme.

Pyetja:

- Cilat janë arsyet e mbajtjes edhe më tej në burg Kiçinajn? Për çka prokurori ka deklaruar se provat nuk ekzistojnë dhe cilat janë mundësitë e kthimit në rishqyrtim të kësaj lënde në gjykatë.

Unë e kam edhe një dokument, që prokurori ka deklaruar se nuk ekzistojnë provat. Ky dokument është i lëshuar me datën 2. 11. 2004 nga prokurori Tomas Hickman për zhdukjen, asgjësimin apo ku ta di unë çfarë provash që janë bërë në ato procedura. Kërkoj që Ministri të përgjigjet në pyetjen e shtruar.

KRYETARI: Ju faleminderit. Urdhëroni zoti Ministër.

JONUZ SALIHAI: I nderuar Kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë, i nderuari deputet Hasani,

Kemi të bëjmë me një çështje të rezervuar. Çështja e drejtësisë nuk është çështje e Ministrisë së Drejtësisë, as e Ministrisë së Drejtësisë. Unë kam pasur mjaft takime informative, të themi, të informohemi se ku qëndron rasti Kiçina dhe rasti tjetër po ashtu i grupit të Kaçanikut. Mua nuk më lejohet tash para Kuvendit ta them mendimin tim, sepse – thash - është rast i rezervuar, është rast i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar. Mirëpo, nga takimet e mia e di që rasti Kiçina shumë shpejt do të përsëritet dhe sigurisht drejtësia do të dalë në pah. Faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. A keni pyetje shtesë? Urdhëroni. Deputeti Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit.

Falënderoj Ministrin kur thotë se është rast i drejtësisë, por mendoj se edhe Ministri është Ministër i drejtësisë, prandaj duhet që Ministri të na e thotë qartë... Këtu thotë: “Kanaçet e pijeve, të gjetura në vendin e krimeve, janë zhdukur nga dollapët”. A do të kemi ne drejtësi përmes kanaçeve, a? Cilat janë arsyet e mbajtjes së njerëzve në burg përmes provave të rrejshme, përmes kanaçeve?

KRYETARI: Urdhëroni Ministër?

JONUZ SALIHAI: Qeveria është ekzekutiv dhe unë jam pjesë e ekzekutivit, kurse gjyqësori është pushtet i ndarë. Edhe një herë do ta përsëris këtë, që ju, të gjithë e dini.

Ju provat që i keni dhe ata që kanë prova, keni të drejtë. Mu për këtë, prokurori ndërkombëtar, ka vendosur që ky proces të përsëritet dhe sigurisht gjykimi dhe gjykatat do ta bëjnë të veten. Mirëpo, mos e përzieri këtu ekzekutivin.

KRYETARI: Ju faleminderit. Deputeti Berat Luzha ka pyetje për Ministrin Salihaj. Urdhëroni zoti Luzha.

BERAT LUZHA: Tash mbushen 7 muaj qëkur në Gjykatën Supreme të Kosovës, si Gjykatë e shkallës së dytë, është bërë shqyrtimi i lëndës ndaj tre kaçanikasve të akuzuar “për krime të luftës” gjatë luftës çlirimtare në Kosovë. Por, edhe pas kësaj kohe të gjatë, atyre ende nuk iu është dorëzuar vendimi përfundimtar dhe ende sikur mbahen peng të Gjykatës, duke pritur një vendim që duhet të shkruhet për pak çaste. Atyre, në këtë mënyrë, iu pamundësohet t’i shfrytëzojnë disa të drejta të garantuara me ligj.

Duhet thënë që, edhe shqyrtimi i lëndës së tyre në shkallën e dytë në Gjykatën Supreme, është bërë me një vonesë të konsiderueshme.

- Pse po vonohet kaq shumë procedura gjyqësore e shkallës së dytë nga Gjykata Supreme e Kosovës për grupin e Kaçanikut?

KRYETARI: Urdhëroni zoti Ministër.

JONUZ SALIHAI: Është po ashtu, e njëjta përgjigje edhe për këtë rast. Ajo që në këtë rast duhet ta definoj ose ta them para deputetëve është se unë do të kërkoj nga kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ose kryetarin të Gjykatës Supreme, që me shkrim për këtë rast të përgjigjet dhe unë besoj që shumë shpejt do të ndodh kjo dhe zotit Luzha t'ia jap përgjigjen. Mirëpo, edhe ky është i njëjti rast dhe shumë shpejt do të përfundojë, informatat janë, por është rast i drejtësisë, rast i gjykatësve ndërkombëtar. Do të thotë, procesi është në përfundim e sipër dhe shumë shpejt do të përfundojë.

KRYETARI: Ju faleminderit. I kthehem pyetjes së shtruar të deputetes Teuta Hadri Ministrit Idrizi. Pyetja është lexuar. Urdhëroni Ministër, e keni fjalën.

SADIK IDRIZI: Poštovana Teuta Hadri, poštovani poslanici, poštovani predsedavajući, Mislim da se pitanje odnosi na to da se plaća suma za lečenje vani kad bi to moglo da se radi u privatnim klinikama?

Odgovor je: sigurno da je bolje da se to izvrši ovde, međutim te privatne klinike odnosno bolnice još nisu licencirane kod nas.

Mi smo prošle godine u ovo vreme započeli licencu privatnih institucija i administrativno uputstvo za privatne klinike je u pripremi i biće doneto da bi mogle, znači, i privatne bolnice da se licenciraju. Momentalno one nisu licencirane i ne šaljemo pacijente u ustanove koje nemaju licencu. Očekujemo, znači, da ćemo najskorije imati i to. Inače je sigurno maltretiranje pacijenata da idu vani za ono što može da se završi ovde.

Kada bude doneto administrativno uputstvo mi ćemo napraviti ugovore i sa ovim bolnicama pa ćemo pacijente, za ono što se može lečiti na Kosovu, vršiti ovde. Toliko.

KRYETARI: Faleminderit. A ka pyetje shtesë? Urdhëroni zonja Hadri!

TEUTA HADRI: Zoti Ministër, licenca nuk është lejuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, por ato po punojnë. Ato spitale punojnë dhe ju, nën kompetenca tuaja, keni mundësi që sa më shpejtë t'i lëshoni këto licenca. Pyetja shtesë është:

- Pse po i denigroni kuadrat tona dhe nuk iu jepni mundësinë që ato, pasi kanë paguar edhe 20% më lirë të çmimeve, të shërohen këtu brenda në Kosovë?

KRYETARI: Urdhëroni zoti Ministër.

SADIK IDRIZI: Jedino da ponovim. Znači, te bolnice će biti licencirane, ali licenciranje je započelo prošle godine i bio je rok do kraja avgusta i mi smo u ovom periodu imali preko 600 aplikacija za licenciranje. Svakodnevno, znači, bord dva puta izdaje te licencije. Za bolnice nismo još licencirali, radi se o administrativnom uputstvu, i biće licencirane. Te ustanove imaju licencu, ali ne kao bolnice, imaju kao diagnostički centri ili nešto slično. Dok ne budu licencirane, to nećemo moći, ali ja mislim da ćemo do kraja godine imati kompletno administrativno uputstvo i licencije. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit. Deputeti Berat Luzha ka pyetje për Ministrin Ardian Gjini.

BERAT LUZHA: Unë kam pyetje për ministrin.

- Çka ka bërë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për mbylljen e deponisë së mbeturinave në fshatin Stagovë, komuna e Kaçanikut?

KRYETARI: Urdhëroni zoti Ministër.

ARDIAN GJINI: Faleminderit zoti Kryetar. Zoti Kryeministër, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Fillimi i pyetjes është i saktë, jemi në fazë të përgatitjes dhe hapjes së tenderit për mbylljen e deponisë në fshatin Stagovë, të deponisë së vjetër në Prizren dhe deponisë së vjetër në Gjakovë, si tri deponi të cilat janë identifikuar si më problematike në këtë moment. Do të thotë, kjo është përgjigja fillestare, mirëpo ka edhe elemente tjera të cilat ndërlidhen me këtë pyetje dhe unë falënderoj zotin Luzha që ka ngritur këtë çështje. Këtu është edhe aspekti i bartjes së kompetencave mbi ndërmarrjet pastruese dhe grumbullimit të mbeturinave nga AKM-ja nëpër komuna dhe kemi një pajtueshmëri të gjerë. Mendoj se, edhe me ndryshimin e sistemit të zgjedhjes së kryetarëve të komunave dhe me kompetenca shtesë – kryetarët e komunave do të jenë drejtpërdrejt, ose komunat do të jenë drejtpërdrejt përgjegjëse për pastërtinë e qyteteve. Ky është një hap shumë i mirë, besoj unë, për tërë Kosovën.

Për deponitë tjera shtesë, të cilat i kemi dhe janë problematike, ne do t'i fusim në buxhet në vitin 2008.

Edhe një herë po e përsëris: Deponia në Kaçanik, në fshatin Stagovë, do të mbyllet sivjet. Faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. A ka pyetje shtesë? Nuk ka. Faleminderit.

Ka pyetje deputetja Sala Berisha-Shala për Zëvendësministrin Hajdaraj. Nuk qenka këtu.

Do të vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

- Interpelancë e Ministrit të arsimit, zotit Agim Veliu, me kërkesë të Grupit Parlamentar të ORA-s.

Në pajtim me Rregullën 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit, Grupi parlamentar i Partisë Reformiste ORA, i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë Ministrin e arsimit, zotin Agim Veliu.

Ministri Veliu, i është përgjigjur kërkesës për t'u paraqitur para deputetëve dhe për ta informuar Kuvendin lidhur me zbatimin e Udhëzimit administrativ, të lëshuar nga Ministria e arsimit lidhur me organizimin e arsimit për klasat e pesta.

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 25.2 të Rregullores së punës së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë më së shumti 2 orë.

Në pajtim me Rregullën 25.7 të Rregullores së punës, përfaqësuesi i interpelancës mban të drejtën gjatë fillimit të debatit në kohëzgjatje prej 10 minutash, kurse në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta.

Ftoj përfaqësuesin e parashtrimit të kërkesës së interpelancës nga Grupi Parlamentar të Partisë Reformiste ORA ta marrë fjalën. Fjalën e ka zoti Genc Gorani.

GENC GORANI: Faleminderit zoti Kryetar i Kuvendit. Zotri ministra, anëtarë të kabinetit, zoti Ministër i arsimit, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Në bazë të Udhëzimit administrativ 12/2007, të datës 25 qershor 2007, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka ndërmarrë organizimin e mësimit të klasave të pesta sipas sistemit të ri arsimor, si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e Rregullores për arsimin fillor dhe të mesëm 2002/19.

Brenda një muaji, pas marrjes në dijeni për këtë udhëzim, Partia Reformiste ORA ka analizuar situatën e krijuar së bashku me një numër të prindërve, mësime dhënëse dhe të ekspertëve në këtë lëmi.

Një numër i madh i çështjeve të rëndësishme na sollën në përfundim se në mungesë të një transparence elementare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në lidhje me përgatitjet dhe rrjedhat e reformës së klasave të pesta, duke pasur parasysh edhe kohën jashtëzakonisht të shkurtër para fillimit të vitit shkollor, interpelanca e Ministrit të arsimit imponohet si mënyrë e vetme për të ngritur në nivel të duhur një komunikim të munguar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ndaj këtij Kuvendi.

Organizimi i ri i mësimit në klasat e pesta përfshin mëse 36 mijë nxënës në mbi 1.600 paralele, me 1.600 mësime dhënëse aktual dhe një numër të madh të atyre që do të duhet të punësohen. Rrjedhimisht, një numër i madh i prindërve, mbi 70 mijë dhe i familjeve, janë po ashtu thellësisht të përfshirë në këtë reformë.

Zoti Ministër,

Në paraqitjen tuaj, presim të na informoni mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përgatitjet për zbatimin e reformës për klasat e pesta. Ju lutem të merrni shënim se presim të na informoni konkretisht edhe për pyetje dhe çështje, si vijon:

1. Mbi cilin planveprim për realizimin e reformës së klasave të pesta jeni bazuar? Kur dhe në cilën instancë, është aprovuar ky plan? Sipas nenit 29 të Ligjit për arsimin fillor, çdo institucion arsimor me fonde publike, ka një këshill të shkollës. Ato përbëhen nga 3 përfaqësues të prindërve, dhe sipas nenit 29.11 këshilli i shkollës mund t'i shprehë pikëpamjet e veta për çdo çështje lidhur me shkollën ose me arsimin fillor apo të mesëm në komunë.
2. Sa takime janë realizuar me këshillat e shkollave dhe në cilin dokument të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë gjenden përfundimet e këtyre takimeve?
3. A ka pasur kërkesa për informim nga prindërit e nxënësve të klasave të pesta dhe - nëse po - cilat kanë qenë kërkesat e tyre dhe çka iu keni përgjigjur?
4. Duke ditur se mësimi në klasat e pesta me sistem të ri, edhe në kushte shumë më të favorshme se këto në Kosovë, është një ndërmarrje komplekse, pse keni sjellur udhëzimin administrativ përkatës aq vonë?

Pra, vetëm 2 muaj para fillimit të vitit shkollor, kur këtë keni mund ta bëni për së paku

një vit më parë.

5. Me vendim të Udhëzimit administrativ 12/2007, nenet 2 dhe 3, përkundër Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, mësuesve të klasave të katërta të vitit shkollor 2006/2007 u merret e drejta që të vazhdojnë me procesin mësimor në klasat e pesta, kurse kjo e drejtë iu jepet mësuesve të cilët ende nuk janë pranuar në institucionet shkollore, së paku në kohën e Udhëzimit administrativ.

Me këtë krijohet një paragjykim për jokompetencë profesionale të mësuesve të deritashëm. Cili është qëndrimi juaj për këtë?

6. Deri në dy javë para fillimit të ri të vitit shkollor, tekstet shkollore për klasat e pesta ishin akoma të pabotuara, së paku jo të gjitha.
A e konsideroni këtë si vonesë, apo ka qenë hap i qëllimshëm i MASHT-it?
7. Sa arsimtarë lëndor të klasave të pesta janë të përfshirë nga mësimi i reformuar në klasat e pesta? Sa prej tyre e kanë humbur vendin e punës dhe sa janë të risistemuar në sistemin e ri shkollore ose gjetiu?
8. Sa arsimtarë të rinj janë punësuar për mbulimin e nevojave të krijuara nga kjo reformë?
Sa prej tyre nuk kanë përvojë paraprake në mësimdhënie?
9. Sa kohë janë investuar në trajnimin e arsimtarëve të rinj. Sa orë, konkretisht, iu është dhënë trajnim për t'u përgatitur për këtë mësim klasor?
10. A është kryer procesi i rekrutimit të mësuesve të rinj? A ka probleme me rekrutimin e mësuesve të rinj? Dhe, së fundi, por jo me rëndësi më të vogël:
11. Na tregoni, zoti Ministër, sa është kostoja e deritashme e zbatimit të reformës dhe sa e parashihni të jetë kostoja përfundimtare?

Të nderuar kolegë deputetë,

I bindur për rëndësinë e temës, ju ftoj që pas paraqitjes së Ministrit, ta zhvillojmë një debat konsekuent dhe përmbajtjesor. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Zoti Ministër, e keni fjalën.

AGIM VELIU: I nderuar Kryetar i Kuvendit, i nderuar Kryeministër, të nderuar deputetë, kolegë ministra, zonja dhe zotërinj,

Reformat në arsim janë jo vetëm domosdoshmëri e kohës por orientim afatgjatë i Kosovës dhe rrugë e vetme drejt një të ardhme më të mirë.

Qeveria e Kosovës e ka deklaruar arsimin ndër tri prioritetet kryesore dhe ky Kuvend e ka mbështetur.

Si rezultat i kësaj, Ministria e Arsimit ka ndërmarrë të gjitha masat për të implementuar këtë prioritet dhe për të ndërtuar një sistem bashkëkohor të arsimit.

Në këtë drejtim, kemi dizajnuar plane dhe programe që pajisin nxënësit me njohuri, shkathtësi dhe shprehje të nevojshme për shekullin 21.

Jemi duke promovuar shfrytëzimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies që motivojnë nxënësit për një përzgjedhje të teksteve më cilësore.

Bazuar në Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, që nga viti 2002, është ndryshuar struktura e sistemit arsimor në Kosovë nga 4-4-4 në 5-4-3 që është pesë vite arsimi fillor, katër vite arsimi i mesëm - i ulët dhe tri vite arsimi i mesëm – i lartë.

Kjo strukturë e re, është në përputhje me sistemin e arsimit në shumicën e vendeve evropiane. Sisteme të tilla të arsimit janë treguar efektive në shumicën e vendeve evropiane, prandaj edhe ky Kuvend është përcaktuar për këtë model përmes aprovimit të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm.

Besoj që ne synojmë të kemi një sistem të krahasueshëm arsimi, prandaj e quaj të drejtë zgjedhjen që ka bërë Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm.

Është e natyrshme që me rastin e implementimit të ndryshimeve të tilla, një numër arsimtarësh lëndor të zëvendësohen me mësues klasor, sepse për ndryshe, është dashur që prerja në mes të dy cikleve të bëhet në klasën e katërt e jo në atë të pestë, siç parashikohet në shumicën e vendeve evropiane.

Të nderuar deputetë,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka qenë e ngarkuar nga ky Kuvend që të implementojë Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, kështu që reforma me klasat e pesta këtë vit shkollor është vetëm vazhdimësi dhe përmbyllje e reformës të filluar me klasën e parë në vitin 2002/2003.

Nxënësit që kanë filluar në klasën e parë në vitin 2002/2003, këtë vit arrijnë në klasën e pestë dhe ne kemi për obligim që atyre t'u ofrojmë arsim sipas strukturës së re.

Deklarimet dhe thirrjet e disa individëve dhe partive politike për të shtyrë implementimin e reformës me klasën e pestë, përbëjnë një mungesë të njohurive mbi rrjedhat e arsimit në Kosovë.

E konsideroj me vend kërkesën e Grupit Parlamentar ORA për interpelancë lidhur me rrjedhat e gjertanishme të organizimit të mësimin në klasën e pestë, por nga deklarimet e tyre dhe disa personave të tjerë, me keqardhje më duhet të them, ka një moskuptim të procesit të reformave arsimore dhe implikimeve të atyre reformave.

Unë jam plotësisht i vetëdijshëm se kjo reformë ka implikime të cilat janë të dhimbshme, mirëpo në asnjë moment nuk mund të rrezikojmë arsimimin e rreth 173.000 nxënësve në klasat 1 deri 5 në arsimin fillor për shkak se në disa komuna disa arsimtarë mund të mbesin jashtë sistemit arsimor.

Në këtë drejtim, dua të falënderoj Sindikatën e arsimit, shkencës dhe kulturës që ka pasur mirëkuptim për rëndësinë e arsimit të gjithë këtyre nxënësve, karshi një numri të arsimtarëve që mund të mbeteshin të papunë si rezultat i kësaj reforme. Kjo mendoj se tregon një vetëdije dhe gatishmëri të SBASHK-ut për reformat në arsim, e cila vetëdije dhe gatishmëri duket se ka munguar tek disa individ dhe ndonjë parti politike duke u bazuar gjithherë në deklarimet e tyre gjatë muajit gusht.

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të theksoj se, nuk qëndrojnë pohimet e disave që Ministria e Arsimit nuk i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmbyllur me sukses ciklin e reformës me klasën e pestë.

Së pari. Në përputhshmëri të plotë me Ligjin e arsimit fillor dhe të mesëm, Ministria e Arsimit ka nxjerrë Udhëzimin administrativ 12/2007 të datës 25.06.2007 i cili përmban të gjitha udhëzimet e nevojshme që kanë të bëjnë me organizimin e mësimi në klasën e pestë. Sipas këtij Udhëzimi, klasën e pestë e udhëheq mësuesi klasor me përgatitje profesionale për mësimdhënie në shkollën fillore.

Ky Udhëzim administrativ është nxjerrë, po ashtu me kërkesën e drejtorive komunale të arsimit, për të pasur një qasje të drejtë dhe unike në pranimin e kuadrit mësimor në klasën e pestë.

Së dyti. Planprogramet për klasën e pestë janë publikuar qysh në janar të vitit 2006. Pra, ky është Planprogrami për klasën e pestë, që është publikuar në janar të vitit 2006 bazuar në Udhëzimin administrativ 6/2006 të datës 20 janar 2006 dhe është shpërndarë në të gjitha shkollat e Kosovës.

Së treti. Gjatë vitit shkollor 2006/2007 janë hartuar edhe tekstet mësimore për klasën e pestë bazuar në ato planprograme të cilat kanë qenë në dispozicion të nxënësve para fillimit të këtij viti shkollor.

Së katërti. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka bërë trajnimin e mësimdhënësve për klasën e pestë në secilën komunë. Ky trajnim është bërë nga hartuesit e planprogrameve dhe disa nga autorët e teksteve shkollore.

Së pesti, dhe ajo që është me shumë rëndësi dhe për të cilën është folur shumë. Komunitat kanë zgjedhur kuadrin arsimor për klasën e pestë në pajtim me Udhëzimin administrativ 12/2007.

Sipas raporteve që kam pranuar nga drejtoritë komunale të arsimit, me kënaqësi deklaroj se i gjithë kuadri arsimor, që është i kualifikuar, është përfshirë në procesin arsimor, me ndonjë përjashtim të vogël. Ky ka qenë një premtim të cilin unë e kam bërë para arsimtarëve të kualifikuar dhe i cili tani është realizuar.

Prandaj, nuk qëndrojnë deklaratimet pompoze të disa individëve në lidhje me largimin e arsimtarëve të kualifikuar si rezultat i reformës me klasën e pestë.

Ministria e Arsimit ka grumbulluar të dhëna nga secila komunë në lidhje me numrin e arsimtarëve që nuk iu janë vazhduar kontratat dhe atyre që janë angazhuar për herë të parë gjatë këtij viti shkollor.

Për vitin shkollor 2007/2008 janë angazhuar, për herë të parë, afër 850 mësimdhënës, të cilët janë angazhuar në bazë të konkursit gjatë muajit gusht.

Të nderuar deputetë,

Reformimi dhe arritja e një sistemi arsimor efikas dhe cilësor, është objektiv i Ministrisë që unë drejtoj. Besoj se ju e keni parasysh që arritja e këtij objektivi bëhet në afat të gjatë dhe është shumë kompleks. Rezultatet e kësaj reforme me arsimin fillor priten të shihen kur do të kemi arritje më të larta në testin kombëtar të këtyre nxënësve, kur ata të arrijnë në klasën e

nëntë, kur do të kemi nxënës më të përgatitur që vijojnë mësimin në arsimin e mesëm – të lartë dhe në arsimin universitar.

Besoj se të gjithë e kemi të qartë që nuk ka alternativë tjetër përveç implementimit të plotë të klasës së pestë. Nëse kjo klasë nuk do të ishte implementuar këtë vit, atëherë do të shembej i tërë sistemi arsimor i ndërtuar që nga viti 2002, gjë që, nuk dua të besoj se është kërkesë e Grupit Parlamentar ORA.

Nga kjo perspektivë, është i pakuptueshëm insistimi për shtyrje të zbatimit të Udhëzimit administrativ 12/2007 që është vetëm kornizë për të mundësuar realizimin e kësaj reforme.

Megjithë dallimet në qëndrimet dhe bindjet që mund t'i kemi në mes veti, jam i bindur se arsimi është prioriteti ynë i përbashkët. Arsimi gjithnjë zhvillohet në një kontekst ekonomik e shoqëror, prandaj nuk duhet pritur që në arsim të realizohen standarde që tejkalojnë mundësitë tona materiale.

Mund t'ju them se klasa e pestë ka qenë mjaft e kushtueshme për buxhetin e Kosovës, por kjo është një domosdoshmëri dhe obligim që kemi ndaj fëmijëve tanë.

Qeveria e Kosovës dhe Ministria që unë drejtoj janë të përkushtuara që këtyre fëmijëve t'iu sigurojnë arsim cilësor dhe sipas standardeve më të mira ndërkombëtare, si rrugë e vetme për një të ardhme të sigurt të tyre dhe të shoqërisë kosovare për vitet në vijim.

Këtu u përmendën edhe këshillat e prindërve. Ministria e Arsimit ka themeluar Këshillin kombëtar të prindërve. Këshilli kombëtar i prindërve është përfshirë në gjithë këtë proces dhe nuk kemi asnjë vërejtje nga ta. Këtu bëhet fjalë për një Këshill paralel të prindërve, nëse mund ta quaj ashtu. Është fjala për një Këshill të prindërve, përbërja e të cilit është rastësisht, rastësisht të gjithë janë nga një shkollë, rastësisht të gjithë janë nga një klasë dhe rastësisht në fund – të gjithë janë nga një parti. ORA-a!? (I drejtohet asaj).

KRYTARI: Ju faleminderit. Ftoj shefin e Grupit Parlamentar të LDK, zotin Gashi, ta marrë fjalën.

ALUSH GASHI: Faleminderit zoti Kryetar.

Arsimi është prioriteti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e vetëdijshme se fati i zhvillimeve të gjithmbarshme në Kosovë varet nga niveli i zhvillimit të diturisë dhe aplikimi i drejtë në jetë.

Ne pranojmë përgjigjen e zotëriut Ministër i arsimit, një përgjigje e thuktë në pyetje, e cila më tepër shtrohet në kuadër të fushatave, sepse pyetjet dhe akuzat natyrisht nuk kanë ndonjë përmbajtje.

Lidhja Demokratike e Kosovës angazhohet dhe mbështet Ministrinë, e cila natyrisht do ta vazhdojë punën edhe në mandatin e ardhshëm, sepse LDK-ja do t'i fitojë zgjedhjet sepse këtë që e bën ORA bëhet për qëllim fushate, që të ngritet cilësia në të gjitha nivelet e arsimit.

Ne kemi mbështetur dhe do ta mbështesim ngritjen e standardeve në arsim në të gjitha nivelet dhe mirëqenien e arsimtarëve në tërësi.

Mbështetjet e investime në arsim, janë reale dhe në të gjitha fazat e punës sonë, ky ka qenë një përkushtim i sinqertë. Nuk ka qenë pjesë e asnjë fushate, por ka qenë një përcaktim yni

dhe mburremi me të arriturat qoftë në rindërtimin fizik të institucioneve të arsimit, qoftë në trajnime, qoftë në ngritje të vetëdijes për pjesëmarrje në shkollim në të gjitha nivelet.

Krahas kësaj, zoti Kryetar, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës insiston që ligji të zbatohet me përpikëri. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. E ka fjalën përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Urdhëroni zoti Hoxhaj.

ENVER HOXHAI: I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit, i nderuar zoti Ministër, Ministër Salihaj, të nderuar deputetë,

Tema, për të cilën ne bisedojmë sot, është e një natyre të veçantë, i një shqetësimi të veçantë. Më lejoni që, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të bëj me dije që Partia Demokratike e Kosovës ka qenë skajshmërisht e interesuar që procesi i reformës të vazhdojë në rrugën sikur ka filluar.

Asnjëherë unë nuk di që në mjetet tona të informimit ka pasur parti politike ose individ të cilët kanë kërkuar që të mos implementohet klasa e pestë. Me atë, Ministri, nuk e di se kujt i referohet.

Shqetësimi ynë mund të përmblihet në dy rrafshë. Rrafshi i parë ka të bëjë me organizimin e klasës së pestë.

Dhe, më lejoni vetëm t'ju bëj me dije një historik të shkurtër.

Në vitin 2001 është miratuar dokumenti Kornizë korikulë. Dhe çdokush, që e njeh dokumentin Kornizë korikulë, e ka pasur të qartë se në vitin 2007 do të ballafaqohet me klasën e pestë. Prandaj, përgatitjet kanë mund të ndodhin jo në muajt e fundit, është dashur të ndodhin shumë më herët.

Në vitin 2003/2004, është bërë regjistrimi i nxënësve të klasës së pestë. Çdokush që atë vit e ka ditur se çka po ndodhë me sistemin arsimor në Kosovë, është dashur ta ketë të qartë që në vitin 2007 shkollor duhet të ndodhë një gjë e tillë. Dhe, ky është shqetësimi i Partisë Demokratike të Kosovës.

Tek, më 26 qershor të këtij viti, Ministria nxjerr një Udhëzim administrativ për klasën e pestë. Dhe këtu nuk kemi të bëjmë me muaj, këtu kemi të bëjmë me dallimin me vite. Do të thotë, edhe organizimi i klasës së pestë është një shqetësim, të cilin ne e kemi ngritë. Dhe, në kohën kur e kemi ngritur, ka qenë seanca e Kuvendit të Kosovës, më 23 maj, kur njëri prej rekomandimeve që ka dalë nga të gjitha grupet parlamentare ka qenë pikërisht rekomandimi që ka të bëjë me klasën e pestë. Ministrisë i është dashur që të kalojë një muaj pas kësaj seance e që të paktën ta nxjerrë një udhëzim administrativ.

Mendoj që, për nxënësit, për prindërit që i kanë nxënësit në shkollë, kjo histori e shkurtër tregon se çfarë nënkupton historiku i klasës së pestë dhe nuk ka fort të bëjë me disponimin aktual, ka të bëjë me një gjendje faktike.

Më 1 gusht, ka reaguuar Partia Demokratike e Kosovës. Më 10 gusht, Ministria e Arsimit, këtu e kam raportin që ka dalë në ueb-faqe të Ministrisë së Arsimit, i ka ftuar drejtorët e drejtorive komunale me një pyetje shumë klasike: – Çfarë të bëjmë me klasën e pestë. Me 1

gusht kemi reaguar ne, më 10 gusht ka reaguar Ministria e Arsimit, dhe përmes raportit ju e kuptoni çfarë sfida ka arsimi.

Mendojmë se klasa e pestë është pjesë kyçe e reformës në sistemin arsimor dhe duhet të zbatohet. Unë falënderoj Ministrin që t'paktën e definoi se çka është klasa e pestë. Por të paktën si Ministër, që është edhe për arsim edhe për shkencë, kur ta definojë duhet të paktën të thotë se “e citoj” një dokument. Ky e citoj dokumentin Kornizë korikulare pa thënë se “e citoj” atë dokument. U krijua përshtypja që është definim i tij. Ai është definim i dokumentit kornizë, kështu që të paktën duhet ta respektojë një metodologji të komunikimit normal modern, që kur thotë “e citoj – e citoj”.

Pa hy në shumë detaje dhe pa debatuar për shumë çështje, më lejoni t'i ofroj disa rekomandime se si dilet prej situatës, si të ndihmojmë nxënësit ose si të ndihmojmë prindërit.

E para që, që kërkoj, është kjo:

Njërin prej dokumenteve esenciale, që ka arsimi në Kosovë është dokumenti Kornizë korikulare. Lus Ministrinë e Arsimit ta miratojë. Asnjëherë s'e ka miratuar. Nuk është dokument zyrtar!? Lus Ministrin e arsimit, mu sot, ta miratojë dokumentin Kornizë. Nëse s'e ka të ditur, është mirë t'i pyes njerëzit që i ka në Ministri - pse deri më tash s'e ka miratuar.

Sistemi ynë shkollor nuk mund të imagjinohet pa dokumentin kornizë. Imagjinoni, e kemi një dokument i cili nuk është ende dokument zyrtar!

Kërkoj nga Ministria e Arsimit që t'i zbatojë ato 17 rekomandime, të cilat kanë dalë nga seanca e Kuvendit të Kosovës – që merren me klasën e pestë dhe që merren edhe me çështjen e arsimtarëve për licencimin e arsimtarëve.

Kërkoj nga Ministria e Arsimit që të vazhdojë trajnimin e arsimtarëve. Unë nuk e di që ka ndodhë trajnim i mirëfilltë i arsimtarëve. Klasa e pestë është një temë shumë më komplekse sesa mendojmë dhe gjatë tërë vitit shkollor, të paktën, në gjysmëvjetorin e dytë, nxënësit ta kenë mundësinë që ta rrisin kualitetin e arsimit, në krahasim këtë ekzistues.

Dhe, kërkesa jonë e fundit është:

Deri në fund të shtatorit, Ministria e Arsimit, të hartojë një raport. Këtë raport t'ia ofrojë Kuvendit të Kosovës për klasën e pestë. Cilat janë sfidat, në këto tri shtylla. Shtylla e parë është mësimdhënia, qysh zhvillohet mësimdhënia në klasën e pestë. Shtylla e dytë është – mësimzënia, sa kanë pasur nxënësit mundësi gjatë një muaji vërtet ta ndjekin klasën e pestë. Dhe, e treta, është – vlerësimi i dijes.

Ma merr mendja, deri në fund të shtatorit, një raport i tillë duhet t'i afrohet Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit për vëmendjen.

KRYETARI: Ju faleminderit. Ftoj përfaqësuesin e AAK, Mazllom Kumnova.

MAZLLOM KUMNOVA: Zoti Kryetar,

Kërkesa për interpelancë për çështje të arsimit gjithnjë është mirëpritur nga ne si një kontribut i drejtpërdrejt që i bëhet arsimit në Kosovë dhe ashtu e kuptojmë, pa marrë parasysh se nga i cili grup parlamentar ngritet si çështje për diskutim.

Pra, edhe sot, kur po debatojmë për një cilësi të ngritur, më konkretisht, vetëm për klasat e pesta, që mua ma merr mendja, është keqdefiniuar. Klasa e pestë është vazhdim i shkollës fillore, është një situatë ekzistuese. Ne nuk mund të flasim vetëm për një situatë ekzistuese. Duhet të flasim për një tërësi, siç është shkolla fillore. Mendoj se kjo reflekton në tërë procesin e arsimit, sidomos të atij fillor dhe nuk bën të merret si problem i shkëputur nga tërësia e procesit të arsimit dhe edukimit në Kosovë.

Pra, sot po ballafaqohemi me procesin e reformës në arsim, të cilin e kemi filluar para katër viteve. Njëkohësisht duhet të jemi të bindur se çështja e ngritur sot, nuk bën të minimizohet vetëm me probleme se çfarë duhet të bëjmë me ata mësime të mësimdhënës që mbetin pa punë dhe kërcënohen që mund të largohen nga shkollat tona. Ne mendojmë se Ministria është e vetëdijshme që nuk guxon të ndodhë kjo.

Për të shqyrtuar dhe marrë në konsideratë situatën e krijuar, problemi na duket është më i thellë dhe hapë një pamje të mangësive në procesin e reformës së arsimit në disa situata të veçanta.

Për këtë çështje që po diskutohet sot, do të duhej të fillojnë përgatitjet shumë herët, që në start të reformës – domethënë para katër viteve, atëherë kur ka filluar reforma.

Duhet të pranojmë se gjatë këtyre viteve të reformës shkollore, jemi përqendruar shumë më tepër në plane, në programe dhe tekste shkollore. Janë anashkaluar problemet tjera, të cilat janë si për shembull: mësimdhënia, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e Qeverisë, e mësuesve, e prindërve të cilët sfidojnë dhe janë pjesë përbërëse e reformës. Nuk mund të ndërveprojnë aktualisht me njëri-tjetrin, nëse ajo nuk është planifikuar mirë që nga fillimi.

Për këto mangësi, ose si thuhet, në raste të tilla të dështimit të procesit të ndryshimit, nuk kërkohet ndonjë ekspertizë, sepse atëherë faktikisht bëhet pjesë e procesit si pasojë e mospërgatitjes me kohë.

Ne mendojmë se për këtë vit shkollor nuk mund të ndryshojmë asgjë, përveç asaj që ka filluar të realizohet dhe mënyrën si i është qasur kësaj çështje ose kësaj situatë të veçantë, sepse në reforma sfidojnë situata të veçanta.

Duhet kuptuar se po të angazhohim mësuesit e klasave të katërta të përcjellin edhe klasën e pestë, do të ekzistonin dy janë probleme, të cilat i veçoj.

E para, sikur të hapeshin vende të reja të punës për të gjitha klasat e para, dhe të merrej mësues a mësuese pa përvojë e menjëherë ta drejtonte klasën e parë pa përgatitje, kam shqetësime se Ministria e Arsimit do ta bënte një gabim të madh.

Unë mendoj ashtu, duke u nisur nga ai fakt, se gjithnjë klasa e parë është një sfidë edhe për mësueset dhe mësuesit me përvojë.

E dyta. Zgjidhja që është bërë nga Ministria, është zgjidhje e momentit të fundit. Ndoshta do të duhej që nga fillimi i vitit të kaluar shkollor të aftësohen mësues për klasa të pesta duke u nisur nga fakti se ka edhe të tillë të profilizuar me shkollë normale e me drejtimin e mësuesisë, që përkohësisht do ta kryenin këtë angazhim deri te një zgjidhje sistemore çfarë e parasheh edhe reforma.

Hapja e kohëpaskohshme e problemeve të arsimit në këtë Kuvend, mendoj se çon drejt asaj se duhet pranuar që së pari s'ë kemi filluar këtë reformë të papërgatitur si shoqëri. Kjo bëhet edhe më bindëse, kur marrim parasysh edhe rrugën që ka ndjekur shkolla jonë në dekadën e fundit të shekullit 20, e ndodhur nën terrorin serb.

Nxitimi për të hyrë në reforma pa krijimin e kushteve të domosdoshme që kërkon zhvillimi i një reforme, në çdo veprimtari shoqërore, e sidomos në arsim, prodhon probleme komplekse me të cilat duhet të merremi seriozisht. Këtë nuk e kemi bërë.

Është kohë e fundit që duhet bërë një analizë serioze e reformës së arsimit me të gjitha sukseset dhe mossukseset. Shkurt, duhet shikuar se si po funksion ky ndryshim brenda arsimit dhe të planifikohet e ardhmja e arsimit në Kosovë me arsim bashkëkohor që i duhet fëmijëve tanë, që i duhet identitetit tonë dhe proceseve tona formuese. Deri tani, nuk e kemi bërë këtë. Do të jemi të papërgjegjshëm nëse këtë nuk e bëjmë sa më shpejt sepse mund të rrezikojmë që reforma të dështojë në tërësi.

Tani na duhet një përpjekje duke u nisur nga bindja se sukcesi i reformës së arsimit është i mundshëm dhe i domosdoshëm. Na duhet një studim – analizë me kompetencë ku mund të konstatohet që një situatë e caktuar ka ndryshuar dhe kështu situata ka sot në arsimin tonë që përfaqësojnë një përmirësim të mirë nga gjendja e mëparshme dhe ka ndryshuar në një gjendje të re. Pos kësaj, ka edhe situata të caktuara që nuk kanë ecur me reformën dhe ka dështuar. E kam fjalën për situata e jo për tërë sistemin. Prandaj, duhet një strategji për të vepruar. Kjo qasje e bën të pranueshme dhe reale, se reforma e suksesshme është e mundshme edhe në kushte të vështira që po kalon Kosova.

Na shqetëson efekti edhe i kësaj interpelance. Çfarë doli nga debati për arsimin që është mbajtur në muajin maj, çfarë do të dalë nga kjo interpelancë. Është përgjegjësi e këtij Kuvendi të nxjerrë disa detyrime për Qeverinë por edhe për veten për një rishikim të reformës së arsimit. E kemi Komisionin për arsim, mund ta zgjerojmë me ekspertë të tjerë.

Reforma e sistemit të arsimit përmbillet në këtë vit shkollor, por procesi i ndryshimeve që synon përmirësim, duhet të vazhdojë drejt ndërtimit të vazhdueshëm të një realiteti të ri në arsim.

Meqë kemi hyrë në fazën e emocioneve të fushatës zgjedhore dhe pati diskutime në këtë frymë, besojmë se e dimë që ndryshimi i forcave të pushtetit në asnjë mënyrë nuk garanton se do të ndryshojnë edhe gjërat tjera.

Duhet të jemi të ndërgjegjshëm për këtë dhe kemi shansin bile arsimit t'i japim një mbështetje serioze me elemente të trynisë dhe ta realizojmë synimin tonë kryesor.

Si Grup, mbështesim fjalën e Ministrit, duke kërkuar përgjegjësi, përgjegjësi ndoshta, për shkak të nxitimit nga qeveria e mandatit të kaluar. Ju faleminderit.

KRYTARI: Ju faleminderit. Nga ORA Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Ne, si Grup Parlamentar, më herët kemi marrë fjalën. I nderuar Kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra....

KRYETARI: Më falni, ju veç e paskeni marrë fjalën më parë si Grup. E ka fjalën Mahir Jagcilar.

MAHIR JAGCILAR: I nderuar zoti Kryetar, Sayın Başkan, sayın bakanlar ve milletvekilleri Eğitim, her toplumun en önemli alanlarından biridir. Bundan dolayı bir ülkenin kalkınması açısından kaliteli eğitimin sağlanması için, kaliteli ve genç kadoların yetiştirilmesi herşeyden önemlidir. Ancak azınlık toplulukların buna gereksinmesi daha da belirgindir.

Kosovadaki Türk ve topluluğu, eğitimde kaydedilen belirli başarılı adımlarına rağmen kadro sorunu, Türk dilinde kitapların olmayışı, gereken standartlara sahip olmayan sınıflarda eğitimin sürdürülmesi ve diğer eğitim altyapı koşullarının olmayışı açısından bazı sorunlarla hala karşılaşmaktadır. Ancak bu fırsatla en güncel sorunlardan biri olan yeni öğretmenlerin işe alınmasına parmak baskam istiyoruz. Bize göre kabul kriterilerine tam olarak saygının gösterilmesi ve Prizren Eğitim Fakültesini tamamlayan öğrencilere bütçenin sağlanmasına öncelik verilmelidir.

Ancak mevcut olan zayıflıkların gelecekte ortadan kaldırılacağına ve Kosovadaki eğitimin daha kaliteli olacağına inanmaktayız. Ayrıca Türk ile Boşnak dilleri üzere eğitime sunulan desteğin devam edeceğine inanıyoruz. Çünkü söz konusu topluluklar, kendi bünyelerinde barındırdıkları nitelikleri itibariyle ayakta kalacak ve ortak eğitime entegre olarak kendi anadilleri üzere eğitimlerini sürdürecektir.

Bundan dolayı Eğitim Bakanı ve Bakanlığının, eğitimin kaliteli olmasına sundukları katkı dolayısıyla selamlıyor ve Türk ile Boşnak dilleri üzere eğitimde mevcut olan sorunların çözümlenmesine daha büyük desteğin sunulacağına inanıyoruz. Dikkatinize teşekkürler.

KRYETARI: Faleminderit. Nga Grupi për integrim Vezira Emruš.

VEZIRA EMRUŠ: Pozdravljam sve prisutne, radno predsjedništvo, ministre i gospodu poslanike,

U ime Grupe za integraciju, ovo je jako osjetljiva tema te bih ja više govorila i u ime svoje Grupe i u svoje ime.

Kada je u pitanju samooobrazovanje i reforma za peti razred, mi se gore u Dragašu suočavamo sa još većim problemima kada je u pitanju jezik.

Pored ovih problema koje tamo na terenu imamo, ova reforma, koja je jako kasno – jako kasno, i jako kasno je došla od strane Ministarstva, od strane MONT-a, tako da je napravila još jednu haotičnu situaciju u Dragašu.

Ja ću iskreno da vam kažem šta se tamo dešava. Gospodin ministar je posetio našu opštinu i jednostavno, mi znamo svi, kada je u pitanju jezik da je tamo školovanje na bošnjačkom, srpskom, albanskom, i to je multietnička sredina. Meni je žao, što se ministar obraća predsjedniku, jer ja sam ministra zvala na Komisiju a nije imao vremena da se javi, pa koristim ovu priliku, rekla sam, u svoje ime.

Ovako, šta znači reforma za peti razred? Mi imamo osnovno obrazovanje. Ta reforma je došla jako kasno. U potpunosti podržavam Grupu ORA, i da je to za sada u školstvu nepotrebno, da se svaki plan i program za obrazovanje, znači svaka vlada ima usvajanje plana i programa za obrazovanje i svaka vlada ima plan i program za reformu kada je u pitanju obrazovanje. Da li smo mi ovde usvojili plan i program reforme, pa da se radi na toj reformi za peti razred?

Ja çu da vam kažem jedan primer sa terena. U selu Restelica, neću da kažem ime i prezime tog nastavnika, šta se tamo dešava. Nastavni kadar, koji je školovao decu do sada, koji je držao peti razred, dobijao otkaz i na isto to radno mesto prima se učitelj koji je bio slab učenik i koji ne zna sam tablicu množenja, a kako će da nauči peti razred. Samo to hoću da vam kažem, jer mi tamo poznajemo jedni-druge, znamo okruženje gde živimo i šta se dešava. Da li je sada ovo politička kampanja neke velike partije da se smene ljudi i da se ponovo zaposle drugi ljudi? Koje je ovo partijsko udvaranje, hoću ja da znam. Da li je to udvaranje Grupe ORA ili je to više udvaranje ove većinske partije kada na smenu dolaze ovakve stvari – reforma a školska godina je počela. Molim vas, to je moje mišljenje. Zahvaljujem se.

KRYETARI: Ju faleminderit. E ka fjalën deputeti Ramadan Kelmendi, nga LDD.

RAMADAN KELMENDI: Faleminderit. I nderuar Kryetar, të nderuar ministra prezent, deputetë të respektuar,

Grupi i LDD shikon hapjen e kësaj teme si temë me rëndësi dhe interes të përgjithshëm dhe vetëm nga këndi i interesit të nxënësit dhe reformës shkollore e ka trajtuar dhe do ta trajtojë.

Natyrisht, pa pretendime politike dhe kualifikime, arsimi është shtyllë e rëndësishme dhe duhet të mbetet një ndër shtyllat më të rëndësishme të shoqërisë kosovare, sepse pa arsim dihet në çfarë niveli do të jetë dhe do të ishte. Andaj, ne vlerësojmë se arsimi nuk ka vend për t'u keqmenaxhuar ose të keqinterpretohet, sepse reforma në arsim është e domosdoshme. Mirëpo, ne kosovarët me arsim bukur shumë jemi keqtrajtuar në të gjitha reformat e deritanishme.

Së pari do të them se Grupi ynë i LDD vlerëson se para se t'i hyhet reformës shkollore, në rastin konkret – reformës së klasës së pestë, duhet bërë analiza profesionale të cilat në kuadër të kësaj reforme mendojmë se mungojnë.

Së dyti. Cili është qëllimi i reformës pikërisht i klasës së pestë, e cili është vazhdim i shkollës fillore dhe këto ndarje, në kuptimin edhe formal, juridik, pedagogjik po edhe didaktik, do të duheshin bërë. Kushtet në të cilat bëhen reformat, a janë plotësuar, në të gjitha kuptimet e analizave profesionale dhe në harmoni me qëllimet që duhet arritur, sepse pa zbërthimin e tyre dhe kompaktësinë e tyre njëra me tjetrën nuk do të dhënë efekte të duhura. Natyrisht se niveli pedagogjik, didaktik dhe psikologjik për të ndihmuar këtë proces dhe prindërit - ka munguar, sikur që mungojnë edhe elaboratet për kuadrat e sistemuara me punë në klasat e pesta dhe jep të kuptojmë se vërtetë një numër i madh i arsimtarëve që kanë punuar paraprakisht nuk kanë pasur të qartë ardhmërinë e tyre në procesin arsimor, disa edhe kanë mbet rrugëve dhe këto janë problemet.

Kyçja shtesë e interesave në këtë reformë, nuk do të reflektohet me procese pozitive.

Megjithatë, ndonëse ne si shoqëri kemi pësuar shumë nga reformat e të gjitha niveleve, reforma duhet të jetë në harmoni edhe me tekstet mësimore, gjë që nuk është përcjell ngase është vetëm rishtypur apo ribotuar me disa emra dhe kjo materie, ata që i kanë nxënësit në këtë klasë, sikurse edhe unë, e shohin se kjo reformë për klasën e pestë jo vetëm që është dashur të bëhet tani, e që është dashur të bëhet edhe më herët, por pikërisht tani nuk kanë qenë kushtet e krijuara dhe ne si prind, si klasë dhe i nxënës, do të kemi vështirësi.

Shpresojmë se kjo do të tejkalohet, por nuk jemi për reforma të nxituara, të paplanifikuara dhe pa profesionalizëm. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku. Le të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU: Kryetar, nëse bën ta respektojmë rendin. Shefja e Grupit e ka kërkuar fjalën, përndryshe unë mundem me vazhdua, s'ka problem.

KRYETARI: Në emër të Grupit ka folur Genc Gorani.

FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU: Mirë, faleminderit zoti Kryetar.

Edhe unë, po lajmërohem kësaj radhe në cilësinë e prindërit, sepse dëgjova këtu për Këshillin kombëtar të prindërve dhe gjëra të ngjashme.

Do t'ju them, si prind, se fare nuk qëndron që vetëm prindërit që janë nga kjo parti kanë pasur shumë drojë se kjo nuk ka qenë moment për t'i hyrë kësaj reforme dhe për këtë do t'i tregoj disa prej argumenteve.

Njëra arsye ishte që, në përfundim të klasës së katërt të fëmijëve, fare nuk jemi ftuar si prindër, që ka qenë rregull për çdo vit së bashku të kuptojmë për suksesin e nxënësve me mbledhje përfundimtare, por suksezi dhe librezat iu janë dhënë fëmijëve pa i ftuar prindërit mu për shkak të asaj që prindërit të mos japin vërejtje aty për aty, sepse kjo është përfolur shumë.

Qysh në qershor, në seancë plenare, ia kam shtruar pyetjen ministrit: “Ministër, po flitet se do të hyni në reforma. A është kjo e sigurt?”. Dhe, kam marrë përgjigje që “të mos ngutemi ne me konkludime se ende asgjë e sigurt nuk është në atë drejtim”.

Pse është e gjithë kjo brengosje? Askush nuk është kundër ligjit dhe fillimit të zbatimit të ligjit, por ne, në mënyrë të sigurt dhe të vendosur jemi kundër hyrjes në reforma në mënyrë stihike – improvizuese.

Kur po flitet këtu, shtrohet pyetja, reforma dihet si është kuptuar. Mësuesi i cili e ka përcjell prej klasës së pestë ta përcjellë deri në klasën e pestë. Prandaj, pyes: a s'ka qenë asnjë mësues me përgatitje adekuate profesionale. Ose, në anën tjetër siç flitet, që mësuesit që janë pranuar tash në konkursin para dy muajve, a të gjithë ata është dashur të shkollohen dhe të janë të gatshëm ta marrin klasën e parë. Jo, nuk janë përgatitur që të hyjnë në reformë dhe ta marrin menjëherë klasën e pestë. Prandaj, habitem se si mund të shtrohet dilema se a janë të gatshëm mësuesit që kryejnë fakultetin e edukimit të fillojnë me klasat e para.

Çështja e trajnimit. Ministri nuk u përgjigj – sa ka qenë trajnimi i kuadrit që është pranuar. Të gjithë e dinë se s'ka pas trajnim. Edhe nëse ka pasur, ka qenë disaditor, sepse s'ka pas afat. Cili është ai trajnim le të përgjigjet këtu Ministri, dhe sa janë përgatitë.

Si në loto është kjo, kush prej neve ka pasur fat që t'i zëvendësohet mësuesi, i cili ia ka përcjell fëmijën katër vite, tash është në klasën e pestë.

Ministri e përmendi suksesin që do ta kenë këto gjenerata të cilat kanë hyrë në këtë mënyrë stihike dhe vonë. Unë po i them ministrit se nuk e njeh psikologjinë e fëmijëve fare, sepse

është dashur të konsultohet edhe me psikolog. Është e sigurt që kur bëhen në këtë mënyrë, kur hyhet në tri vite e t'i ndërrohet kujdestari fëmijut, të katërtën e ka një mësues, në të pestën një mësues tjetër kujdestar, në të gjashtë tjetër. Kjo ka treguar kudo që është hyrë në reformë dhe që ka treguar dështim, do të thotë suksesi ka qenë shumë më i vogël i atyre nxënësve kudo që janë bërë këso improvizime.

Ministri duhet ta njohë edhe psikologjinë e fëmijëve. Nëse nuk e njih, është dashur të konsultohet edhe me ekspertë.

Ne pyesim, sa ka kushtuar kostoja. Ministri tha, ka qenë e kushtueshme reforma. Normal, kur të bëhet me improvizime, kostot janë shumë më të larta.

Planprogrami, mund të them se edhe fëmijët e kanë vërejtur, ka shumë përsëritje, dhe është një kamuflim, një program shpejt e shpejt i hartuar dhe fëmijët të jenë faktikisht në një klasë, që nuk ka qenë për momentin që ai planprogram ta kenë tamam që i takon klasës së pestë.

Zoti ministër,

Ne, si Parti, që në fillim ju kemi shtruar pyetjen shumë konkrete, prandaj edhe kemi pritur përgjigjen. Ju na keni detyruar të marrim fjalën, sepse në fjalën tuaj kemi parë se keni pasur një material të përgatitur fillimisht dhe nuk keni qenë në gjendje aty për aty të jepni përgjigje konkrete. Prandaj, ju lusim që kur ta merrni fjalën përmbyllëse t'na i jepni ato përgjigje të cilat ne i kemi shtruar sepse tek e fundit interpelanca e ka atë qëllim, të shtrohen pyetje, të merren përgjigjet dhe të merret një përfundim. Faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet deputetja Zylfije Hundozi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit zoti Kryetar. Të nderuar kolegë deputetë, i nderuar Ministër i arsimit,

Edhe gjatë kësaj interpelance dhe në kuadër të asaj që patëm mundësinë të dëgjojmë nga fjala e Ministrit u paraqit bindshëm dhe arsyeshëm e gjithë pasqyra e aktiviteteve që ka bërë Ministria e Arsimit që nga fillimi i parë i ndryshimeve në reformë në arsim e deri te ky i fundit që u shtrua sot si temë – agjendë e kësaj interpelance dhe unë mendoj se strategjia dhe hapat që ka bërë Ministria e Arsimit, edhe pse ka pasur vështirësi në këtë ecuri dhe duhet pasur konsideratë se nuk kanë qenë të lehta. Mirëpo, unë mendoj se këtë reformë dhe këta hapa që ka bërë Ministria vërtet janë adekuat dhe shoh me perspektivë në të ardhmen fushën e arsimit me punën që është bërë.

Do të veçoj me këtë rast, meqë u dha mundësia për edhe dy preokupime që janë në komunën e Gjilanit. E para është ajo, që e tha edhe Ministri, se hapësira shkollore është e ngushtë për mësim. Në këtë rast, në qytetin e Gjilanit, vërtet hapësira shkollore është shumë e ngushtë për shkak se në disa shkolla kemi nga katër ndërrime dhe dihen pastaj vështirësitë që kanë personeli arsimor dhe nxënësit për të mbajtur mësimin.

Unë mendoj që ndërtimi i tri shkollave që janë parashikuar, dy fillore dhe një e mesme për qytetin e Gjilanit do të mundësojnë një hapësirë të re, e cila nuk do të bëhet shpejt por e shoh se zgjidhja do të jetë në fazën vijuese.

Çështja e dytë, të cilën do ta veçoj me këtë rast, është ajo që kemi pasur në Gjilan probleme nga ana e qeverisë komunale të shfaqura ndaj Ministrisë së Arsimit gjatë pranimit. Besoj se hapat në vijim ose masat që duhet ndërmarrë Ministria duhet të shkojnë deri në fund për

arsye se vërtet nga ana e qeverisë komunale janë bërë veprime jo të ligjshme, jo të mira dhe ka prodhuar reagime të mëdha, por edhe ka nxjerrë vështirësi dhe telashe të mëdha drejtorëve nëpër shkolla lidhur me fillimin e procesit arsimor.

Unë pres nga Ministri dhe Ministria që këto masa të ndryshohen dhe të merren parasysh kriteret të cilat i ka vë Ministria e Arsimit.

Do të përmendja vetëm një drejtor të një shkolle fillore që më tha dje pasdite se për shkak të fushatës së zgjedhjeve në vijim, në vend të personelit të kualifikuar, në një shkollë për arsimtar të kualifikuar për lëndën adekuate e kanë marrë imamin e xhamisë. Kjo nuk do koment!

Prandaj, mendoj se Ministria e Arsimit duhet të ndërmarrë masa adekuate në mënyrë që të tejkalojë këtë situatë, sepse vërtet kjo ka krijuar probleme të caktuara. Faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, le të përgatitet deputetja Myrvete Dreshaj.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti Kryetar, zoti Ministër, kolegë deputetë,

Është mirë që Ministria e Shkencës dhe Teknologjisë po e zbaton Ligjin për arsimin parauniversitar dhe që po përpiket që në vitin 2007/2008 ta përmbyllë reformën në shkollat fillore.

Pasi që kjo reformë paraqet ndryshim të madh në sistemin e shkollimit të gjertanishëm parauniversitar, është dashur të përgatitet më herët, të bëhen analiza më të mira dhe anë të pozitive e negative për sistemin e arsimit në Kosovë, e jo vetëm të kopjojmë verbërisht sistemet e huaja të funksionimit qofshin ato edhe Perëndimore.

Shtetet e zhvilluara ekonomikisht dhe ato që nuk kanë probleme të papunësisë, mund t'i lejojnë vetes komoditetin e eksperimenteve të ndryshme, e neve, këto eksperimente, po na kushtojnë shtrenjtë.

Udhëzimi administrativ 12/2007, i datës 25 qershor, është nxjerrë vetëm 2 muaj pa filluar mësimi dhe ky fakt tregon se nuk ka pasur përgatitje të mirëfillta dhe pasojat e kësaj me siguri do të shfaqen më vonë. Tek nxënësit dhe arsimtarët, vërehen menjëherë, pasi që shumica e tyre, që kanë pasur orët në klasat e pesta, kanë mbetur pa to dhe me këtë rast nuk është marrë parasysh kriteri i kualifikimeve, siç na ka premtuar Ministri i Arsimit, por janë marrë parasysh kriteret me të cilat ne në Kosovë jemi mësuar: kriteri familjar dhe ai partiak. Dhe, me këtë reformë, në këtë kohë kaq delikate për Kosovën, kur papunësia është në rritje e sipër, pasi që ju jeni pjesë e Qeverisë, zoti Ministër, është dashur të jepni propozime dhe mundësi që ta zvogëloni papunësinë. Me këto veprime, edhe pse janë bërë me qëllim të mirë, papunësia është rritur edhe më tepër.

Pasi që çdo ditë po ballafaqohemi ne deputetët me njerëz që kanë mbetur pa punë, për shkak të kësaj reforme dhe ata arsimtarë me përgatitje adekuate, me ato përgatitje të cilat nuk është dashur të përjashtohen nga puna, propozoj që ta rishqyrtoni edhe një herë zbatimin e këtij Udhëzimi administrativ dhe pasojat e tij në këtë kohë.

Jam e sigurt se shtyrja e zbatimit të tij për vitin e ardhshëm do të jetë zgjidhje më e mirë për nxënësit, arsimtarët dhe arsimin në përgjithësi në Kosovë. Faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Myrvete Dreshaj, le të përgatitet deputeti Sabri Hamiti.

MYRVETE DRESHAJ: Faleminderit zoti Kryetar. Ministra, kolegë deputetë,

Nuk është herë e parë që ky Kuvend në këtë mandat po debaton për çështje të arsimit. Mirëpo, gjithnjë kemi debatuar në raste të shkëputura, ose debati i përgjithshëm nuk ka rezultuar me ndonjë nismë serioze për të ndryshuar situatën.

Po ashtu, nuk duhet të kemi iluzione se reforma e arsimit - në mungesë të statusit politik të Kosovës dhe sidomos me zhvillim të ngadalësuar ekonomik, pse jo edhe drejt një varfërie – mund të pritet që të jetë një reformë e mirëfilltë. Për një reformë dihet çka kërkohet. Kërkohet mbështetje e fuqishme politike, financiare, burime njerëzore si dhe qëllime të qarta. A i kemi pasur të gjitha këto atë ditë që kemi filluar reformën? Jo! Jo, sepse nuk e kemi kaluar fazën e miratimit të reformës, siç quhet në praktikën e arsimit – si nxitje e interesit për reformën. Prandaj edhe sot dhe në moto do të përballemi me mangësi të një procesi të tillë të ndryshimit në arsim.

Doemos duhet pranuar se, nismën për këtë reformë e ka përgatitur administrata e UNMIK-ut, por e kemi përcjell edhe ne me mjaft mangësi. Kemi hyrë të papërgatitur dhe pa mbështetje të faktorëve të tjerë, të cilët i radhita më parë.

Është fakt se, gjithë kjo fillon me të ashtuquajturën “epokë të Dangsnerit” me shumë nxitim, duke shpërfillur realitetin e zhvillimit të shkollës sonë në dekadën e fundit të shekullit 20. Atëherë kur shkolla jonë kishte synim kryesor të mbijetojë terrorin shtetëror serb.

Aq më tepër, ne jemi ndër të parët në rajon që iu kemi qasur kësaj reforme. A ka qenë e menduar mirë kjo çështje?

Po ashtu, të gjithë e dimë, se nuk kemi organizuar fazën e përgatitjes dhe miratimit të ndryshimeve të gjera, që janë themelore për reformën dhe për të cilat ndryshime ka pasur më tepër nevojë shkolla jonë.

Edhe sot, kur flasim për klasën e pestë, duhet ta kuptojmë si pjesë të kësaj tërësie. Po atë vit, kur e kemi filluar reformën, duhej të merreshin për bazë të gjitha sfidat me të cilat po ballafaqohemi sot, domethënë me situatë me të cilat po përballemi gjatë procesit të këtyre ndryshimeve.

Po ashtu, është fakt se mësuesit tanë janë të përgatitur për klasën e pestë. Ata mund ta kryejnë këtë punë mësimore dhe jam e bindur se këtu nuk duhet të kemi dilema. Pra, mësuesi duhet llogaritur prej klasës së parë deri në klasën e pestë, sepse është një tërësi e programeve mësimore dhe e kërkesave të tjera.

Çdo ndërprerje e këtij cikli, mund të jetë me pasoja, sepse po bëjmë kështu një shkëputje nga një tërësi që nuk tolerohet në arsim. Sivjet, duhet të vazhdohet ashtu siç e ka menduar Ministria, sepse jemi në proces, mirëpo kjo nuk është zgjidhje. Ne, gjatë këtij viti, duhet bërë të gjitha përgatitjet që arsimtarët të vazhdojnë edhe klasën e pestë. Çdo reformë e ka edhe pjesën e dhembshme, por kjo varet sa bëhen përgatitjet me kohë.

Zoti Kryetar,

Unë mendoj se ky Kuvend duhet t'i drejtohet Qeverisë me një kërkesë për një analizë serioze të reformës së arsimit, sepse ky është vit shkollor përmbyllës dhe është praktikë e zbatimit të reformave që në mënyrë permanente të përcjell një vlerësim kompetent.

Këtë nuk e kemi bërë deri më tash, duke mos llogaritur studimet brenda Ministrisë së Arsimit. Nuk e kemi bërë sepse nuk kemi ngritur institucione kompetente që merren me procesin e ndryshimeve në arsim, siç është Këshilli kombëtar për arsim, Qendra kombëtare për vlerësim dhe Instituti i studimeve pedagogjike, për të cilin para pesë vjetëve është marrë nisma për themelimin, ndërsa – sa kam informacione – këto ditë është duke u bërë strukturimi i tij.

Edhe kjo ka qenë një mangësi, e cila, padyshim ka reflektuar në procesin e reformës, por jo për të mirë.

Çështja, aktualisht kërkon zgjidhje të problemeve për arritjen e një reforme të gjerë që mbështetet në përkatësinë vendore. Domethënë, në veçanti të shkollës sonë, duke mënjeluar zgjidhjet e huazuara nga jashtë, si quhen “zgjidhje të rreme të reformave shkollore”.

Aktualisht, problemi është se ne duhet me kompetencë të vlerësojmë se si po funksionon brendshmi procesi i ndryshimeve në arsim. E di që në arsim është vështirë të vlerësohet, por kjo nuk do të thotë se nuk duhet ta bëjmë. Fakt është se këtë nuk e kemi bërë as dje, as sot. Këtë duhet ta bëjmë sa më shpejt, duke mundur kështu që procesi i ndryshimit në arsim të kthehet në përparësi. Mos të harrojmë se ndryshimi në arsim është proces i ndërlikuar shoqëror dhe politik. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, le të përgatitet deputetja Teutë Sahatqija.

SABRI HAMITI: Falemnderit zoti Kryetar i Kuvendit. Të nderuar ministra që jeni të pranishëm këtu,

Unë do të thosha se biseda në Kuvend për reformën në arsimin parauniversitar, në formën si po zhvillohet sot, ose është e hershme ose e vonuar. Kush do, mund ta marrë si të dojë, sepse mënyra e të folurit po tregon se po kalohet nëpër segmente dhe po harrohet tërësia.

Ministri Veliu, tregoi që reforma në arsimin strukturor, në arsimin parauniversitar te ne - s'ka të bëjë as me këtë Ministër, as me këtë legjislaturë. Është në reformë që ka kapë dy legjislatura të Kuvendit dhe dy ministra të dy qeverive të ndryshme të Kosovës.

Raporti i Ministrit Veliu, ishte i saktë, a – në kuptimin matematik të fjalës. Ai dha një raport të saktë, të cilin, unë mendoj, që Ministria është dashur ta bëjë shumë më publik, sepse mua më duket që zhurma është në komunikim, jo në esencë. S'ekziston problemi i klasës së pestë. Ekziston fundi i strukturimit të reformës parauniversitare në Kosovë. S'ka të bëjë kjo me klasën e pestë, po ata që kanë pasur pak njohuri për këto probleme ose që problemet i shohin zakonisht nga empiria personale mund të kenë pasur për herë të parë një fëmijë që i ka mbërri në klasë të parë dhe u tha, dy njerëz e thanë në diskutim këtu – “unë po flas si prind, se unë e kam fëmijun në të pestën”.

Unë kam respekt për implitë personale, por kjo s'ka të bëjë me implitë personale. Kjo është një reformë që është aprovuar në Qeverinë e Kosovës e që i ka rregullat e veta dhe po mbërrin në kulm. Klasa e pestë sivjet është mbyllja e saj dhe ne mund të bisedojmë sot në kuptimin e para folëses sime, që tha është koha të fillojë analiza e vërtet e efekteve të kësaj dhe jo më të ndryshimit të saj, sepse arsimi është sistem shumë konservativ dhe nuk

ndërrohet përditë, por të korrighohen hapat që nuk janë të mirë. Të perfeksionohet, jo të ndërrohet. Nuk mund të bëhet ndërrimi në sistem të arsimit si sistem shumë gjithëpërfshirës dhe tradicional për çdo ditë, për çdo brez, për çdo nevojë dhe për çdo imperi personale.

Pra, unë mendoj se Ministria e Arsimit, po të mos ta bënte përmbylljen me klasën e pestë, ne është dashur ta marrim në përgjegjësi Ministrin dhe ta heqim. Jo t'i bëjmë probleme pse e ka gjetur instrumentariumin ligjor që ta mbyllë reformën. Duhet t'i shohim problemet në sistem.

Ai dha të dhëna, por unë po them se mua m'duket që mënyra e komunikimit publik të Ministrisë nuk është shumë efektive se edhe punët që i bën nuk i kallon sa duhet. Se, po të kallxoheshin në këtë formë – në mënyrë substanciale këto punë - nuk do të bëhej zurma për klasë të pestë, sepse nuk ekziston afëra – klasa e pestë. Është e shpikur. Kjo është, përmbyllja e reformës. Kemi marrë sistemin e ri 5-4 - 3 dhe 4 dhe ka filluar prej klasës së pestë, katër vite na mbërrijmë. Cikli i klasës së ulët po mbërrin në klasën e fundme të pestën, ndërsa klasa – shkalla e mesme që quhet, i ka bërë katër vjet dhe shkalla e lartë katër vjet. Ne po e mbyllim me të pestën sivjet, s'po hapim kurgjo. Faktikisht është pika e mbylljes.

Kjo, sa i përket arsimit publik dhe të Ministrisë. Pra, mbyllja është, nuk është hapja.

Unë i kuptoj njerëzit, të cilët mendojnë për një arsim më cilësor. Po, tjetër është reforma strukturore, tjetër është a bëhet mësimi cilësor. Ministria dhe çdo ministri dhe çdo vend, duhet të ketë instrumentet e krijimit të kushteve për mësimdhënie më të mirë dhe për nivel më të lartë. Ai, është problem krejt tjetër, nuk lidhet me strukturë. Ajo do permanencë. Ministria duhet të ketë instrumente të sigurimit të cilësisë në mësim si patë reformë si s'patë, si u krye si s'u krye. Këto janë punë permanenca, që ndodhin në gjithfarë sistemi.

Problemi - sa është përgatitur? Për mua është qesharake të bisedohet – jo është përgatit me kohë, jo s'është përgatit. Unë jam njeri i atij zanati dhe i përcjell edhe për zanat edhe qefi këto probleme. Nuk është e vërtetë! Është biseduar kaq shumë për këto programe, edhe në nivel të Kosovës dhe - në krahasime – edhe me Shqipërinë dhe me shtete tjera. Është biseduar gjerë e gjatë, edhe nga ekspertët.

Po unë po ju them që, në këtë kuptim, e keni gabim nëse thoni që Kosova s'është përgatitur. Është, nga vendet që provojnë të hyjnë në këto sisteme, më e përgatitura – sidomos sa i përket teksteve. Teksteve, sidomos nga lëmitë fundamentale. Për të gjitha vitet është provuar që të krijohen tekste të reja dhe të jepen në përdorim me kohë.

Unë e di që edhe për të pestën, tekstet fundamentale janë botuar.

Ju, mund të thoni, dhe këtë pyetje mund ta shtroj edhe vetë: a do të ketë sukses të madh kjo? Ndoshta edhe nuk do të ketë sukses të madh brezi i parë, por ne duhet t'i forcojmë brezat tjera. Sistemi ruhet, brezat perfeksionohen. Dhe, kjo është krejt çështje tjetër. Siç është krejt çështje tjetër, e dorës tjetër, problemi sa arsimtarë në një reformë e ndërrojnë vendin e punës. E kjo është pasojë dhe nuk duhet as Ministria të fshehët pas kësaj as ne që luajmë lojën – lojtarin e kujdestarit social të Kosovës. Çdo reformë nxjerr diçka dhe shti diçka të re. Unë shifrat nuk i di. Është në detyrën e Ministrisë që, nëse ka nevojë për arsimtarët që janë të dobishëm dhe s'mund të japin në këtë klasë të pestë mësim, të sistemohen tjetërkund. Por, kjo nuk është punë që duhet ta bëjmë ne. Çdo reformë, ka pasoja dhe një shoqëri duhet të jetë e gatshme t'i marrë pasojat në të gjitha pikat e saj.

Pra, nuk është mirë, po them, të bisedojmë veç me voluntarizëm për këto probleme, sepse janë probleme të rëndësishme, e sidomos nga imperitë personale. Ajo i bie sikur ndokujt s'i shkon në çerdhe fëmija dhe thotë mbyllni çerdhet se fëmija im nuk e duron çerdhen. Janë qesharake këto sende. Ose, unë kam dëgjuar në këtëfarë aferën mediatike, që ka qenë më tepër propagandë. Zakonisht, ku ka pak analiza dhe profesionalizëm, propaganda del edhe më e pabesueshme. Unë kam pa njerëz dhe fytyra që i kam njoft rastësisht personalisht që thotë në televizion: “ne e dojmë reformën, por i dojmë fëmijët tanë më shumë”. Ky është argumentim qesharak, prandaj edhe ka shkolla të ndryshme. Ka njerëz që s'po i çojnë fëmijët në shkolla publike hiq. Po i çojnë në sholla private dhe është e drejtë e tyre. Mirëpo, nuk është e drejtë e një njeriu, i cili ka një sens për një fëmijë të vetin dhe ta sjell në pyetje një strukturim total, të rëndësishë së veçantë për Kosovën.

Pra, nuk mund njeriu të niset nga përvoja e vet dhe ta bëjë bërskotë një reformë që është planifikim shoqëror dhe interes shoqëror i Kosovës. Natyrisht, zgjedhja personale është zgjedhje e tij.

Unë mendoj që Ministria ka bërë atë që mund të bëhet në këto kushte dhe është mirë që tashti, meqë sistemi po mbyllet, të shkohet në atë që quhet analizë e sukseseve dhe korrekturave të veçanta që ndodhin, në të gjitha lëmitë: të mësimdhënieve, të programeve, të teksteve. Faleminderit.

KRYTARI: Ju faleminderit. E ka fjalën Teuta Sahatqija, le të përgatitet Xhezair Murat.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit zoti Kryetar. Përshëndetje përsëri të gjithë të pranishmit dhe unë do t'ia kisha filluar si vijon.

Zoti Ministër, sa i përket ORA-s dhe fillimit të diskutimit të zotit Genc Gorani, ishin disa pyetje, pyetje të cilave ju ende nuk iu përgjigjët. Ishin pyetje shumë konkrete. Shpresoj se për ato pyetje do të dëgjojmë përgjigjen në vazhdim, në përgjigjen tuaj.

Sa i përket disa shpjegimeve, disa interpretimeve të ndryshme dhe lidhjeve me matematikë, që matematikisht diskutimi ishte i mirë. Matematikën unë e çmoj shumë. Mirëpo, nëse flasim për fëmijë, për fëmijët e një moshe shumë të ndjeshme, për fëmijët e klasës së pestë, ku pikërisht edhe matematika është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe edhe thyesat nëse nuk mësohen në klasën e pestë qysh duhet ato kurrë përjetë nuk kanë të mësohen. Por, jeta dhe puna e atyre fëmijëve, nuk është matematikë. Është shumë më komplekse. Dhe, të gjithë ne e dimë që puna me njerëz, e sidomos puna me fëmijë, është një punë shumë e rëndë, punë që do përkushtim të madh, punë që kërkon një kompleksitet dhe punë shumë afatgjate.

Prandaj, i nderuar zoti Ministër, Partia Reformiste ORA dhe Grupi Parlamentar i saj, nuk e përmendi në asnjë mënyrë, në asnjë fjalë fushatën, gjë e cila nuk mund të thuhet për Partinë tuaj.

Ne jemi të brengosur dhe mendojmë që kjo brengë është brengë e të gjithëve. Ju keni pasur mundësi të shihni nëpër media, keni pasur mundësi të bisedoni me mësues, keni pasur mundësi të bisedoni jo vetëm me prindërit e Partisë Reformiste ORA por edhe me prindërit e të gjitha partive, sepse në fund të fundit, çdokush rastësisht mund të jetë prind, çdokush rastësisht mund të ketë fëmijë, çdokush rastësisht mund të ketë fëmijë pikërisht në klasën e pestë, por nuk janë ato raste të rastësishme. Ato janë raste të të gjithë atyre nxënësve të klasave të pesta, prandaj mos të flasim për klasat e pesta të Partisë ORA apo të partisë tjetër. Të jemi pakëz më serioz. Është problem i cili kërkon me të vërtetë angazhim të të gjitha

partive dhe të gjitha strukturave, jo vetëm të një partie. Me të njëjtën mënyrë edhe ne i jemi qasur, jo si parti por si deputetë, si njerëz të cilët përkushtohemi për një problem madhor.

Këtu edhe u pa prej partive tjera. U pa që ato fjalë me të cilat u artikulua ORA, u artikuluan edhe të gjitha partitë tjera, përveç partisë e cila po mundohet të mbrohet me diçka të pambrojtshme.

Sa i përket këshillit të prindërve. Këshilli i prindërve do të duhej të ishte njëfarë oponente e Ministrisë. Këshilli i prindërve do të duhej të ishte një grup i cili mbron interesat e fëmijëve, i cili edhe mund të kundërshtojë, por jo të bëhet avokat i Ministrisë. Ju lutem, nëse prindërit tjerë flasin, atëherë të ulemi e të mendojmë dhe të themi, këtu është problemi. Eja, ta zgjidhim bashkë atë problem, secili në mënyrën e vet, secili me atë përkushtimin, me mundësitë e veta të cilat i ka.

Këtu dolën shumë gjëra të cilat nuk kanë përgjigje. Njëra preja tyre është: A do të kemi ne mësues të përjetshëm të klasave të pesta apo ata mësues do të kthehen përsëri në klasën e parë dhe të vazhdojnë deri në të pestën. Në qoftë se ka qenë ashtu, pse nuk janë marrë më herët ata mësues e nuk janë përgatitur. Pse udhëzimi administrativ të bihet në datat kur përfundon mësimi për të nisë diçka kur fillon mësimi.

Të gjitha këto tregojnë, fatkeqësisht, një joseriozitet, një përgatitje jo të mjaftueshme, të cilën gjë patët mundësi ta vëreni edhe prej diskutimeve të kësaj partie tjera dhe të deputetëve tjerë.

Prandaj, askush nuk ka penguar të niset kjo më herët. Dhe, në qoftë se hidhet çështja te ministrinë tjera, te qeverinë tjera, te kohërat tjera, atëherë kush i ka udhëheqë edhe herave tjera, ju lutem.

Të mos politizojmë këtë çështje, e cila nuk politizohet. Ne jemi për reformë, e respektojmë reformën por ajo reformë duhet të jetë reformë e mirëfilltë, reformë me përgatitje dhe reformë prej të cilës do të përfitojnë qytetarët, në radhë të parë fëmijët e Kosovës. Faleminderit.

(Seancën plenare e kryeson Gazmend Muhaxheri, anëtar i Kryesisë së Kuvendit)

KRYESUESI : Faleminderit. E ka fjalën deputeti Xhezair Murati, le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

DŽEZAIR MURATI: Poštovani predsjedavajući, gospodo ministri, kolege poslanici,

Neću ništa novo reći ako kažem da oblast obrazovanja predstavlja fundament opstajanja jedne zajednice, pogotovo manjinskih zajednica. Ovom prilikom ću pomenuti da su riješeni neki od problema u nastavi na bosanskom jeziku u posljednjih nekoliko školskih godina. Primera radi, otvorene su tri grupe na fakultetima, stvorena je mogućnost da neki pojedinci studiraju na maternjem a odgovaraju na ispitima na maternjem jeziku, i tako dalje.

Kao pozitivan primjer navešću da je pred početak ove školske godine...

Predsjedniče! Ustvari predsjedavajući, hoćete li stvoriti malo uslova da govorim ili, ako je nekima dosadno, mogu da napuste Skupštinu. Vidim zamorili su se, a i ramazan je! Čestitam ga ovom prilikom!

Dakle, kao pozitivan primjer ću spomenuti da je na početku ove školske godine, u sredini gde živi najveći broj Bošnjaka u Prizrenskom regionu, direktorijat za obrazovanje, na čelu sa gospodinom Hotijem i Regionalna kancelarija za obrazovanje sa gospodinom Milaimom Elshanijem i Hajrullahom Byrdynijem u poslednji momenat riješila poveći broj problema koje smo imali za početak ove školske godine. To kažem i navodim kao pozitivan primjer, a ja ću takodje reći da jedan veći broj osnovnih problema ostaje i provlači se već nekoliko godina.

Ja ću spomenuti, kažem samo neke. Početak je školske godine, a mi opet dočekujemo bez dovoljnog broja udžbenika. Mnogi udžbenici nisu odštampani, a oni koji su odštampani u prevodjenju napravljen je loš prevod pa se njime ne mogu snaći ni sami nastavnici, a kamoli učenici.

Šta je nastava bez, recimo, osnovnog sredstva za nastavu, a to je udžbenik. Mislim sa time, kod nas zaista ovo se provlači poduže. Zatim, problem kombinovanih odeljenja. Znae, kada se olako spajaju razredi, dobija se i lošija nastava a i uvijek po jedan nezaposlen nastavnik. To je dakle.... Ovaj peti razred o kojem toliko govorimo danas nije bauk, kao što je rekao kolega Hamiti. Sada se sa njime slažem, ali je problem što su mnogi nastavnici ostali bez norme pa to stvara dodatne probleme, drastično smo i smanjili časove, tako da to stvarno stvara problem.

Dalje, u nekim školama, u sredinama gde žive Bošnjaci, gospodo nisu objavljeni konkursi za upis učenika u prve razrede u nastavi na bosanskom jeziku i ja ću navesti da se time čak i fond za humanitarno pravo pozabavio jednim upozorenjem koje je objavljeno ovih dana u nekim medijima. Ovo mislim da treba da se ispravi.

Dalje, u nekim sredinama se uopšte konkursi ne objavljuju. Primjer ću navesti Opštinu Peć. Tamo, znate kad se ne objavi konkurs, onda neki „moćni pojedinci“, prema svom nahodjenju zapošljavaju ljude, pa onda ostane nastavnik pa se zaposli poljoprivrednik, i tako dalje, i tako dalje – imamo i takve primjere.

Dalje, i dalje je u upravama škola, gospodo, recimo u nekim sredinama kao što je Prizren niti u srednjim, a niti u osnovnim školama nemamo nijednog zamenika direktora iz redova Bošnjačke zajednice i pored znatnog broja učenika u svim tim školama. Mi smo do sada ukazivali Ministarstvu u više navrata da je neophodno da se zaposli jedan savjetnik koji bi radio po pitanjima problema u nastavi na bosanskom. Do sada to nije naišlo na reagovanje, na rezultat, iako imamo solidnu saradnju.

I, na kraju, ja bih se pozabavio još jednim problemom. Roditelji Bošnjaci, gospodo, nakon rata su se plebiscitarno izjasnili da naša djeca uče albanski, kao jezik sredine, kao nematernalni jezik i mi smo dakle očekivali da od ovoga na neki način dobijamo što smo tražili, a tražili smo kvalitetniju nastavu, tražili smo kvalitetne udžbenike i da problem nastavnika koji predaju albanski kao nematernalni, bude riješen finansiranjem. Medjutim, nijedan od ovih zahtjeva nije ispunjen.

Inače, sasvim poslednja riječenica, danas je Ministar govorio i reagovao sasvim u skladu sa usvojenim Zakonom u ovoj Skupštini. Gospodo, u usvajanju Zakona o obrazovanju u ovoj Skupštini učestvovali su sve zajednice predstavljene u Parlamentu i mi smo svi usvojili taj zakon. Ne vidim sada razloge, i samim tim mi smo prihvatili reformu koju predviđja sadržina tog zakona i ne možemo dalje to da politizujemo ili problematizujemo. Ja bih toliko za danas. Hvala vam!

KRYESUESI: E ka fjalën deputeti Fetah Berisha, le të përgatitet deputetja Besa Gaxherri.

FETAH BERISHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Që në fillim dua t'ju sjell ndërmend se pas uzurpimit të lokaleve tona arsimore nga regjimi serb, pas mbajtjes së mësimit nëpër lokale private, pra pas mbijetesës së arsimit shqip në Kosovë, arsimi shqip po stabilizohet në lokalet e veta dhe po stabilizohet në pikëpamje pedagogjike me suksese të dukshme.

Arsimi shqip, në të gjitha nivelet, pati vështirësi të mëdha deri te stabilizimi normal me kuadro, me lokale, me vështirësi financiare, pati vështirësi fillimisht me tekste shkollore, me programe mësimore e të tjera. Kjo çështje donte kohë dhe duhet të bëhet gradualisht, dhe po bëhet gradualisht, por edhe të shpejtohet brenda mundësive që kemi.

Zbatimin e reformave në arsim edhe për klasën e pestë, mbështetur në kurrikulimin, është i vështirë, por zbatimi i reformave në arsimin tonë dhe trajnimi i mësimdhënësve është domosdoshmëri. Përgatitja e trupit mësimor për mësimdhënie është me rëndësi, sepse krahas kualifikimit profesional bëhet edhe trajnimi për përvetësimin e metodave të reja në mësimdhënie, kështu që suksesi për arsimin dhe edukimin e brezit të ri është edhe sukses për të ardhmen e Kosovës.

Për këtë, do të veçoja vetëm tri momente. Të kihet parasysh, dhe duhet të na interesojë të gjithëve, se kur të pranohet kuadri, në rend të parë të shikohet kualifikimi adekuat e profesional. Pranimi i kuadrove arsimore asnjëherë të mos bëhet dhe kurrë në baza partiake dhe miqësie, e kjo në shumë vende po ndodhë dhe të gjithëve duhet t'na interesojë deri ku ka arritur realizimi i reformave në arsimin tonë dhe cilat janë vështirësitë.

Dhe, fare në fund, desha ta përgëzoj ministrin Veliu për informatën mjaft të ngjeshur që e paraqiti këtu para nesh dhe për planprogramet, për reformën në arsim edhe për klasën e pestë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit. E ka fjalën deputetja Besa Gaxherri. Le të përgatitet, i fundit, deputeti Ferid Agani.

BESA GAXHERRI: Faleminderit zoti kryesues. I nderuar Ministër, të nderuar kolegë,

Ne jemi të vetëdijshëm se në arsimin në Kosovë ka shumë nevojë për reforma, ka edhe shumë nevojë që ligjet që janë në fuqi në Kosovë të aplikohen dhe mendoj se Ministria, përveç reformave, përveç punëve tjera, në radhë të parë ka obligim apo duhet të jetë shumë më këmbëngulëse që ligjet që janë në fuqi në Kosovë të monitorohen dhe të aplikohen.

Nuk po them asgjë të re nga kolegët e mi, por po them dhe me shumë fakte se kjo reformë është e ngutshme dhe në këtë reformë po hyjmë sikur në reforma tjera, të papërgatitur. Dhe, tek fundi i fundit, ky është obligim yni si deputetë të reagojmë sepse këto sprova – të shumta që po bëhen pas lufte.....

(Dëgjohet rënie me dorë në mikrofon)

A domë me u dëgjuar apo domë me bë shou këtu në Kuvend? Ka filluar fushata dhe tash na pëlqen me folë më shumë ndoshta për gjëra tjera se sa për këto, që janë shumë të rëndësishme, dimë me thënë secili e unë po vazhdoj se reforma atakohet në fëmijët tanë dhe nuk mundemi me ia bë qefin as veti as ministrit, as qeverisë se që gjithçka është OK-ej.

Unë jam për reforma dhe tërë qytetarët, tërë populli i Kosovës, është për reforma, dhe jo vetëm në arsim, por për gjithçka në Kosovë. Mirëpo, për çdo reformë duhet të përgatitemi që ajo reformë të jetë e suksesshme. A jemi përgatit për reformën në fjalë? Nuk jemi përgatit. Dhe, po bëjmë sprovë me fëmijët tanë, me të ardhmen tonë, që – edhe ashtu – është shumë e dëmtuar. Të gjitha reformat që janë bërë në Kosovë pas lufte kanë qenë të papërgatitura mirë. Tek e fundit, nuk është problem që të përgatitemi më mirë, siç bie fjala edhe me objekte, sepse për të qenë reforma e suksesshme duhet të kemi hapësirë shkollore, duhet të kemi tekste të mjaftueshme, që nuk pajtohem me kolegët që thonë se kemi tekste, bile edhe më mirë të pajisur se sa në regjion. Duhet të kemi kuadro adekuate për t'u përgatitur dhe këto gjëra kemi mund me i bë dhe pastaj t'i hymë reformës e jo të bëjmë sprovë fëmijun por t'i bëjmë sprovë gjërat tjera që është dashur të përgatiten dhe të futen në reformë.

Me ju thënë të vërtetën, më shumë më shtyri të marr fjalën kolegu zoti Fatmir Rexhepi, sepse vërtet po e shoh se kjo interpelancë po i përngjan më shumë fushatës politike dhe nuk pajtohem me kolegun që kërkon që kuvendet komunale të jenë të kontrolluara nga Ministria. Ia përkujtoj kolegut të nderuar se pikërisht ju, sidomos vendësi juaj Lutfi Haziri, ka bërë hapa shumë të shpejtë dhe shumë të gabuar për decentralizimin. Këto janë pasojat. Mirëpo, paskeni menduar që decentralizimi duhet me u bërë veç kur jeni ju në Qeveri dhe kur i keni kuvendet komunale.

(I bie mikrofonit)

Dhe, ju lutem, merrni fjalën e mos ndërhyri, bëhuni të durueshëm dhe dëgjoni. Pyes kolegun, çfarë të keqe paska në qoftë se një imam apo një hoxhë me shkollimin adekuat qenka pranuar si mësues në një shkollë të caktuar, që unë nuk e di cila është.

Dhe, kolegë të nderuar, unë po e përmbyll dhe them edhe një herë që unë personalisht jam tip parimor, për tema të caktuara duhet të diskutojmë në parim dhe të mos anojmë e bëjmë fushatë politike, aq më pak kur është në pyetje kaq e rëndësishme, siç është arsimi, dhe fëmijët tanë. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete. E ka fjalën deputeti Ferid Agani, le të përgatitet deputetja Gjylshene Berisha, si e fundit për të marrë fjalën. Një moment! Si duket, për replikë paraqitet Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Unë kam një sqarim plotësues, sepse nuk është çështje e fushatës. Jemi njerëz të pjekur, i dimë mandatet, i dimë detyrat. Është problem pak i madh tani, e veçova se nuk ishte edhe çështje lidhur me interpelancën e sotme dhe në rend dite sot ajo çka ka ndodhë në Gjilan. Është e vetmja komunë në Kosovë, pra Qeveria Komunale e Gjilanit e cila nuk ka punuar në pajtim me rregulloren e arsimit, që e ka nxjerrë Ministria e Arsimit, e cila është në pajtim me ligjin. Pra, i ka shkelë të gjitha normat e këtij procesi gjatë pranimit.

E mora si rast, që është shumë i vërtet. Imami i fshatit është pranuar, është me pa asnjë ditë shkollë dhe është pranuar vetëm e vetëm me përçarë dhe me bë problem në fshat. Është lënë anash arsimtari i matematikës ose ai i cili ka qenë më afër i kualifikuar për këtë lëndë. Kjo është mëse e vërtetë dhe mundeni ta vërtetoni. Prandaj, nuk ka të bëjë kjo me diçka tjetër, por

kjo është në interesin e një procesi, prandaj edhe ishte vërejtje imja e drejtuar në adresë të saktë.

Çështjet tjera, që po ngritën, lidhur me emrat që u përmendën këtu, decentralizim e të tjera, mendoj se janë fare të pavend. Nuk na takon ne si deputetë, saherë që të nxjerrim çështje të ndryshme këtu, të përsërisim edhe ato çështje që s'janë fare në rend dite. Prandaj lus edhe zonjën e cila përmendi pak parë edhe zotëri Lutfiun e të ruhen pak nga ato etiketime sepse nuk janë me vend. E sa për reformat, le të dihet se ato kaherë kanë filluar, s'po fillojnë sot. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit. E ka fjalën deputeti Ferid Agani, le të përgatitet deputetja Gjylshene Berisha, e fundit.

FERID AGANI: Ju faleminderit zoti kryesues, i nderuar zoti Ministër, të nderuar koleë deputetë,

Debati në këtë interpelancë, po shkon prej një skaji në skajin tjetër dhe me pyetje të shumta, me pak përgjigje, me mjaft konstatime të cilat janë shumë të qarta për të gjithë ne.

Mendoj se interpelanca ka qenë e qëlluar dhe si çdo interpelancë i ka edhe qëllimet e veta përfundimisht. Interpelanca zakonisht kur thirret, thirret për përcaktuar, për të vlerësuar në të vërtetë një proces, një veprim, për të nxjerrë përgjegjësi konkrete ose për të nxjerrë përfundime relevante për çështjen në fjalë. Konkretisht, bëhet fjalë për një çështje të ndryshme, bëhet fjalë për nxënës të klasave të pesta dhe këtu dëgjuam vlerësime të ndryshme, në mesin e të cilave më së shpeshti u dëgjuan fjalët: pa përgatitje dhe një nguti. Do të thotë, është shumë e qartë se bëhet fjalë për fazën përfundimtare të një procesi të reformës, është shumë e qartë se ajo duhet të ndodhë dhe është shumë e qartë që është duke ndodhë. Po ashtu është e qartë, sepse po del në pah gjithnjë e më tepër që mësimdhënësit e angazhuar në këtë fazë përfundimtare të kësaj reforme janë mjaft të papërgatitur, janë rekrutuar në fazat përfundimtare, mu para fillimit të vitit shkollor dhe kjo me siguri do të ketë reperkusione në kualitetin e procesit mësimor të fëmijëve në klasat e pesta.

Unë, personalisht, do t'isha shumë i interesuar të di nga Ministri, se çka Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka ndërmarrë ose do të ndërmerr që të monitorojë këtë proces i cili ka filluar qe dy javë. Është shumë e qartë se kërkohet një veprim energjik që këto mungesa dhe mangësi evidente, që tregojnë shembuj të shumtë eklatant, deri aty që fëmijët do të mësohen nga njerëz të pashkolluar, të papërgatitur, të pakualifikuar. Kjo është shumë serioze. Dhe Ministria e Arsimit duhet të jetë shumë vigjilente, shumë aktive në këto ditë dhe në baza ditore të përcjellë situatën në tërë këtë sistem shkollor të Kosovës dhe të reagojë shumë shpejt për rastet konkrete në mënyrë që nxënësit të mos ballafaqohen me pasoja, për të cilat nuk dua të përdor fjalë të rëndë – improvizimi nuk është fjalë adekuate për këtë situatë, por nguti – me siguri po. Një nguti ndoshta e paarsyeshme, dhe kur ka qenë e njohur se në këtë fazë do të hyjmë, pse më herët nuk janë bërë përgatitjet adekuate. Ndoshta ka pasur mundësi që këta nxënës të rekrutohen më herët, të bëhen trajnime adekuate përkatëse të tyre. Nuk është lehtë që nxënësi i shkollës fillore, i arsimit të ulët, të nxirret nga klasa e katërt në të pestën., sepse është një realitet krejtësisht tjetër social e psikologjik. Prandaj me siguri se këta arsimtarë janë para një sfide shumë serioze me këta nxënës. Të gjithë janë pranuar rishtazi në punë, shumë prej tyre ndoshta mund të jenë edhe pa përvojë adekuate të mësimdhënies dhe tash ballafaqohen me nxënës të cilët kanë nevojë të veçantë didaktike dhe psikologjike.

Prandaj, unë pres që Ministria e Arsimit të jetë me të vërtetë vigjilente në këtë aspekt dhe të ndërmarrë masa konkrete dhe veprime energjike në drejtim të asaj që të parandalohen pasojat negative dhe natyrisht të fuqizohet procesi i reformës. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit. E ka fjalën deputetja Gjylshene Berisha, le të përgatitet Ministri Veliu.

GJYLSHENE BERISHA: Faleminderit i nderuar kryesues. Të nderuar ministra, të nderuar deputetë,

Pa dashje klasën e pestë e bëjmë temë. Mendoj që këtë bisedë është dashur ta bëjmë kur për herë të parë kemi filluar të diskutojmë për klasën e nëntë, me të cilën ne filluam reformat në arsim.

U bë shumë fjalë edhe për trajnimet, trajnimet e mësimitdhënësve e ndoshta edhe për trajnimet e deputetëve. Në periudhën e transicionit në të cilën gjendej Kosova, edhe ne kemi qenë pjesë e trajnimeve. Dhe ndryshimet jo vetëm në arsim, por në sistem, kalojnë në tri grupe, e ato janë: në njerëzit, të cilët nuk i pranojnë – i refuzojnë reformat; në njerëzit të cilët rrinë anash – as nuk i pranojnë as nuk i refuzojnë; dhe në njerëzit të cilët i përkrahin reformat.

Jam shumë e kënaqur që, edhe Partia së cilës unë i përkas e gjithashtu edhe Ministri, e po ashtu edhe ministri i kaluar kanë përkrahur reformat në shoqëri në periudhën transitore të Kosovës për ta përqaftuar demokracinë dhe për ndërtuar një shkollë në të cilën nxënësi do të jetë në qendër të vëmendjes.

Sot flasim për klasën e pestë e ne do të duhet të flasim shumë e shumë më vonë, pas disa vitesh, kur do t'i bëjmë analizat rreth sukseseve për këto reforma mirëpo rezultatet në arsim, asnjëherë nuk mund të jenë evidente pas një a dy javësh që ka filluar mësimi, por rezultatet në arsim duhet shikuar pas dhjetë a njëzet vitesh.

Duke dashur që arsimi i Kosovës të jetë i krahasueshëm me sistemin arsimor të Evropës, mendoj që rrumbullakimi i kësaj reforme në këtë vit shkollor, është mjaft me vend sepse gjithmonë, nëse e lëmë punën për nesër, nesër është vonë. Reformat janë të dhimbshme, për këtë kemi qenë të vetëdijshëm, jo vetëm kjo legjislaturë, por legjislatura e kaluar në të cilën kam qenë pjesëmarrëse, i kemi përqaftuar, i kemi votuar dhe Ministri nuk do të fillojë prej zeros dhe secili ministër që vjen nuk do të fillonte prej zeros por do të vazhdonte dhe vazhdimësia garanton edhe suksese.

Fatkeqësisht, në çdo vit shkollor, opozita është përpjekur në çdo mënyrë të pengojë procesin mësimor e në anën tjetër për të penguar pushtetin dhe të tregojë se ajo është e cila duhet të udhëheqë me pushtetin. Megjithatë, fatmirësisht, këshilli kombëtar i prindërve dhe të gjithë të tjerët, janë pajtuar se nxënësi është mbi të gjithë.

Ne punojmë për të ardhmen, prandaj, zoti Ministër keni përkrahjen për punën e mëtejshme në rrumbullakimin e kësaj reforme për fëmijët tanë, të cilët nesër mund të punësohen e t'u pranohen diplomat në tërë Evropën dhe më tutje. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete. Për fjalë është paraqitur edhe deputeti Xhevat Bislimi.

XHEVAT BISLIMI: Faleminderit, zoti kryesues. Dëgjuam këtu recitime, vjersha fort të bukura për fushatë zgjedhore, por që arsimi është në këtë gjendje, siç po përshkruhet, që reforma na ka sjellë gjithë këto të mira – ne e dimë të gjithë se s’na i ka sjellë.

Dikush e pranoj se ne duhet të jemi të përgatitur si shoqëri edhe për pasojat, por ne i bëjmë reformat që të prodhojnë pasoja pozitive e jo negative siç po bëhet, siç po ndodhë me reformat tona.

Dikush e krahasoi me Evropën! Po ne e dimë që jemi larg Evropës, e arsimi nuk mund të jetë në shkallën e arsimit evropian.

Dikush tha se opozita po e pengon pushtetin që ta rregullojë arsimin, ta zhvillojë arsimin, ta fuqizojë shkollën e tjera – e tjera. S’është e vërtetë absolutisht, sepse çështja e arsimit nuk është çështje e pushtetit dhe e koalicionit por është çështje e gjithë shoqërisë – e Kosovës, pra edhe e opozitës, sepse unë konsideroj se opozita është pjesë e kësaj shoqërie, pjesë e këtij pushteti edhe pse nuk është në qeverisje, nuk është në pozitë.

Prandaj, harrone atë punë se po ju pengon opozita. Po e pengoni vetveten. Sepse, nëse merret mosha e drejtorëve, që keni zgjedhur ju që po bëni reforma, mesatarja e moshës së drejtorëve të shkollave sigurisht se është mbi 50 vjeç dhe janë të gjithë ish militantë e fanatikë të asaj partie të famshme që e dimë të gjithë, prandaj me ta reforma nuk bëhet, zotëri të nderuar. Nuk është opozita që ua ka vënë ata drejtorë në krye, por i keni vënë vetë. Njerëz të harxhuar, të konsumuar, që janë dogmatikë dhe nuk mund ta bartin reformën. Prandaj, hapni sytë, mos harroni se reforma nuk bëhet me njerëz të harxhuar, me njerëz të moshës mbi 50 a 60 vjeçare, të cilët duhet të shkojnë në pension. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit. E ka fjalën Ministri i arsimit, Veliu.

AGIM VELIU: Faleminderit kryesues.

Falënderoj të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës, të cilët, me diskutimet e tyre – po i kontribuojnë përmbylljes së reformës në arsimin parauniversitar. Edhe pse e thash në fjalën hyrjes se nuk është fjala për reformë të një klase për hyrje në reformë, por është fjala për përmbylljen e reformës e cila përmbyllet me klasën e pestë.

Të gjithë ata deputetë, të cilët kanë votuar Ligjin e arsimit fillor e të mesëm dhe tash dalin kundër reformës, me ta nuk pajtohem assesi. I thërras ata që t’i shqyrtojnë mendimet dhe diskutimet e veta.

Nuk pajtohem, po ashtu, me ata që thonë se reforma është nisë pa përgatitje, po përfundohet pa përgatitje e bile ka të atillë se nuk e dinë ku jemi, ka të atillë që thanë si deputetë të Parlamentit të Kosovës – po flitet se po hymë në reformë, a fjala është për përmbylljen e reformës, kështu që këto qëndrime nuk më janë të qarta.

Nuk pajtohem me ata që konstatojnë se Ministria e Arsimit, gjegjësisht arsimi kosovar po përmbyll reformën pa përgatitje të duhura. Unë që në fillim ju informova se Ministria e Arsimit, me ekspertë të Kosovës, me ekspertët më të mirë të arsimit që ka, e ka hartuar Planprogramin për klasën e pestë me kohë. Planprogrami ka përfunduar së hartuari në dhjetor të vitit 2005, ndërsa është autorizuar nga Ministria e Arsimit në janar të vitit 2006 dhe i tërë viti 2006 ka qenë vit në të cilin arsimtarët e Kosovës janë njohur me Planprogramin e ri për klasën e pestë dhe për përmbylljen e reformës.

Po diskutohet shumë për Udhëzimin administrativ të cilin e ka nxjerrë Ministria e Arsimit në qershor të këtij viti. Udhëzimi administrativ nuk është asgjë tjetër veç një urdhëresë, me të cilën zbatohet Ligji të cilin e ka aprovuar ky Kuvend dhe komunat e Kosovës, me kërkesat e të cilave është aprovuar dhe nga Ministri iu jepen udhëzime të nevojshme si të veprohet në implementimin e kësaj, gjegjësisht për përmbylljen e reformës. Aty kategorizohen ata arsimtarë që mund ta kenë të drejtën të pranohen në sistemin arsimor, me kualifikime përkatëse, e po ashtu është lënë edhe një fleksibilitet për arsye se është herë e parë e përmbylljes së reformës, që do të thotë se përveç mësuesit klasor për lëndët që nuk kanë përgatitje të mjaftueshme - mësim të japin arsimtarët lëndorë të cilët deri më tani kanë punuar me klasat e pesta. Kështu edhe është vepruar në tërë Kosovën, aty ku kemi pasur zgjedhje të mirë me mësuesin e klasës e kemi bërë, e aty ku nuk kemi pasur kemi lejuar disa lëndë – si matematika, gjuha apo ndonjë tjetër – t’i japë me përparësi mësuesi gjegjësisht arsimtari që ka punuar deri këtë vit me klasat e pesta.

Edhe një herë po e theksoj me kënaqësi, që asnjë arsimtar i diplomuar nuk ka mbetur pa punë. Ne kemi premtuar, premtimin e kemi mbajtur – asnjë arsimtar i kualifikuar nuk ka mbetur pa punë.

Mund të ketë mbetur ndonjë punëtor arsimi pa kualifikim dhe ka mundësi që ndonjë arsimtar i kualifikuar të mbetet pa punë për arsye se ka refuzuar një punë të cilën ia ka ofruar drejtoria komunale. Deri sot ka punuar në një shkollë, ndërsa drejtoria komunale, i ka ofruar të punësohet në një shkollë tjetër, që do të thotë se ka raste kur njerëzit refuzojnë ta ndërrojnë mjedisin.

Më duhet të jap sqarim edhe për një të pavërtetë, që u fol këtu nga zoti Hoxhaj. Korniza e kurikulit të ri në Kosovë apo siç quhet “libri i bardhë”, është aprovuar në vitin 2001 nga Departamenti i atëhershëm i arsimit, që udhëhiqej nga UNMIK-u. Më vonë, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar, në bazë të informacioneve që unë i kam, diku në shtator të vitit 2002, kurse e konsideroj si të aprovuar dhe të nënshkruar me aprovimin e Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm në vitin 2002 nga Shtajneri për arsye se Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm është aprovuar në bazë të kurikulit të ri apo “librit të bardhë”. Në këtë dokument kanë marrë pjesë rreth 215 ekspertë vendor dhe ndërkombëtar. 30 ekspertë ndërkombëtar kanë qenë nga Shqipëria, nga Sllovenia, Bosnja, Turqia, Shtetet e Bashkuara, Anglia, Kanadaja, Gjermania, Austria, Franca e tjera.

U përmendën edhe disa çështje që më tepër janë politike si për shembull rasti i Dragashit. Atje ekziston problemi edhe politik edhe ligjor. Arsimtarët e komunitetit atje, i refuzojnë planprogramet e Kosovës dhe vazhdojnë të punojnë me planprograme e ligje të një shteti që, për ne, është i huaj. Domethënë këtu kemi edhe problemin politik, edhe problemin ligjor. Ata refuzojnë, po ashtu, t’i nënshkruajnë kontratat me drejtoritë komunale, e dihet se s’ekziston mundësi që dikush të punojë pa kontratë pune.

Për kuadrin. Me udhëzimin administrativ, ne kemi përcaktuar kualifikimet e kuadrit të cilat mund të punojnë me klasën e pestë dhe kuadri, në bazë të ligjit, siç dihet është përgjegjësi e komunave dhe jo e Ministrisë së arsimit. Komunat e Kosovës e kanë këtë të drejtë të punësimit dhe të zgjedhjes së kuadrit, mirëpo gjithnjë duke u bazuar në ligje. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Për replikë për fjalën e Ministrisë, janë paraqitur deputeti Enver Hoxhaj dhe deputetja Vezira Emrush. E ka fjalën deputeti Enver Hoxhaj.

ENVER HOXHAI: I nderuar kryesues, i nderuari – ose të nderuar ministra, të nderuar deputetë,

Është një fat që në Kuvendin e Kosovës mund të komunikohet me mesazhe jashtë Kuvendit të Kosovës dhe të informohet Ministri për ngjarjet që ndodhin në Ministrinë e tij dhe që ndodhin edhe në Kuvendin e Kosovës.

Formulimi im ishte shumë preciz. Dokumenti Kornizë kurikulare nuk është miratuar në Qeveri të Kosovës. Mirëpo, është fat sikur thash, që Ministri t'mund të informohet në n ndërkohë dhe të thotë diç të tillë.

Problemin që e kemi ngritur ne, dhe unë ju kisha lutur për mirëkuptim, sepse vërtet ka të bëjë me arsimtarët. Shumica e deputetëve kanë debatuar, edhe Ministri, për klasën e pestë, për kohën kur e kanë kryer vetë klasën e pestë. Jo, për kohën e klasës së pestë sot. Këta flasin për klasën e pestë, në kohën se si ka qenë klasa e pestë.

Pa hyrë në debat të detajshëm, unë përsëri jam i interesuar që të kërkojë nga Ministria e Arsimit që të zbatojë këtë kornizë kurikulare, që s'e ka zbatuar deri më tash, që t'i zbatojë rekomandimet që kanë dalë prej seancës së Kuvendit të Kosovës ku në mënyrë decitive përmendet klasa e pestë. Ne çdo vit shkollor e kemi përfunduar dhe filluar pa një analizë të çdo klase dhe për rastin konkret ne kërkojmë që brenda një muaji të analizohet çka po ndodhë me klasën e pestë. Cilët arsimtarë, çfarë lëndë po japin, do të thotë mësimdhënia. Sa është efektiv procesi i mësimzënies dhe sa është efektiv vlerësimi i dije.

Meqë tema që u ngrit është e ndjeshme dhe askush nuk është kundër reformës.....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Mund t'ia zgjasim kohën për edhe një minut.

ENVER HOXHAI: ...Do të thotë, fjalja e fundit, ne jemi për vazhdimin e klasës së pestë. Shqetësim kemi pasur për mënyrën se si është organizuar klasa e pestë. Kisha lutur Ministrin, kisha lutur deputetët mos ta rikujtojnë klasën e pestë kur e kanë kaluar vetë, por ta marrim këtë çështje më seriozisht, të shohim se si ofrohet matematika aty, se si ofrohet gjuha e huaj aty, çfarë përmbajtje ka për gjuhën e huaj dhe nëse doni mund kemi debat shumë të detajshëm për një çështje të tillë, si ofrohet muzika, si ofrohet arti dhe sa të kualifikuar janë arsimtarët që japin mësimin klasor. Çështja është më serioze sesa mendojmë, kështu që kërkesa e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës është që, vërtetë ato sugjerime që ne i ofruam, të merren në konsideratë nga ana e Ministrisë.

KRYESUESI: Faleminderit. E ka fjalën Ministri Veliu.

AGIM VELIU: Unë mund të pajtohem që Ministria e Arsimit ta shqyrtojë si po ecën, si po përmbillet reforma dhe gjithsesi kjo është në planin e veprimit të Ministrisë së Arsimit, por nuk mund të pajtohem me kërkesat që udhëheqësi i Departamentit të arsimit në kabinetin e qeverisjes së mirë i bënë vazhdimisht, sepse ato kërkesa ose janë në proces të Ministrisë së Arsimit ose janë në përfundim. Këtë e kemi në plan, dhe sigurisht Ministria e Arsimit do ta shqyrtojë se si po përmbillet reforma. Po ashtu, ka në plan rishqyrtimin e planprogrameve jo vetëm të klasës së pestë por të të gjitha planprogrameve që janë aprovuar deri tani në Kosovë dhe janë planprograme të reja pas luftës, të bazuara në dokumentin që ju e përmendët "libri i bardhë" dhe thoni se "është një dokument i mirë por nuk po zbatohet", ose që "është dokument i mirë por nuk është meritë e Ministrisë por meritë e" ku ta di kujt, kështu që të

gjitha punët e mira që bëhen kinse “nuk janë meritë e Ministrisë”, ndërsa nëse janë të këqijat duhet të jenë edhe të mirat. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër. E ka fjalën deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Ponovo pozdravljam sve prisutne, Imam konkretno pitanje za gospodina ministra. On je doslovce rekao da u Gori postoji problem odbijanja potpisivanja ugovora sa MONT-om. To nije tačno. Prvo, taj ugovor koji se nudi, gospodin Ministar... jako je žalosno da ne zna da gore ima nastavu na albanskom, nastavu na bošnjačkom i nastavu na srpskom jeziku. To se ne dešava sa nastavom na bošnjačkom, sa nastavom na albanskom, to se dešava sa nastavom na srpskom jeziku. Znači, svi ugovori koji su tamo nudjeni, nudjeni su na bošnjačkom jeziku. Oduzeto je pravo. Ovde je problem jezik, nije problem ugovor. Da li su ti isti ugovori nudjeni.... Ja pitam gospodina ministra, da li su ugovori isti svuda? Da li je sa tim ugovorima gospodin ministar bio na terenu u Mitrovici – severnoj Mitrovici, u Gračanici? I to je Kosovo. Da li je tamo nudio te ugovore? To je pitanje za ministra. Trenutno se čini jedan veliki pritisak na jednu malu zajednicu koja je raseljena i ja molim ministra da kaže da li je bila obnova ugovora od strane MONT-a sa Srpskom zajednicom koja se školuje isto na srpskom jeziku kao i mi gore u Gori?

KRYESUESI: Ju faleminderit. Fjalën e ka zoti, Genc Gorani, përfaqësues i interpelancës.

GENC GORANI: Faleminderit, zoti kryesues. Më falni për vonesën, por zoti Ministri deshi t’ma transmetojë një pjesë të përgjegjës të cilën unë do ta marrë parasysht në këtë përmbyllje të interpelancës. Ju faleminderit zoti Ministër.

Së pari kisha dashur të falënderoj të gjithë kolegët deputetë të cilët e kanë përkrahur këtë interpelancë me debatet e tyre. Mendoj se ka qenë relativisht përmbytjesore, ka mund të jetë edhe më tepër. Supozoj se vetë faza paraelektorale e ka bërë të veten. Shihet se kërkesa për interpelancë ka qenë e arsyeshme dhe kjo është gjithë e rëndësishme. Shihet se ka pasur çështje të rëndësishme, e në rend të parë mungesë të një komunikimi të mjaftueshëm, dhe mendoj se kjo është potencuar nga disa kolegë. Ka pasur propozime e sugjerime, të cilat i përkrahim në përgjithësi, e veçanërisht ato që kanë të bëjnë me monitorimin e realizimit të kësaj reforme, ose përmbyllje të kësaj reforme, siç po themi.

Megjithëkëtë, më duhet të konstatoj me keqardhje se në disa momente, edhe nga vetë Ministri, është kaluar në gjuhë të fushatës. Në tekstin e interpelancës, e kam përmendur emrin e subjektit tim politik vetëm një herë, jo rastësisht. S’është qëllimi të bëjmë fushatë prej kësaj. Ka mjaft elemente për debat të mirëfilltë, absolutisht jashtë kontekstit të fushatës. Ndërkaq, Ministri e përmendi në fund atë se thuaja i gjithë qëllimi ka qenë në një kontekst fushate të ngushtë të vetëm një subjekti politik. Për fat, debati e vërtetoi të kundërtën, jam i bindur.

Po ashtu, në tekstin e interpelancës, jo në tekstin original, por në këtë tekst që e lexova këtu, kam shtruar 11 pyetje. Për shumicën e pyetjeve, nuk kam marrë përgjigje. Vetëm për çështjen e trajnimit, ku është përmend se 1.500 arsimtarë janë trajnuar, por nuk kam informatë se sa janë trajnuar. Për shembull, a janë trajnuar ata arsimtarë me tekstin e ri shkollor. Sepse, u përmend, nga zoti Ministër se planprogrami është botuar që në muajin janar të vitit 2006. Dakord, shumë në rregull. Por arsimtarët e rinj, 850 që janë përmendur nga Ministri, janë rekrutuar vetëm rishtas dhe tekstet shkollore është pikëpyetje a kanë qenë botuar në atë kohë. Ministri nuk na e sqaroi këtë problem.

Në pyetjen e parë: a ka pasur planveprim për realizimin e reformës, nuk kam marrë përgjigje. Dhe, duhet t'i përgjigjem se, s'ka pasur.

Në pyetjen e dytë: a janë konsultuar këshillat e prindërve dhe ku janë përfundimet e këtyre konsultimeve, cili është ai dokument – s'ka pasur përgjigje. Dhe duhet të përgjigjem se, s'ka pasur rezultat prej kësaj.

Në pyetjen e gjashtë: deri dy javë para fillimit të vitit shkollor tekstet shkollore për klasat e pesta ishin ende të pabotuara. A është kjo vonesë, apo ka pasur farë qëllimi. A është mirë kjo që është bërë ashtu? Nuk e kuptova prej fjalës së Ministrit.

Sa arsimtarë të rinj janë punësuar, e kuptuam. Mirëpo, s'është e qartë faktikisht se si është realizuar risistemimi i arsimtarëve të cilët kanë qenë të prekur. Nuk e di sa. Thotë se, asnjë s'e ka humbur punën prej tyre të cilët kanë qenë të kualifikuar. Pres një raport, besoj se ky raport do të vihet dhe nëse ka probleme, besoj se kjo çështje do të kthehet prapë këtu.

Në fund: kur është bërë çështja e kostos së realizimit të kësaj reforme? Përgjigja është jashtëzakonisht e mjegullt. Nuk është e pranueshme që një ministër me thënë ka kushtuar diçka pak apo shumë ose mjaft dhe arsyetohet. Ne na duhen shifrat konkrete. Madje, nëse ka probleme buxhetore këtu në këtë Kuvend, ne mund të ndihmojmë.

Po i kthehem problemit shumë të rëndësishëm të komunikimit. Është çështje e rëndësishme. Nëse një ministri nuk din t'i komunikojë veprimet dhe rezultatet pozitive si pretendon, ky është problem politik sepse ne atëherë bartim një problem, i cili mund të jetë kryekëput teknik, në rrafshet tera dhe atëherë kthehet në një problem politik i cili, jo gjithherë, mund t'na ndihmojë në zgjidhjen e problemeve.

Sipas Rregullores, në tekstin e interpelancës, ne kemi propozuar, kemi bërë rekomandime. Këtë rekomandim nuk mund ta ndërrojmë. Ne mund, ose të heqim dorë nga rekomandimi, ose ta vëmë në votim.

Sipas vlerësimit tonë dhe sipas vlerësimit të plotë kolegëve këtu, kjo reformë, përmbyllja e kësaj reforme – ta quajmë si të doni – s'ka qenë e përgatitur me kujdes. Ka pasur kohë të mjaftueshme dhe ka pasur edhe mjete të mjaftueshme që kjo reformë të përgatitet si duhet. Kjo s'është kryer! Arsyet pse s'është kryer në këtë mënyrë, nuk i kemi dëgjuar këtu.

Andaj, përsëris kërkesën që të vëhet në votim ky rekomandim:

- Të shtyhet zbatimi i Udhëzimit administrativ në vitin shkollor 2008, për shkak të përgatitjeve të pamjaftueshme për zbatimin e saj, si dhe pasojave të rënda negative ndaj nxënësve, arsimtarëve dhe procesit mësimor në përgjithësi dhe për t'i siguruar kushtet paraprake optimale për realizimin e suksesshëm të përmbylljes së kësaj reforme.

Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI: Ju faleminderit.

Interpelanca ka marrë fund.

Vë në votim Rekomandimin e Grupit Parlamentar të Partisë Reformiste ORA.

Ju ftoj, të deklarojeni me votim, kush është “për” dhe kush është “kundër” këtij rekomandimi.

Kërkoni ta lexojë? Kërkesë e Grupit Parlamentar ORA është: Të shtyhet zbatimi i Udhëzimit administrativ në vitin shkollor 2008.

Këtë rekomandim e vëmë në votim. Propozuesi sqaroi rekomandimin.
Ju lutem, deklarohuni!

Regjia, ju lutem të jeni gati për votim.

(Polemikë – nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYESUESI: Sipas Rregullës 25 pika 9, jam i obliguar ta vë në votim Rekomandimin e Grupit Parlamentar. Ju mund të deklaroheni me votë a jeni për apo kundër.

Regjia, ju lus të jeni gati.

Vë në votim Rekomandimin e Grupit Parlamentar.

Të pranishëm në sallë janë 77 deputetë.

(Ndërhyrje nga vendi, nuk dëgjohet)

Jo, deputetët janë të numëruar, zonja Kelmendi. S'është problem, kemi njerëz që na informojnë sa janë të pranishëm.

Votojmë tash.

Konstatoj se me 39 vota kundër dhe 11 vota “për”, Rekomandimi i Grupit Parlamentar ORA nuk miratohet.

Tash do të bëjmë pauzë deri në orën 14:00.

(Vijon pauza)

(Pas pauze, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI: Jemi duke pritur, sepse s'kemi kuorum. Në sallë janë vetëm 50 deputetë .Po presim edhe pak.

Në radhë e kemi pikën e katërt të rendit të ditës. Meqenëse nuk është ministri këtu, do ta lemë për më vonë, si pikë të tetë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën jokontestimore.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 29 gusht 2007, kështu që janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimit e tij në parim.

Në sallë tash janë 64 deputetë.

Ftoj ministrin Salihaj ta prezantojë ligjin.

JONUZ SALIHAI : I nderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Ekspozeja ime për këto projektligje do të fokusohet shkurtimisht në disa nga aspektet përgatitore dhe përmbajtjesore të këtyre projektligjeve. Më lejoni që fillimisht të them se përgatitja e projektligjeve për procedurën kontestimore, jo kontestimore dhe përmbartuese, është rezultat i mirë i punës dhe i bashkëpunimit të ekspertëve të njohur kosovarë dhe i atyre ndërkombëtarë, si dhe i përkushtimit për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e përgjegjësive që kemi si Ministri e Drejtësisë në gjendjen shumë delikate sa i përket sistemit të drejtësisë nëpër të cilën ka kaluar dhe po kalon Kosova e ballafaquar me vështirësi të shumta të gjyqësorit për zgjedhjen e problemeve pronësore juridike, si dhe të fushës civile në përgjithësi ku të dhënat flasin për vonesa në mbi njëqind mijë lëndë të pazgjidhura ku shumica e konsideruar janë të natyrës civile- juridike. Projektligjet për procedurën kontestimore, jokontestimore dhe përmbartuese paraqesin jo vetëm një masë ndihmëse, por edhe një domosdoshmëri. Kjo për faktin se këto janë ligje të reja dhe moderne, janë ndërhyrje komplementare e fuqishme në përmirësimin e gjendjes të sistemit gjyqësor dhe stimulimin e konceptioneve të reja për zgjidhjen e kontesteve të ndryshme, pa cilat sot nuk mund të paramendohet sundimi i ligjit dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik as në vendet më të përparuara të botës.

Kisha pasur dëshirë të më dëgjoni pak. Të nderuar deputetë. Më lejoni t'ju përkujtoj se tri projektligje të tilla janë përgatitur para jush, më shumë se dy vjet më parë, atëherë kur nuk kishte fare Ministri të Drejtësisë. Mirëpo, gjatë vitit 2005 ato janë kthyer nga Kuvendi i Kosovës për ripunim në Qeveri, pas kërkesës së UNMIK-ut, për shkak të mungesës së kompetencës, si dhe gabimeve dhe të metave që këta zyrtarë të Zyrës Ligjore të PSSP-së i kanë konstatuar.

Në këtë kontekst ne besojmë se Ministria e Drejtësisë, duke qenë përgjegjëse në këtë fushë, në bazë të përgjegjësisë të dhëna me anë të Rregullores 2005/53 dhe 2006/26 për plotësimin e Rregullores për themelimin e Degës së Ekzekutivit, ka bërë plotësimet dhe ndryshimet e nevojshme, duke pasur parasysh edhe rekomandimet e Kuvendit të Kosovës, me rastin e kthimit të tyre për ripunim, si dhe ka kompletuar përmbajtjen e atyre në masë të konsiderueshme. Këto projektligje janë përgatitur nga ekspertët e shquar të Kosovës, duke përfshirë profesorë të Fakultetit të Drejtësisë, gjyqtarë më eminentë të Kosovës, nga Gjykata Supreme, Gjykata e Qarkut dhe ato komunale, Qeveria dhe nga Ministria e Drejtësisë, si dhe për ekspertë të huaj, të gjithë këta njohës të mirë të fushës civile, sidomos të asaj procedurës civile. ...

KRYETARI: Ministër, po flisni për këto tri ligjet, apo për çfarë?

Këto projektligje përcaktojnë parimet themelore prej momentit të inicimit të procedurës, qoftë asaj kontestimore apo jokontestimore e deri te përmbarimi i tyre në procedurën përmbartuese. Projektligji për procedurën kontestimore rregullon procedurën kontestimore nga aspekti formal dhe material, kompetencën e gjykatave, mjetet dhe objektin e kësaj procedure gjyqësore për bërjen e gjykatës dhe procesin gjyqësor, afatet dhe përmbartueshmërinë. Risi paraqet rregullimi modern i kontestit me element ndërkombëtar, pastaj vazhdon me modernizimin e statusit të gjyqtarit dhe përjashtimin e tij, palët dhe rolin e tyre, përfaqësimin me prokurë të palëve, shkresat dhe parashtresat e domosdoshme për procedurë, komunikimi me anë të shkresave nga palët me gjykatën dhe e kundërta, mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të goditjes etj.

Duke lexuar përmbajtjen e këtyre do të konstatojmë se ato synojnë krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore për zëvendësimin e një legjislacioni të zbatueshëm i cili është trashëguar nga sistemi i kaluar...

KRYETARI: Zoti. ministër, ju lutem flisni vetëm për një ligj, Projektligjin për procedurën jokontestimore.

JONUZ SALIHAI: Unë po flas në parim për tri projektligjet, mandej do të flas për secilin veç e veç. Andaj, përfundimisht ,besoj se fuqizimi i këtyre projektligjeve është i një rëndësie të veçantë, sepse do t'i hapte rrugën shtimit të efikasitetit të punës të gjyqësorit,gjë e cila do të ndikonte në parandalimin e kryerjes së vetë gjyqësisë nga ana gjyqtarëve për shkak të zvarritjes së procedurave gjyqësore civile, si dhe në shtimi e besimit të gjyqtarëve në gjykatat tona.

Projektligjet janë mjaftë voluminoze dhe rregullojnë në tërësi fushën e së drejtës procedurale civile, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së fjalën e ka Sadudin Berisha.

SADUDIN BERISHA: I nderuari kryetar i Kuvendit , të nderuar ministra, kolegë deputetë! Grupi Parlamentar i LDK-së së Kosovës ka mirëpritur këtë prezantim të ministrit të Drejtësisë për shqyrtim të parë të Projektligjit për procedurën jokontestimore, që bie në kuadër të ligjeve bazike apo sistimore të legjislacionit të Kosovës. Që në fillim dua të theksoj se Grupi Parlamentar i LDK-së i jep përkrahje të plotë këtij projektligji për procedim të mëtejshëm, pas përkrahjes që do t'i bëhet në këtë takim.

I nderuari kryetar. Projektligji për procedurën jokontestimore për fushën që rregullon është një ligj që përfshinë më se 282 nene që tregojnë se është një projektligj që rregullon një fushë të gjerë të marrëdhënieve përmes rregullave të caktuara procedurale, sipas të cilave gjykatat vendosin për të drejtat dhe interesat personale- familjare dhe pasurore që zgjidhen në procedurën jashtë kontestimore. Ky projektligj ndryshon nga zgjidhjet e deritanishme jo të standardizuara dhe të paharmonizuara me rregullat dhe direktivat e Bashkimit Evropian, ofron rregulla procedurale shumë më të avancuara , më funksionale dhe më efikase , praktika të reja procedurale në përputhshmëri me praktikat ndërkombëtare. Rëndësia e veçantë e këtij projektligji është se shfuqizon Ligjin për procedurën jokontestimore të vitit 1986, sepse ky ligj nuk përkon fare me rrethanat e reja për dallim nga projektligji që sot e kemi në diskotekë.

Struktura normative e këtij projektligji është e rregulluar mirë, duke e vlerësuar qartë që nga nisma rreth mundësisë të iniciojë procedurën jokontestimore kush mund të jetë pjesëmarrës në një procedurë të tillë e kështu radhazi, duke u precizuar çdo fazë e zhvillimit të procedurës jokontestimore. Në pjesën e dytë të Projektligjit ku përfshihen rregullimi i gjendjes personale, rregullimi i marrëdhënieve familjare, si dhe shqyrtimi i pasurisë trashëgimtare, vlerësimi ynë është se marrëdhëniet personale, familjare dhe pasurore janë të rregulluara relativisht mirë, megjithatë vlerësojmë se kontributi i Grupit Parlamentar të LDK do të jetë konkret dhe më i madh në fazën e amendamentimit të projektligjit, pas miratimit në parim të tij.

I nderuari kryetar. Në fund theksoj se Grupi Parlamentar i LDK-së i jep përkrahje miratimit në parim të këtij projektligji dhe falënderon Ministrinë për punën e deritanishme. Ju faleminderit!.

KRYETARI: Hydajet Hyseni, në emër të PDK-së.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar,
Zonja dhe zotërinj deputetë,
I nderuari ministër,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës që në krye të punës i jep mbështetje Ligjit për procedurën jo kontestimore dhe pakos së ligjeve që i ka paraqitur sot Ministria e Drejtësisë edhe përkundër vërejtjeve që kemi në këto ligje.

Edhe këto ligje po na procedohen, pa një strategji unike dhe pa një program të harmonizuar legjislativ. Për pasojë po na ndodh që të miratojmë ligje specifike, pa i pasur ligjet themelore. Kjo për pasojë, rrezikon pastaj edhe të dëmtojë koherencën e sistemit legjislativ në Kosovën e re. Por, duke pasur parasysh faktin se procesi ligjvënës në Kosovë ende ndodhet në një fazë të zhvillimit ekstensiv, si dhe kufizimet jo vetëm objektive që po na shoqërojnë, por edhe ato të tjera që po na imponohen me disa kompetenca të rezervuara, herë të transferuara e pastaj të konservuara e të rikthyera e tjera, mendojmë se është e justifikueshme që ne t'i miratojmë në parim projektligjet edhe kështu siç janë, kurse gjatë procesit të amendamentimit edhe të kontribuojnë në përmirësimin e tyre. Meqë sponsor i këtyre ligjeve është Ministria e Drejtësisë, është edhe e drejtë që të kërkojmë pak më tepër sa i përket rregullsisë, madje edhe metodologjisë ligjvënëse, asaj standarde që mund të shërbejë pastaj edhe si model për ministritë dhe zyrat ligjore të ministrive të tjera se si bëhen ligjet. Nuk mund që në një pako të ligjeve edhe në vetë titullin e ligjit, në njërin ligj të jetë një formë, në tjetrin një formë tjetër. Jemi deklaruar për një formë standarde ose edhe në dispozitat përfundimtare të vërehet i njëjti fenomen. Shpresojmë, megjithatë se të gjitha këto do t'i korrigjojmë në procesin e amendamentimit dhe si të tillë ne si grup parlamentar e mbështesim. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Në emër të AAK-së Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!

I nderuari zotëri Kryetar,
Të nderuar ministra,
Deputetë të nderuar,

Projektligji për procedurën jokontestimore është i nevojshëm për plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e së drejtës procedurale civile. Në këtë aspekt ne vlerësojmë kontributin e Ministrisë së Drejtësisë në përpjekjet për të kompletuar këtë fushë me legjislacion modern dhe praktik. Projektligji ka për qëllim t'i rregullojë procedurat, sipas të cilave gjykatat veprojnë dhe vendosin për të drejtat dhe interesat personale, familjare dhe pasurore. Projektligji është voluminoz. Ka pesë pjesë të mëdha dhe 282 nene. Po ashtu, ky projektligj modernizon dhe lehtëson procedurën jokontestimore dhe është në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe ato evropiane. Sa i përket zbatueshmërisë së ligjit, në bazë të deklaratës për implikim buxhetor, projektligji është i përballueshëm për buxhetin e Kosovës. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet këtë projektligj në parim dhe do të angazhohemi për përpunimin e tij të mëtejshëm në Komisionin përkatës. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Në emër të ORA-s Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit zoti kryetar!

Sa i përket Projektligjit për procedurën jokontestimore edhe Grupi Parlamentar ORA e ka analizuar këtë ligj dhe mendojmë se është një ligj i cili është shumë i nevojshëm për

funksionimin e mirëfilltë të sistemit gjyqësor të Kosovës. Por, gjithsesi, kishim dashur të cekim se edhe ky ligj për të qenë ligj sa më kompatibil dhe sa më koherent me kohën e sotme e cila ka ndryshuar prej 86-ashtës kur është ligji përpara këtij që ka qenë, mendojmë që në bazë të kësaj duhet t'i jepet kohë edhe grupeve të interesit, duhet të mbahen edhe dëgjimet publike, në mënyrë që ligji të jetë sa më i mirë për shfrytëzim. Prandaj, si grup parlamentar i japim përkrahjen në parim këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Në emër të LDD-së ,Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI: I nderuari kryetar,
Të nderuar ministra prezentë, deputetë, kolegë,
Grupi Parlamentar i LDD-së., pasi që bëri shqyrtimin e Propozim ligjit për procedurën jokontestimore vlerësoi, më sa vijon:

1. Se Ministria e Drejtësisë dhe Komisioni Hartues i Propozim ligjit kanë bërë një punë të çmuar në hartimin dhe prezantimin e Propozim ligjit për procedurën jokontestimore për debat parimor në seancën e Kuvendit të Kosovës.
2. Mungesa e Ligjit për procedurën jokontestimore dhe aplikimi i ligjit të vjetër dhe i Rregullores së UNMIK-ut e cila rregullon këtë materie, kanë shkaktuar probleme në raportin jokontestimor në të cilën gjykatat vendosnin për të drejtat dhe interesat personale- familjare, pasurore në procedurën jokontestimore. Andaj ky propozim jep shanse për t'i eliminuar këto. Ky propozim ligj i procedurës jokontestimore, në mënyrë shumë të qartë, të kuptueshme dhe të realizueshme, përcakton rregullat procedurale në mbështetje të cilave gjykatat në Kosovë do të vendosin për të drejtat dhe interesat personale- familjare, pasurore në procedurën jokontestimore. Bazuar në këto argumente Grupi Parlamentar i LDD-së, në parim përkrah miratimin në lexim të parë për procedim të mëtutjeshëm të Propozim ligjit për procedurat jokontestimore, sepse, nevoja për këtë ligj është e domosdoshme, ngase Kosova po kalon në një realitet të ri të marrëdhënieve ekonomiko –shoqërore, gjë që kushtëzon që edhe procedura jokontestimore t'i përshtatet rrethanave të reja që po krijohen. Ligji i vjetër është shumë i ngarkuar në zgjidhjen juridike të një sistemi të kaluar ekonomiko- shoqëror dhe ai nuk mund t'i përmbushë nevojat bashkëkohore juridike të procedurës jokontestimore. Zgjidhja e çështjeve civile rëndon punën faktike të gjykatave, në mungesë të Ligjit për procedurën jokontestimore, kontestimore dhe përmbaruese, andaj, pas miratimit të këtyre ligjeve themelore të fushës civile si mjaft të komplikuar në vendosje, do të jetë më e lehtë dhe e bazuar për të vendosur në të ardhmen gjykatat të lidhen me problemet që i trajtojnë.

Propozim ligji i procedurës jokontestimore, i propozuar, mund të zbatohet në strukturën dhe organizimin e tanishëm të Ministrisë të Drejtësisë dhe gjykatave, por kjo nuk do të thotë se nuk duhet bërë reforma të mëtutjeshme në drejtësi dhe gjyqësi. Këto tri propozim ligje që sot po i debatojmë, rrumbullakojmë mundësinë e veprimit juridik nga ana e gjykatave në sferën civile dhe në jetën praktike. Ne vlerësojmë se kreu i tretë i Propozim ligjit për procedurat jokontestimore duhet ripunuar, ngase shpallja, zhdukja ose vdekja e një personi dhe të provuarit e vdekjes, nuk duhet aplikuar në rastet e të pagjeturve në Kosovë, eshtrat e të cilëve tani mbahen në Serbi dhe është temë mjaft e hapur. Mëgjithë këto ,Grupi Parlamentar i LDD-s, kontributin e vet do ta japë në Komisionin Funksional në këtë drejtim, duke deklaruar edhe një herë se në parim përkrah miratimin e Propozim ligjit të procedurës jokontestimore. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Në emër të Grupit për Integrim Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Mi smo pažljivo razmotrili sva tri zakona koja su nam danas data ovde u paketu i u potpunosti podržavamo iste zakone, Zakon o vanparničnom postupku, Zakon o parničnom postupku i Zakon o izvršnom postupku. Mislim da su danas preko potrebni našem kosovskom društvu kako bi počelo da funkcioniše Kosovo kao pravna država i sudstvo, Ministarstvo pravde. U načelu podržavamo u potpunosti zakone i nadamo se da će u daljoj proceduri naši poslanici koji su članovi funkcionalnih komisija obratiti pažnju na činjenice koje su sada meni strane, ali verujem u svoje kolege i da će ovaj Zakon još više da dobije na dalju proceduru u svojoj doradi. Hvala!

KRYETARI : Ju faleminderit! Pasi nuk ka kandidat tjetër të paraqitur për diskutim, lus regjinë dhe deputetët të përgatitet për votim, në parim.

Votojmë tash: Në sallë, aktualisht, janë 67 deputetë.

Për.....53

Kundër..... 2

Miratohet projektligji në parim.

Pas miratimit në parim ,në bazë të rregullave 23 dhe 35 Kuvendi ngarkon këto komisione,

Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, si Komision Funksional dhe Raportues,
Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe
Komisionin për Komunitete.
Ju faleminderit!

Pika e gjatë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbaruese

Projektligji u është shpërndarë deputetëve, më 29 gusht 2007 dhe janë përmbushur të gjitha kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftoj ministrin Jonuz Salihaj që të paraqesë ekspozenë për projektligjin në fjalë.

JONUZ SALIHAI: Ju faleminderit kryetar. Do të flas pak më shkurtimisht se më parë. Kam nderin që në emër të Ministrisë të Drejtësisë t'ia paraqes për miratim në Kuvend të Kosovës Projektligjin për procedurën përmbaruese. Projektligji është rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj. Në gjendjen shumë delikate sa i përket sistemit të drejtësisë nëpër të cilin ka kaluar dhe po kalon Kosova e ballafaquar me vështirësi të shumta të gjyqësorit për zgjedhjen e çështjeve të ndryshme dhe të shumta të natyrës përmbaruese, Projektligji për procedurën përmbaruese paraqet jo vetëm një masë ndihmëse, por një domosdoshmëri, si për faktin se është një ligj i ri dhe modern, por edhe për faktin se ky ligj është ndërhyrje komplementare e fuqishme në përmirësimin e gjendjes së sistemit gjyqësor dhe stimulimin e koncepcioneve të reja për zgjedhjen e çështjeve të ndryshme dhe të shumta të cilat kanë të bëjnë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ,të cilat i kemi prezent në gjykatat tona, pa të cilat sot nuk mund të paramendohet , zbatimi i sundimit të ligjit.

Projektligji . thashë edhe më parë, praktikisht është kthyer nga Kuvendi i Kosovës dhe është ripunuar nga komisionet tona, sidomos nga Zyra Ligjore. Projektligji përcakton parimet

themelore, prej momentit të inicimit të procedurës përmbarese deri te përfundimi i saj, duke synuar krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore për zëvendësimin e legjislacionit të zbatueshëm i cili është trashëguar nga sistemi i kaluar ku shumë nga dispozitat ligjore të tij tani më vetëm janë të tejkaluara.

Fuqizimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë, sepse do t'i hapte rrugë shtimit të efikasitetit në punën e gjyqësorit, gjë e cila do të ndikonte në parandalimin e kryerjes së vetëgjyqësisë nga ana e qytetarëve për shkak të zvarritjes së procedurave gjyqësore – civile, si dhe do të ndikonte në shtimin e besimit të qytetarëve në gjykatat tona. Ky projektligj është me të vërtetë voluminoz, por rregullon në tërësi fushën e procedurës përmbarese, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare.

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë. Fuqizimi i këtij projektligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e Ministrisë së Drejtësisë, prandaj, besoj se ju do ta keni parasysh dhe do ta miratoni në leximin e parë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI : Ju faleminderit zoti Ministër. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ,Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: I nderuari zoti kryetar,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Është e vërtetë se ne kemi një projektligj të ri për procedurën e përmbarimit, mirëpo, t'ju them të vërtetën kam pritur se do ta kemi një ligj më funksional, më pak të komplikuar. Ky, përkundrazi, është edhe më i komplikuar se ai ligji i vjetër, sepse shumë gjëra i ka rregulluar e që nuk e kanë vendin këtu, si fjala vjen, përmirësimi i gabimeve të zyrtarëve apo si i quajmë ne referentëve të ekzekutimit.

Ai mund të rregullohet me ndonjë akt nënligjor ose me ndonjë rregullore të veçantë. Përndryshe, ky ligj, jashtë çdo dyshimi është se është më rëndësishmi ndër gjitha ligjet procedurale siç janë: Ligji për procedurën kontestimore, jashtë kontestimore, administrative, Ligji për konfliktin administrativ, procedurën e konfliktit administrativ e të tjera.

Kjo për faktin se askush nuk do të iniciojë ndonjë procedurë për realizimin e të drejtës së vet po të mos e priste finalen e tij e finalja është realizimi i vendimit për të drejtën të cilën e ka fituar në procedurë gjyqësore.

Për këtë arsye se ligji i mëparshëm ka qenë jashtëzakonisht i komplikuar dhe ka qenë shumë formal, me procedura shumë të ndërlikuara, kjo e bën që numri i lëndëve të pazgjidhura në gjykatë të arrijë në më se njëqind mijë lëndë, që pjesa më e madhe u përkasin ekzekutimeve.

Si do që të jetë, kur është në pyetje realizim i kërkesave me para, do të ishte mirë që të formohej një agjencion i veçantë, në mënyrë që ajo të shkojë me një procedurë më të shpejtë e jo t'i kalojë të gjitha procedurat sikur që parashihen me këtë ligj. Mendoj se kur është në pyetje titulli ekzekutiv , aktgjykimi apo vendimi i gjykatës, i cili është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm ,kundër tij nuk do të duhej të lejohej kundërshtimi. Nëse lejohet kundërshtimi, së paku nuk duhet të lejohet ankesa kundër vendimit për refuzimin e kundërshtimit, sepse këto janë momentet- faktorët që e zvarrisin realizimin e një kërkesë të një pale për të cilën edhe procedurat gjyqësore zvarriten. Pra, fajtori kryesor për zvarritjen e

procedurave është Ligji për përmbartimin. Prandaj, këtë ligj duhet ta përsosim edhe më tutje ,ta thjeshtësojmë , sepse është shumë i komplikuar, siç thashë edhe më shumë se ai i mëparshmi. Përndryshe, si grup parlamentar ne e përkrahim, por do të kemi shumë punë për ta bërë një ligj çfarë vërtet do ta bënte më funksionale procedurën e përmbartimit. Ju faleminderit!.

KRYETARI : Ju faleminderit! .Në emër të PDK-s,deputeti, Hydajet Hyseni..

HYDAJET HYSENI : I nderuar kryetar,
Zonja e zotërinj deputetë,
I nderuari ministër,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet në parim Projektligjin për procedurën përmbartuese.

Është tashmë e njohur për secilin se sistemi ynë i drejtësisë shoqërohet me shumë mangësi-anomali. Njëra nga më kryesorët është pikërisht mos përmbartimi i aktgjykimeve dhe i aktvendimeve të gjyqësorit. Është bërë tani edhe një rregull që gjyqësia jonë të kritikohet dhe të sulmohet herë me vend herë pa vend edhe në situata e raste që nuk lidhen drejtpërdrejt me funksionimin jo krejt të përsosur të gjyqësisë sonë. Por, është po aq e pa kontestueshme, le të jetë kjo edhe e vullnetit më të mirë dhe e pakontestueshme edhe kritikën që i bëhen drejtësisë sonë që për të kërkuar prej saj funksionalitet dhe efikasitet të plotë është e domosdoshme edhe që të krijohet baza e nevojshme ligjore. Dhe jo vetëm kjo, por edhe infrastruktura e duhur ligjore institucionale e shoqërore ,madje edhe ambienca e duhur shoqërore , që gjyqësia të jetë vërtet instrument efikas i sundimit të ligjit.

Ligji që ne po shqyrtojmë sot, besojmë se do të krijojë bazën ligjore për një progres në këtë drejtim dhe si të tillë Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet në parim dhe do të kontribuojë me vërejtjet e sugjerimet e tij gjatë procesit të amendamentimit. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Në emër të AAK-së, Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!
I nderuari zoti Kryetar, ministra,
Të nderuar deputetë,

Edhe Projektligji për procedurën përmbartuese është i rëndësishëm për plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e së drejtës procedurale civile. Qëllimi i këtij projektligji është që të modernizojë dhe lehtësojë procedurën e përmbartimit. Megjithatë, është e qartë se duhet ende të përpunohet ligji dhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ,duke marrë parasysh se ligji është i zbatueshëm për nga aspekti buxhetor e përkrah në parim dhe do të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm të tij. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit!Në emër të ORA -s ,Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit. Sa i përket Ligjit për procedurën përmbartuese ky ligj e plotëson, i ndihmon në plotësimin e një mozaikut të ligjeve shumë të rëndësishme, mungesa e të cilëve është vërejtur dhe ka shkaktuar pengesa dhe dëme, veçmas në rastet e

kontesteve në mes të bizneseve. Kjo sidomos kur bizneset kanë pasur konteste me institucione qeveritare dhe mungesa e tij ka shkaktuar zvarrite të ekzekutimit të vendimeve me ç'rast u ka shkaktuar dëme të konsiderueshme bizneseve të cilat në shumë raste kanë ardhur deri te pengesat e mëdha, ndoshta edhe deri te falimentimet për shkak të mungesës së Ligjit për procedurën përmbartuese. Prandaj, si të tillë, ne e mirëpresim ardhjen e këtij ligji në Kuvend, por përsëri insistojmë, sikur në ligjin paraprak, që para amendamentimit të organizohen dëgjimet publike, të përgatitura mirë me profesionistë, në mënyrë që ky ligj të jetë ligj i cili do t'i plotësojë nevojat e qytetarëve, të cilët kërkojnë për përmbartjen e këtij ligji. Prandaj, si grup parlamentar e përkrahim në parim dhe kontributin tonë në plotësimin e këtij ligji me amendamente, do ta japim përmes përfaqësuesve tonë në Komision. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Në emër të LDD-së Milazim Haliti.

MILAZIM HALITI: I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për procedurën përmbartuese dhe vlerëson se projektligji është i hartuar mirë nga grupi punues i Qeverisë, ku kanë punuar ekspertë, profesorë dhe gjyqtarë të mirënjohur dhe me përvojë. Nevoja për hartimin e këtij projektligji ka qenë i domosdoshme, sepse Ligji i vjetër nuk është i standardizuar me norma ndërkombëtare dhe si i tillë nuk mund t'u përshtatet nevojave të kohës. Projektligji është mjaft voluminoz dhe përmban dispozitat që rregullojnë përmbartimin e vendimeve të gjykatave civile, me ç'rast ato do të jenë më efikase për përmbartimin e këtyre vendimeve. Projektligji ka strukturën e duhur që fillon me dispozitat themelore, pastaj vazhdon me dispozitat përmbartuese që rregullojnë zbatimin e përmbartimit të vendimeve, mjetet e goditjes, procedurën kundër përmbartimit. Në vazhdim përfshijnë dispozitat që kanë të bëjnë me objektin e përmbartimit, realizimin e kredisë, përmbartimin për sendet e luajtshme dhe ato të paluajtshme për aksionet dhe pjesët në shoqëritë tregtare, duke përfunduar me përmbartimin e vendimit për kthimin e punëtorit në vendin e punës dhe përmbartimin e vendimit nga lëmi i të drejtës familjare.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete të shumta financiare, pasi që përmbartimi i vendimit të gjykatave civile zbatohet nga strukturat ekzistuese të tyre. Përkundër vlerësimit pozitiv që i bëhet këtij projektligji, ne mendojmë që ky projektligj ka nevojë për disa korrigjime dhe riformulime që duhet t'i bëhen projektligjit, qoftë edhe ato vërejtjet teknike. Po i përmendi disa nga vërejtjet. Neni 213.3 ku thuhet shumica e garancionit duhet të jetë e barabartë me një të dhjetën e vlerës së përcaktuar të paluejtshmërisë, por nuk mund të jetë më e madhe se 5000 euro. Pastaj, para nenit 234 ku është dhënia e paluajtshmërisë për shfrytëzimin e propozuesit të ekzekutimit, si dhe në nenin 236, përsëritet kjo, përderisa në të gjitha rastet e tjera në këtë projektligj është thënë- propozuesi i përmbartimit e jo i ekzekutimit. Në nenin 301.1 thuhet: Përgjashtimisht nga neni 310 të këtij ligji si dhe neni 301.2 ku thuhet ky përmbartim zbatohet në bashkëpunim me organin e kujdestarisë. Në mënyrën e rregulluar në nenin 309, paragrafi katër dhe pesë të këtij ligji, këto dy nene të lartpërmendura i mungojnë projektligjit pasi që projektligji në fjalë ka gjithsej 304 nene. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji edhe me bindjen se vërejtjet e theksuara nga deputetët që u thanë më parë do të merren parasysh nga Komisioni Funkcional, Grupi Parlamentar i LDD-së e përkrah në parim miratimin e këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Meqë nuk ka kandidat tjerë të interesuar për diskutim shkojmë në votim në parim të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Në sallë janë të pranishëm 65 deputetë.

Votojmë tash.

Për..... 60 vota,

Kundër..... 2.

Konstatohet se miratohet Projektligji në procedurën përmbaruese. Ju faleminderit!

Vazhdojmë më tutje.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën kontestimore

Projektligji u është shpërndarë deputetëve, më 29 gusht 2007 dhe janë përmbaruar kushtet për shqyrtimin e tij në parim dhe miratimin e këtij ligji.

Ftoj ministrin Jonuzi që të marrë fjalën.

JONUZ SALIHAI: Së pari duhet të shtoj para jush, të nderuar deputetë , se ne do të bashkëpunojmë shumë me Komisionin për Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese që eventualisht, zbrastëritat t'i mbulojmë. Janë, tri ligje ,me të vërtet shumë voluminoze. Si duket ekspertët tonë vështirë e kanë të punojnë me ligje me më pak nene, por megjithëkëtë janë ligje të harmonizuara nga ndërkombëtarët dhe nga vendorët , të punuara dhe të ripunuara një kohë shumë të gjatë. Besoj që nuk na mbetet edhe shumë që t'i harmonizojmë qëndrimet rreth ndonjë neni ose rreth ndonjë pakënaqësie bashkë me Komisionin për Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese dhe Zyrës sonë ligjore.

Sa i përket Ligjit për procedurën kontestimore, mund t'ju them shkurt se ky ligj rregullon procedurën kontestimore nga aspekti formal dhe ai material, kompetencën e gjykatave, mjetet dhe objektin e kësaj procedure gjyqësore ,përbërjen e gjykatës dhe procesin gjyqësor, afatet dhe përmbarueshmërinë etj. E thashë më përpara se risi paraqet rregullimi shumë modern i kontestit me element ndërkombëtar, pastaj vazhdon me modernizimin e statusit të gjyqtarit dhe përjashtimin e tij. palët dhe rolin e tyre, përfaqësimin me prokurë të palëve, shkresat dhe parashtresat e domosdoshme për procedurë, komunikimin me anë të shkresave nga palët me gjykatën dhe e kundërta. Pra, mjetet e rregullat të jashtëzakonshme të goditjes e tjerë, pra është një lepezë e gjatë e neneve që rregullon ky ligj, prandaj unë ju ftoj që në leximin e parë ta përkrahni, në mënyrë që eventualisht në vërejtjet që do t'i kemi së bashku ti mënjanojmë në leximin e dytë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI : Ju faleminderit, zoti ministër!. Fjalën e ka deputeti Sadudin Berisha, në emër të LDK-së.

SADUDIN BERISHA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Kolegë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka mirëpritur Projektligjin për procedurën kontestimore dhe vlerësimi ynë është se ky projektligji të përkrahët dhe miratohet sot në parim. Vlerësimi ynë i

përgjithshëm është se Projektligji për procedurën kontestimore është i një rëndësie të veçantë me vetë faktin se përcakton rregullat procedurale në bazë të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidh kontestet nga marrëdhëniet juridiko – civile të personave fizik dhe juridikë të natyrës kontestimore.

Nevoja për një projektligj të tillë ka qenë e kamotshme, sepse Kosova ka kaluar në një ekonomi të tregut të lirë, në njërën dhe se ky projektligj shfuqizon ligin për procedurën kontestimore të vitit 1977.

Projektligji për procedurën kontestimore ofron zgjidhje të reja dhe një infrastrukturë ligjore të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, duke i eliminuar pengesat procedurale në rastin e zhvillimit të procedurave kontestimore.

Projektligjet për procedurën kontestimore është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare, qofshin ato konventa të ndryshme, rregulla deklarata, karta për rekomandime të cilat rregullojnë marrëdhëniet në fushën e procedurës civile.

Zgjidhje që ofron ky projekt ligj në tri pjesët e tij që e përcakton strukturën e këtij projektligji, Grupi Parlamentar i LDK-së vlerëson se ky strukturim i ligjit është i mirë, duke përfshirë dispozitat e pazgjidhshme në kreun e parë të projektligjit, ato të kreut të dytë, duke përfshirë dispozitat ligjore në gjykimin e çështjes juridike, me gjitha fazat e tij e deri te pjesa e tretë që përfshinë dispozitat ligjore për procedurat e posaçme kontestimore si dhe ato kalimtare të fundit.

I nderuari kryetar, vlerësimi i përbashkët i Grupit Parlamentar të LDK-së është se në leximin e parë projektligji duhet të përkrahet me obligimin tonë të përbashkët që në procedurat e mëtejme kontributi ynë do të jetë konkret, duke ofruar zgjidhje më të mira në pjesë të caktuara të projektligjit përmes amendamentimit të tij. Pra, në fund Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah dhe e mbështet në leximin e parë projektligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Në emër të PDK-së deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit zoti kryetar. Si edhe dy ligjet e mëparshme, Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet në parim edhe Projektligjin për procedurën kontestimore, si një ligj të rëndësishëm që rregullon në përgjithësi fushën e të drejtës civile. Do të duhej vlerësuar edhe puna e Ministrisë dhe e stafit që ka punuar në këtë ligj, vërtet për punën jo vetëm vëllimore, por edhe të kujdesshme e cilësore. Eventualisht do të mund t'i bëhej vërejtje pse kjo pako e ligjeve është lënë për në fund. Ndërmarrjet e tilla ligjvënësë duhet të bëhen në kohën e duhur që deputetët dhe Kuvendi të kenë kohën e mjaftueshme për shqyrtimin dhe amendamentimin e tyre. Edhe për kundër kësaj, duke pasur parasysh dhe vështirësitë objektive me të cilat përballemi bashkërisht në procesin e ligjvënies, Grupi Parlamentar i PDK-së do të kontribuojë në përmirësimet eventuale në procesin e amendamentimit të tij. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Deputetja Gjylnaze Syla në emër të AAK-së.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

Sikurse dy ligjet e mëparme që posa i votuam në parim, edhe Projektligji për procedurën kontestimore është i nevojshëm për plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e së drejtës procedurale civile.

Projektligji ka për qëllim që të rregullojë procedurën në bazë të cilës gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko- civile të personave fizik dhe juridikë. Edhe ky ligj është voluminoz dhe përmban 38 pjesë apo 530 nene. Projektligji modernizon dhe lehtëson procedurën kontestimore dhe është i bazuar në praktikat dhe standardet e mira ndërkombëtare dhe sidomos ato të Bashkësisë Evropiane. Në bazë të deklaratës për implikime buxhetore, Projektligji është i përballueshëm për buxhetin e Kosovës, meqë parashihet që për tri vjet, prej vitit 2008 -2010 të shpenzohen 30 mijë euro.

Në fund theksoj se Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet Projektligjin në parim dhe do të japim kontributin tonë në Komision për punimin e mëtejme të këtij projektligji. Ju faleminderit!.

KRYETARI: Ju faleminderit! Nga ORA, Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit, zoti Kryetar,

Edhe ky ligj është njëri nga ligjet i cili e plotëson spektrin e nevojshëm për të drejtën procedurale. Prandaj, për t'i mos i përsëritur fjalët ne në parim si grup parlamentar e përkrahim këtë ligj dhe kontributin tonë përmes përfaqësuesit do ta japim në Komisionin Parlamentar.

KRYETARI : Ju faleminderit! Fadil Geci, në emër të LDD-së,

FADIL GECI: I nderuari zoti Kryetar, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Nevoja për këtë projektligj ishte shumë e madhe pasi që Kosova po kalon nga një realitet në një realitet të ri shoqëror dhe ekonomik. Kosovës i nevojiten rregulla të reja juridike për zgjidhjen e kontesteve civile. Këto rregulla duhet t'u përshtaten rrethanave të reja të cilat janë krijuar në Kosovë. meqenëse ligji i vjetër i vitit 1977 tashmë është tejkaluar dhe nuk është efikas e i standardizuar me direktivat e BE-së. Prandaj, ky projektligj është më se i nevojshëm dhe i domosdoshëm për Kosovën. Lidhja Demokratike e Dardanisë. konsideron se ky projektligj krijon një infrastrukturë ligjore të përshtatur me standardet ndërkombëtare dhe me direktivat e BE-së. Ky projektligj për procedurat kontestimore ofron zgjidhje më efikase për gjykatat dhe është shumë praktik për shqyrtimin e kontesteve civile.

Ana tjetër pozitive e këtij ligji ekziston se nuk ka një kosto të lartë dhe mund zbatohet nga strukturat ekzistuese në kuadër të Ministrisë dhe nuk kërkon mjete të shumta financiare dhe është shumë i vlefshëm për plotësimin e vakumit ligjor. Në këtë drejtim ,gjithashtu ,ka përkrahjen e plotë të BE-së. Kurse anë tjetër negative, mendoj që janë disa nene të këtij projektligji që janë shumë të gjata dhe jo konkrete. Lidhja Demokratike e Dardanisë e përkrah në parim dhe mendon se gjatë kalimit të këtij ligji nëpër komisionet funksionale do

të përmirësohen disa nene dhe ky ligj do të jetë shumë funksional. Lidhja Demokratike e Dardanisë do të japë mendimin e vet nëpër komisione që ky ligj të jetë më i mirë dhe shumë praktik për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Milazim Haliti.

MILAZIM HALITI: I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për procedurën kontestimore përcakton rregullat përmes të cilave gjykata vendos për kontestet nga marrëdhënia juridiko- civile të personave fizik dhe juridikë. Është projektligj shumë i nevojshëm ,sepse ligji i vjetër i takon një sistemi të tejkaluar ekonomik dhe nuk është konform standardeve ndërkombëtare. Ky projektligj është mjaft voluminoz dhe ka për qëllim t'i eliminojë pengesat procedurale që kanë ekzistuar ,ka një sistematizim të ri dhe infrastrukturë të harmonizuar me standarde ndërkombëtare. Projektligji parasheh dispozitat e përgjithshme, kompetencën lëndore territoriale, kompetencat e posaçme të gjykatave parashtrës, seancat gjyqësore, afatet, procesverbalet dhe vendimet e gjykatave, pastaj mjetet e rregullta dhe ato të jashtëzakonshme juridike. Gjithashtu, parasheh gjykimin e çështjes dhe procedurën e saj, shkallët e gjykimit ,ndihmën juridike, marrjen e provave dhe përgatitjen e seancave kryesore.

Edhe pse është një vlerësim pozitiv për hartimin e këtij projektligji, projektligji ka nevojë për disa riformulime më të qarta të dispozitave, me qëllim që ato më lehtë të implementohen. Më këtë rast po ua paraqes disa nga vërejtjet. Neni 149 të jetë formulim më i përshtatshëm ku thuhet aktgjykimi për shkak të padëgjushmërisë ose mosbindjes. Para nenit 152 është titulli: Dhënia, hartimi me shkrim dhe dëgjimi i aktgjykimit. Këtu duhet një riformulim i ri që mund të jetë -vendosja hartimi dhe pastaj të vazhdohet me tekstin që është thënë më lartë.

Te neni 177 paragrafi 1 pika 1 ku është- tregimin e aktgjykimit kundër të cilit paraqitet ankimi edhe këtu duhet riformulim i ri ,siç është edhe mund të jetë- numri dhe data e aktgjykimit dhe pastaj të vazhdohet. Para nenit 253 të shënohet tërheqja e padisë edhe në të gjitha nenet ku është dhënia e aktgjykimit, do të duhej të zëvendësohej me fjalët- shpallja e aktgjykimit. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji dhe me korrigjimet riformulimet që do t'i bëjë Komisioni Funksional ,unë e përkrah në parim miratimin e këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI : Ju faleminderit! Meqenëse nuk ka kandidatë tjetër të interesuar për diskutim, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Në sallë janë të pranishëm 68 deputetë.
Votojmë tash.

Për..... 59 vota,
Kundër.... 4.

Konstatohet se miratohet Projektligji për procedurën kontestimore.

Pas miratimit në parim në bazë të rregullave 23 dhe 35 Kuvendi ngarkon këto komisione:

Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë kushtetues, si Komision Funksional dhe Raportues,

Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës-

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtat dhe për përgjegjësitë e deputetit;

Ky projektligj është hartuar nga Komisioni Parlamentar për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 3 shtator 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftoj kryetarin e Komisionit ,Hydajet Hysenin të marrë fjalën.

HYDAJET HYSENI: I nderuar zoti Kryetar,
Zoti ministër,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që në emër të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese t'i paraqesim këtij Kuvendi Projektligjin për deputetët ose më saktë, Projektligjin për të drejtat dhe e përgjegjësitë e deputetit. Siç është e njohur çështja e të drejtave dhe përgjegjësi të deputetëve në Kosovë është rregulluar me dispozitat e Kornizës Kushtetuese, kreu 9, 1.6. pika a, b, c. ç dhe d pastaj nenet 9.1.23, 9.1.24 dhe 9.1.25. Edhe Rregullorja e punës së Kuvendit rregullon pjesërisht këtë materie. Por është bindje e përgjithshme se edhe përkundër kësaj çështje e statusit e mandatit, imunitetit dhe çështjeve të tjera që lidhen me deputetin dhe funksionimin e tij, në të vërtetë në praktikën tonë është e parregulluar. Vendet e tjera i kanë të rregulluara këto zakonisht me ligj. Prandaj edhe ishte konstatuar kaherë, si nevojë e ngutshme dhe e pashtyeshme që edhe Kuvendi i Kosovës t'i qaset kësaj çështje në mënyrë meritore. Ka pasur edhe çështje konkrete, që janë shtruar në këtë Kuvend e që lidheshin pikërisht me çështjen e pazgjidhur të statusit të deputetit. Prandaj edhe Komisioni për Çështje Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese e për çështje të tjera juridike ka ndërmarrë me kohë nismën për hartimin e këtij projektligji. Është formuar grupi punues me anëtarë të komisioneve të tjera, Komisionit për Buxhet me ekspertë në përbërje: Nerxhivane Dauti, udhëheqëse e grupit punues, Sadudin Berisha, Gjylnaze Syla, Hysnija Beshkoviq, Dragisha Krstoviq, Nazim Jashari, Naser Osmani, Gani Koci. Zyra Ligjore e UNMIK-ut ka qenë ftuar jo gjithmonë ka marrë pjesë, Mishel Majkel Fren prej OSBE-së, Virtyt Ibrahim Aga nga Agjensioni Evropian për Rindërtim, Dejvid Pajn nga NDI, Petra Bles, këshilltare e kryetarit të Kuvendit, kurse më vonë ka qenë e organizuar edhe një tryezë e posaçme në procesin e finalizimit, në të cilën, pos shefave të grupeve parlamentare, kanë qenë ftuar edhe drejtuesit e komisioneve parlamentare, të cilët edhe kanë marrë pjesë dhe ekspertë të jashtëm si: Karlo Binda nga Instituti Nacional Demokratik Amerikan, Lia Han, parlamentare nga Estonia që ndihmon Kuvendin dhe Zyrën e kryetarit të Kuvendit, Piter Vargut parlamentar i njohur nga Belgjika dhe të tjerë. Ne shfrytëzojmë rastin që ti falënderojmë jo vetëm partnerët tanë për ndihmën e pakursyer që na kanë dhënë, por edhe anëtarët e Grupit punues për punën vërtet të lodhshme, sintetizuese e shteruese që kanë bërë. E them edhe sintetizuese, sepse në praktikë, në procesin hartimit të Projektligjit, janë marrë parasysh përvojat e vendeve të ndryshme veçanërisht të vendeve me tranzicion të suksesshëm, përvojat, të cilat është bërë përpjekje të përshtaten me kushtet tona. Gjatë gjithë kohës Grupin punues e ka shoqëruar edhe një vështirësi të cilin dua ta theksoj edhe për opinionin që na ndjek.

Ky Kuvend ka miratuar një numër të madh të ligjeve, edhe mendoj se e meriton mirënjohje kjo punë ligjdhënëse e Kuvendi të Kosovës, por më së vështiri e ka pasur ta hartoj Ligjin për vetveten. Thonë edhe rrobaqepësit më vështirë e kanë kur i prenë rrobat

vetvetes, por megjithatë ishte një nevojë, ishte një domosdo dhe për të hequr çdo keqkuptim se është krijuar përshtypja sikur ky ligj rregullon vetëm benificionet, privilegjet, dua të nënvizoj se Projektligji të cilin ju e keni me vëmendje, besoj që do ta lexojnë me vëmendje edhe opinioni, rregullon çështje, një gamë çështjesh që lidhen jo vetëm me lehtësitë që duhet të kenë deputetët, por në radhë të parë me përgjegjësitë e tyre, me statusin e deputetit, me mandatin e tyre, me të drejtat e deputetit në fazën e kandidimit, por edhe kufizimet dhe obligimet që kanë deputetët. Në raportin e deputetit me institucionet e tjera edhe qendrore edhe ato lokale, rregullohet edhe çështja e kompensimit të tij dhe kjo është rregulluar jo gjithmonë duke avancuar, por përkundrazi duke pasur parasysh edhe mundësitë e kursyera të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit të Kosovës funksionojnë në kushte veçanërisht të rënda që nuk mund t'i gjesh në asnjë vend në fqinjësi, edhe në vende me nivel të përafërt të zhvillimit me tonin. Rregullohet në mënyrë të veçantë edhe çështja e Kodit të Mirësjelljes së deputetit dhe parimet e inkompatibilitetit që ne i kemi besuar dhe ende besojmë se do të ndihmojnë funksionalizimin e mëtejshëm, më të mirë edhe sasior edhe cilësor të legjislaturës së re. Nuk pretendojmë se ligji është i përsosur, ligje të tilla nuk ka, por jemi të bindur se ky Kuvend bashkërisht, siç kemi punuar dhe deri tani, do të kontribuojnë në përmirësimet eventuale për çka presim edhe kontributin e opinionit dhe të shoqërisë civile, me qëllim që legjislaturës së ardhshme t'i sigurojmë një bazë ligjore adekuate e funksionale. Ju faleminderit Zoti Kryetar!

KOLË BERISHA: Ju faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Alaush Gashi.

ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet në parim këtë projektligj dhe shfrytëzon rastin ta përgëzojë Komisionin Funksional për organizimin e një grupi të mirë punues, për organizimin e debateve para leximit të parë dhe për marrjen në konsideratë të standardeve bashkëkohore për hartimin e këtij projektligji.

Grupi ynë angazhohet që përfaqësuesi i ardhshëm në Kuvendin e Kosovës të ketë kushte normale të punës që ta ushtrojë funksionin e vet në të mirë të qytetarëve në nivel të lakmueshëm dhe mundësisht që t'i ketë kushtet e punës për një punë dinjitoze, sepse përfaqësimi është thelbi i demokracisë së vendeve të lira të cilave synojmë që edhe ne t'u bashkëngjitemi.

Ne, e parapëlqejmë modestinë e cila e përfshinë këtë ligj dhe insistojmë që kjo modesti të vazhdojë në kuadër të mundësive financiare të vendit tonë. Si grup do të angazhohemi në këtë fazë, që në rast të nevojës të zhvillohen edhe debate të tjera publike, sepse nga dëshira e Komisionit Funksional që të zgjidhë çdo çështje, konsiderojmë se ka nene të tepërta. Për shembull neni 6, nuk është nen të cilin ne e mbështesim. Po ashtu, neni 33.2 konsiderojmë se është tepër i detarizuar dhe nuk mund të imponojë sjelljen e vendeve të tjera se si do të sillen për çështje administrative të nevojave të familjarëve apo të deputetëve. Andaj, në përmbyllje, zoti Kryetar, ne e mbështesim edhe një herë dhe do ta japim kontributin tonë që ky ligj të jetë shembull për vendet e tjera. Ju faleminderit!

KOLË BERISHA: Ju faleminderit, profesor. Në emër të AAK-së, Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuara kolege deputete dhe kolegë deputetë,

Sot për ndryshim nga herët e tjera, po debatojmë për veten. Edhe pse ky debat ka të bëjë me çështjet tona, jam e bindur se qytetarët janë të interesuar, sepse projektligji definon të ardhurat tona, veprimtaritë jashtë Kuvendit, përgjegjësitë tona që rrjedhin nga mandati i dhënë nga votuesit dhe të drejtat tona në funksionin e deputetit

Në parim shumë njerëz hezitojnë që të diskutojnë publikisht për të ardhurat e veta, por këtë e kemi detyrë. Personalisht i gëzohemi këtij rasti që publikisht t'i diskutojmë të drejtat dhe përgjegjësitë tona dhe të jemi transparent ndaj qytetarëve të Kosovës. Njëkohësisht, qytetarët do të informohen drejtë dhe do të evitohen paragjykimet e mundshme lidhur me privilegjet tona.

Do të përqendrohem në tri çështje kryesore. Njëra ndër çështjet të cilat i rregullon ky ligj janë pagat. Unë them se kjo është mirë, sepse çdo përfitim duhet të rregullohet me ligj, në mënyrë që të jetë i verifikueshëm, të ketë bazë ligjore dhe të jetë transparent për të tjerët.

Sipas projektligjit, deputeti i Kuvendit të Kosovës duhet të marrë një pagë bazë e cila është më e vogël se ajo e ministrit. Shtrohet pyetja se a është kjo zgjidhja më e mirë? Nuk them se projektligji ofron zgjidhje të përkryer, por ofron zgjidhje adekuate. Deputetët vendosin për çështjet vitale të shoqërisë. Ky vendim duhet të jetë i pavarur dhe pavarësia në vendimmarrje duhet të sigurohet ashtu që deputetët mos të jenë të varur financiarisht nga ekonomia ose Qeveria. Pavarësia në këtë ligj është një komponentë së cilës i është kushtuar një kujdes i veçantë. Pavarësia në vendimmarrje me këtë ligj nënkupton që deputetët mos të kenë punë të tjera dhe t'i përkushtohen vetëm punës në Kuvend. Pra, deputetët nuk do të mund të ushtrojnë funksionin e ministrit ose funksione të ndryshme të tjera qeveritare ose në ndërmarrjet publike ose private. Ky koncept është koncept parimor dhe shtyllë e këtij projektligji. Megjithatë përjashtim është bërë për profesorët të cilët janë kuadro deficitare në Kosovë. Ata do të mund të ligjërojnë në fakultete për studime mastër dhe të doktoraturës, por jo edhe për studentët në studime fillestare. Kjo është një zgjidhje e avancuar, e bazuar në shtetet e avancuara demokratike dhe i kontribuon pavarësisë së Kuvendit.

Çështja e dytë, që është shtyllë e këtij projektligji është deklarimi i konfliktit të interesit. Ky projektligj parasheh që çdo deputet duhet të deklarojë pasurinë e vet para se të bëhet deputet. Po ashtu, duhet të deklarojë pasurinë e familjes së vet, punën e tyre, por edhe aksionet në qoftë se i ka në ndonjë ndërmarrje dhe deklarimi i pasurisë duhet të pasojë çdo vit. Pra, deputeti ose deputetja që në mënyrë direkte ose indirekte ka ndonjë përfitim nga vendimi i Kuvendit, jo vetëm që nuk do të ketë të drejtë të votojë, por as të flasë për këtë çështje. Kjo shtyllë e projektligjit gjatë procedimit nuk duhet të lëkundet.

Çështja e tretë me rëndësi në këtë projektligj është detyrimi i organeve qeverisëse që t'i shqyrtojnë kërkesat e deputetëve që bëhen lidhur me brengat e qytetarëve. Aspekti i afrimit të deputetit me qytetarët në këtë projektligj është i theksuar. Pra, ky projektligj i detyron kuvendet komunale që të sigurojnë kushte për deputetët nëpër komuna që të sigurojnë një zyre, ashtu që deputetët të jenë sa më afër votuesve dhe jo si deri më tani kur deputetët kanë marrë vetiniciativa ose është dashur që qytetarët të vijnë në Prishtinë për të sjellë një letër lidhur me brengat e tyre. Po ashtu, në të ardhmen, për shkaqe financiare deputetët nuk mund të presin se do t'i ofrohen zyra individuale. Mirëpo, sipas projektligjit është gjetur një zgjidhje e mirë me kosto të vogël për zyrat e deputetëve në kuvendet komunale. Për hir të transparencës së plotë, duhet të flasim edhe për të drejtën e deputetit për të marrë një pagë tranzicionale pas përfundimit të mandatit. Nëse një deputet ka shërbyer për një mandat, do të marrë pagën bazë të deputetit për 9 muajt e tjerë pas përfundimit të mandatit dhe nëse ka

shërbyer dy mandate, do të marrë 12 muaj pas përfundimit të mandatit. Shtrohet pyetja se a duhet deputeti të marrë pagën edhe pas përfundimit të mandatit? Për të qenë korrekt nuk duhet harruar se deputeti e lë profesionin e vet për t'u bërë deputet dhe i duhet një periudhë tranzicionale që të gjejë një vend të punës ose të rikthehet në punën e mëparshme.

Për të qenë të arsyeshëm, atëherë deputetët që ushtrojnë katër vjet detyrën e deputetit duhet të ndihmohen që të gjejnë një punë tjetër dhe kjo nuk duhet të zgjasë më shumë se 9 muaj, pavarësisht sa mandate ka shërbyer. Nëse deputeti e gjen punën më herët, kjo ndihmë duhet të ndërprehet. Sa i përket pensionit suplementar për deputetët prej 85% që e parasheh ky projektligj, këtu do të jem më kritike dhe e them haptas se duhet ndryshuar dhe gjetur një zgjidhje tjetër. Komisioni në këtë pikë duhet të përpiket të gjejë një zgjidhje më të arsyeshme. Pos kësaj vërejtjes së fundit, unë konsideroj se në tërësi projektligji është lehtë i kuptueshëm, i përgatitur mirë, me memorandum shpjegues të detajuar dhe me një kosto transparente financiare. Për këtë falënderoj sponzorizuesin, komisionet dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e projektligjit dhe vazhdojnë ta mbështesin punën e Kuvendit. Projektligji është bazë serioze për punë efikase dhe funksionale të Kuvendit dhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të PDK-së, Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar,

Për rëndësinë e këtij ligji nuk duhet të flas, sepse gati u thanë të gjitha këtu. Mirë është që më në fund flasim edhe për vetveten, sepse duhet të flasim, se nëse nuk flasim ne, nuk flasim as të tjerët dhe nuk besojnë shumë se edhe të tjerëve ju ndihmojmë nëse vetveten nuk e ndihmojmë në këtë rast. Prandaj, nuk do të duhej të ishte shqetësuese kjo. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet këtë projektligj dhe e ka dhënë kontributin e vet edhe gjatë procedurave të hartimit në forma të ndryshme. Në këtë rast do të ndalem vetëm në dy ose tri çështje, që për mua konsideroj se do të duhej të merreshin pak parasysh gjatë shqyrtimit, tash e tutje nga të gjitha grupet parlamentare.

Nën një, e kam fjalën për nenin 4, për të drejtën e kandidimit. Ne e dimë se e drejta për t'u zgjedh dhe për të zgjedhur është një e drejtë që janë të drejtat universale dhe gjithkund në botë njihet edhe si kategori kushtetuese e të drejtave të njeriut, dhe të fillojë nga Kushtetuta, te Ligji i zgjedhjeve dhe te Ligji për deputetët. Unë konsideroj se në këtë ligj neni 4 është vetëm një dyfishim Ligjit për zgjedhje. Ligji për zgjedhjet përcakton qartë kush mund të kandidohet, si mund të kandidohet dhe të gjitha procedurat e tjera rreth kandidimit. Prandaj, më duket se është i tepërt të jetë në këtë ligj, sepse mund të ngatërrohem ndonjëherë në këtë çështje.

Çështja tjetër për të cilën dua të flas dhe duhet të kemi shumë parasysh rreth mospërputhshmërisë të mandatit të deputetit. Unë, pajtohem plotësisht me atë se mandati i deputetit nuk do të duhej të ishte i përputhshëm me organet ekzekutive që dalin nga Kuvendi, gjë që në shumtën e vendeve ose ato që kanë një, po them një praktikë të gjatë të demokracisë nuk është i përputhshëm. Prandaj, konsideroj se as te ne nuk duhet të jetë i përputhshëm. Por, kur është fjala te mospërputhshmëria në nenin 8, në ushtrimin e funksioneve dhe funksioneve të tjera publike, këtu duhet të kemi edhe të jemi mjaft të kujdesshëm. Unë do të marrë vetëm një shembull: Në qoftë se një kirurg i mirë që rastis edhe mund të jetë edhe deputet, të mos mund ta ushtrojë profesionin e vet dhe në sallë të operojë, të kemi parasysh këtë fakt, prandaj të analizohet edhe një herë mirë dhe drejtë kjo çështje, sepse mund të bëjmë gabime shumë të mëdha ose një profesor në ushtrimin e

profesionit të tij si profesor fakulteti etj. që konsideroj se duhet të zgjidheshin në një mënyrë më të drejtë se sa si është përcaktuar këtu në këtë projektligj.

Një çështje tjetër rreth pensionit suplementar. Ka praktika të ndryshme rreth kësaj dhe as ne nuk duhet të jemi të veçuar nga ata. Por më duket se nuk është e drejtë që çështja e benificioneve nga ajo se ke qenë deputet nuk do të duhej të lidhet shumë me stazhin e punës, sepse stazhin e punës dhe atë çështje e rregullojnë ligjet e tjera. Janë: Ligji i punës, Ligji për pensionet e të tjera. Ky benificion që rrjedh nga ky mandat, nuk duhet të ketë ndonjë bazë tjetër përpos bazës, bazën e të qenurit deputet. Ne mund ta rregullojmë me dy mandate, tri e pesë, nuk është e rëndësishme kjo fort, por të lidhet edhe me bazat e tjera të pensionimit, unë konsideroj se është e padrejtë dhe nuk duhet të figuroj këtu dhe një çështje tjetër, çështja e përcaktimit të lartësisë së pagës. Neni 17 përcakton lartësinë e pagës të kryetarit të Kuvendit, anëtarëve të Kryesisë etj dhe kur vjen te përcaktimi i pagës të deputetit thotë: do të përcaktohet sipas praktikave të deritashme, ndërsa më vonë me Ligjin për pagat e funksionarëve të lartë. Unë e konsideroj që kjo çështje duhet të rregullohet për të gjithë njësoj dhe të mos lihet se qysh është bërë ai krahasimi kryetari kaq e tjetri kaq, të bëhet ky krahasim edhe në mes të pagës së deputetit dhe funksionarëve të tjerë ekzekutiv. Të mos lihet kështu, se në fund të fundit nuk mund të jetë kryetari i Kuvendit pa qenë deputet në radhë të parë. Nuk mund të jetë anëtar i Kryesisë pa qenë deputet dhe si e tillë e njëjta duhet të vlejë edhe në përcaktimin e pagës bazë. Këto ishin ato vërejtje për të cilat konsideroj se gjatë procedimit të mëtutjeshëm duhet të kihen parasysh dhe të rregullohen.

KRYETARI: Ju faleminderit. Në emër të ORA-s, Nazim Jashari.

NAZIM JASHARI: Zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar ministra,

Ky ligj të cilin e kemi sot para vetes, është ligj sigurisht i nevojshëm për mirëfunksionimin e institucioneve tona dhe në këtë aspekt mendoj që duhet gradualisht ta ndërtojmë bazën ligjore të funksionimit të institucioneve tona kryesore. Po ashtu, ta kemi Ligjin edhe për Qeverinë apo Ligjin për ministrinë, në mënyrë që krejt veprimtaria e institucioneve tona të bazohet në ligj.

Nga ana e sponzoruesit të këtij projektligjit, pra Komisionit për Legjislacion, u përmenden një vistër emrash të cilët kanë punuar në hartimin e këtij projektligji. Më duhet të them se është e vërtetë se një grup ka qenë formuar nga Komisioni për hartimin e këtij projektligjit, mirëpo barrën kryesore për hartimin e këtij ligji e kanë bartur dy-te veta të atij grupi, pra një nëngrup më i vogël i cili e ka kryer punën dhe i cili në njëfarë mënyre ia ka dhënë formën këtij projektligji. Pra ky projektligj që e kemi këtu rregullon shumë aspekte të punës së deputetëve dhe me këtë e rregullon në njëfarë mënyre punën e Kuvendit të Kosovës, në një mënyrë moderne, sepse për bazë janë marrë disa ligje të cilat janë përdorur, që janë marrë nga kuvendet me traditë dhe të cilat e kanë edhe një efikasitet pune, dhe duke shërbyer si model, sigurisht që është bërë përpjekje që edhe ky Kuvend ta ketë një efikasitet më të lartë se sa që e ka pasur deri me tani. Në këtë aspekt sigurisht që janë krijuar edhe benificione edhe favore për deputetët, në mënyrë që ata të jenë sa më efikas në ushtrimin e kompetencave dhe të përgjegjësive që iu delegohen nga qytetarët. Shpresojmë që në mandatin e ardhshëm deputetët që do të jenë ulur në këto banka, do të jenë nën nivelin e përgjegjësive dhe benificioneve që ua lejon ky ligj, sepse deri më tani realisht, mbase edhe për shkak të mungesës së këtij ligji, ne nuk kemi qenë shumë në nivel të përgjegjësive dhe shpeshherë punën në Kuvend e kemi marrë në mënyrë shumë

fakultative. Më shumë nuk kemi ardhur në Kuvend se sa që kemi ardhur, disa prej nesh së paku dhe në këtë mënyrë do të jetë në dorën e qytetarëve që zgjedhjet që vijnë ta vlerësojnë kontributin e secilit deputet konform angazhimeve të tyre në Kuvend.

Desha të ndalem posaçërisht te disa dispozita të këtij projektligji të cilat kanë të bëjmë me disa përfitime të deputetëve në raste të jashtëzakonshme, pra, përfitime me rastin e shkuarjes në pension apo përfitimeve me rastin e ndonjë aksidenti apo fatkeqësie e cila e determinon një pensionim të parakohshëm të deputetit. Pra, janë këto nene 24, 26, 27, 28, 29, si nene të cilat e kanë një ndjeshmëri shumë të veçantë lidhur me funksionimit e shoqërisë kosovare. Mendoj se në dispozita kalimtare duhet të thuhet qartë se këto nene do të fillojnë të zbatohen vetëm atëherë kur Kuvendi i Kosovës do ta miratojë Ligjin për sigurimin sociale dhe Ligjin për sigurimin Pensional, me ç'rast të gjithë qytetarët e Kosovës do ta kenë mundësinë që ta gëzojnë të drejtën për sigurim social dhe sigurim pensional dhe jo vetëm deputetët e Kuvendit të Kosovës ta kenë këtë të drejtë pra, duke u bazuar vetëm në këtë ligj. Pra, është e pamoralshme që ne si deputetë të kemi të drejtë në sigurime pensionale, të kemi të drejtë, në sigurime sociale, kurse të mos ta kenë qytetarët këtë të drejtë. Prandaj, në dispozitat kalimtare duhet të shkruhet qartë që këto nene fillojnë zbatimin vetëm atëherë kur Kuvendi i Kosovës ua garanton këtë të drejtë të gjithë qytetarëve të Kosovës. Po ashtu, mendoj se është e nevojshme për hir të mbarëvajtjes së punës së Kuvendit të Kosovës të parashihet diku edhe pozicioni i zëvendësit të shefit të Grupit Parlamentar, sepse Grupi Parlamentar i LDK-së është vështirë të udhëhiqet vetëm nga Alush Gashi, i cili edhe ashtu është i stërngarkuar me punë, por duhet ta ketë një zëvendës i cili i ndihmon atij në ushtrimin e detyrës, kurse grupet më të vogla nuk e kanë shumë problem këtë punë.

KRYETARI: Ku po je ti ngushtë për te?

NAZIM JASHARI: Po e kam koleg, prandaj po angazhohem dhe besoj që do të rritej efikasiteti i punës së Kuvendit edhe me këtë. Në kuvendet e tjera kjo ekziston, prandaj, mendoj se me këto përmirësime, të cilat unë i sugjeroja, ky ligj do të ishte i mirë dhe do të kryente shumë punë për Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit!.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit 6+ Husnija Beshković

HUSNIJA BEŠKOVIĆ: Uvaženi predsjednice Skupštine, predstavnici Vlade, dame i gospodo poslanici,

Mi danas imamo pred sobom Nacrt zakona o pravima i odgovornostima poslanika koji je Komisija za sudska pitanja, zakonodavstvo i Ustavni okvir prosledila Skupštini na usvajanje, a na osnovu Ustavnog okvira Kosova, poglavlje 9, tačka 1, 2. 4. Ova materija je do sada bila regulisana Poslovníkom o radu Skupštine, ali po saznanjima koje imamo, uskoro u svim parlamentima u okruženju i regionu prava i obaveze poslanika regulišu se Zakonom, kako bi bili obavezujući za Skupštinu i ostale institucije.

Nacrt zakona o pravima i odgovornostima poslanika ima za cilj regulisanje statusa poslanika, prava poslanika u fazi kandidovanja, tokom mandata, zaštitu njihove funkcije putem institucije imuniteta, odnose sa vladinim i drugim javnim institucijama, prava poslanika na nadoknade i druge materijalne nadoknade za vreme trajanja i nakon prestanka mandata, kao i pravila dobrog vladanja i pravila za slučaj sukoba interesa. Zakon je svojim delovima uskladjen sa međunarodnim standardima i zakonodavstvom Evropske Unije, pa otuda odražava napore privremenih institucija Kosova za uskladjivanje zakonodavstva Kosova sa međunarodnim standardima i zakonodavstvom Evropske Unije.

Za izradu ovog Zakona, kao standard su poslužili zakoni koji regulišu ovo pitanje u neposrednom okruženju, a veliki doprinos za izradu ovog zakona su dali, pored radne grupe i međunarodni eksperti koji su o Nacrtu zakona dali visoke ocene. Zakon je neophodan sa stanovišta svih političkih etnita koji su zastupljeni u Skupštini Kosova i predstavlja dobar pravni okvir za pravnu i socijalnu sigurnost poslanika kako aktuelnih, tako i bivših nosilaca ove važne funkcije.

Dakle, Parlamentarna Grupa 6+ u načelu prihvata Nacrt zakona o pravima i odgovornostima poslanika, a svoj doprinos daće u daljem procesiranju istog. Hvala vam na pažnji!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ramadan Kelmendi në emër të LDD-së

RAMADAN KELMENDI - Ju faleminderit!

I nderuari kryetar, ministra të pranishëm, kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDD-së ka shqyrtuar në tërësi këtë propozim ligj, dhe unë si anëtar i Komisionit për Çështje të Kushtetutës dhe Kornizës, po ashtu kemi dhënë një kontribut relativisht të gjatë në këtë propozim ligj. Në veçanti ky propozim ligj ka filluar të trajtohet që nga data 29.1.2007, pastaj është trajtuar me dt. 7.2.. Kemi mbajtur edhe një debat publik dhe janë bërë, gjegjësisht janë hartuar tri propozim ligje. Kemi ardhur në këtë, që është para deputetëve. Ne mendojmë se ky propozim ligj nuk është vetëm për ne, por është edhe për legjislaturat që do të vijnë dhe natyrisht mbi bazushmërinë e organit më të lartë ligjdhënës siç është Kuvendi dhe jemi ne, ne këtu nuk kemi konflikt interesi, por kemi obligim. Obligim që t'i rregullojmë përgjegjësitë dhe të drejtat e deputetit dhe kryesisht këtu duhet të konsistojmë të cilat janë këto liri dhe të drejtat e deputetit në raport me shtetet fqinjë dhe me obligimet që i kemi ne si deputetë ndaj qytetarëve, por edhe obligimet tona profesionale. Unë, vlerësoj se disa dispozita të këtij neni janë pjesërisht diskriminuese për ne deputetët, sepse ato kufizojnë veprimtarinë tonë paraprake dhe pas largimit të mandatit. Për këtë do të qes paraqesë amendamente dhe nuk duhet të lëshohem si disa kolegë që disa u lëshuan këtu dhe në Komision nuk i kanë thënë këto. Duke u bazuar në këtë, unë edhe kërkoj që vërtet edhe legjislaturat e deputetëve të përcaktohen drejt, mos të lihen pezull për të krijuar pastaj mosmarrëveshje. Është legjislatura e vitit që e ka miratuar Deklaratën Kushtetuese dhe Kushtetutën e Kaçanikut. Është thënë se Kuvendi do të vendos, por duhet të përcaktohet brenda sa dhe legjislaturat që pastaj kanë pasuar ose të sqarohen në tërësi.

Në veçanti, Grupi ynë e përkrah, natyrisht se jemi vonuar në miratimin e këtij propozim ligji. Do të kisha kërkuar që edhe në emër të Grupit ky të bëhet, të miratohet brenda kësaj legjislature si i tillë në procedurat që janë paraparë. Përfundimisht unë propozoj, gjegjësisht ua tërheq vërejtjen deputetëve që të ndalen në dispozitën e nenit 5, dispozitën e nenit 7, 8 dhe 9, dhe këto nuk e kanë vendin këtu, sepse përkund në, gjatë Grupit punues nuk kanë qenë, këto janë futur pastaj nëpër një derë të vogël që cenojnë të drejtat dhe liritë dhe përgjegjësitë e deputetit.

Në përfundim edhe një herë e konfirmojë se ne e përkrahim në shqyrtim të parë, me kërkesë që dispozitat e kontestuara edhe në Komision edhe këtu le t'i shqyrtojnë mirë, sepse ato dispozita cungojnë shumë veprimtarinë e deputetit në jetën private, në biznesin privat, në punën private e tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit. Në emër të Grupit për Integrim, profesor Agani.

FERID AGANI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Përsëritës në emër të Grupit Parlamentar për Integrim paraqitjen e këtij projektligji. Konsiderojmë se kjo paraqet një avancim të punës së Kuvendit të Kosovës dhe një garanci për përparimin e mëtutjeshme të proceseve demokratike në të. Duke mos dashur t'i përsëris disa vërejtje të kolegëve tanë, do ta kisha theksuar, veçanërisht, lidhshmërinë e dispozitave që rregullojnë sigurimin shëndetësor dhe pensional të deputetëve me legjislacionin, i cili vlen për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe në veçanti do të kisha theksuar nenin 7, veçanërisht paragrafin 3 të këtij neni, i cili paraqet një zgjidhje të papranueshme ligjore me të cilën, në një farë mënyre, diskriminohen profesorët në institucionet arsimore të sektorit privat, në krahasim me ata që janë të angazhuar në Universitetin publik. Mendoj se kjo duhet të korrigjohet.

Grupi Parlamentar për Integrim në parim e përkrah këtë projektligj.

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti,

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Kuvendit,
Kolegë të respektuar,

Natyrisht që unë e përkrah në parim këtë ligj, i cili është hartuar me një përkujdesje, unë do të thosha të jashtëzakonshme dhe në disa pika duket që është për së tepërmi i shtresuar, por kjo është në dorën tonë dhe ne do ta punojmë tutje, sepse është ligj i sponzoruar pikërisht nga Parlamenti dhe për Parlamentin. Këtu u përmend që është mirë që të miratohet në këtë legjislaturë. Unë duhet të nënvizoj që të bëhemi të vetëdijshëm, sepse edhe në Kryesi kemi biseduar në mbledhjen e fundit dhe ta dinë juristët tanë, këtu në Kuvend e dinë, që çdo punë në punë legjislative që nuk kryhet, nuk mbarohet deri në fund të kësaj legjislature, ajo punë është zero për atë tjetrën, kështu që nuk ka nevojë të bisedojmë, por duhet ta sistemojmë punën që ligjet që i vëmë në lexim të parë të krijojmë konsensus në Kuvend që të kryhen sa të punojë kjo legjislaturë. Pra, kjo vlen edhe për këtë ligj që po e kalojmë, sigurisht, jam i bindur sot, në lexim të parë.

Unë çfarëdo tjetër që të kem rreth precizimit të neneve të këtij ligji, do t'i bëj në grupet ku marrë pjesë, qoftë politike, qoftë funksionale të Kuvendit. Sot për këtu i kam dy çështje themelore të cilat duhet t'i theksoj dhe t'i vë në spikamë që këtu. Më së pari neni 6 duhet të fshihet, mendoj unë, për shkak se një ligj që ka të bëjë me përgjegjësitë dhe detyrat e deputetit paragjykon sistemin politik, i cili zakonisht rregullohet me Kushtetutë dhe nuk është mirë ne që të paragjykojmë çfarë funksioni do të ketë deputeti. A do të ketë mundësi të ketë edhe detyra ekzekutive, sepse kjo do të varet nga tipi i sistemit që do ta ndërtojmë ose nga kushtetuta që do të miratohet. Pra, unë mendoj që neni 6 të hiqet krejt dhe nuk është mirë të humbim kohë me të. Neni 25 që ka të bëjë me statusin e deputetëve, ku thuhet viteve '90, unë mendoj që ai nen duhet të ekzistojë, por nuk duhet të lëhet i papërcaktuar, siç ka mbetur tash, që Kuvendi me vendim të veçantë të nxjerrë statusin e deputetëve të viteve '90. Unë u çudita me variacionin që e dha Ramadani, si njëri i atyre viteve, njëri prej deputetëve. Unë mendoj se ky nen duhet përafërsisht të jetë kështu: „Statusi i deputetit, të legjislaturave të viteve '90“, ose unë do ta përktheja „të Kuvendit të Republikës së Kosovës“, shumë më i njohur në vitet '90, „është i njëjtë me legjislaturat e viteve 2000“. Unë nuk dua ta shpjegoj më tutje, po duhet të sjellë një përvijë që shumica e dinë për t'u kandiduar për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës ka qenë pak si vështirë në

vitet '90-ta. Jemi gëzuar të gjithë kur kemi mbërri t'i bindim ose t'i trimërojmë nga 400 veta që të kandidojnë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Naxhije Doçi. Le të përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi.

NAXHIJE DOÇI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar ministra,
Kolegë të nderuar deputetë,

Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit është i mirë që është përpiluar se përmes tij do të rregullohen me ligj të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit gjatë mandatit të tij. Ka qenë kërkesë dhe dëshirë e vazhdueshme në Kosovë për t'u hartuar një projektligj i tillë përmes të cilit do të rregulloheshin si duhet dhe me të drejtë e pakontestueshme statusi, të drejtat dhe imuniteti i deputetit.

Komisioni Parlamentar për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, e ka iniciuar këtë projektligj dhe ka kontribuar në formimin e grupit punues me ekspertë parlamentarë dhe kjo është një punë që meriton të lavdërohet si Komision. Grupi punues prej 13 anëtarëve vendorë dhe ndërkombëtarë në Kosovë, për hartimin e këtij projektligji pos funksionalizimit të aftësive të veta profesionale në këtë aspekt, ka hulumtuar edhe shumë praktika parlamentare të shteteve demokratike dhe parlamentare të Unionit Evropian. Rëndësia e veçantë e këtij projektligji është edhe përputhshmëria e tij me standardet ndërkombëtare, me parimet e legjislacionit të aplikueshëm të Bashkësisë Evropiane dhe me Akikomuniten e BE-së. Pra, është një projektligj që nuk i cenon parimet e legjislacionit të Bashkësisë Evropiane.

Arritshmëria e harmonizimit të këtij projektligji me standardet evropiane është suksesi dhe aftësia e pjekurisë sonë politike si Kosovë dhe e profesionalizimit tonë legjislativ për hartim të ligjeve. Ndër shembujt konkret të përputhshmërisë së këtij projektligji me standardet evropiane, vërehet në nenin 3, paragrafi 1 ku parashihet liria e shprehjes dhe citoj: *Deputeti është përfaqësuesi i qytetarëve dhe gjatë mandatit të tij i nënshtrohet vetëm ndërgjegjes së tij.* Në nenin 2 të këtij projektligji bëhet me dije, me të drejtë se deputeti gjatë ushtrimit të mandatit të deputetit gëzon status të veçantë, e unë do të thosha edhe se deputeti duhet të punojë në mënyrë të veçantë që ta realizojë dhe ta arsyetojë këtë status të veçantë në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe në pajtim me Ligjin për zgjedhjet dhe me këtë ligj në shqyrtim.

Neni 7, paragrafi 3 i Projektligjit në fjalë nuk është i qartë ku thuhet: *Përfashtim nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, deputeti që ka titullin e profesorit të Universitetit publik dhe ai mund t'i kryejë aktivitetet në Universitet, të cilat janë të kufizuara në hulumtime shkencore, ligjërata për titull shkencor etj.* Pjesa ligjërata për titull shkencor nuk kuptohet se a ka të bëjë me përmbajtjen e ligjëratave të rregullta vjetore para studentëve apo ndonjë ligjërata për avancimin e tij shkencor, e që duhet të përcaktohet qartë.

Në nenet 6, 7, 8 dhe 9, bëhet fjalë për funksionet e kufizuara dhe të ndaluara të deputetit që nuk mund të punojë në ministritë tona, në sektorin publik dhe privat e tjera dhe se nuk mund të marrë paga apo kompensim në këtë sektor, por se nuk është theksuar qartë se çfarë masash duhet marrë kundër deputetit, që mbase hetohet se kryen edhe këto detyra të ndaluara të deputetit.

Në nenin 11, paragrafi 2, bëhet fjalë se imunitetin deputetit mund t'ia marrë Kuvendi i Kosovës me kërkesën e prokurorit të përgjithshëm të Kosovës dhe , siç thuhet, në paragrafin 3 të këtij neni - citoj: *Kërkesën për suspendimin e imunitetit të deputetit mund ta paraqet gjykata e cila e ka rastin në hetim*”, por nuk tregojnë qartë se cila gjykatë e ka rastin në hetim- ajo Komonale e Qarkut apo Supreme. Pra , në nëntë paragrafët e nenit 11, ku flitet për çështjen, për heqjen e imunitetit të deputetit, ka disa çështje të paqarta që mendoj se duhet theksuar më saktësisht se si mund të dënohet apo ndëshkohet deputeti pas heqjes së imunitetit tij si deputet.

Neni 29, paragrafi 1 nuk është i qartë kuptimisht, por mendoj se duhet thënë: *“Pensionin suplementar prej 70% mund ta marrë anëtarë apo anëtarët e familjes pas vdekjes së deputetit”*, ose duhet formuluar ndryshe ky nen se nuk është mirë. Me memorandumin shpjegues është bërë një përpjekje për një formulim më të qartë të këtij neni, por ai është memorandum e jo nen. Mendoj se edhe togfjalëshi pension suplementar duhet zëvendësuar me formulimin shqip: *Pensioni plotësues ose pensioni shtues*.

Në nenin 52, paragrafi 1 ku thuhet: *Deputeti gjatë mandatit të tij mund të pranojë dhuratat në pajtim me nenin 33 të Ligjit kundër korrupsionit etj.* Mendoj se duhet të jetë e kundërta, sepse deputeti duhet ta ketë ndërgjegjen e pastër në çdo pikëpamje se është i mandatuar me votën e popullit dhe se vota e popullit dhe se vota e popullit është e shenjtë. Edhe për këtë nen, në memorandumin shpjegues është bërë një përpjekje për një sqarim tolerues të shumës së mundshme të pranimit të dhuratave nga ana e deputetëve, që mendoj se nuk duhet të shpjegohej. Gjithashtu, pensioni suplementar për deputetët, i paraparë me nenin 24 dhe në paragrafët pasues të tij, të mos ketë dallime të mëdha në përqindje sipas mandateve. Pra, sipas mandatit të parë, të dytë dhe të tretë e me radhë, por të jetë me një përqindje më të përafërt, pa marrë parasysh se sa është përqindja, se kujtoj, në këtë mënyrë do të konsiderohet dhe vlerësohet njëjtë dhe në mënyrë të barabartë deputeti.

Në fund po theksoj se Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit është i punuar me një përkushtim të dalluar nga Grupi punues dhe si i tillë edhe ka më pak gabime thelbësore dhe gjuhësore dhe ato, në të shumtën e rasteve, ndoshta janë më tepër gabime vetëm teknike që mund të eliminohen lehtë. Prandaj, këtë projektligj e përkrah në parim me shpresë se gjatë amendamentimit ose plotësimit do të jepet edhe kontributi i Komisionit dhe i deputetëve të tjerë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi, Lë të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi .

NEKIBE KELMENDI: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Unë pajtohem plotësisht me mendimin e kolegut Gani Koci, kur tha se neni 4 i këtij projektligji duhet të fshihet tërësisht. Kjo është në kundërshtim edhe me vetë titullin e këtij projektligji, sepse titulli i Projektligjit është të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit . që do të thotë se bëhet fjalë për njerëzit që e kanë statusin e deputetit, kurse në nenin 4 bëhet fjalë për kandidimin për mandat të deputetit që nuk është fare objekt i rregullimit me këtë ligj. Më tutje, sa u përket neneve 6, 7,8,9 e që kanë të bëjnë me mospërputhshmërinë, mospërputhshmëria është e rregulluar me Ligjin për konflikte të interesit dhe nuk e di cilit atëherë duhet t'i besojmë. Këtij ligji apo atij ligji i cili është në fazën përfundimtare dhe shpresoj së shpejti do të gjendet në rend dite.

Neni 17 bën fjalë për pagat. Mendoj se deputeti nuk është në marrëdhënie pune në Parlament. Deputeti e ka statusin e deputetit në Parlament dhe për statusin që e ka të deputetit i takon

kompensimi për punën, për veprimtarinë, aktivitetin politik e të gjitha ato që i ushtron si deputet në Parlament. Prandaj, duhet të përmirësohet jo paga, paga kanë ata që janë në marrëdhënie pune.

Neni 51, regjistri i interesave është i paqartë krejtësisht, sepse në këtë nen, më duhet ta lexoj për t'i bindur kolegët se është i paqartë, thuhet: *Regjistri i interesave, deputetët duhet t'i regjistrojnë në regjistrin e interesave të gjitha interesat relevante të përcaktuara me aneksin e këtij ligji*. Ne nuk kemi marrë aneks që ta dimë se çka është, çka nënkupton ky nocion *regjistri i interesave* dhe çka duhet të regjistrohet në te. Përndryshe, në parim edhe unë e mbështes këtë projektligj.

KRYETARI: Ju faleminderit! Vetëm një pyetje: A duhet të regjistrohet si stazh i punës koha e kaluar në Parlament?

NEKIBE KELMENDI – Koha e kaluar jo. Nuk je në marrëdhënie pune në Parlament.

KRYETARI: Mirë, ju faleminderit!. Shkojmë më tutje. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi. Të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti Kryetar i Parlamentit të Kosovës! Edhe unë duke lexuar këtë projektligj, i bashkëngjitëm vlerësimit të atyre deputetëve për rëndësinë që ka ky projektligj për deputetët e Parlamentit, që përcakton statusin e tij dhe rregullat bazë ku mjaft mirë është i ndërtuar, sepse vetë praktika dhe përvoja jonë gjer më tash, që kemi kaluar nëpër këto seli të Parlamentit, tregon që megjithatë këto na kanë munguar, sikur që nuk kanë munguar edhe nënçmimet e ndryshme për imunitetin e deputetit, kushtet dhe trajtimi i deputetit. Unë mendoj brenda jetës publike këtu në Kosovë, qoftë në institucionet publike, qoftë në ato shtetërore, që nga kjo seli ku jemi këtu brenda e deri te zyrat ndryshme komunale, Prandaj, është mirë që kjo brenda këtij ligji parashihet sidomos kur është në pyetje edhe çështja e imunitetit të deputetit. Shpeshherë deputeti ka qenë i përçmuar në rastet e ndryshme ose jo i trajtojnë drejtë me mandatin që duhet të përfaqësojë si emblemë e zgjedhur e votës qytetare. Është mirë, po ashtu, që brenda këtij projektligji që është futur edhe statusi diplomatik i deputetit, si dhe përgjegjësitë që i takojnë deputetit në mandatin e tij. Pra, janë këto që i përkrah në parim, sepse vërtet e bëjnë jetën më të mirë dhe kushtet më të mira për të punuar deputeti në mandatet e ardhshme. Por ajo që më ka ra në sy, po ashtu, është, që brenda disa neneve që nuk do të isha pajtuar - që duhet të rishikohen është edhe çështja e kompensimit që u ngrit këtu nga disa deputetë dhe unë kujtoj se ajo duhet të jetë adekuate me mandatin që i takon të zgjedhurit brenda këtij institucioni dhe për atë duhet të mendohet mirë, që ajo të zgjidhet edhe gjatë mandatit të rregullt, deputeti duhet pra të ketë financimin adekuat, kompensimin e mirë e jo ashtu si është paraparë këtu. Unë, po ashtu, e përkrah vlerësimin shumë me vend të deputetit Kelmendi, që e tha me një gjuhë shumë të butë, që i janë cunguar disa të drejta deputetit sidomos me nenin nr. 9. Unë kujtoj se këtu është një diskriminim për liritë, aftësitë, afinitetet individuale të njerëzve që mund të jenë deputetë dhe kujtoj që kjo nuk duhet të qëndroj brenda këtyre dispozitave të këtij projektligji. Prandaj, duke i dhënë këto vërejtje, unë kujtoj se munden këto korrigjohen. E përkrah në parim dhe besoj që është një punë e mirë që duhet të përfundojë brenda këtij mandati. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, Le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

BEHXHET BRAJSHORI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji mëton që të rregulloj në fushë të rëndësishme, do të thotë statusin e deputetit në kohën derisa dhe në periudhën pas deputetit dhe mendoj se është mjaft mirë i ndërtuar, sikur që e thanë edhe kolegët. Sigurisht se kjo do të përbëjë edhe një bazë të mirë për të ardhmen dhe ne na mbetet që ta perfeksionojmë sa ka mundësi këtë ligj. Mendoj, se neni 7, paragrafi 7.1 dhe pastaj neni 9, paragrafi 9.1 pak a shumë duhet korrigjuar. Ka të bëjë me mospërputhshmërinë me marrëdhëniet e rregullta të punës dhe me mospërputhshmëria me aktivitetet ekonomike. Derisa në të parën se mandati i deputetit është në mospërputhje me marrëdhënien e rregullt të punës në sektorin se në sektorin privat, e që unë e mbështes nismës se deputeti duhet ta ketë aktivitet primar, përveç disa fushave që janë të përcaktuara me ligj, punën e deputetit në Parlamentin e Kosovës.

Në paragrafin 9.1 thuhet se deputeti nuk mund të jetë anëtar i bordit në ndonjë kompani private, por jo edhe publike. Unë, mendoj se këtu duhet vu theksin, sepse zakonisht të ndërmarrjet publike kemi probleme të theksuara, sikur që edhe neni ose paragrafi 9.5 ku thuhet: deputeti nuk mund të kryejë aktivitete ekonomike, por duhet të shtuar edhe aktivitete tjera që mund të shkaktojnë konflikt të interesit në fushën e aktiviteteve ekonomike. Përndryshe, unë e mbështes dhe mendoj se do ta japim kontributin tonë në procedurat e mëtutjeshme. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit!. Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha. Le të përgatitet deputeti Xhevat Bislimi.

FETAH BERISHA: I nderuar zoti Kryetar,
Të çmuar kolegë deputetë,

Sot në këtë seancë po e shqyrtojmë Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Ky projektligj është i vonuar, por më mirë vonë se kurrë. Edhe pse po kalon mandati i dytë, pozita e statusit të deputetit nuk është e kënaqshme as në pikëpamje funksionale, e as në pikëpamje materiale. Pozita e statusit të deputetit tonë ka edhe ndryshim të theksuar edhe në raport me kolegët e tyre në shtetet fqinje, edhe në shtetet e tjera në rajon e më gjerë. Legjislacioni ynë kishte zbraztësi në këtë lëmi, e ky projektligj shpresoj se do ta plotësojë këtë vakum. Pra, statusi i veçantë i deputetit të definohet me dispozitat ligjore si të drejtat, përgjegjësitë, imuniteti, pozita materiale, relacioni me institucionet lokale, qendrore, si përfaqësues edhe i subjektit politik, edhe përfaqësues i subjektit elektorale të cilin e kanë zgjedhur.

Edhe për këtë projektligj, si zakonisht thuhet që është i përafërt me standardet ndërkombëtare dhe nuk cenon parimet e legjislacionit të Bashkësisë Evropiane. Po ashtu, ky projektligj në disa segmente ka implikime buxhetore, por duket se implikimi buxhetor nuk është i papërballueshëm. Ky projektligj duket se është bërë me përkushtim për t'i rregulluar të drejtat dhe pozitën e deputetit, si respektimin e imunitetit të deputetit edhe gjatë mandatit, edhe pas mandatit të tij, pjesëmarrësit e politikave të qeverisjes lokale e të tjera. Po mirë, edhe ky projektligj ka mangësi dhe duhet dhënë sugjerimet për plotësimin e tij të mëtutjeshëm që të jetë në këtë lëmi një legjislacion i përkryer. Unë po veçoj vetëm nenin 18, i cili rregullon pagën kalimtare të deputetëve. Edhe në këtë nen është thënë se këtu bëhet një lloj diferencimi në mes të deputetëve. Deputeti që ka një mandat merr pagën nëntëmujore, deputeti që ka dy mandate merr pagën dymujore. Unë, mendoj se ky diferencim nuk duhet të jetë. Deputeti, pavarësisht se a e ka mandatin e parë ose të dytë, paga plotësuese ose kalimtare duhet të jetë 12 mujore.

Në nenin 17, i cili rregullon renditjen e pagave, paga bazë e deputetit radhitet pas pagës së ministrit. Ma thotë mendja se paga e deputetit është e ulët në krahasim me ministrin dhe duhet të jetë e barabartë me te.

Në nenin 16, i cili rregullon lartësinë e pagave, shihet një ndryshim i madh në mes të deputetit dhe kryetarit të Parlamentit dhe anëtarëve të Kryesisë. Shikoni tabelën, e keni atje në ligj. Nenin 19 definohej të drejtat e deputetit për kompensim. Pastaj, në këtë projektligj ishte edhe tabela ku Kryesia ka marrë një vendim për mbushjet telefonike të deputetëve dhe të anëtarëve të Kryesisë e të të tjerëve. Ju lutem, pse është ky ndryshim kaq i madh? Deputeti i merr 30 euro mbushje, ndërsa niveli tjetër është 60 dhe 100. E kanë këtë nivel të 60-ve dhe të 100 –ve, kanë edhe telefona fiks dhe i kanë të gjitha kushtet e plotësuara në krahasim me deputetin, ndërsa deputeti i merr 30 euro. Mendoj se edhe pas mandatit të deputetit duhet të definohet më qartë statusi, imuniteti i tij edhe të jetë një kartë dëshmuuese për te, sepse megjithatë ishte në një funksion të lartë shtetëror dhe të ndershëm.

Është për t'u lavdëruar neni 6, i cili nuk lejon që deputeti t'i ketë dy apo më shumë poste, siç ka tani. Po ashtu, mendoj se edhe mandati i legjislacionit të '90 dhe deputetët të cilët shpallën Republikën e Kosovës në atë kohë, edhe zgjedhjet e '92-ës, të cilat ishin zgjedhjet e para pluraliste në Kosovë, ani pse në atë kohë nuk ishin të njohura ndërkombëtarisht ta quajmë, duhet ta kenë vendin në këtë projektligj, jo të lihet më vonë. Të dy mandatet janë tejet të rëndësishme. Ishte vështirë në rrethanat e atëherëshme të ishte deputet. Bile, atëherë, nuk ishte si sot, prandaj në një nen të caktuar duhet të zënë vend edhe këto dy legjislacione. Ma thotë mendja se edhe mosha 55- vjeçare e deputetit për pensionim të jetë mosha 50 - vjeçare, kështu që të zbritet për 5 vjet. Ju faleminderit!.

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi.

XHEVAT BISLIMI- Ju faleminderit, zoti Kryetar,
Zotërinj deputetë,

Unë pajtohem me pjesën e ligjit ku rregullohet statusi i deputetit, ku parashikohen disa të drejta e përgjegjësi për deputetin, ku mbrohet dinjiteti i deputetit etj. Por nuk pajtohem absolutisht me atë pjesën privilegjet pas mandatit, pensioni etj.

Pse nuk pajtohem? Sepse deri më sot e kam fjalën për dy legjislaturat pas luftës e para luftës nuk kemi pasur as legjislatura as Kuvend, këto dy legjislatura, këta deputetë, ky Kuvend deri me sot nuk e kanë përmbushur vullnetin e popullit dhe as nuk kanë arritur t'i përmbushin obligimet, betimin, përbetimin që e kanë bërë në emër të popullit, në emër të cilit kanë ardhur këtu dhe shpeshherë dinë edhe të kreken. Prandaj, angazhimi që të paktën t'i realizojmë të drejtat tona, sa për te drejtat e Kosovës dhe të qytetarit pune e madhe, është vërtetë qesharak edhe jo i ndershëm. Të jemi të singertë, ta rregullojmë statusin e deputetit që e ka mandatin, por deputeti që nuk e ka përmbushur vullnetin e popullit, ky Kuvend që e ka votuar pakon e Ahtisarit, në kundërshtim me vullnetin e popullit, këta deputetë nuk meritojnë asnjë privilegj pas mandatit. Përkundrazi, meritojnë diçka tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit edhe juve. Meqë nuk ka kandidat tjetër të interesuar për diskutim, kalojmë në miratimin në parim të këtij projektligji. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash.

Në sallë kemi 74 deputetë. Konstatoj se me 72 vota “për” dhe 1 “kundër” miratohet Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Ju faleminderit!.

I kthehemi pikës së katërt për shkak se ministri nuk ishte këtu dhe është shtyrë për më vonë. Ta kryejmë edhe këtë pikë të rendit të ditës, pastaj të shohim.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor

Projektligji u është shpërndarë deputetëve ,më 20 gusht 2007 dhe janë përmbushur të gjitha kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim .

Ftoj ministrin Gjini ta marrë fjalën.

ADRIAN GJINI – Ju faleminderit zoti kryetar, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, Vlerësimi strategjik mjedisor është një instrument i rëndësishëm për t’i integruar konsideratat mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e planeve dhe programeve të caktuara të cilat mund të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin e Kosovës dhe nëpërmjet tij të sigurohen marrja parasysh e planeve dhe e programeve gjatë përgatitjes para miratimit të tyre.

KRYETARI: Ju lutem t’i zëni vendet deputetë.

Rëndësia e projektligjit në fjalë, është se mbulon këtë zbrazësi ligjore që i mungon Kosovës, do të thotë duke u nisur prej faktit që Kosovën e pret një zhvillim i hovshëm ekonomik dhe industrial dhe i bazuar në standardet e Bashkimit Evropian. Në këtë aspekt është parë si domosdoshmëri nxjerrja e një ligji i cili e rregullon këtë fushë në Kosovë. Me këtë ligj do të kontribuohet në ruajtjen dhe mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe për një përdorim të kujdesshëm dhe racional të burimeve natyrore. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurohen instrumentet për integrimin e mjedisit në procedurën e përgatitjes dhe miratimin e planeve dhe të programeve , tek të cilat ekziston mundësia që me realizimin e tyre të shkaktohen ndikime të konsiderueshme një mjedis, të sigurohet një nivel i mbrojtjes së mjedisit dhe të sigurohen kushtet për zhvillim të qëndrueshëm.

Me miratimin e këtij ligji, do të sigurohet, që në nivel planifikimit dhe përgatitjes së programeve, të përfshihen informatat mjedisore, të cilat do të garantojnë vlerësim të ndikimit të politikave, planeve dhe programeve në mjedis, konsiderimin në fazë të hershme të çështjeve mjedisore, mundësive të rrezikut, një lidhshmëri në mes çështjeve nacionale, rajonale dhe globale mjedisore dhe identifikimin e opsionit më të preferuar nga analizat, nga alternativat e analizuara.

Hartimi i Ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor, është marrë si prioritet i bazuar në strategjinë legjislative të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të Qeverisë, në të cilën bazë do të krijohet mundësi për përmirësimin kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut, me përdorimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e shkarkimeve të ndotësve në mjedis, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar, bashkërendimin e politikave për t’i përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe pjesëmarrjen e publikut në këtë proces.

Ligji është në pajtueshmëri me direktivat e Unionit Evropian për vlerësimin mjedisor dhe direktivat e tjera që ndërlidhen në këtë fushë. Struktura dhe përmbajtja e ligjit- në kapitullin

e parë paraqiten dispozitat e përgjithshme si qëllime dhe lënda e rregullimit të këtij ligji për kryzimet, parimet themelore të vlerësimit strategjik mjedisor, fushëveprimi, detyrimet e përgjithshme me organet kompetente. Në kapitullin e dytë përshkruhen procedurat për vlerësimin strategjik mjedisor, ku përfshihen edhe fazat e procedurës për vlerësimin strategjik mjedisor, vendimmarrja mbi nevojën e përgatitjes së vlerësimit strategjik mjedisor, vendimi për përgatitjen e raportit dhe forma e përmbajtjes dhe propozimet e vendimit.

Në kapitullin e tretë, kur paraqiten rastet kur kërkohet vlerësimi strategjik mjedisor, nga neni 4 i këtij ligji hartohet raporti për vlerësimin strategjik mjedisor etj. Në kapitullin e katërt përshkruhen fazat e procesit për vendimmarrje, për dhënien e pëlqimit për raportin e vlerësimit strategjik mjedisor.

Në kapitullin e pestë paraqiten mbikëqyrjet në zbatimin e këtij ligji në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj.

Në kapitullin e gjashtë përcaktohen rregullat e dispozitave ndëshkuese dhe të kundërvajtjes.

Në kapitullin e shtatë paraqiten dispozitat kalimtare dhe përfundimtare dhe ky kapitull ka për qëllim përcaktimin e afatit për nxjerrjen e akteve nënligjore, të cilat dalin nga ky ligj. Me këtë ligj realisht tentohet që të sigurohet që për projektet të cilat janë në fazën fillestare dhe projekte të cilat kanë elemente strategjike të zhvillimit në Kosovë, të përgatiten vlerësimet paraprakisht. Këtu ka të bëjë me projekte të mëdha infrastrukturore siç janë: ato energjetike; ujore, infrastrukturore, të cilat në rastet e veçanta mund të kenë edhe efekte ndërkombëtare dhe rajonale.

Mendoj se, një këtë aspekt ky ligj i mungon Kosovës. Në të kaluarën, këto projekte sikur që janë hidrocentralet e mëdha, liqenet e të cilëve shtrihen në zona ndërkufitare, janë rregulluar me ligje të vjetra. Ky ligj do t'i mundësojë Kosovës që të ketë bazë për zhvillimin e këtyre projekteve në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të LDK-së, Shaban Halimi e ka fjalën.

SHABAN HALIMI – Ju faleminderit zoti Kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolege dhe kolegë deputetë.

Projektligji, të cilin e kemi në shqyrtim është projektligj i treti me radhë që del nga Ministria e Planifikimit Hapësinor, siç janë: Ligji për mbrojtjen e ambientit, Ligji i ndikimit në mjedis dhe Ligji i vlerësimeve strategjike në mjedis. Me këtë ligj rumbullakohet një çështje mjaft interesante dhe e leverdishme për qytetarët në përgjithësi, sepse është në pyetje ambienti dhe mjedisi ku jetojnë qytetarët. Për dallim nga ligji i parë, ky ligj për shembull, ndikon drejtpërsëdrejti në vlerësimin strategjik të ndikimeve që kanë objektet ekonomike, strategjike, të cilat janë në ndërtim dhe të cilat duhet të ndërtohen.

Në këtë drejtim, do të thotë, Grupi Parlamentar, gjegjësisht, anëtarët e Komisionit Funkcional i kanë propozuar Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike që ta japin votën e vet pro këtij ligji në lexim të parë dhe të japin kontributin e tyre në komisionet funksionale. Ju faleminderit zoti Kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit. Në emër të PDK-së, Selvije Halimi, me kartelën e Berat Luzhës.

SELVIJE HALIMI – Ju faleminderit! Projektligji për vlerësimin strategjik, është një projektligj që së bashku me Ligjin që e kishim pak më herët për vlerësimin e ndikimit në mjedis, plotësojnë Ligjin për mjedisin edhe pse me vonesë të shtynë të mendosh se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, më në fund është përqendruar vërtet në fushë veprimtarinë e vet, gjegjësisht në lëmin të cilin e mbulon dhe kujdes të veçantë do t'i shtroj mbrojtjes së mjedisit. Megjithatë, mbetet të shihet se çka do të bëjë në të ardhmen dhe sa do ta mbikëqyrë zbatimin e këtyre projektligjeve.

Është një fatbardhësi se në këtë rast kemi dy projektligje të cilat duhet ta plotësojnë njëri-tjetrin dhe Komisioni do t'i shqyrtojë së bashku, me qëllim të plotësimit të tyre dhe të mos lejohet konflikti mes neneve apo dispozitave të caktuara.

Partia Demokratike e mbështet në parim këtë projektligj dhe shpresojmë që gjatë punës në komisione, të gjitha ato mangësi do të plotësohen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit. Në emër të AAK-së, Mazllom Kumnova.

MAZLLOM KOMNOVA: Zoti Kryetar,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor dhe me këtë rast ka konstatuar se Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, është duke e bërë një përpjekje serioze në konsolidimin e legjislacionit për mjedis, duke llogaritur se, përveç këtij projektligji, kemi edhe tri ligje për mbrojtjen të mjedisit të specifikuar.

Arsyet pse na duhet një ligj i tillë qëndron se kërkesa globale të marrëveshjeve ndërkombëtare mjedisore, si dhe direktivat e BE-së janë, që përveç projekteve duhet vlerësuar edhe ndikimet eventuale në mjedis të planeve dhe programeve zhvillimore të vendit. Kjo do të sigurojë që vendimet të merren në informata të bazuara, të konsiderohen të gjitha opsionet dhe alternativat si dhe të konsiderohen vërejtjet e publikut në procesin e vendimmarrjes. Për t'i siguruar këto janë miratuar protokolli për vlerësimin strategjik mjedisor në vitin 2003 dhe direktiva e veçante, po e njëjta me dy ... Në përgjithësi vlerësimi mjedisor në kontekstin global del, projektet individuale, diga, autostradë dhe termocentrale, fabrika aeroporte e të tjera janë çështje të Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis. është shumë e rëndësishme, Dy planet, programet dhe politikat strategjike në fushat e ndryshme zhvillimore, si i tha edhe ministri - energjetika, minierat, bujqësia, pylltaria, transporti e të tjera, janë çështje të vlerësimit strategjik mjedisor. Pra, këto dy projektligje nuk i plotësojnë njëri-tjetrin. Absolutisht. I kanë të ndara veprimtaritë.

Pas miratimit, javë më parë të Ligjit për vlerësimin e ndikimi në mjedis, është për lëvdatë përcjellja e menjëhershme e këtij ligji edhe pse në parim duhej të shkohet anasjelltas, ose këto dy projektligje të shkojnë bashkë. Kjo kornizë ligjore, nëse duhet të implementohet në mënyrë strikte, jam i sigurt se do të sigurojë një zhvillim të planeve dhe programeve, por edhe projekteve konkrete në pajtim me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm, duke marrë në konsiderim edhe situatën e rëndë mjedisore aktuale, sidomos kur merret parasysh fakti se Kosova po hyn në fazën e pavarësisht si shtet, e kur duhet të fillojë të zhvillojë politika, paraprijnë investimet konkrete që doemos duhet të kenë ndikim në mjedis.

Po ashtu është e njohur se përveç institucioneve tona vlerësimin mjedisor e kërkojnë edhe institucionet kryesore financiare; Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim, Banka Evropiane e Investimeve e të tjera. Qëllimi i këtij projektligji është të krijoj kushte të ndërveprimit për mbrojtjen e mjedisit gjatë procedimit të përgatitjes, miratimit dhe sidomos

të realizimit të planeve dhe programeve zhvillimore , që në mungesë të vlerësimit të tyre, mund të rrezikojnë resurset natyrore dhe jo vetëm natyrore por edhe të kulturës, të mirat materiale e të tjera. Në këtë kontest na merr mendja se në projektligj duhet të precizohen me kreun e parë të dispozitave të përgjithshme se çfarë janë këto plane dhe programe. A janë zhvillimore, a shkollore a çfarë janë” Edhe pse një përpjekje e tillë është bërë në përkufizime, si dhe në zhvillimin e parimeve të vlerësimit strategjik mjedisor, por ka dalë e mangët, ashtu si ka dalë edhe neni 4, pika 1. Besojmë se gjatë punës në komisione do të plotësohen dhe përmirësohen këto mangësi. Propozoj që në Komision të dy ligjet të trajtohen së bashku, pasi që vetë natyra e rregullimit të tyre është e ngjashme- ky projektligj dhe projektligji që e kemi miratuar në seancën e kaluar.

Duke e përgëzuar edhe një herë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet në parim këtë projektligj. Falemnderit!

KRYETARI: Ju falemnderit. Nga ORA - Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA –Zoti. Kryetar ,për të mos ardhur edhe unë në pozitë të më thuash thuaje më shpejtë, unë po them menjëherë-Grupi Parlamentar ORA e përkrah ligjin në parim.

KRYETARI: Ju falemnderit! Nga LDD-ja Lulzim Zeneli

LULZIM ZENELI: Duke e ndjekur rrugën e njëjtë, dëshiroj ta adresoj një vërejtje që e kam. Unë besoj që do të jetë produktive. Vërejtja adresohet sa i përket nenit 16 ku duhen të qartësohen procedurat e miratimit apo edhe të refuzimit të Raportit për vlerësimin strategjik mjedisor. Unë besoj se gjatë procedurës parlamentare kjo çështje do të evitohet dhe në parim Grupi Parlamentar i LDD-së e mbështet. Ju falemnderit

KRYETARI: Ju falemnderit. Grupi 6+ Rifat Krasniq

RIFAT KRASNIQ: Ju falemnderit zoti Kryetar.

Unë do ta zgjas me tepër.

Sayın Meclis Başkanı, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

Çevreye olumsuz etkide bulunan faktörlerin değerlendirilmesiyle ilgili Yasa Tasarısını prensipte onayladıktan sonra, Çevreye olumsuz etkide bulunan faktörlerin stratejik değerlendirilmesine ait Yasa Tasarısının görüşülmesine sıra geldi. Çünkü bununla, bu alandaki yasama tamamlanmış olacaktır, aynı zamanda bu Yasa, yaşam ortamı ile insan sağlığının en yüksek seviyedeki korunum plan ve programlarına ilişkin çevrenin stratejik değerlendirilmesinin yapılmasını sağlamış olacaktır.

Sözkonusu Yasayla ayrıca, çevre ile doğal kaynakların daha faydalı bir şekilde istifade edilmesi ve yasamanın Avrupa Birliğinin talimatlarına göre gelişmesi ile uyumlaştırılması yönündeki sorumluluklar güçlendirilmiş olacaktır. Çevrenin stratejik değerlendirilmesiyle ilgili yaklaşık olarak Çevreye olumsuz etkide bulunan faktörlerin değerlendirilmesine ait Yasa Tasarısındaki süreçlere bence süreçler öngörülmüştür. Bundan ötürü de Komisyonumuz, bu konuyu gözönünde bulundurarak, prensipte onaylanması gereken bu Yasa Tasarısını da görüşecektir. Ju falemnderit shumë.

KRYETARI: Ju falemnderit! Në emër të Grupit për Integrim, Ferid Agani..

FERID AGANI: Ju faleminderit zoti Kryetar. Grupi Parlamentar për Integrim në parim e mbështet këtë projektligj, por e ka një çështje, të cilën dëshiron që ndoshta Ministri t'ia sqarojë Kuvendit. Me qenë se në shkresën shpjeguese - përcjellëse Ministria deklarohet se ekziston një përputhshmëri e lartë e këtij projektligji me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe numërohet një varg i direktivave të Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian, ndërsa në deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së thuhet shumë qartë se ky projektligj në pjesë shumë të rëndësishme nuk është në pajtim me legjislacionin Evropian. Unë kuptoj kapacitetet e implementimit të ligjeve dhe rrethanat e Kosovës dhe faktin se Kosova nuk do të jetë në gjendje edhe nuk është në gjendje qysh tani të miratojë ligjet të cilat janë në përputhshmëri të plotë me legjislacionin Evropian, mirëpo kur bëhet fjalë për një ligj i cili i rregullon procedurat për zgjedhjen e projekteve të cilat kanë ndikim në mjedis, atëherë do të më kishte interesuar se pse këto pjesë shumë të rëndësishme që janë të përmendura këtu, nuk janë të inkorporuar në ligj. Kjo nuk është e qartë, sepse me materialin që ju ka dorëzuar deputetëve nuk ekziston shkresa përcjellëse e Agjencionit për Integrim Evropian me rekomandimet dhe komentet shtesë prej të cilave do të mund të kuptonim se për çka bëhet fjalë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit. Kandidatja e fundit është Naxhije Doçi.

NAXHIJE DOÇI: Ju faleminderit zoti Kryetar.

Projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor është i shumëpritur dhe shumë i nevojshëm për te ne në Kosovë, se deri më tani nuk e kishim si të tillë. Është një projektligj i ri dhe shumë i rëndësishëm, qëllimi i të cilit është vlerësimi strategjik mjedisor i planeve dhe i programeve për t'u siguruar shkallë më të lartë mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Ky projektligj do të sjellë risi dhe siguri rregullative për shfrytëzim efikas të mjedisit dhe të resurseve natyrore të ne. Do të përcaktoj kushtet dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis të planeve dhe të programeve të caktuara të përgatitura nga nivelet qendrore dhe lokale dhe mbi parimet e mbrojtjes së mjedisit do të përcjellë edhe procedurat e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe të programeve të tilla. Për hartimin e këtij projektligji ceket se janë marrë për bazë legjislacionet e përafërta të vendeve të rajonit si janë: Sllovenia, Kroacia dhe Shqipëria dhe kujtoj se është bërë një hap i mirë ngase janë hulumtuar dhe përvojat e të tjerëve.

Vlen për t'u cekur se ky projektligj është në harmoni me parimet themelore të legjislacionit Evropian, si edhe nuk përmban elemente diskriminuese në te. Në nenin 3, pika 5 ku flitet për informimin dhe transparencën me publikun, për planet ose programet e caktuara dhe për ndikimin e mundshëm të tyre në mjedis, gjatë finalizimit të procedurave nuk është cekur se si do të realizohet në ecuri e tillë. Në të mirë të sqarimit më të plotë të këtij parimi, propozoj edhe një pikë shtesë të këtij neni, pra të pikës 6, ku do të konkretizohet më qartë realizimi i qëllimit të përmendur për informim dhe për transparencë me publikun.

Në kapitullin e gjashtë të dispozita ndëshkuese, neni 24, ku parashihen gjobat për mundësitë e shkaktimit të dëmeve të konsiderueshme në mjedis të planeve dhe të programeve të hartuara nga organet kompetente të administratës qendrore dhe lokale, mendoj se shuma e gjobave nuk është ecuri e qëlluar e dëmeve të shkaktuara, pasi gjoba sado që të jetë ajo e

madhe, paguhet nga projektuesi i planit e të gabuar, por e keqja është se dëmi mbetet, që do të ndikojë jo mirë në mjedis dhe për komunitetin mjedisor.

Propozoj edhe një pikë shtesë të nenit në fjalë ku do të parashihen kritere parandaluese më të suksesshme dhe më pozitive për moslejimin e shkaktimit të dëmeve të planeve dhe të programeve të hartuara me gabime.

Në fund po ceku se Projektligjin për vlerësimin strategjik mjedisor e përkrah në parim pasi është një Projektligj i mirë dhe se krijon kushtet e mira për kritere pozitive në këtë aspekt, ashtu si krijonte edhe Projektligji për vlerësimin e ndikimit për mjedis në aspektin e vet. Mendoj, se miratimi brenda një kohe të shkurtër, të përafërt të shkurtër të këtyre dy projektligjeve do t'i plotësoj nevojat e domosdoshme legislative për shfrytëzim të mjedisit tonë sipas nevojave tona, dhe sipas rregullave dhe modeleve pozitive të shteteve demokratike të Bashkësisë Evropiane. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI: Ju faleminderit! Meqë nuk ka deputetë tjetër të interesuar për diskutim, shkojmë në votim të Ligjit për miratim në parim.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.
Të pranishëm në sallë janë 65 deputetë

Votojmë tash.

Me 62 vota “për” dhe 1 kundër miratohet në parim Projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor.
Ju faleminderit!

Mledhja do të vazhdojë punën të hënën, më 17 shtator, në orën 10.

(Vazhdimi i punës së Seancës plenare, më 17.09.2007)

KRYETARI: Vazhdojmë punën nga seanca e së premtes. Në radhë është pika 9 e rendit të ditës.

-Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 21 nëntor 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet, rekomandimet e tyre, si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për ushqim e ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ushqimin nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ushqimin nuk përmbajnë implikime buxhetore. Amendamente në tekstet e projektligjit kanë propozuar, në cilësitë e komisioneve funksionale: Komisioni për Bujqësi dhe Komisioni për Shëndetësi dhe në cilësinë e komisionit kryesor, Komisioni për Buxhet dhe Financa.
Urdhëro, Ramadan!

RAMADAN KELMENDI: Ju faleminderit kryetar. E di rendin e ditës, por për shkak të urgjencës që është krijuar së paku, më lejoni një minutë që në mënyrë informative ta paraqes një kërkesë.

Unë u drejtohem: kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Grupit Iniciator. Vetëm një minutë, ju kisha lutur, ngase situata është urgjente (Kryetari: Ramadan, ju e dini procedurën). Ramadan Kelemendi: Zoti Kryetar, dhe ka vluar situata në Mitrovicë. Po rrënohet pllaka përkujtimore e Avni Haradinajt dhe në Mitrovicë sot mund të eskalojë situata. Desha t'i them dy fjalë dhe më asgjë të mos bëjmë. (Kryetari, urdhëro). Ramadan Kelmendi: Unë në cilësi të deputetit të Kuvendit të Kosovës i drejtohem kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kryetarit të Kosovës, Kryesisë së Kosovës, i drejtohem Grupit Negociator, Kabinetit Qeveritar dhe të gjithë deputetëve të nderuar që janë këtu dhe që nuk janë. Më lejoni që në fillim të seancës së sotme të kërkoj si çështje mjaft urgjente debatin për çështjen e sigurisë në Mitrovicë nga dita e djeshme.

Dje në orën 10 e 20, në Lagjen e Boshnjakëve ka ardhur makineri e rëndë me regjistrim të Serbisë me çka filluar të rrënojnë pllakën përkujtimore të dëshmorit Avni Haradini i cili është vlarë në mbrojtje të Mitrovicës Veriore. Situata është në rrezikshmëri të skajshme për çështjen e sigurisë së qytetarëve shqiptarë në atë pjesë. Ata kanë protestuar dhe sot kërkojnë qëndrimet e Qeverisë, të dikujt, ose nëse s'ka mundësi, le të shkojë burrë dikush atje lë të shikojë se sa është situata e rëndë. Kjo është situata- vlerësoni, të gjithëve iu drejtova. Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kelmendi, rregulla e re 23.2 thekson: Në fillim të seancës ky propozim i rendit të ditës do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë kandidatë ose grupe parlamentare, apo 6 anëtarë të Kuvendit i propozon me shkrim kryetarit një amendament për rendin e ditës, i cili hidhet në votim. Kryesia e miraton propozimin e rendit të ditës dhe ua shpërndanë atë secilit anëtar të Kuvendit. I njëjti publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës në internet.

Nëse ju e konsideroni se çështja është urgjente, përse grupi juaj parlamentar nuk e ka dorëzuar në afatin e caktuar me ligj, me Rregullore dhe natyrisht edhe me shkrim. Është dashur si çështje urgjente të paraqitet me shkrim. Ju faleminderit! Urdhëroni z. Xhavit !

XHAVIT HALITI: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Duke pasur parasysh shqetësimin e deputetit Kelmendi, e kuptoj atë dhe i kuptoj të gjitha shqetësimet e qytetarëve të Mitrovicës dhe të Kosovës, për një akt të tillë vandal, por besoj që ne duhet të jemi edhe në nivelin e përgjegjësisë dhe të kuptojmë që Serbia është e interesuar të na provokojë. E në qoftë se është e interesuar të na provokojë, ne duhet të jemi në gjendje që këtyre provokimeve t'u përgjigjemi me urtësi, me urtësinë që na takon, duke mos rënë pre e provokimeve të tilla. E dimë gjendjen në Mitrovicë dhe si e njohim gjendjen në Mitrovicë, po aq i njohim dhe i dimë mundësitë tona reale. Thirrja nga ky Parlament për reagim popullor, mendoj që nuk i bën mirë institucioneve të Kosovës, në kushtet ku ne jemi duke zhvilluar vërtet një angazhim shumë të madh për statusin e Kosovës.

Në qoftë se ata e kanë rrëzuar pllakën në fjalë, ata e kanë pasur këtë qëllim. Na detyrojnë neve që të ngrihemi në protesta, që të futemi në valën e protestave si na ka ndodhur në të kaluarën përmes makinacioneve dhe informatave të pa verifikuara që kanë dalë në terren.

Mitrovica është një qytet i cili nuk do të ndahet, për këtë janë përcaktuar edhe fuqitë e mëdha, ata që do të vendosin realisht për fatin e Kosovës dhe të Mitrovicës dhe të gjitha këto mendoj, duke përfshirë edhe pllakën në fjalë dhe nesër edhe përmendoren e tij, po në atë vend që është rrëzuar, do të vendosen pas statusit të pavarur të Kosovës dhe do t'u bëja thirrje që të mos u jepmi shkas qytetarëve për revoltë, po t'u bënim thirrje që ata ta ruajnë vërtet gjakftohtësinë, ashtu siç e kemi pasur përvojën edhe në të kaluarën kur jemi provokuar nga forcat e tilla, forcat e errëta të cilat këtë, mendoj dhe jam i bindur këtë që po e them, e presim që ne të bëjmë. Të krijojmë situata të papranueshme edhe për bashkësinë ndërkombëtare, situata të cilat nesër mund të eskalojnë edhe me konfrontim me forcat e KFOR-it dhe të UNMIK-ut që janë të vendosura andej dhe dihet se në cilën pjesë dhe a do të lejoheshin që ne ta mbrojmë lagjen në fjalë, e cila realisht është nën përkujdesjen e forcave të KFOR-it.

Prandaj, meqenëse u ngrit publikisht do t'ju lusja edhe juve edhe deputetin Kelmendi, edhe qytetarët e Mitrovicës, që të kenë mirëkuptim për situatën e cila mund të eskalojë dhe mund të rrezikojë vërtet qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare, në qoftë se eskalon dhe mund të japë vlerësim pozitiv, në qoftë se ne jemi më të durueshëm dhe konstatojmë këtë që po e them se provokimi është i organizuar nga forcat e Qeverisë serbe. Nuk dua të them qysh jemi mësuar forcat paramilitare, militare e tjera, por direkt jam shumë i bindur që janë të organizuara nga forcat e Qeverisë serbe, nga forcat e BIAS- Shërbimit Sekret Serb, me qëllim që të na provokojë. Prandaj, ju kisha lutur që deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe qytetarët e Mitrovicës dhe të Kosovës të mos bien në provokimet e tilla. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Haliti! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Kuvendit,

Deputetë të respektuar,

Tani përtej rregullave të punës në këtë Kuvend doli një situatë, një problem, të cilin e theksoi deputeti Kelmendi. Unë në princip pajtohem me atë që foli para meje kolegu Haliti, i cili idenë e vet, madje e argumentoi në tri -katër pika të qëndrueshme. Unë e respektoj deputetin Kelmendi se njeriu që vjen nga ajo zonë e trazuar e Kosovës dhe me primesa të trazirave që janë permanente dhe ne i dimë, nuk janë të sodit dhe të djeshit, unë e respektoj dhe i besoj informatës së deputetit Kelmendi. Por, meqë tash problemi u shtrua në Kuvend dhe u adresua edhe në Kuvend edhe te kryetari i Kuvendit, te Qeveria dhe te Grupi i Unitetit, mendoj që ajo që duhet të bëhet për këtë, në këtë moment është që organet kompetente të marrin përgjegjësitë e veta edhe për këtë punë. Kjo i bien që ose kryetari i Qeverisë, ose ministri i Brendshëm të japim informata institucionale para Kuvendit. Ky është propozimi im dhe unë mendoj që kjo seancë dhe ky Kuvend sot nuk mund të bëjë asgjë më tepër, sepse ne kemi një informatë të një koleges tonë të respektuar, mirëpo nuk kemi kurrfarë informate të studiuar institucionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Gjatë ditës do të kërkojmë informata nga ministri i Punëve të Brendshme, ose nga kryeministri. Kalojmë në rendin e ditës E ka fjalën Fatmire Mulhaxha-Kollçaku.

FATMIRE MULHAXHA KOLÇAKU: Ju faleminderit zoti kryetar! Unë po lajmërohem për rend të ditës, d.m.th. për pikën -Shqyrtimi i dytë i Ligjit për ushqim. T'ju informoj, duke u nisur nga fakti që ky ligj në rend të parë ka për detyrë që të sigurojë jetën dhe shëndetin e njeriut, Komisioni për Shëndetësi, Punë, dhe Mirëqenie Sociale, ka kërkuar të

drejtën që të marrë pjesë në amendamentimin e këtij projektligji. Dhe këtë e ka bërë me përkushtim të madh, duke u konsultuar me një numër të madh ekspertësh vendorë të shëndetësisë publike. Për këtë projektligj amendamentit i ka bërë edhe Komisionit për Bujqësi. Ne kemi mbajtur dëgjim publik të përbashkët. Gjithashtu, kemi pasur edhe takime të përbashkëta. Dallimi i vetëm që kemi që është kyç në këto amendamente tona të dy komisioneve, qëndron në faktin që ky projektligj parasheh formimin e Agjencionit së Ushqimit, që duhet të jetë njëri ndër agjencione më të rëndësishme të Kosovës. Prandaj, ne, meqenëse Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka konsideruar që për shkak të rëndësisë së madhe që ka, siç e ceka, në jetën dhe shëndetin e njeriut, për momentin ky agjencion duhet të formohet në kuadër të Zyrës së kryeministrit dhe jo siç është kërkuar në versionin që ka ofruar Ministria e Bujqësisë, në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, për shumë argumente, sepse kjo domethënë është një çështje multidisiplinare dhe kërkon një trajtim të tillë.

Për ta mbështetur këtë gjë, kryetari i Kuvendit, i cili e ka ditur problemin që ka qenë, siç po e theksoj, te çështja kyçe- formimi i agjencionit, ne kemi mbajtur një takim të përbashkët- të dy komisionet, në prezencën e kryetarit të Kuvendit, i cili ka vendosur që këtë çështje ta rikthejë edhe një herë për rishqyrtim, çështjen e formimit të agjencionit në Qeveri dhe unë kam këtua vendimin e Qeverisë, të nënshkruar nga kryeministri zoti Agim Çeku, në të cilin në dy pika theksohet: Agjencioni Kosovar i Ushqimit i paraparë të themelohet sipas Projektligjit për ushqim, duhet të themelohet në kuadër të Zyrës së kryeministrit.

Do të thotë, ajo që kërkoj sot nga ju deputetë të nderuar, është që të mbështetni versionin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, një version që mbështet edhe nga kryeministri. Do të thotë, në çështjet e tjera nuk ka dallime të mëdha, sepse aty fjalën e kanë pasur ekspertët të cilët shumë mirë e njohin këtë lëmi dhe dallimi është vetëm te formimi i agjencionit. Prandaj, unë u mundova që ta jap një sqarim për deputetët të cilët, ndoshta, nuk kanë pasur informata më të përafërta dhe ju falënderoj për fjalë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Urdhëroni zoti Zeneli!

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryetar! Nuk e kam pasur ndërmend të diskutoj, ta marrë fjalën, mirëpo pasi që kolegeja nga Komisioni për Shëndetësi e dha mendimin e vet dhe në emër të Komisionit, më lejoni që në emër të Komisionit për Bujqësi ta jap edhe qëndrimin tonë si Komision që kemi punuar në kontinuitet të plotë për një periudhë të gjatë në këtë projektligj. Është fakt që këtu është krijuar një dualizëm sa i përket koncepteve që janë adresuar nga ana e Komisionit për Shëndetësi në raport me këtë projektligj.

Mirëpo, ajo esenciale çka qëndron në këtë projekt është, Komisioni për Bujqësi punën e vet e ka bazuar në përpikëri të plotë me dokumentet të cilët rregullojnë këtë çështje. Unë vetëm dua të citoj:

Amendamentet e Komisionit për Bujqësi janë në pajtim të plotë me rregullën apo dokumentin 2001/18 që themelohen ministritë dhe adreson çështjen e agjencioneve.

Ju lutem, ta keni në konsideratë se ky projektligj është një projekt i cili i adreson çështjen e kualitetit të ushqimit, të sigurisë së ushqimit dhe çështjet që kanë të bëjë ushqimi me prejardhje bimore dhe shtazore. Ajo çka ngërthen në vete ky projekt ka të bëjë me fushën e veterinës, me fushën e kontrollit të ushqimit, cilësisë, fushën e bimëve,

Inspektoratin fito-sanitar dhe inspektoratet të cilat kanë të bëjnë, kryekëput, me çështjen e sigurisë dhe kualitetin e ushqimit.

Në qoftë se ne e adresojmë një përgjegjësi të tillë në kuadër të Qeverisë, ju them me përgjegjësi të plotë, se ky Kuvend, ose këta deputetë të cilët mendojnë kesi soji gabojnë rëndë, për arsye se ky projekt është hartuar në përputhje të plotë dhe mendimet që i kanë dhënë ekspertët e FAOS dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë, që kanë qenë edhe spozorizues të këtij projekti.

Ndryshimi i konceptit është ndryshim i tërësishëm i menaxhimit të kësaj fushe. Nëse mendojmë se çështjen e veterinarisë dhe të ushqimit ta shkëpusim nga një segment që i takon bujqësisë dhe të kalojë në kompetencat e Qeverisë, atëherë ju them me përgjegjësi të plotë se ky projekt bie në kundërshtim të plotë me dokumentin 2001/18 që krijon agjencionet, që e administrojnë fushën e ushqimit dhe definitivisht kemi të bëjmë me një projekt i cili nuk mund të jetësohet asnjëherë. Fundi i fundit kemi probleme të mëdha me nënshkrimin e ligjeve të cilët adresohen prej çështjes së Zyrës Ligjore në kuadër të UNMIK-ut. Me përgjegjësi të plotë them se në qoftë se adresohet një çështje e tillë çfarë ka menduar Komisioni për Shëndetësi, ky ligj nuk mund të jetësohet asnjëherë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka profesor Gashi.

ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës ky ligj është i një rëndësie të posaçme, mendoj se edhe grupet e tjera kanë një ndjenjë të njëjtë.

Ne me shumë përkushtim kemi punuar si grup në versionin e parë. Po ashtu, në përgatitje të amendamentimit, qoftë në njërin apo në tjetrin komision.

Si Grup Parlamentar, zoti kryetar e kemi mbështetur që të jetë në rend dite, me shpresë që kur të vijë deri te harmonizimi i amendamenteve, ne do ta kemi një pozicion të qartë se për çfarë do të votojmë si deputetë.

Ne si Grup Parlamentar sot nuk e kemi një propozim të qartë të amendamentuar për këtë ligj. Andaj, zoti Kryetar, ju lutem që mos na detyroni që të votojmë një konfuzion. Andaj, me respektim të Zyrën Ligjore të Kuvendit të Kosovës, nëse është ky që kërkon ligji që ky të jetë leximi i tretë, le të jetë i treti, i katërt, i cilit do qoftë, por mos kërkon nga ne që të votojmë për një çështje për të cilën ne jemi të bindur që nuk është e kristalizuara dhe ne e shohim që ky amendament krijon një konfuzion.

Prandaj, ju lutem që t'u jepet mundësi komisioneve, Ministrisë dhe Qeverisë dhe mundësisht, në njërin prej mbledhjeve të ardhshme, do të thotë, mundësisht në mbledhjen e parë, që të na vijë qëndrimet e kristalizuara.

Këto janë dy koncepte. Vetëm nëse votohet për një amendament, një koncept, ky koncepti tjetër do të ketë vështirësi. Andaj, në emër të Grupit Parlamentar ju shprehim qëndrimin tonë se ne s'jemi të gatshëm të votojmë për një çështje që nuk e kemi plotësisht të qartë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Afrim Azuarllxhiu e ka fjalën.

AFRIM AZUARLLXHIU: Ju faleminderit, zoti kryetar! Ju përshëndes të gjithëve. Edhe ne si Grup Parlamentar pajtohemi me propozimin e zotit Gashi që kjo procedurë të shtyhet për më tutje, sepse mendojmë se problemet nuk janë zgjidhur. Nëse dëgjohen mendimet e Komisionit për Shëndetësi, atëherë ata kanë të drejtë. Mirëpo, nëse dëgjohet ana tjetër, atëherë del një konfuzion jashtëzakonisht i madh, prandaj, mendojmë se kjo çështje duhet të shtyhet deri sa të definohet mirë. Të ulen përsëri Ministria për Bujqësi, bashkë me Ministrinë për Shëndetësi, t'i definojnë problemet dhe pastaj të paraqitet edhe një herë në Kuvend që edhe ne të kemi më të qartë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Atëherë propozimin e deputetit Alush Gashi e hodhi në votim, që të shtyhet për leximin e tretë:

Kush është për? Shumica. Ju faleminderit! Kundër 6. Abstenim 1. Ju faleminderit!. Projektligji shtyhet deri në arritjen e marrëveshjes ndërmjet dy komisioneve- zyrave ligjore.

Kalojmë në pikën e radhës. Pika e dhjetë e rendit të ditës.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë organike.

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 13 prill 2007. Komisionet parlamentare i kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet e tyre si vijon: Komisioni për Çështje Gjyqësore Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për bujqësinë organike e ka bazën e vetë juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për bujqësinë organike nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

3. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për bujqësinë organike nuk përmbajnë implikim buxhetore.

Kalojmë në miratimin e amendamenteve sipas radhës:

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për..... 58,

Kundër .. 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për..... 61,

Kundër s'ka.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për..... 64,

Asnjë kundër

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4
Votojmë tash:
Për..... 62,
Kundër .. 1.
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 5
Votojmë tash:
Për..... 62,
Asnjë kundër
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 6
Votojmë tash:
Për..... 63,
Asnjë kundër
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 7
Votojmë tash: Ju njoftoj se në sallë janë 78 deputetë.
Për..... 62,
Asnjë kundër.
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 8
Votojmë tash:
Për..... 65,
Asnjë kundër
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 9
Votojmë tash:
Për..... 61,
Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 10
Votojmë tash:
Për..... 58,
Asnjë kundër.
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 11
Votojmë tash:
Për..... 63,
Asnjë kundër.
Miratohet amendamenti.

Amendamenti 12

Votojmë tash: Kemi dy propozime, Propozimin e Komisionit FunkSIONAL dhe Komisionit për Buxhet A kanë shpjegime përfaqësuesit e komisioneve për këtë? Komisioni FunkSIONAL, Komisioni për Buxhet. Urdhëroni zoti Osmani.

NASER OSMAN: Zoti kryetar, ne si Komision e kemi vlerësuar dhe kemi dhënë këtu shumë dhe e konsiderojmë që në Parlament duhet të votohet propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Rifat Krasniq.

RIFAT KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti kryetar! Edhe ne në Komision kemi biseduar, kemi parë këtë dënim dhe kemi vlerësuar që Komisioni për Buxhet që e ka bërë atë në kundërshtim me Komisionin për Bujqësi. Ne dëshirojmë që vendimin tonë, amendamentimin tonë, ta përkrahim këtë.

KRYETARI: Ju faleminderit! Urdhëroni zoti Zeneli.

LULZIM ZENELI: Kur është çështja te dënimi, pikërisht te gjobat, të cilat ngritën në rast të shkeljes, Komisioni për Bujqësi ka konsideruar se gjoba varion si propozim i Komisionit prej 300 € deri në 1000 €. Ndërsa në anën tjetër e kemi 300, deri 3000. Mirëpo, ne e kemi konsideruar këtë variacion të gjatë, për shkak se shkallja e shkeljes mund të ndryshojë dukshëm dhe këtë ma së miri e vlerësojnë ata që janë kompetentët. Prandaj ,konsiderojmë që kjo korrespondon thjeshtë me nevojat, jo nevojat, po pikërisht me gjendjen aktuale e cila mbretëron këtu te ne. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Kalojmë në votim për Propozimin e Komisionit për Buxhet.

Votojmë tash:

Për..... 38,

Kundër ... 11,

Miratohet amendamenti në propozim të Komisionit për Buxhet, si Komision FunkSIONAL.

Kalojmë në procedurën e votimi në tërësi të projektligjit bashkë me amendamentet

Votojmë tash:

Për..... 64,

Kundër ...1.

Konstatohet se miratohet teksti i Projektligjit për bujqësi organike bashkë me amendamentet e dhëna.

Pika e 11 e rendit të ditës.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor

Miratimi në parim të këtij projektligji është bërë me 31 maj 2007. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar në Kuvend , e kanë paraqitur këtë raport dhe rekomandimet si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor ka bazën e vetë juridike kushtetuese.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor nuk i cenojnë të drejtat e komuniteteve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor nuk përmbajnë implikime buxhetore. Kalojmë në miratimin e amendamenteve të këtij projektligji.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për..... 59,

Kundër ... 1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për..... 60,

Kundër1.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për..... 64,

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për..... 62,

Kundër ... 1.

Miratohet amendamenti.

KRYESUESI: Vazhdojmë seancën.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Për..... 56,

Abstenim..2

Asnjë kundër.

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Për..... 61,

Kundër1

Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për..... 61,

Kundër ...2.

Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Për..... 60,

Kundër3

Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Për..... 57,

Kundër ...2.

Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Për..... 61,

Kundër ...2

Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Për..... 57,

Kundër2

Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Për..... 57,

Kundër ...1

Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Për..... 59,

Kundër1

Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

Për..... 58,

Asnjë kundër

Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Për..... 56,

Kundër ...2
Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16
Votojmë tash:
Për..... 58,
Kundër ...1
Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17
Votojmë tash:
Për..... 54,
Kundër ...1
Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18
Votojmë tash:
Për..... 61,
Asnjë kundër
Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19
Votojmë tash:
Për..... 59,
Asnjë kundër
Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20
Votojmë tash:
Për..... 54,
Kundër ...2
Miratohet amendamenti 20.
Dhe, amendamenti i fundit, e hedhim në votim.

Amendamenti 21
Votojmë tash:
Për..... 59,
Asnjë kundër
Miratohet amendamenti 21.

Lus deputetët që të deklarohen për tekstin në tërësi të Projektligjit me ndryshimet e bëra dhe amendamentet e votuara.

Në sallë janë 71 deputetë.
Votojmë tash:
Konstatoj se me 66 vota “për” dhe asnjë “kundër” Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës-në pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.

-Shqyrtimi i propozimeve të partive parlamentare për anëtarë në Komisionin ad - hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së

Në pajtime me nenin 23.2, pika d) të Ligjit për RTK, shumica e partive politike të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës i kanë propozuar anëtarët për formimin e Komisionit Ad - hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së. Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 6 shtator 2007 ka shqyrtuar propozimet e partive parlamentare dhe ka kërkuar nga partitë që nuk i kanë bërë propozimet t'i bëjnë deri më 13 shtator 2007. Propozim vendimi i Kryesisë për formim të Komisionit Ad - hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së u është shpërndarë deputetëve.

Partitë që nuk i kanë propozuar emrat e anëtarëve për formimin e Komisionit Ad - hoc mund t'i propozojë tani, e ato janë:

Lista Serbe për Kosovë,
Partia Shqiptare Demokristiane,
Partia Demokratike Ashkali e Kosovës dhe
Iniciativa Qytetare e Gores. Pra, janë katër subjekte politike që nuk i kanë paraqitur deri më tani anëtarët për këtë komision.

Ftoj, pra, kryetarët ose përfaqësuesit e partive në fjalë, por edhe të LDD-së, qenka Lulzim Zeneli këtu, që t'i propozojnë emrat për anëtarët e Komisionit Ad - hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së.
Deputeti Mark Krasniqi e ka fjalën.

MARK KRASNIQI: Kryesia e Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës ia ka dhënë propozimin me shkrim Zyrës së Kryetarit të Parlamentit më 12 të këtij muaji që Mustafë Halili të jetë anëtar i këtij bordi. Nuk di pse nuk e kemi në rend të ditës.

KRYESUESI: Zoti deputet, anëtarë të Komisionit Ad - hoc mund të jenë vetëm deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe lus që ta propozoni veten për anëtar të Bordit të RTK-së. Atëherë, Mark Krasniqi, pra, nga PSHDK-ja. Nga Iniciativa Qytetare e Gores, Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUSH: Mislim da je greška. Građanska inicijativa Gore je na spisku, ima kandidata, a nema Građanska inicijativa Srpske liste GIS. Samo se radi o grešci.

KRYESUESI: Po e pranoj, gabimi qenka për një parti tjetër që nuk është në Kuvend. Më lejoni që t'jua lexoj listën definitive të anëtarëve të Komisionit Ad - hoc për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së :

Ramadan Musliu nga LDK-ja
Hajredin Kuçi ,anëtar i PDK-së.
Mazllom Kumnova, AAK,
Ylber Hysa, ORA,
Lulzim Zeneli, LDD,
Xhezair Murati, Vakati,
Mahir Jagcilar, KDTK
Emrush Xhemaili, LPK
Gjergj Dedaj, PLK
Ferid Agani, PD

Zylfi Mrxha, PRBK
Numan Baliq, SDA
Vezira Emrush, GIG
Mark Krasniqi, PSHDK
Bislim Hoti, IRDK

Mandati i këtij komisioni është që të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve dhe Kuvendit t'ia propozojë anëtarët e Bordit të RTK-së. Lus deputetët që të deklarohen për formimin e Komisionit Ad - hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së dhe përbërjen që lexova.

Kush është “për”, le ta ngrisë dorën. Shumica. A ka kundër? Nuk ka, A ka abstenime? Një abstenim. Konstatoj se me shumicë votash, asnjë kundër dhe me një abstenim, Kuvendi formoi Komisionin ad - hoc për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i propozimeve të partive parlamentare për anëtarë në Komisionin ad - hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave**

Konstatimet hyrëse. Në pajtim me nenin 4.4 pika e) të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe transmetimin, shumica e partive politike të përfaqësuesve në Kuvendin e Kosovës i kanë propozuar anëtarët për formimin e Komisionit ad - hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 6 shtator 2007, ka shqyrtuar propozimet e partive parlamentare dhe ka kërkuar nga partitë që nuk i kanë bërë propozimet, t'i bëjnë deri më 13 shtator 2007. Propozimvendimi i Kryesisë për formimin e Komisionit ad - hoc të Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave u është shpërndarë deputetëve.

Partitë që nuk i kanë propozuar emrat e anëtarëve për formimin e Komisionit ad – hoc, mund t'i propozojnë tani. Më lejoni t'jua lexoj emrat e anëtarëve të Komisionit që janë propozuar gjer më tani.

Naim Jerliu, anëtar i LDK-së
Fehmi Mujota, PDK
Myrvete Dreshaj- Baliu, AAK
Fatmire Mulhaxha, ORA
Besa Gaxherri, LDD
Rifat Krasniq, PDTK
Emrush Xhemaili, LPK
Gjergj Dedaj, PLK
Ferid Agani, PD
Xhezair Murati, VAKAT
Zylfi Mërxha, PBRK
Numan Baliq, PVD
Vezira Emrush, GIG
Xhevdet Neziraj, IRDK

Nuk i kemi propozimet për PSHDK-në, për Listën Serbe, për Partinë Demokratike PDAK dhe për GIS.

A ka propozime nga këto subjekte politike për anëtarë? Zef Morina e ka fjalën.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues! Meqenëse këtu nuk figuron Partia Demokristiane për Integrim, mendoj që në vend të PSHDK-së të jem unë, apo ndoshta profesor Marku e ka ndonjë propozim tjetër. Por, nëse nga PSHDK-ja shkon prapë profesor Marku, atëherë duhet të jetë edhe anëtar i Partisë Demokristiane për Integrim.

KRYESUESI NAIM MALOKU: E ka fjalën deputeti Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: A duhet të jetë patjetër prej partisë të cilën e përfaqësoj unë, apo mund të jetë prej partisë tjetër- ta propozoj unë.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Duhet të jetë deputet i Kuvendit të Kosovës, zoti profesor.

MARK KRASNIQI: Pa marrë parasysh partinë, apo jo?

KRYESUESI NAIM MALOKU: Duhet të jetë i të njëjtës parti.

MARK KRASNIQI: Hajt t'i numërojmë votat sa janë.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Atëherë, Zef Morina, anëtar i 15-të. E hedh në votim listën e propozuar për formimin e Komisionit ad - hoc për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Kush është “për”? Ju faleminderit! Shumica absolute. A ka “kundër”? Asnjë. A ka abstenime? 1 abstenim. Në sallë janë 74 deputetë. Me asnjë votë “kundër” dhe me një abstenim, Kuvendi emëron anëtarët e Komisionit ad - hoc për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave. Mandati i këtij komisioni është që të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve dhe Kuvendit t’ia propozojë anëtarët e Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave.
Ju faleminderit!.

Kalojmë në pikën e radhës, të 14-të të rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe
Financa lidhur me kërkesën e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe
Zhvillim Rural për transferin e mjeteve buxhetore**

Ministria për Bujqësi në pajtim me nenin 27.3 të Ligjit për menaxhimin e financave publike ka bërë kërkesë për lejimin e transferit të mjeteve buxhetore në shumë prej 300 mijë eurosh nga kategoria e investimeve kapitale në subvencione.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në pajtim me këtë ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë për Bujqësi dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.
Rekomandimi i Komisionit, së bashku me kërkesën e Ministrisë për Bujqësi u është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet e Financa zotin Naser Osmani që ta arsyetojë rekomandimin.

Fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit!
I nderuari kryesues,
Të nderuar deputetë,

Ka që një kohë të gjatë që ka ardhur kërkesa për një transfer. Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për një transfer për 300 mijë euro nga pozicioni i investimeve kapitale në subvencione dhe transfere.

Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike, neni 27.3 parasheh që shumën nga një pozicion në një pozicion tjetër mbi 40% ta miratojë Kuvendi i Kosovës.

Meqenëse kemi të bëjmë me një donacion të Agjencionit Evropian për të njëjtën shumë, konsideroj që Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë një kërkesë të tillë. Të gjitha procedurat ligjore janë respektuar nga Ministria në fjalë, po ashtu edhe nga Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe konsideroj që janë plotësuar të gjitha kushtet për një miratim të tillë. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputeti Alush Gashi.

ALUSH GASHI: Ju faleminderit zoti Kryesues! Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet kërkesën e ministrit të Bujqësisë dhe Pylltarisë, si edhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ne do të votojmë për këtë propozim. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Nuk ka të paraqitur të tjerë për fjalë. Lus deputetët që të deklarojnë për rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Lus regjinë që të bëhet gati për votim. Votimi është elektronik.

Votojmë tash. Në sallë janë 71 deputetë. Konstatoj se me 56 vota “për” dhe 7 vota kundër,” Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e transferit të mjeteve buxhetore të Ministrisë për Bujqësi në shumën prej 300 mijë euro nga kategoria e investimeve kapitale në subvencione. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës, pika e 15 e rendit të ditës.

- Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Ministrisë për Energji dhe Miniera për transferin e mjeteve buxhetore nga Ministria në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit

Konstatimet hyrëse. Ministria për Energji dhe Miniera në pajtim me nenin 27.3 të Ligjit për menaxhimin e financave publike ka bërë kërkesë për lejimin e transferit të mjeteve buxhetore në shumën prej 1 milion euro nga kategoria e investimeve kapitale të Ministrisë në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me këtë, ka shqyrtuar kërkesën e Ministrisë për Energji dhe Miniera dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Rekomandimi i Komisionit ,së bashku me kërkesën e Ministrisë për Energji dhe Miniera, u është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta arsyetojë rekomandimin. Fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit i nderuari kryesues! Këtu vetëm kemi një rast tjetër dhe duhet të bëj një sqarim që Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka rekomanduar miratimin , por e ka rekomanduar që kjo çështje të bartet në Kuvend, që Kuvendi të vendosë lidhur me këtë çështje. Këtu kemi një situatë tjetër kur të bëhet bartja, vetëm bëhet ndërrimi i projektit, ndërsa është në një shtyllë, domethënë që ka të bëjë brenda investimeve kapitale. Fjala është që mjetet në shumë prej 1 milion euro të barten nga një projekt që ka qenë i dedikuar për ngritjen e linjes ajrore 400 kw Kosovë-Shqipëri të bartur në KOS, respektivisht në AKM për projektin e lartëpërquesit 110 kw në Vushtri.

Meqenëse nuk kemi argumente që projektin për linjën Kosovë – Shqipëri e ka finansuar Banka Gjermane ,deri atëherë, konsideroj që nuk duhet ta miratojmë, derisa nuk e kemi të argumentuar që mjetet janë të siguruar nga Banka Gjermane për këtë projekt. Ju faleminderit!.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemaili. Besoj. në cilësinë e kryetarit të Komisionit Funkcional. Urdhëroni!

BAJRUSH XHEMAILI: Përshëndetje zoti kryesues,
Ministra të nderuar,
Kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Që në fillim dua të theksoj se Grupi Parlamentar i PDK-së nuk e pranon transferin e mjeteve të linjës buxhetore të Ministrisë të Energjisë dhe Minierave prej 1 milion eurosh për investime kapitale të cilat janë dedikuar për projektin e ngritjes së linjës ajrore 400 KW Kosovë - Shqipëri në të mirë të AKM-së për programin e transmissioinit KOSTT.

Kjo përpjekje tregon edhe një herë se Qeveria kur është në pyetje AKM-ja kurrë nuk e kursen buxhetin konsoliduar të Kosovës, qoftë edhe në dëm të Kosovës. Edhe pse që në fillim të vitit gati një e treta e tërë Buxhetit të konsoliduar i është ndarë AKM-së, ju zotëri të Qeverisë doni që të bëni nderë me AKM-në që ta qerrasni edhe me një milion euro më shumë, se pak iu kanë dukur!

Arsyetimi i Qeverisë për këtë transfer është tejet i paqëndrueshëm pa as më të voglin argument dhe është arsyetim tejet naiv. Naiv deri në fund. Sipas jush, mjaftuaka që pasi për këtë projekt të linjës Kosovë-Shqipëri ka interesim dhe indikacione ta financojë Banka Gjermane për Zhvillim, këto mjete të barten menjëherë në AKM, pasi kështu po kërkua MEM-i, Ministria e Energjetikës dhe e Minierave.

Meqë gati kemi hyrë në tremujorin e fundit të vitit, këto para ka qenë dashur të harxhohen deri më tani për projektin e dedikuar, i cili do të duhej të ishte punuar, por Ministria e Energjetikës dhe e Minierave, në vend se ta kishte kryer punën në lidhje me projektin, ajo as që e ka filluar atë dhe, për më keq, do që t'i transferojë këto mjete të projektit dhe ta lë Kosovën pa këtë projekt kapital energjetik.

MEM-i para se të kërkojë transferin e këtyre mjeteve duhet të japë llogari, për se nuk e ka bërë projektin për të cilin ka kërkuar mjete në fillim të vitit 2007, a nuk ka ekspertë, a nuk ka mundësi, apo për çka është fjala, duhet ta dimë ne.

Naiviteti ministror qëndron në faktin se i ka mjaftuar Ministrisë që Banka Gjermane për Zhvillim ka interesim dhe indikacione të financojë këtë projekt. Pyetja shtrohet, zoti ministër dhe ju qeveritarë të tjerë të nderuar, po çka nëse nuk keni ditur t'i lexoni mirë interesimet dhe indikacionet e Bankës Gjermane, siç nuk keni ditur shpesh t'i lexoni. Apo, çka nëse ky farë interesimi i Bankës Gjermane bie dhe projekti mbetet pa u filluar fare. Ky hap nuk guxon të merret vetëm për shkak se banka paska treguar interesim dhe indikacione, por ky hap i transferit të mjeteve mund të merret vetëm atëherë, dhe vetëm atëherë, kur ka garancinë se do ta financojë projektin apo kur nënshkruhet ndonjë marrëveshje e tillë.

Grupi Parlamentar i PDK-së nuk e miraton një transfer të tillë parash prej 1 milion eurosh edhe për faktin se linja interkonektuese 400 KW Kosovë – Shqipëri ka përparësi prej të gjitha projekteve të tjera, sepse është edhe problem politik për faktin se Serbia po saboton, po shantazon dhe po bllokon eksportin – importin e rrymës elektrike.

Energjia elektrike nuk po kontraktohet direkt nga prodhuesi, por përmes palës së tretë, pikërisht për shkak se Serbia nuk lejon sa herë të dojë, që rryma të transferohet përmes rrjetave të saj elektrike interkonektuese dhe kushtëzon edhe partnerin, edhe çmimin.

AKM-ja nuk duhet vetëm të kërkojë para, siç po kërkon tani për KOSTT-in, por duhet t'i kryejë edhe detyrat të cilat i takojnë pikërisht sa i përket obligimit të saj ndaj KOSTT-it, sepse fajtorë janë fuqitë e rezervuara që ende ky KOSTT nuk njihet jo vetëm nga Serbia, por nuk njihet nga asnjë mekanizëm ndërkombëtar, edhe pse Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës njihet me të drejtat e barabarta në tregun e përbashkët energjetik për Evropën Juglindore.

Kjo nuk ka kryer asnjë punë në këtë drejtim dhe nuk qanë kokën, por lypë para. Dhe tani, në vend se Qeveria të shpejtojë për të ndërtuar këtë linjë interkonektuese Kosovë – Shqipëri, që është në funksion të KOSTT-it për të cilin po lyp para, në mënyrë që mos të bllokohemi në linjën interkonektuese të Serbisë, Qeveria po bën të kundërtën, po ia merr paratë një projekti prioritar dhe po i hedh në një mekanizëm që nuk e njeh askush, apo thënë edhe më troç, po i japim para mekanizmit për tregti të rrymës, i cili punon pa kurrfarë transparence me mundësi ideale për t'i keqpërdorur paratë, duke tregtuar rrymë prej një pale të tretë, e cila është shumë më e shtrenjtë për konsumatorin, kurse në anën tjetër ato para i merren projektit që shërben për të krijuar linjën e cila shkurton rrugën dhe politikisht është shpëtim për ne dhe kushton më lirë për konsumatorin.

Ky veprim i bartjes së kësaj shume është veprim i gabuar politik dhe tejet i dëmshëm që vonon ndërtimin e linjës Kosovë – Shqipëri dhe favorizon linjën që shkon për Serbi, e cila po na bllokun atëherë kur po gjendemi më së ngushti. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti deputet! Para se të vazhdojmë me qëndrimet e grupeve parlamentare, më lejoni deputetë të nderuar, t'ua sqaroj se juve u është shpërndarë rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Më lejoni t'ua lexoj rekomandimin që ua kemi shpërndarë deputetëve: “Miratohet kërkesa për transferin e mjeteve të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave në shumë prej 1 milion eurosh nga kategoria e investimeve kapitale në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit, për programin e transmissioinit KOSTT në kategorinë e investimeve kapitale.

Arsyetim: Duke u bazuar në nenin 27.3 të Ligjit mbi menaxhimin publik dhe përgjegjësitë e financave publike për transfer 100% të mjeteve nga një organizatë buxhetore në tjetrën është i domosdoshëm lejimi nga Kuvendi dhe PSSP-ja.

Në pajtim me këtë është e nevojshme të bëhet transferi i mjeteve buxhetore siç është paraqitur në rekomandim për t'u bërë implementimi i tij.” Nënshkrimi i kryetarit të Komisionit për Buxhet. Ua lexova këtë tekst sepse erdhëm deri te një qëndrim tjetër, sa munda unë ta kuptoj nga kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Alush Gashi e ka fjalën.

ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së nuk është shumë entuziast sa i përket AKM-së. Ne mendojmë se është koha, ndoshta edhe është vonuar shumë që të gjitha ato kompetenca duhet bartur në Qeverinë e Kosovës. Ne me shumë kujdes kemi analizuar rekomandimin, është rekomandim i Qeverisë sonë, por në këtë rekomandim kur ka të bëjë me AKM-në ne kërkojmë sqarime. Andaj, lusim përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin respektiv që të shpjegojë se si do të harxhohet ky 1 milion dhe a do të menaxhohet ky 1 milion nga ana e Qeverisë.

Na është thënë që mund të përdoret në KOSTT, na është thënë që do të investohet në një trafo shumë të rëndësishme për një pjesë të rëndësishme të vendit tonë, andaj ne jemi të gatshëm ta mbështesim nëse Qeveria jonë e arsyeton këtë. Sa u përket vetëm kërkesave të AKM-së, ne kemi rezerva. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Në emër të AAK-së Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues,

Unë mendoj që kolegu im Gashi tashmë i përmendi. Është mirë që Qeveria dhe ministri Çeku ta arsyetojnë, por mbasi është edhe Ministri i Financave këtu, mendoj që edhe zoti Shatri duhet të japë një përgjigje dhe një arsyetim në lidhur me mjetet, ashtu që mos të kenë deputetët ndonjë dyshim lidhur me këtë dhe ta kenë të qartë transferin e 1 milion eurove. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Në emër të ORA-s, deputeti Nazim Jashari.

NAZIM JASHARI: Ju bashkëngjitem parafolësve të mi, të cilët shprehën kundërshtim lidhur me zhvendosjen e mjeteve nga një linjë buxhetore në linjën tjetër buxhetore, për më tepër që KOSTT-i si shoqëri aksionare e regjistruar në Kosovë, nuk është ndërmarrje publike. Pra, ajo është e regjistruar si shoqëri aksionare dhe nuk e di pse duhet që paraja jonë publike e vjelur nga taksapaguesit kosovarë, të drejtohet drejt një ndërmarrjeje që nuk është ndërmarrje publike, por shoqëri aksionare. Në qoftë se është shoqëri aksionare, le ti mbledhë paratë aksionarët e vet.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Në emër të LDD-së, besoj, deputetja Besa Gaxheri.

BESA GAXHERI: Ju faleminderit, zoti kryesues,

Para se të jap mendimin për Grupin parlamentar të LDD-së edhe një herë reagoj në rekomandimin që u lëshua nga Komisioni i Buxhetit pasi që jam edhe anëtare e këtij Komisioni. Nuk është e vërtetë që Komisioni i Buxhetit ka marrë një vendim që të miratohet kërkesa. Ne të gjithë anëtarët e komisionit e kemi shqyrtuar shumë mirë kërkesën dhe me arsyet të cilat i ka paraqitur Ministria e Energjetikës nuk e ka parë të arsyeshme, për të mos i përsëritur fjalët e kolegeve, për ta miratuar këtë transfer të mjeteve.

Andaj, edhe në emër të Grupit të LDD-së konsiderojmë që nuk duhet të bëhet ky transfero. Unë vetëm po e citoj këtë: “Ministria e Ekonomisë dhe e Financave na ka dhënë një arsye, po them gojore, sepse nuk ka pasur asnjë dokument që Banka Gjermane për Zhvillim kushtimisht e mbështetë projektin të cilin mendojnë këta që e kemi parashikuar në Buxhetin e vitit 2007. Andaj, në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk mbështetet transferi i këtyre mjeteve.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Në emër të Grupit për Integrim, Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: U potpunosti se kao grupa slažemo sa prethodnim izvestiocima i dobro znamo da je KOSTT privatna agencija i nemamo potrebe mi kao Vlada da finansiramo sredstva da bi neko gradio trafostanicu i dalekovod od sredstva Vlade koja su namenjena za drugi budžet. Hvala!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Ministri Ethem Çeku e ka kërkuar fjalën.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues,
Kolegë deputetë të nderuar,

Mua më vjen mirë që sot po e diskutojmë linjën 400 KW dhe duke e ditur se cila është rëndësia e kësaj linje, unë besoj që sot ju duhet të falënderoni Qeverinë, Ministrinë dhe KOSTT-in që nuk është kompani aksionare, që nuk është kompani publike, po është kompani e themeluar nga Qeveria jonë dhe e aprovuar këtu, sepse ka arritur t'i tërheqë dhe si donacione janë premtuar 14 milion euro nga Banka Botërore, nga Qeveria gjermane, nga projekti i studiuar nga Banka Botërore dhe i mbështetur nga Qeveria gjermane. Projekti kushton 14 e diçka milion euro dhe ato para janë të ndara nga Qeveria gjermane për ndërtimin e linjës 400 KW. Ne si qeveri e kemi shtyrë përpara këtë projekt, sepse është me interes të fushës së energjisë elektrike. Nuk flas për interesat nacionale në këtë rast, po flas për interesat e harmonizimit të dy sektorëve mes hidros dhe termos dhe, si të tillë, ne e kemi kërkuar nga Qeveria të na alokojë në fillim mjete financiare në mungesë të donacioneve.

Duke parë se kemi siguruar donacione, janë premtuar 14 milion euro nga Qeveria Gjermane, nga Banka Gjermane për Zhvillim, atëherë ne kemi kërkuar që ato mjete të dedikohen për rajonin e Mitrovicës dhe Vushtrrisë ku është fyti i ngushtë, i cili ka të bëjë me rehabilitimin e trafos në atë pjesë. Ju e keni tërë dokumentacionin që është paraparë se çka do të bëhet me ato 14 milion euro në aspektin e linjës dhe 1.5 milion euro për rehabilitimin e një trafoje për rajonin e Mitrovicës, të Vushtrrisë dhe për rajonet e tjera të cilat nevojiten për furnizim me energji elektrike.

Prandaj, unë ju ftoj, kolegë të nderuar deputetë, që ta mbështetni këtë transfero. Nuk ka të bëjë fare me AKM-në. KOSTT-i është kompani që menaxhohet nga ne, i themeluar nga Parlamenti sipas Ligjit të energjisë, do të thotë nuk ka të bëjë fare me një kompani, me atë që u përmend se është private apo një kompani që është aksionare. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur deputeti Ali Sadriu, e ka fjalën, ju lutem. (Ndërhyrje nga salla). Ju lutem, vetëm një moment, ju do të keni fjalën si deputet me kohë prej 10 minutash, edhe Bajrush Xhemaili edhe Nazim Jashari, si deputetë do ta keni fjalën 10 minuta. Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Ju faleminderit, zoti kryesues,
Nderime për ju dhe për të gjithë të pranishmit,

E mora fjalën për të dhënë kontributin tim lidhur me transferet të cilat po ndodhin. Procedura dhe mënyra e trajtimi të këtyre transferove, siç ceku kryetari i komisionit, precizohet me ligj dhe ka arsyen e vet të plotë pse ndodh ashtu.

Transferi kur ndodhë mbi 40%, është përgjegjësi e Kuvendit që duhet ta trajtojë. Por, edhe në Komisionin e Buxhetit unë kam kërkuar dhe një material i tillë nuk ka kaluar, sepse këtu duhen dy arsyetimi, jo një. Dhe po vërejtje jo vetëm në këtë rast, por edhe në rastet e tjera arsyetimet zakonisht jepen atje ku duhet të shkojnë mjetet. Për mua dhe të tjerët që e njohim procesin e formimit të buxhetit, kur dimë se kërkesat buxhetore për trajtim në qarkoren e parë zakonisht janë dy herë apo tri herë më të mëdha se mundësitë që i dirigjojnë kufijtë buxhetor, çka nënkupton se mbesin shumë projekte tepër të vlefshme dhe të rëndësishme të pa përfshira dhe hyjnë vetëm ato që kanë prioritet të lartë. Prandaj, këtu është esenca që duhet një arsyetim i thellë i të gjitha transfereve kur ndodhin si të tilla, si ky, edhe ai i mëparshmi dhe të tjerë, të jepet arsyetimi pse janë kërkuar atëherë me një prioritet aq të lartë dhe pse nuk është realizuar si projekt i tillë. Vetëm atëherë duhet të mendohet për alokimin atje ku janë të nevojshme, por zakonisht po krijohet praktikë e keqe, sepse gjithë herë shkojmë nga ajo se ku na duhen mjetet, e pastaj shohim se ku janë ato mjete. Mjetet edhe mund të mbesin, pra. Për mua është shumë i rëndësishëm arsyetimi pse projekti të cilit i është dhënë prioritet me miratimin e buxhetit, të Ligjit mbi buxhetin që ka kaluar disa rrathë, disa trajtime, ku Ministria e ka mbrojtur me fanatizëm atë projekt, e tani nuk është realizuar. Dhe, tek mandej vjen problemi tjetër, të cilin e sqaroi ministri. Ndoshta ekzistojnë arsye të plota të tij, unë nuk i di shumë, sepse në komision nuk kanë ardhur këto informata që i dëgjova këtu. Por, desha vetëm këtë ta sqaroj se për mua është shumë më i rëndësishëm arsyetimi i parë se arsyetimi i dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Deputeti Nazim Jashari e ka fjalën.

NAZIM JASHARI: Ju faleminderit, zoti kryesues,

Megjithatë është mirë të respektohet Rregullorja e Punës e cila thotë qartë se si jepet replika.

Zoti ministër, unë aktin e themelimit të KOSTT-it nuk e kam pasur në dorë. Unë për ditë i lexoj gazetatat, për ditë i shoh konkurset dhe tenderët që i publikon KOSTT-i dhe aty shkruan qartë, mirë dhe shqip, sh. a.- shoqëri aksionare. Ky është element i parë. Elementi i dytë, nuk e di kush është themeluesi i KOSTT-it, unë nuk e di që e ka ky Kuvend, por nëse e ka themeluar ky Kuvend, ai do të duhej ta kishte një bord, i cili do të

mbikëqyrte punën e atij KOSTT-i. Do të ishte mirë të na jepte informacione më të plota lidhur me bordin e KOST-it, kujt i jep llogari KOSTT-i, sepse realisht KOSTT-i është një ndërmarrje e cila është ndarë nga KEK-u, pra nuk është më pjesë e KEK-ut, dhe nuk e dimë në bazë të cilës rregullativë është ndarë nga KEK-u, mirëpo, po e përsëris edhe një herë, të gjitha aktet e veta që i publikon gazeta i publikon si sh. a.- shoqëri aksionare, e shoqëria aksionare nuk mund të kërkojë para nga Kuvendi i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur Bajrush Xhemaili.

BAJRUSH XHEMAILI: Edhe pse me vonesë, ju faleminderit! Zoti ministër, unë e di nevojën shumë të madhe që ka rrjeti për të investuar, por problemi është se ju keni marrë një kahe krejt tjetër se vetë e keni sjellë deri këtu, sa pothuaj se është shkatërruar rrjeti me politikat tuaja në favor të Termocentralit Kosova C, por ju jeni duke e lënë projektin 400KW Kosovë-Shqipëri, thashë edhe më parë, po e leni veresi. Për këto që i thatë ju, nuk shkruan asgjë në këto materiale, po thoni i keni materialet, e në këto materiale që mi keni sjellë s'ka asgjë. Ka vetëm indikacione dhe interesim nga Banka Gjermane për Zhvillim që ka mundësi ndonjëherë të arrihet ndonjë marrëveshje. Kështu është kjo aty. Në qoftë se ju vërtet i keni të alokuara dhe e keni nënshkruar një kontratë për 14 milion, për hair ju qoftë, por ju në vend që sot të raportoni që e keni kryer këtë projekt, domethënë që keni kërkuar 1 milion për këtë linjë Kosovë-Shqipëri, ju sot po dilni me diçka që nuk është në material fare dhe po na qitni në një terren krejt tjetër. Se çfarë shoqërie është KOSTT-i, unë tashmë 6 vjet po merrem me energjetikë dhe besoj se e di, nuk ka nevojë askush askujt t'i thotë, se ato janë të shkruara në dokumente. Por këtu nuk mund të pranohet diçka blanko, pa pasur asnjë dokument. S'ka kontratë që kanë thënë, dhe ne po i qojmë mjetet diku tjetër. Ne po e favorizojmë, edhe njëherë po them, një projekt që, fundi i fundit, unë nuk e mohoj rëndësinë që ka kjo çka doni të bëni ju me këtë 1 milion, por linja Kosovë – Shqipëri është jetike për energjinë në Kosovë për shkak se Serbia po na bllokun kur po do. Ja, kjo është kjo. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUSH: Hvala, pozdravljam sve prisutne. Hoću da dam do znanja da je Agencija KOST je, kao što smo rekli, akcionarsko društvo, ima donacije i zainteresovana je i Nemačka sa 14 miliona, kako smo čuli od gospodina ministra. G-din ministar zna za ovu trafostanicu i za dalekovod u Vučitrnu ako imaju prioritet za izgradnju, da postoji javno preduzeće KEK koje je nažalost i ono, da li zna ministar da je to javno preduzeće Vlade, a da je u potpunosti privatizovano od strane menadžera koji trenutno rade u KEK-u punih 8 godina, i da li ćemo mi ta javna preduzeća da vratimo u nadležnost Vladi, ili ćemo da proizvodimo od KEK-a još mala javna preduzeća. Znamo da je KEK proizvođač, da prenosi energiju i da je distributer. Ako imamo KEK, zašto ne bi dali da takav dalekovod uradi KEK sa svojim stručnjacima, trafostanicu koja je prioritetna, a kako vidim iz izlaganja ostalih poslanika, ova linija sa Albanijom imala je prioritet i dobila je od ove Skupštine saglasnost i novac koji je stajao i nije iskorišćen. Znači, u potpunosti ponovo dajem do znanja ministru da kažem, da tvrdim da su to privatna preduzeća za sada, a kada će Vlada da vrati nadležnost nad ovim preduzećima, mi smo tu da brinemo o tim preduzećima i da stvarno budu u nadležnosti Vlade. Hvala!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Ministri Ethem Çeku e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Do të mundohem të jap edhe sqarime shtesë që të kuptohemi shumë drejt. Do të thotë, Qeveria për këtë vit për linjën 400 KW ka ndarë vetëm 1 milion euro. Vetëm 1 milion euro ka ndarë për këtë vit për të ndërtuar 400 KW në mes Kosovës dhe Shqipërisë. Neve nuk na kanë mundur financiarisht që të hymë në këtë projekt me 1 milion euro, prandaj kemi bërë përpjekje së bashku me KOSTT-in që menaxhon nivelin e rrjetit dhe e dimë se cilin nivel e menaxhon KOSTT-i dhe ka arritur që të marrë mbështetje dhe na ka argumentuar me letërën që e ka dërguar se ka arritur të marrë mbështetje për të financuar nga Banka Gjermane linjën 400 KW. Pastaj, gjatë diskutimeve, ata kanë shtruar kërkesën në ministri që ato mjete tona, pasi janë siguruar, të them kushtimisht, të hyrat nga Qeveria gjermane në shumën prej 14 milion eurosh donacion, 1 milion euro tonat t'i alokojmë për nevojat e komunës së Mitrovicës dhe Vushtrisë dhe është përshkruar projekti detal për atë pjesë se çka duhet të bëhet me ato 1.5 milion sa kushton projekti. Do të thotë, ne e kemi mbështetur kërkesën, e kemi dërguar në Qeveri, Qeveria e ka aprovuar dhe pastaj ka ardhur tek ju, kolegë të nderuar deputetë. Do të thotë, Buxheti i Qeverisë për këtë problem ka qenë vetëm 1 milion. Krejt projekti ka qenë 14 milion e diçka. Kemi arritur të marrim donacione, të na mbështesin në dhënien e donacioneve dhe ne pastaj kemi thënë, mos i shpenzoni këto para për studime dhe analiza, por vendosni në investime drejtpërdrejt tek qytetarët. Është e juaja ta aprovi, apo mos ta aprovi.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Bajrush Xhemali e ka fjalën, replikë.

BAJRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, Krejt problemi është se ku është ai dokument. Nëse është ai dokument që banka i ka alokuar, na e ka ndarë atë donacion, krejt ok. Unë po pajtohem. Por nuk është kështu, peshku në det e fëlterja në zjarr, nuk shkon kjo kështu. Kjo është krejt çka jam duke thënë unë.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Të bisedohet këtu para ekspertëve të KEK-ut, që janë të shumtë këtu që punojnë në KEK, të cilët herë tregojnë, herë nuk tregojnë që punojnë atje, është ky problem i tyre, dhe të na dorëzojnë informacione të seleksionuara, nuk është mirë. Unë e di që këtu ka njerëz që i njohin mirë këto probleme, por shpeshherë kur flasin, duke i plotësuar interesat personale, i seleksionojnë informatat.

Ne sot e kemi një temë të veçantë rreth këtij një milioni, i cili kërkon lejen e Kuvendit që të bartet nga një projekt te tjetri. Kjo në shikim të parë është e thjeshtë dhe unë besoj që, normalisht, e kupton secili çka do të thotë kjo. Mirëpo, argumentimet që i ka dhënë Qeveria, unë si laik në këtë lëmi, por si i përkushtuar në procedurat demokratike të vendosjes, e kam lexuar gërmë për gërmë dhe në kuptimin e argumentimit unë nuk kam çka i shtoj asaj që thotë Bajrush Xhemajli.

Është e vërtetë që në dokument thuhet: - kemi indikacione. Nuk thuhet askund në dokumentet që zotërinjtë e Qeverisë dhe të Ministrisë na i kanë ofruar se ekzistojnë garancat me shkrim a me gojë të Qeverisë Gjermane që po i dhënka, këtu tash po thuhet 14 milion, që ne na gëzon shumë, por dokumentet që ne i kemi në dorë nuk e thonë këtë, pos se thonë –indikacion. Indikacion në kontrata me para qesharake, të përdoret termi, se ai edhe në letërsi kur përdoret, është problem të interpretohet sa kuptime i merr. Pra, ne, asnjëri prej nesh nuk kundërshtojmë që paratë e Buxhetit të Kosovës që janë të orientuara për financime kapitale të shkojnë poshtë, të shtyhen. Larg asaj!

Ne edhe në grupin tonë e kemi shqyrtuar gjerë e gjatë këtë problematikë dhe jemi kushtëzuar me këta tipa të argumentimeve që ne nuk na janë dukur shumë promovuese dhe shumë argumentuese. Këta i kanë ndarë një milion para për të bërë linjën për Shqipëri. Vetë po thonë që i kemi ndarë në mënyrë me pak a shumë iniciativë, se me një milion nuk ndërtohet linja. A është kështu, zoti ministër? Unë besoj se është kështu. Domethënë, jeni përpjekur të bëni diçka për një temë të madhe në mënyrë që të ngjallni interesimin e donatorëve për te.

Unë ju përgëzoj nëse ju i keni njellë ata dhe i keni fituar 14 milion të krijohet linja. Unë ju përgëzoj nëse është kështu, por dokumenti që ju na i ofroni thotë se vetëm na është dhënë një fjalë, e kemi një indicje, ekziston një dëshirë në ajër që është faktikisht një kërkesë virtuale. Pra, shkurt i bjen dhe unë bëj pyetje tash: Çka na duhet AKM-ja nëse kjo farë ndërmarrjeje qenka publike e ndërtuar nga Qeveria, ç'na duhet të hyjë ndërmjet AKM-ja që ne t'ia qesim paratë AKM-së që t'i marrë ajo, apo është ndërmarrje publike të cilën e sundon direkt ose indirekt AKM-ja, siç e sundon KEK-un?! Unë dua këtu sqarim, ç'don AKM-ja të marrë para nga buxheti nëse firma qenka e Qeverisë, pse përmendet AKM-ja? Pra, unë i kam një mori pikëpyetjesh që për mua, megjithatë, nuk janë të sqaruara, ndonëse e kam lexuar tekstin e Qeverisë germë për germë dhe jam përpjekur ta shpjegoj. Besa, edhe i kam pyetur do njerëz që i dinë ngapak këto punë. Nëse është puna kështu, dhe nëse nuk kemi dokumente shtesë, unë propozoj që kjo temë të shtyhet për mbledhjen tjetër, të argumentohet me krejt fuqinë që e ka Ministria dhe Qeveria dhe ne atëherë nuk kemi kurrfarë arsye të mos e japim pëlqimin, ta qojmë dorën që buxheti të realizohet brenda vitit dhe të realizohet për kërkesa të qytetarëve, qoftë të Vushtrisë, qoftë të Prizrenit, qoftë të Prishtinës, apo të cilitdo rajon. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ministri Et'hem Çeku e ka fjalën.

ET'HEM ÇEKU: Ju i dini raportet në mes të kompanive publike dhe AKM-së. Të gjitha kompanitë publike i përgjigjen AKM-së dhe nuk është ndoshta përgjegjësi e imja pse i përgjigjen. Unë kam kontaktuar personalisht me bankën dhe janë shprehur të gatshëm për të investuar, mirëpo pasi kërkohet dokumentacioni, unë propozoj po ashtu që deri ta sigurojmë tërë dokumentacionin nga Banka Gjermane për Zhvillim, ta shtyjmë edhe për një kohë. Ne vetëm kemi dashur që mjetet të cilat i kemi në dispozicion t'ia ofrojmë KOSTT-it, t'i menaxhojë ato sepse jemi në prag të dimrit dhe na nevojitet kjo. Sa u përket përgjegjësisë për rrjet, unë duhet t'ju them që është punë e madhe kjo që jemi duke bërë dhe nuk bëjë politikë me energji, siç bëjnë disa nga kolegët tanë këtu.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Deputeti Alush Gashi e ka fjalën.

ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Shihet se nevojia për sqarim që e ka kërkuar Grupi jonë, u konfirmua edhe në këtë debat. Ne me të vërtetë jemi shumë të interesuar që ky sektor të jetë i suksesshëm, por jemi të përcaktuar që të mos marrim vendime pa qenë të bindur plotësisht. Ne kemi argumente t'i besojmë në fjalë Qeverisë, por ne jemi të përcaktuar që të besojmë me dokumente. Andaj, zoti kryesues, Grupi Parlamentar i LDK-së lutë që kjo çështje të vazhdojë në seancën e ardhshme, atë ditë kur do të argumentohen këto të dhëna gojore nga ana e Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit zoti Kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, konsideron se në Seancën kur do të sigurohen dokumentet të cilat ministri Çeku tha se do t'ia sjellë Kuvendit, në atë kohë të merret edhe vendimi për transferin. Prandaj, edhe ne propozojmë që kjo të shtyhet për kohën kur sigurohen dokumentet përkatëse. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Kërkohej një votë për shtyrjen e kësaj pike për seancën e ardhshme.

Kush është “për”?

Ju faleminderit. A ka “kundër”? Jo.

A ka abstenime – një abstenim.

Ju faleminderit!

Në sallë janë 80 deputetë.

Shtyhet pika e rendit të ditës për seancën e ardhshme dhe obligohet Ministria që ta sigurojë dokumentacionin e kërkuar këtu nga grupet parlamentare dhe deputetët që morën pjesë secili veç e veç në debat.

Është kërkesa për një pauzë. Për sa kohë? 15 minuta pauzë për kafe. Në orën 12,00 takohemi këtu prapë në vazhdim të seancës.

Vazhdimi i seancës pas pauzës, në orën 12:00, nën drejtimin e Kryetarit Kolë Berisha

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e 16-të të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin fiskal për 6 mujorin e parë të vitit 2007

Ministria për Ekonomi dhe Financa, në pajtim me nenin 40 të Ligjit për menaxhimin e financave publike, ka përgatitur Raportin fiskal për 6 mujorin e parë të vitit 2007. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me këtë e ka shqyrtuar dhe e ka përkrahur në parim, si dhe ka rekomanduar që të radhitet për shqyrtim në seancën plenare. Raporti u është shpërndarë deputetëve dhe mund ta hapim diskutimin.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, i nderuari Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Raporti fiskal i Qeverisë për 6 mujorin e parë të këtij viti, për dallim nga disa raporte i është përcjellë Kuvendit me kohë në afatin e paraparë ligjor. Edhe kjo ka mundësuar që në Komisionin për Buxhet dhe Financa të ketë kohë të mjaftueshme për analizimin dhe shqyrtimin e tij, për të cilin i ka paraqitur Kuvendit Rekomandimin, që të shqyrtohet në seancën e Kuvendit.

Pa u lëshuar në analizat detale të raportimit, më duhet edhe njëherë të përsërisë vërejtjen time si deputet dhe si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, drejtuar Zyrës së Auditorit Gjeneral që nuk i përcjellë Kuvendit me kohë të gjitha auditimet e bëra, siç është paraparë me Rregulloren në fuqi të kësaj zyre.

Ne jemi shumë të kufizuar gjatë shqyrtimit të raporteve fiskale që vijnë nga Qeveria, sepse duhet çdoherë të bazohemi dhe t'u besojmë shifrave dhe treguesve të paraqitur në këto raporte pasi që nuk kemi përpara edhe raportet e auditimit të cilat do të na ndihmonin shumë që të bëjmë një analizë dhe vlerësim real e të saktë për raportet e shqyrtuara.

Në këtë drejtim, jam i sigurt se nxjerrja e Ligjit për auditimin e jashtëm do të ndikonte më mirë gjatë analizave të raporteve të Qeverisë dhe rekomandimeve që do të nxirrte Kuvendi i Kosovës në këtë rast. Sa i përket Raportit, është një teknikë më e përparuar e raportimit në krahasim me vitet e kaluara, është më i specifikuar dhe më i detajizuar për organizatat buxhetore. Mirëpo, edhe pse përdoret metoda e krahasimit, mungojnë disa tregues që paraqesin progresin ndaj planit aktual, po ashtu mungojnë analizat dhe komentet, ndërsa disa shpenzime duhet të paraqiten si pozicione në mënyrë të veçantë, siç janë shpenzimet lidhur me statusin e Kosovës.

Është inkurajues trendi i ngritjes së të hyrave gjatë kësaj periudhe që arrin në 65.4% të planit vjetor, që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar është realizimi i të hyrave për 30.9% mbi planin, ndërsa në krahasim me vitin e kaluar është një rritje prej 35.7%. Struktura e të hyrave mbetet vazhdimisht e njëjtë, që do të thotë se pjesa më e madhe e buxhetit mbledhet në kufi. Duke marrë parasysh se Komisioni për Buxhet dhe Financa është në prag të finalizimit të Projektligjit për tatimin e vlerës së shturë, konsiderojmë se kjo strukturë do të mbetet edhe për disa vite e njëjtë. Shpenzimet kanë një ngritje të vogël në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe kryesisht kanë të bëjnë me ngritjen e pagave, me ngritjen e shërbimeve komunale si dhe me subvencione dhe transfere. Mirëpo, marrë në tërësi, shpenzimet për këtë periudhë janë realizuar për 37% të ndarjeve të tërësishme vjetore, ose 74.1% sipas planit, marrë në tërësi. Kjo përqindje e shpenzimeve në këtë nivel, është ndikuar nga realizimi i ulët i shpenzimeve kapitale që për ne është një brengosje mjaft e madhe dhe për t'u mbyllur plani deri në fund të vitit, për këtë kategori nevojitet një angazhim dhe efikasitet më i madh i Qeverisë, si dhe i komunave.

Do të ishte e dobishme të kemi të bashkangjitur në Raportin edhe një pasqyrë për projektet që janë miratuar në Buxhetin e Kosovës për këtë vit dhe të tregohen se në cilën shkallë janë realizuar, që t'i kemi të qarta fazat e fazat e realizimit të tyre, të këtyre projekteve si dhe në Raportin e fundit të kemi të qartë tepricën e mjeteve nga kjo kategori.

Me vërejtjen që raportet e ardhshme të përcillen të plotësuara edhe me analiza dhe komente, që do ta plotësonte një pasqyrë reale për rrjedhën e parasë publike, i rekomandoj Kuvendit, që për shpenzimet e periudhës përfundimtare të këtij viti, të jetë më llogarimarrës ndaj Qeverisë dhe të ndikojë që sa më parë të nxirret Ligji mbi auditimin e jashtëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ftoj Ministrin Shatri ta marrë fjalën.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Siç u tha edhe nga parafolësit, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, në pajtim me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, paraqet para Qeverisë dhe Kuvendit Raportin periodik të 6 mujorit dhe kësaj radhe e kemi paraqitur me kohë, por më duhet të them me keqardhje që shqyrtimi i këtij Raporti sot duket pak i

vonuar, sepse shifrat që kanë të bëjnë me 6 mujorin, tashmë gati tre muaj pas kanë ndryshuar në tërësi sa u përket çështjeve kyçe, siç janë investimet kapitale dhe kategoritë etjera edhe të të hyrave, edhe të shpenzimeve. Megjithatë, është obligim ligjor dhe na jemi të gatshëm që, përveç asaj që është raportuar në dokumentin zyrtar, të ofrojmë edhe të dhëna të tjera plotësuese sipas interesit të deputetëve ose interesimit të veçantë të komisioneve, të grupeve apo edhe të deputetëve veç e veç.

Konkretisht, edhe lidhur me investimet kapitale, Ministria e Financave disponon çdo ditë të dhënat më të reja lidhur me procedurën e shpenzimit të mjeteve publike në shpenzimet kapitale sipas projekteve në veçanti. Në qoftë se ky Kuvend ose dikush nga deputetët, grupet parlamentare, komisionet e dëshirojnë këtë, ne mund t'ia bëjmë brenda ditës të sodit ose për një datë kur ju do ta kërkonti dhe do t'i keni në vazhdimësi edhe të dhënat shtesë. Unë e kam me veti një dokument të tillë që flet deri në fund të gushtit për shpenzimet kapitale sipas projekteve veç e veç, por nuk do të thosha që në kuadër të Raportit 6 mujor të nxjerrë një dokument tjetër që flet për tetë muaj, kështu që nuk do të jenë të dhënat e krahasueshme, vetëm sa për informim.

Ajo që dëshiroj sot të them, është që të hyrat që kryetari i Komisionit për Buxhet i kuantifikoi edhe me përqindje edhe shumat që i keni në dokument janë si rezultat i shtrirjes së aktivitetit të Shërbimit Doganor, në veçanti i kontrollit, i mundësimit që të bëhet kontrolli më rigoroz i të hyrave, i hyrjes së mallrave në veri të vendit. Pra, rezultatet e arritura mbi parashikimet e buxhetit nga Shërbimi doganor i dedikohen shtrirjes dhe kontrollit më detal dhe ma të rreptë në hyrje të mallrave në kufi, në veri. Po ashtu, pjesa e të hyrave që është realizuar nga Administrata tatimore, është rezultat i shtrirjes së veprimit të Administratës tatimore në horizontale, pra nuk ka ndryshim të politikave fiskale, nuk ka ngritje të tarifave dhe të taksave, por ka një aktivitet që është shtrirë në vi horizontale duke i përfshirë edhe ato ndërmarrje obliguese tatimor të cilat në forma të ndryshme, në periudhat e deritashme iu kanë shmangur obligimit ndaj buxhetit. Në veçanti, në këto të hyra për këtë vit ka rëndësi edhe licenca e Operatorit të Dytë të Telefonisë Mobile, e cila pra me 75 milion euro e ka një vend të rëndësishëm në të hyrat buxhetore të këtij viti.

Shpenzimet si kategori e veçantë e këtij Raporti, duhet të them që nuk kanë ndonjë shmangie nga kategoritë e veçanta, në veçanti te pagat dhe mëditjet janë afër dinamikës së paraparë, po ashtu mallrat dhe shërbimet janë pak nën dinamikën kur pjesëtohet gjysma e vitit me gjysmën e mjeteve të destinuara për këtë qëllim, dhe shërbimet komunale janë te 50% ose janë në përputhje me dinamikën e paraparë. Them që brengë e veçantë për periudhën e 6 mujorit të parë kanë qenë shpenzimet kapitale, të cilat janë realizuar diku rreth 20% e shumës së paraparë për vitin 2007, dhe kjo për këtë periudhë ka qenë e vetmja brengë që Qeverinë e ka obliguar të shqyrtojë dinamikën e ulët të shpenzimeve dhe të propozojë masa për organizatat buxhetore, në mënyrë që të përshpejtohet dinamika e shpenzimit të parave publike dhe të zihet hapi brenda afatit të caktuar.

Sa për informim tuajin dhe për kureshtjen e juaj do të them që të dhënat për 8 muaj janë edhe më inkurajuese dhe rezultatet janë shumë më të avancuara, qoftë te kategoria e të hyrave buxhetore, qoftë te shpenzimet buxhetore. Fjalën e kam këtu për periudhën 8 mujore ku janë realizuar 66% e të hyrave buxhetore vjetore për 8 muaj. Pra, shpresojmë se deri në fund të vitit, në qoftë se vazhdon kjo dinamikë, në qoftë se nuk ndodhë diçka e jashtëzakonshme, Qeveria e Kosovës në buxhetin e vet bashkë me të hyrat nga Operatori i Dytë do të ketë diku rreth 200 milionë euro para të cilat do të

mund të parashihen në shpenzimet e buxhetit për vitin 2008, si të hyra të veçanta dhe do të sistemohen në shpenzime në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Diçka e ngjashme është bërë në përgatitjen e deritashme për buxhetin 2008, qoftë në dokumentin e kornizës së shpenzimeve, qoftë në versionet e para të buxhetit për vitin 2008. Po ashtu, shpenzimet në të gjitha kategoritë janë në përputhje me kohën dhe më duhet të them që, kur përfshihen 8 muaj, pra edhe dy muaj shtesë që i kemi ndërmjet 6 mujorit dhe ditës së sotme, rezultati është shumë më i kënaqshëm dhe sillet diku rreth 30% të shpenzimeve kapitale. Duhet të them që procedurat janë pak sa të ngatërruara dhe informatat për realizimin në realitet dhe ajo që vjen si moment i pagesës, gjithmonë vonojnë, sepse realizuesit e projekteve kapitale njëherë duhet ta realizojnë punën në terren, pastaj të paraqesin faturat për pagesë, kështu që gjithmonë pagesa bëhet pasi që të kryhet puna. Pra, në realitet punët shkojnë më shpejt se sa që paraqiten në raporte.

Me këto vërejtje, në qoftë se ka kërkesa dhe nevojë për sqarime të mëtejshme, unë jam këtu dhe besoj që do t'u sigurojmë të dhëna edhe sot, edhe në ditët e ardhshme, kurdo që dikush nga Kuvendi është i interesuar. Ne i dërgojmë edhe raporte periodike mujore Kuvendit, por ato ju nuk e keni parë të nevojshme që t'i shqyrtoni në seanca, edhe raporte 3 mujore edhe Raportin final, prandaj ju rekomandoj që të diskutoni dhe të vlerësoni punën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financa, qoftë në çështjen e të hyrave, të realizimit të të hyrave buxhetore, qoftë në procesin e shpenzimeve. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ftoj shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së, zotin Alush Gashi

ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke iu falënderuar kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe ekspertëve të Grupit tonë, e ka shqyrtuar me shumë kujdes Raportin dhe ne e pranojmë si të tillë. Me këtë rast, përgëzojmë ministrin Shatri që në kuadër të afateve ligjore ka sjellë një Raport shumë të detajuar dhe ofron një optimizëm për ngritje dhe fuqizim të këtij raporti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe ky Raport si edhe raportet e tjera periodike – vjetore dëshmojnë se kjo Qeveri ishte e paaftë të planifikojë dhe të menaxhojë me efektivitet buxhetin dhe në përgjithësi fondet publike. Derisa 15% e popullatës jeton në varfëri ekstreme me 0.93 euro në ditë, afër 40% e popullatës në varfëri relative me 1.44 euro në ditë, kur ka nevojë që kudo që të investohet nëpër Kosovë, në çdo fund viti në çdo fund 3 mujori, në çdo fund 6 mujori Qeverisë i teprojnë mjetet.

Qeveria nuk ka orientime se ku t'i investojë mjetet, sepse nuk ka strategji, nuk ka objektiva, nuk ka plane të qarta për arritjen e qëllimeve dhe duke mos e ditur qëllimet e veta, nuk di se ku t'i reallokojë mjetet e kursyera dhe të hyrat që janë krijuar nga burimet tjera, siç është rasti me licencën e telefonisë mobile apo të hyrat nga ndonjë burim tjetër.

Në faqen 4 të Raportit vërehet se janë 170.19 milion euro suficit, për 6 muaj, deri në muajin qershor. Qeveria nuk është transparente se si do të jetë rrjedha e këtij suficiti buxhetor, kështu që apeloj që shfrytëzimi i këtyre mjeteve të jetë transparent të paktën para Kuvendit dhe këto mjete të mos përdoren për fushatë elektorale të partive në pushtet.

Nga të dhënat e këtij Raporti po vërtetohet fakti se është bërë një vlerësim jo real i burimit të të hyrave dhe tani na del se gjoja paskemi rritje të të hyrave. Kjo është një demagogji që e karakterizon këtë Qeveri, e cila nuk e ka realizuar atë që e ka premtuar. Përkundrazi, ka thelluar krizën në ekonomi, ka rritur shkallën e varfërisë, ka thelluar krizën energjetike që tashmë është bërë realitet i hidhur që po e paralizon funksionimin normal të jetës së qytetarëve e të mos të flasim për biznesin dhe për rrjedhën e zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

Nga Raporti vërehet se edhe në këtë 6 muaj 235.9 milion euro apo 52.8% e të hyrave realizohen në kufi, kurse vetëm 80.47 milion euro apo 18% nga të hyrat e përgjithshme janë realizuar nga Administrata Tatimore, që krahasuar me 6 muajin e vitit 2006, janë 10% më të ulëta. 16.4 milion apo 20% e të hyrave janë të paspecifikuara me një arsytim tepër naiv dhe jo real. Kjo vërteton faktin se Qeveria nuk ka përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e Administratës Tatimore, dhe ka qenë e paaftë për të rishqyrtuar politikat tatimore, që do të ndikonin për të ndryshuar këtë Raport në favor të të hyrave të brendshme dhe, çka është më e keqja, i kanë munguar objektivat e qarta në fushën fiskale dhe financiare.

Qeveria ka lejuar që në Administratën Tatimore të qarkullojnë militantët politikë të koalicionit qeverisës që nuk kanë asnjë lidhje me profesionalizmin në këtë fushë. Në krye të Administratës Tatimore vihet shoku apo miku i mirë i ministrit, të cilit ia caktojnë pagën dhe benificionet tjera sipas dëshirës pa kurrfarë baze ligjore. Zëvendës drejtorë dhe drejtorë e zyrave qendrore dhe regjionale, vihen militantët partiak sipas urdhrave të partisë në pushtet, që është dashur të shpërblehen, sepse në mënyrë të ndershme apo të pandershme ju kanë sjellë vota. Në Administratën Tatimore inspektorët tatimorë pranohen me shkollë të mesme, shikoni Raportin e Auditorit të Përgjithshëm faqe 15, sepse kriter për punësim kanë qenë të punësohen miqtë, shokët, farefisi me vlerat e dyshimta profesionale. Prandaj, në Administratën Tatimore ka vlerësime paushalle, ka parregullsi në metodologjinë dhe në vlerësimet e kontrollit, të cilat dëmtojnë rëndë biznesin në përgjithësi dhe favorizojnë individët e caktuar në veçanti.

Asnjëherë Qeveria nuk e ka respektuar Ligjin e Administratës Tatimore, sidomos nenin 8, sipas të cilit Administrata Tatimore e Kosovës duhet t'i raportojë Kuvendit. Asnjëherë nuk është bërë e ditur në asnjë raport se sa është shuma e detyrimeve tatimore të paarkëtuara, që është një pasuri që duhet të raportohet. Nga Raporti i Auditorit e dimë se në fund të vitit 2006, shuma e detyrimeve tatimore të paarkëtuara është 197 milion euro, kurse nga kjo shumë 65 milion euro janë shtuar vetëm në vitin 2006. Po as nga ky Raport që po e shqyrtojmë, nuk dimë sa është rritur kjo shumë brenda këtyre gjashtë muajve, sepse është shqetësuese që detyrimet të jenë shumë më të mëdha sesa të hyrat të cilat i realizon Administrata Tatimore.

Të nderuar deputetë,

Këtij Raporti i mungojnë miliona euro nga paaftësia e Qeverisë për të luftuar evazionin fiskal dhe ekonominë informale. I mungojnë miliona euro nga mosdoganimi i cigareve

të kontrabanduara, kafesë, pijeve alkoolike, të karburanteve dhe të mallrave tjera të forta. I mungojnë miliona euro nga kontrabanda me mallra që barten në mënyrë të lehtë, siç janë: ari, telefonat, syzat etj. Qeveria nuk ka bërë dhe nuk po bën asgjë për ta ndërprerë tregtinë ilegale si pasojë e mungesës së kontrollit në pikat kufitare.

Të nderuar deputetë,

Buxheti krijohet për t'u shfrytëzuar, por me efikasitet dhe efektivitet. Nuk mund të konsiderohet ndonjë e arritur mosshfrytëzimi i buxhetit si pasojë e planifikimit të keq të mjeteve dhe mosorientimit të mjeteve aty ku duhet. Qeverinë e koalicionit që në fillim e ka karakterizuar paaftësia për ta realizuar investime të shumë kërkuara në infrastrukturë, në arsim, në kulturë, në bujqësi e sidomos në shëndetësi.

Në seancën e datës 30.11.2006, gjatë shqyrtimit të parë të Projektbuxhetit, Ministri i Financave foli gjatë për investimet, dha shifra fiktive për rritjen e buxhetit për investime kapitale, duke mos llogaritur mjetet që barteshin nga viti 2006, si pasojë e paaftësisë për të menaxhuar me to, sigurisht duke menduar se qytetarët verbërisht do të besonin në ato që thuheshin. Janë planifikuar 198.8 milion euro për shpenzimet kapitale. Nga Raporti shohim se janë rritur këto mjete në 213.6 milion euro, kurse janë shpenzuar vetëm 38.36 milion euro apo 17% e këtyre mjeteve. Edhe vetë Qeveria e di se nuk mund t'i realizojë edhe më tepër se 80% të investimeve kapitale për 6 muajt e tjerë të vitit.

14 organizata buxhetore i kanë realizuar 0% mjete për investime kapitale, 12 të tjera i kanë realizuar nën 5% mjetet për investime kapitale. Derisa infrastruktura rrugore është në gjendje kaotike, Ministria e Transportit i ka shpenzuar mjetet për investime kapitale vetëm 6.2%. Gjendja në shkollat tona është nën çdo nivel, kurse Ministria e Arsimit i ka shpenzuar mjetet për investime kapitale vetëm 6.8%. Ministria e Shëndetësisë ka realizuar 3.7%, Ministria e Tregtisë 1.1%, kurse Ministria e Energjisë dhe e Minierave 1.2%.

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar të pranishëm në seancë, që nuk janë hiq këtu, vetëm ministri dhe është për keqardhje, por sigurisht janë duke dëgjuar diku përmes televizorit. Ne si Grup parlamentar ndoshta do të ishim pajtuar disi me demagogjinë e premtimeve të kësaj Qeverie, por nuk mund të justifikohet shkalla e papërgjegjshmërisë së kësaj Qeverie dhe paaftësia totale që të planifikohen dhe të realizohen investimet publike, që do të sillnin shërbime më të mira për qytetarët, që do të krijonin kushte për gjallërimin e biznesit dhe për gjenerimin e ekonomisë.

Në kategorinë paga dhe mëditje janë shpenzuar 102.2 milion euro. Nga këto mjete vetëm për mëditje me orar të shkurtuar janë shpenzuar 3 milion e 557.000 euro, për të cilat nuk ka fare transparencë dhe le hapësirë për dyshim. Secili ministër i ka bërë koeficientët si ka dashur vet për të preferuarit e tyre në Ministri dhe nuk dihet pse udhëzimi për koeficientet e shërbyesve civilë ende nuk është miratuar nga Qeveria.

Në kategorinë mallra dhe shërbime, ku në vazhdimësi kjo Qeveri ka abuzuar më së shumti me mjete buxhetore, ka vazhduar edhe në këtë 6 muaj me ritëm të njëjtë. Për shërbimet e telekomunikimit janë shpenzuar 3.300.000, kurse për shpenzimet kontaktuese, për të cilat nuk ka fare transparencë, janë shpenzuar 6.800.000 euro, për derivate 8.600.000 euro. Nëse do të mbahet në mend për diçka kjo qeveri, në të ardhmen do të mbahet për trendin e shpenzimeve për luksin qeveritar. Kanë folur sa kanë dashur

me telefona celular, kanë shpenzuar sa kanë dashur karburante, kanë shkuar ku kanë dëshiruar dhe kanë marrë sa kanë dashur për mëditje.

Në të gjitha ministrinë ka lidhje të kontratave pa procedura të prokurimit, që pason mbulimi më vonë me dokumentacion fiktiv, e ka vërtetuar Zyra e auditorit gjeneral. Ka lëvizje të mjeteve nga një nënkod në tjetrin pa respektuar fare procedurën. Mendova se do të jetë këtu ministri i Energjisë dhe i Minierave dhe e mora shembull vetëm Ministrinë e Energjisë dhe Minierave.

Nuk ka planifikuar fare mjete për akomodim e ka shpenzuar 19.677 euro, ka planifikuar për shpenzime të telefonit 42.300 euro për tërë vitin e ka shpenzuar vetëm për 6 muaj 49.648 euro, pra 7.348 euro më shumë. Ka planifikuar për shpenzimet e udhëtimit për tërë vitin 15.500 euro, e ka shpenzuar 28.517 euro, pra për 6 muaj 13.000 euro më shumë.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të AAK-së Mazllom Kumnova. Të vazhdojmë. E ka fjalën Mazllom Kumnova.

MAZLLOM KUMNOVA: Unë do t'i jap përparësi, meqë është femër.

(Zhvillohet polemikë)

KRYETARI: Zoti Kumnova, urdhëroni, ju lutem. Vazhdoni, sepse nuk kemi ndarë kohën për diskutim sipas grupeve parlamentare. Ne jemi ata që s'kemi pranuar ta ndajmë kohën sipas grupeve parlamentare. Ju lutem, mos e pengoni punën e seancës. Ju i keni shpenzuar minutat tuaj. Edhe ju duhet të diskutoni sipas të gjitha grupeve parlamentare të tjera.

Urdhëroni, zoti Kumnova!

MAZLLOM KUMNOVA: Cilin ta dëgjoj këtu unë tash!?

KRYETARI: Nëse s'shkoni në vend, mund ta ndërprejmë mbledhjen. Ju lutem, s'keni të drejtë, e keni shfrytëzuar të drejtën për diskutim dhe kohëzgjatjen. Mos e pengoni punën në Kuvend. Zoti Kumnova, a doni ta merrni fjalën, apo do ta marrë ndokush tjetër.

MAZLLOM KUMNOVA: Zoti Kryetar, zoti ministër, Edhe Grupi parlamentar....

KRYETARI: Mund ta dorëzoni diskutimin. Po mund ta merrni të gjithë fjalën, me rend.

(Reagim, pa kyçe të mikrofonit)

KRYETARI: Po, ku shkruan ashtu? Secili deputetë ka të drejtë për dhjetë minuta. Ju lutem, shfrytëzoni mundësinë për ta dorëzuar diskutimin me shkrim.

Meqenëse s'po keni mirëkuptim, tash do ta japim një pauzë. Pauza zgjatë deri në orën 14,30.

(Në vijim, jepet vazhdimi i diskutimit me shkrim i deputetës Safete Hadërgjonaj)

Në Ministrinë e Transportit nuk ka fare të planifikuara mjete për blerjen e mobilieve e janë shpenzuar 15,681 euro e njëjta gjë ndodh edhe në MAPH dhe në ministritë tjera.

Të nderuar deputet

Shqetësuese është mënyra e shpenzimit të mjeteve nga MEF që është e thirrur për koordinimin dhe administrimin financiar të buxhetit. Kjo ministri për shpenzime jashtë vendit ka shpenzuar 273,747 euro, për akomodim 102,474 euro, kurse avans ka 113,271 euro. Ka shpenzuar 218,459 euro për telefon, për shërbime këshillëdhënëse 360,970 euro, për ushqim dhe pije 136,903, ka planifikuar për të shpenzuar 27,000 për mjete transporti e ka shpenzuar 43,797 euro.

Në KBF përfaqësuesit e Ministrisë janë arsyetuar se këto shpenzime janë edhe të Grupit Negociator. Për mua është shumë e paarsyeshme që të përfshihen këtu shpenzimet e grupit negociator. Asnjëherë nuk është prezantuar një raport i shpenzimeve të këtij grupi edhe pse disa herë në Kuvend është kërkuar një gjë e tillë.

Kërkoj nga Qeveria përkatësisht nga MEF

- që të paraqes një raport të detalizuar të shpenzimeve të GN
- që të jetë transparente ndaj deputetëve që përmes një raporti më të detalizuar ti njoftoi deputetët me projektet investive kapitale, të cilat janë paraparë të realizohen. Sa prej këtyre projekteve janë realizuar e sa janë në realizim e sipër dhe cilave mjete të paraparë për projekte të caktuara iu është ndërruar destinacioni.
- Të njoftoi Kuvendin me vendimet e nxjerra nga Qeveria që kanë pasur implikime buxhetore, a i ka shoqëruar këto vendime deklarata financiar.
- Të njoftoi Kuvendin a ka bërë marrëveshje mirëkuptimi me të gjitha organizatat buxhetore që krijojnë të hyra sipas nenit 5. Kërkoj që të respektohet neni 5.3 dhe kopja e të gjitha marrëveshjeve ti dorëzohet Kuvendit.

Rekomandoj në emër të GP te PDK që:

- Të respektohet LATP dhe të ndërpriten dukurit negative në AT.
- Të respektohet LMFPP dhe udhëzimet e nxjerrura sidomos nga departamenti i thesarit
- Të miratohet udhëzimi për koeficientet në shërbimin civil
- Të caktohen kriteret për largimin e shërbyesve civil sipas letrës së qëllimit të mirë e jo të përdoret çelësi partiak.
- Të zvogëlohen shpenzimet enorme për pozicionet e caktuar si për derivate, reprezentacion, telefonata etj.

Mos realizimi i premtimeve të qeverisë, abuzimi me mjete të taksapaguesve, kaosi energjetik, shtrenjtimi i kostos së jetës së qytetarëve dhe mos aftësisë e kësaj Qeverie për të bërë asgjë, arbitrariteti në administratën tatimore, rritja e papunësisë, bënë që ne të jemi kundër këtij raporti gjashtëmujor.

Ministri në një emision televiziv ka deklaruar po citoj “se auditori gjeneral e ka vërejtur mizën e nuk e ka vërejtur buallin” le të mbetet nën përgjegjësinë e këtij koalicioni që nuk lejoj asnjëherë të formohet një komision hetimor nga Kuvendi i kërkuar nga GP i PDK, për kontribuar në parandalimin e keqpërdorimit të buxhetit.

(Vazhdimi i seancës pas pauzës, në orën 14,30)

KRYETARI: Deputeti Mazllum Kumnova e ka fjalën.

MAZLLUM KUMNOVA: Zoti Kryetar, ministra dhe deputetë,

Edhe Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar me kujdes Raportin fiskal për gjashtëmujorin e parë të vitit 2007, i hartuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa si dhe detyrim që del nga Ligji për menaxhimi i financave publike. Me këtë rast, kemi konstatuar si vijon:

Raporti është hartuar me kompetencë dhe pasqyron në detaje të gjitha informacionet por frekuentohet me terminologji që për ne, të cilët nuk jemi ekspert të kësaj fushe, na krijon edhe dilema shpesh. Po ashtu, pasqyrat e të dhënave, pa komente mund të çojë në gjykime dhe vlerësime të ndryshme. Ndoshta mund të merret si raport për një periudhë të vitit, dhe duhet të merret si i tillë, dhe nuk bënë të klasifikohet si raport i vitit, kur përmbajtja dhe formësimi kërkojnë një qasje dhe metodologji tjetër.

Disa tregues mund të interpretojnë me një optimizëm, siç janë shpenzimet në total për 9% rritje, mirëpo në strukturë tregojnë një disiplinë të tërë në vitin 2007 në krahasim me të dhënat nga auditet për vitin 2006.

E dyta. Grumbullimi i tatimeve ka shënuar një rritje në krahasim me vitin e kaluar dhe është treguesi i angazhimit të mekanizmave të Qeverisë, por edhe vetëdijesim më i lartë i qytetarëve për të kryer detyrimet ndaj shtetit.

Mbetet për ne shqetësuese se rreth 170 milion euro janë suficit deri në muajin qershor të vitit 2007, ndërsa investimet kapitale nuk janë realizuar sipas planifikimit në këtë periudhë të vitit rreth 20%. Përse ndodhë kështu, padyshim adresa është Qeveria dhe mungesa e menaxhimit, në shikim të parë, dhe jo si po akuzohet sot dhe në këtë debat dhe bëhet klasifikimi që mund të përdoren për fushatë këto mjete, që po më duken shumë shkollareske.

Ma merr mendja se debati do të ishte shumë më konkret po t'i kishim të dhënat sipas projekteve të investimeve kapitale, si dhe cilat kanë qenë dështime nga këto projekte, të cilat kanë filluar me një kujdes të duhur dhe ku qëndron arsye e këtij ngadalësimi.

Kështu, me një vlerësim negativ të përgjithshëm për menaxhim, nuk do të kontribuojmë në zgjidhjen e problemeve. Prandaj, shpjegimet shtesë, sidomos për këtë pozicion do të kishin qartësuar angazhimet dhe menaxhimin financiar për këtë periudhë.

Po ashtu shumë, ligje të miratuara, kanë pasur një kosto dhe nuk kemi të dhëna se si po realizohet kjo. Domethënë, ne mendojmë se ky raport duhet të refletkojë edhe për zbatueshmërinë e Ligjit.

Për ne mbeten të mjegulluara disa të hyra jo të përcaktuara, sidomos kur përmenden bankat, edhe pse të gjithë e dimë se raportimi i bankave mësa duket, nuk është korrekt dhe transparent. Kompetencat e Ministrisë, si duket, nuk mund të preken në këtë fushë.

Janë disa pozicione financiare që kërkojnë shpjegime përse mjedisi për shembull të jetë zero-investim, mbrojtja të jetë vetëm 2% e të tjera, për të cilat të gjithë jemi të vetëdijshëm se, aktualisht, kanë një prioritet.

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ka vlerësuar përkundër këtyre konstatimeve që radhitem se një raportim i tillë i detajuar, transparent dhe nuk mund të zë vendin të një zbërthimi të raportit vjetor, sepse është për një periudhë të caktuar brenda një viti, dhe se mund të dizajnohen, plotësohen dhe të përmirësohen raportet e pozicioneve që u diskutuan.

Me këtë vlerësim, si Grup parlamentar, e mbështesim Raportin fiskal për gjashtëmujorin për vitin 2007. Ju faleminderit Kryetar, kaq kisha.

KRYETARI: Ju faleminderit! Për ORA, Nazim Jashari.

NAZIM JASHARI: Ju faleminderit zoti kryetar.

Raporti fiskal për gjashtëmujorin e vitit 2007 së pari, është lajmë i mirë që ka ardhur me kohë në Kuvend, mirëpo ana e keqe e këtij raporti se si raport është i mangët, është i cunguar, nuk i ka të gjitha fletët që është dashur t'i ketë dhe nuk e di quditërisht se pse nuk është marrë masa përkundër vërejtjeve që janë bërë në komision që raportit, të cilit i mungojnë faqet: 13,14,15 dhe ato pikërisht në pjesën e cila është ta quajë ashtu, pjesa më e rëndësishme e raportit, pjesa e shpenzimeve buxhetore. Pra, nuk është marrë masë që ato faqe t'i shtohen këtij raporti në mënyrë që raporti të jetë i kompletuar, së paku në aspektin formal.

Sa i përket këtij aspekti, pra aspektit formal teknik, ky raport e ka këtë mangësi. Mangësi tjetër, të cilën dua ta përmend këtu para jush, është që analizat e raportit - janë analiza shumë të paqarta, konfuze dhe nuk krijojnë një ndihmesë për lexuesin e raportit që të mund të vije deri te një përfundim i duhur lidhur me rrjedhën e qarkullimit të parasë në Kosovë. Vazhdimisht po i referohem posaçërisht shpenzimeve, sepse të hyrat janë të hyra. Afërsisht, ne e dimë fuqinë tonë të vjeljes së tatimeve dhe e dimë se sa të holla në këtë sistem të vjeljes mund të realizohen, prandaj edhe nuk kemi dilema që në atë aspekt gjithçka do të shkojë me një automatizëm përderisa të hyrat kryesisht vilen në doganë.

Mirëpo, te shpenzimet - janë defektet e kësaj Qeverie. Kjo Qeveri, nuk jam i vetmi që po e them, e pranojnë edhe këta vetë, nuk është e zonja të shpenzojë para. Është e zonja të shpenzojnë para pa lidhje, po nuk është e zonja shpenzojë para me projekt, me program. Veçmas, është e pazonja të shpenzojë para për investime kapitale.

Në vitin e kaluar, në fund të vitit nga 190 milion euro, të parapara për investime kapitale kishim një "suficit" në thojza, se ai nuk ishte suficit por është mungesë e aftësisë së shpenzimit të parasë - të 56 milionëve, kurse këtë vit jemi dëshmitarë që shpenzimet kapitale në gjashtëmujorin e parë janë realizuar vetëm diku 17, 18 apo 19% varësisht, meqë nuk kemi informacione të sakta, diku paraqiten 14%, diku paraqiten 18% në të njëjtin raport por kemi lëvizje të parametrave ose të analizave, nuk dihet se çka ka marrë për bazë si analizë. Sidoqoftë, me shifra kemi nga 200 milion të parapara në fillim të vitit - afër 200 milionëve, kemi 38 milion të shpenzuara. Pra, i bjen afërsisht dikun afërsisht 18%.

Me këtë dinamik të shpenzimit të parasë për investime kapitale, më duhet të them që edhe një herë po vërtetohet kategorisht se kjo Qeveri nuk është e koncentruar për punë, nuk është e koncentruar për ti shërbyer qytetarit, por ma tepër ajo është e koncentruar vetëm në realizimin e favoreve dhe të mirave që ua mundëson postin në të cilin ndodhen. Këtu ministri Shatri sigurisht që nuk e ka përgjegjësinë për mosshpenzimin e këtyre parave, nuk është kryeministër mirëpo përgjegjësia, për moskompletimin teknik të raportit, është e ministrit Shatri. Sa i përket shpenzimeve të parasë, kjo është veçmas po them edhe një herë te shpenzimet kapitale - është përgjegjësi e tërë e Qeverisë dhe është një katastrofë e madhe, sepse parat të cilat janë grumbulluar nga taksapaguesit kosovarë dhe të cilat janë paraparë që t'i kthehen prap këtij taksapaguesi me anë të rrugëve, me anë të kanalizimeve, ujësjellsëve apo shkollave - nuk po i kthehen, por po mbetin para në fund të vitit të

parealizuara dhe me këte po i kemi dy dëme. Dëmi i parë, është që nuk i kemi objektet kapitale në shfrytëzim dhe dëmi tjetër është që paratë kaq të munguara nuk po i kthehen biznesit në formë të punës që ata, duke punuar, ia dalin të realizojnë të hyrat nga këto investime.

Mendoj se nuk ka tregues më të mirë për aftësinë menaxheriale të një qeverie se sa shpenzimet kapitale dhe mendoj se çdo fjalë është e tepërt për punën e kësaj qeverie pas këtyre dështimeve të përsëritura të një pasnjëshme në menaxhimin e shpenzimeve kapitale. Dhe përderisa jemi në praktik të zgjedhjeve, shpresoj shumë që mbase do t'ia dilni disi t'i shpenzoni këto para pak me një dinamikë pak më të përsheptuar, por kanë mbetur tepër shumë. Kanë mbetur edhe 165 milion, e si ti bëhet halli deri në fund të vitit të shpenzohen këto para. Pra, janë tepër shumë para për t'i shpenzuar deri në fund të vitit, veçmas duke marrë parasysh - po e përsëris edhe një herë - aftësinë menaxheriale. Ndoshta me ndërrim të destinimit, siç po synohet tash, edhe të bëhet diçka po nuk mund t'i ndërrohet destinimi i të gjitha këtyre 165 milionëve që kanë mbetur deri në fund të vitit të shpenzohen në shpenzime kapitale.

Grupi Parlamentar ORA, sigurisht që nuk ia jep përkrahjen këtij raportit edhe për shkak të asaj që thash në fillim - për shkak të mungesave teknike, po edhe për shkak të mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë nga ana e zyrtarëve të qeverisë. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI: Ju faleminderit! Pasi nuk ka përfaqësues të grupeve tjera për fjalë, fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori.

BEHXHET BRAJSHORI: Ju faleminderit zoti kryetar. Të nderuar kolegë deputetë, anëtarë të kabinetit,

Ne sot po e shqyrtojmë një raport të përkohshëm të buxhetit për një periudhë të caktuar dhe thjeshtë është raport financiar. Nuk përfshinë një dimension më të gjerë të zhvillimeve ekonomike dhe të indikatorëve ekonomik dhe mendoj se në këto korniza duhet shqyrtuar Raportin për periudhën janar-qershor 2007.

Ajo çka mund të vërehet te ky raport është fakti se raporti është paraqitur me kohë në Kuvendin e Kosovës sipas Ligjit mbi menagjimin e financave publike dhe përfshin dy komponente të rëndësishme - që të dyja, për mendimin tim, kanë një tendencë ose një ecje pozitive. E para, të hyrat, sikur që u tha edhe nga kolegët dhe shihet edhe nga raporti qartë, se ato e kanë një ecje pozitive krahasur me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe tash në këtu mund të diskutojmë se kanë qenë realisht të planifikuar të hyrat apo jo, mirëpo të hyrat janë planifikuar në bazë të asaj strukturave të hyrave që janë përcaktuar

me ligj. Edhe në doganë, sipas tipeve të të hyrave të taksave po edhe brenda vendit po në të njëjtën mënyrë.

Brenda një periudhe të shkurtër struktura e të hyrave nuk mund të ndryshojë. E kam fjalën për aplikimin apo jo të të hyrave të ndryshme të akcizës së doganave e tjera, prandaj reflektohen sipas asaj që ligji i ka përcaktuar të hyrat totale në përgjithësi.

Natyrisht se nuk mund të themi se në këtë rast ne mund të jemi në tërësi të kënaqur edhe me aspektet tjera, do të thoja të hyrave, sepse mund të ketë në një kategori pak a shumë të hyrë ma të madhe, në tjetrën pak më të vogël, mirëpo është me rëndësi se të hyrat totale kanë shënuar një ngritje, siç u tha edhe më herët 35.7% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Komponentë e dytë ka të bëjë me shpenzimet. Nëse vërejmë, ne kemi në total vetëm një ngritje jo shumësubstanciale të shpenzimit, por ajo që është me rëndësi, e unë e theksoj në këtë rast është se te mallrat dhe shërbimet kemi një rënie të shpenzimeve. Do të thotë kemi rrënie të shpenzimeve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe kjo tregon për një disiplinë financiare në përgjithësi. Është me rëndësi të madhe që ne të krijojmë shprehinë e disiplinës financiare edhe të shfrytëzimit të mjeteve sipas destinacionit.

Ajo që Qeverisë i mbetet si barrë e angazhuar, që vazhdimisht edhe që grupi parlamentar i LDK-së po ashtu e ka diskutuar, është nevoja e ngritjes së efikasitetit të shpenzimeve te kategoria e shpenzimeve kapitale. Kjo nuk është diçka e re, nuk ndodhet vetëm me këtë raport. E kemi një gjendje pak a shumë të trashëguar edhe më herët, por këtu duhet ngritur efikasitetin dhe këto janë gjitha angazhimet e Qeverisë që të përmirësohen procedurat e tërësishme që do të mundësojnë një shfrytëzim efikas të mjeteve të buxhetit të Kosovës.

Megjithkëtë, kemi një ecje, do të thoja pozitive, sepse natyrisht ne duhet të kemi parasysh edhe përgatitjen e projekteve me kohë do të thoja ndoshta më herët se sa viti kalendarik financiar që fillon dhe do të na mundësojë një periudhë më të hershme kohore për ta shfrytëzuar.

Thashë se gëzon fakti që te struktura e shpenzimeve kemi këtë rënie të shpenzimeve te mallrat e shërbimet dhe natyrisht tendenca edhe për të zvogëluar shpenzimet tjera qoftë te shpenzimet komunale apo shpenzimet tjera që përbëjnë strukturën e tërësishme të shpenzimeve.

Raporti si i tillë është mjaft transparent. Unë do të thoja, për këtë fazë, është mjaft i detajizuar. Edhe Qeveria mund të paraqet të dhëna konkrete për projektet e caktuara të shkallës së shfrytëzimit të mjeteve ndoshta në fund të vitit kalendarik, sepse është vështirë tash për t'i matur në tërësi ose është vështirë për të pasur indikator se sa një projekt i caktuar është i realizuar në këtë fazë.

Ne sot jemi në shtator, besoj se në krahasim me periudhën që po e analizojmë, kemi indikatorë më të përmirësuar sesa që paraqiten në këtë raport financiar.

Prandaj, shkalla e realizimit të projektit të investimeve kapitale mendoj se duhet të jetë një obligim që Qeveria duhet të paraqet me rastin e aprovimit të Raportit përfundimtar për vitin përkatës - këtë rast Raportin e vitit 2007 gjatë vitit të ardhshëm 2008, ku ne,

natyrisht do të shihnim se sa në të vërtetë kanë mbetur mjete të pashfrytëzuara, pra edhe në kategori të ndryshme të shpenzimeve.

Këtu përmendet shpeshherë suficiti. Ndoshta nga një kuptim mund të merret si suficit. Por, ajo është një rrjedhë e rregullt e parave. Unë për mendimin tim nuk mund ta quaj suficit në kuptimin e plotë të fjalës. Suficiti çka nënkupton? Ajo është rrjedhë e caktuar e parave dhe në një moment të caktuar gjendet e atillë. Suficiti llogaritet në fund të vitit, nëse absolutisht mbyllet gjithë librat kontabël dhe mjetet kanë mbetur pa shfrytëzuara. Prandaj kemi një periudhë ecëse në këtë drejtim dhe unë mendoj se nuk mund të flitet për një suftificim në kuptim e plotë të fjalës.

Është tepriçë e parasë sipas rrjedhës normale të parasë së gatshme, pra edhe të parave tjera në kuadër transfereve financiare që bëhen.

Unë mbështesë Raportin në këtë fazë në këtë formë siç është. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Unë, pak më parë, kërkoja edhe dy minuta kohë që ta përfundoj diskutimin tim në emër të Grupit Parlamentar të PDK dhe në emrin tim si nënkryetare e dytë e Komisionit për buxhet dhe financa.

Kryetari i Kuvendit nuk e pa të arsyeshme që mua t'ma zgjatë diskutimin për dy minuta, kurse deputetëve të partisë së tij, të cilës ai i takon ua ka zgjatur diskutimin edhe për debatet e kota dhe që s'kanë thënë asgjë.

Unë sot isha duke diskutuar për një çështje shumë të rëndësishme për interesin e qytetarëve të Kosovës, të cilët janë taksëpagues dhe e mbushin buxhetin e Kosovës për interesin e Qeverisë dhe vetë Kuvendit. Prandaj, me moszgjatjen e diskutimit tim, u dëshmuam edhe një herë se sa seriozisht i qaset Kuvendi çështjes së parasë publike dhe çështjes së interesit të qytetarëve dhe në përgjegjësi sa është i gatshëm Kuvendi të shikojë apo të monitorojë financat publike apo parat të cilat vijnë nga taksëpaguesit kosovar, e që edhe ne si deputetë këtu jemi taksëpagues të këtyre mjeteve dhe marrim pjesë në buxhetin e Kosovës.

Atëherë, meqenëse nuk mu dha mundësia që ta përfundoj diskutimin tim, unë do të tërhiqem nga diskutimi, kurse Kryetari le të vazhdojë me tjerët.

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit zoti kryetar.

Nuk është çudi që tash e tri vjet vazhdon praktika e këtij Kuvendi që saherë të debatohet për çështje të rëndësishme, bëhen përpjekje dhe inskenohen gjëra të tilla që ose të përfundoj dhe dështojë ai debat ose të detyrojë opozitën që vërtetë të dalë nga punimet e Kuvendit. Kështu ka ndodhur edhe në kohën e miratimit të këtij buxheti, për të cilin po flasim tani për shpenzimet gjashtëmujore. Kështu ka ndodhur edhe në çdo debat të rëndësishëm. Është thënë sa e sa herë që në debate të tilla të rëndësishme, nuk duhet të ketë kufizime kohore, sepse kemi të bëjmë me çështje shumë vitale dhe kemi të bëjmë me çështje të rëndësishme, siç është edhe ai i miratimit të buxhetit, po edhe shpenzimeve buxhetore në periudhën e caktuar.

Mësohuni një herë që të lëni një shembull të mirë për punën e Kuvendit të ardhshëm, nuk e kemi me tapi këtu askush. Do të ndërrohem dhe të shohim se si do të vazhdojë dhe si do të funksionojë Kuvendi.

Nuk dua të ndalem në strukturën e të hyrava, pasi që e tha zëvendësministri dhe këtu ishte kur e miratuam edhe Ligjin për statusin e deputetit që vërtetë një herë e përgjithmonë duhet të ndahen pushtetet, dhe nuk di a foli në emër të cilësisë e deputetit apo të mbrojë Ministrinë përkatëse, Zëvendësministër i së cilës është. Prandaj edhe për këtë çështje duhet të kemi shumë kujdes në të ardhmen.

Nuk dua të ndalem në raport sepse në Komision jemi marr vesh që ky raport duhet të plotësohet dhe nuk di pse ka dalë pa ato plotësime që i ka kërkuar vetë Komisioni.

Përveç asaj që Raportit i mungojnë shumë faqe, e ndoshta me qëllim janë hequr ose është faji të administrata, Raporti nuk përshkohet me një analizë të shpenzimeve, së paku jo mikroanalizë por një mikroanalizë të atyre shpenzimeve për periudhën e caktuar, do të thotë për periudhën gjashtëvjeçare.

Fatmirësisht janë dy linja buxhetore, nuk ka ndryshime të mëdha, sepse aty veprohet në mënyrë strikte, sidomos të mallrat e shërbimet, të pagat dhe mëditjet, që nuk ka ndonjë lëvizje poshtë-lartë edhe pse Zëvendësministri e krahasoj me vitin e kaluar. Mirëpo, nuk di si do t'i arsyetojë Qeveria shpenzimet në linjën buxhetore të shpenzimeve kapitale.

Në fillim të miratimit të këtij buxheti ne kemi pasur një listë të të gjitha projekteve kapitale të Qeverisë për këtë vit fiskal. Do të dëshiroja shumë që Ministri ose Zëvendësministri, në këtë rast, të na thonë se cilat prej këtyre projekteve kanë filluar dhe janë realizuar në periudhën gjatëmuajore të këtij viti fiskal. Unë them, asnjë dhe vetëm asnjë prej këtyre projekteve as që kanë filluar. Jo që janë realizuar, por as që kanë filluar. Vërehen në këtë gjatëmuajorin e dytë investime ose fillime të punimeve. Ne po shohim edhe në Prishtinë se si po shtrohen trotualet, rëra mbi asfalt dhe gurët katrorë mbi rërë, e që nesër bie shi dhe e heq atë rërë dhe pastaj lëvizim nëpër katror.

U tha një konstatim se buxheti është keqmenaxhuar. Aty ku ka keqmenaxhim, meqë është verifikuar deri më tani nga të gjitha raportet e auditorit dhe revizorit gjeneral, aty ka edhe keqpërdorim, dhe aty ku ka keqpërdorim nuk mund të thuhet ndryshe por ka vjedhje të parasë publike. Se kush e ka vjedhë atë para publike, janë institucionet tjera, është gjyqësia, është policia që duhet të veprojë në këtë rast. Se përse janë vjedhur, dhe për çfarë destinimesh janë bërë këto, le t'u mbetet prapë atyre që ta verifikojnë. Mirëpo, është intersat para çdo fushate zgjedhore ose para çdo zgjedhje, veç vlojnë projektet, vlojnë gjëja investimet dhe kjo nuk thotë gjë tjetër vetëm një hedhje hi syve para opinionit se ne kemi bërë diçka ose kemi vepruar diçka.

Në këtë rast 168 milion euro kanë qenë investime kapitale, zoti Ministër, dhe ti ke realizuar për 6 muaj 14%. Të kanë mbetur edhe 6 muaj, do t'i realizosh edhe 14%. A mund të krenoheni se ju menaxhoni drejt buxhetin në qoftë se në fund të vitit fiskal do të keni vetëm 28% të realizimit të këtyre fondeve të shpenzimeve kapitale? Se sa dhe si e keni projektuar këtë buxhet, kohëve të fundit kanë treguar edhe vetë kërkesat e agjencioneve buxhetore për të bartë mjetet nga një projekt në një projekt tjetër. Ku ishit ju, zoti Ministër ose ku ishin ministrat tjerë që në fillim të projektimit të buxhetit nuk i kanë parë dhe si kanë parashikuar këto gjëra. Mëse katër ministri i kemi, deri tash kërkesat e mjeteve barten prej një linje në një linjë tjetër buxhetore. A mos është ky

menaxhim i mirë i buxhetit? Nuk ka asnjë emër tjetër përveç kësaj që i thonë: keqmenaxhim, keqpërdorim, korrupsion dhe çka jo tjetër.

Unë do të përmendi vetëm një shembull. Tash e dy vite është grryer maxhistrallja Prishtinë – Pejë, tash e dy vjet janë ndarë mjetet për atë magjistrale. Pse nuk mbushen ato gropat?

- Pse keni filluar tash të hapni gropat dhe tek në tetor t’i mbushni ato gropat?
- Vitin e kaluar keni ndarë për rrugën Skenderaj – Prishtinë një shumë të caktuar - për një fazë të caktuar.
- Sa e keni realizuar atë dhe ku jeni me fazën e dytë të këtij viti?
- Sa mjete keni shpenzuar në mirëmbajtje të rrugëve në këtë periudhë?
- Sa ura i keni ndërtuar?
- Sa rrugë të reja i keni ndërtuar që i keni pasur në projektet e juaja?

Raporti thotë asnjë. Vetëm 14% dhe asnjë emër të një projekti të caktuar. Kemi të drejtë të dyshojmë, sepse ky dyshim nuk na ka lindur rastësisht. Këtë dyshim tonin po e verifikojnë, siç e thashë në fillim, edhe auditorët, edhe raportet e auditimit.

Zoti ministër, fajin gjithmonë për mosrealizimin e projekteve e hodhni te Ligji i prokurimit publik. Me insistimin tuaj, dhe të tjerëve, është bërë edhe ndryshimi i ligjit. Athua, prapë qenka ligji pengesë, sepse kështu u tha nga përfaqësuesit e Ministrisë në mbledhje të Komisionit. Unë dua t’ju lexoj vetëm një nen nga ky Ligj, që nuk është pengesë e realizimit të projekteve, dhe a e keni respektuar ju zoti Ministër.

„Kreu III neni 7 - Planifikimi i prokurimit.

Jo më pak se 60 ditë kalendarik para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë dhe të pajisë agjencionin e prokurimit publik me planifikimet paraprake të prokurimit.“.

Sa nga agjencionet, që në këtë rast janë ministritë, dhe agjencionet tjera buxhetore e kanë respektuar këtë rregull?

Rregulla tjetër po e njëjtit nen thotë: „Jo më pak se 10 ditë kalendarik, pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal çdo autoritet kontraktues do të përgatisë dhe do t’i dorëzojë APP-ës një planifikim përfundimtar“. Sa bëjnë prej 24 dhjetorit 10 ditë deri në realizimin e kësaj rregulle nga agjencionet. A e kanë bërë këtë?

Pse duhet vonohet furnizimi në shkollat me qymyr dhe duhet të fillojë në tetor kur këtë keni mund ta bëni në janar, keni mundur ta bëni në shkurt, në mars në prill, në maj, në qershor, në korrik, në gusht dhe kështu me radhë. Ka faj ligji këtu, apo ka faj dikush tjetër. Sepse, gjërat që bëhen me ngutë ato bëhen shkel e shko dhe ato bëhen sipas atyre që dëshirojnë t’i bëjnë ashtu, do të thotë pse dojnë të përfitojnë më shumë, që të përfitojnë më lehtë prej këtyre. Këto nuk i keni parasysh dhe nuk i keni realizuar fare.

Një tjetër çështje, zoti ministër. U fol shumë për atë që quhet suficit. Në ligjin për buxhetin të vitit fiskal 2007, neni 6, thuhet: „Jo më vonë 30 ditë, pas ndarjes së plotë buxhetore për vitin 2007 Qeveria ia paraqet Kuvendit dhe Përfaqësuesit special të Sekretarit të përgjithshëm një pasqyrë fillestare që thekson shumat, burimet dhe shpenzimet e përgjithshme të elementeve të fondeve të bartura si tepriçë nga viti fiskal 2006“. E keni realizuar, e keni bërë këtë? E keni respektuar këtë rregull? E keni

respektuar ligjin, zoti ministër? Unë e them se nuk e keni respektuar, prandaj dikush duhet të ketë përgjegjësi për mosrespektim të ligjit. Së paku në nivelin politik Kuvendi duhet ta shtrojë këtë çështje njëherë e përgjithmonë nëse thirrëmi në realizimin e ligjshmërisë dhe në mbrojtjen e ligjeve.

Unë do t'i them edhe dy fjalë që nuk arriti.....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A jeni për ate që tia vazhdojmë a jo? Urdhëro Gani.

GANI KOCI: A mund të flasë ju lutem, meqë Kryetari ma dha fjalën.

KRYETARI: Pyeti anëtarët e partisë tënde a mund të flasësh a jo, unë për veti, ta dhashë fjalën.

GANI KOCI: Shqetësuese është mënyra e shpenzimit të mjeteve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, që është e thirrur për koordinim dhe administrim financiar të gjithë buxhetit. Kjo Ministri, për shpenzime jashtë vendit, ka harxhuar hiq më pak se 273 mijë euro për gjashtë muajë. Për akomodim 102 mijë, për avans 113 mijë. Ka shpenzuar 218 mijë euro për telefon, për shërbime këshillëdhënëse mbi 360 mijë, për ushqim dhe pije mbi 136 mijë, ka planifikuar gjatë kësaj periudhe të shpenzojë 27 mijë për mjete transporti dhe ka shpenzuar 43 mijë.

Në Komisionin për buxhet dhe financa është shtruar dhe është kërkuar që të arsyetohen këto çështje, këto shpenzime, sepse është thënë se janë ë Grupit negociator. Po pajtohemi se një pjesë e tyre janë të Grupit negociator dhe si të tilla do të duhej ta kishin një linjë të veçantë të shpenzimeve të tyre dhe mos të mbulojë shpenzimet e veta Ministria e Ekonomisë dhe Financave me shpenzimet e Grupit negociator. Po, po - është kërkuar Komisioni për buxhet dhe këtë nuk e ka bërë. Dhe, për një kërkesë të tillë, ne qëndrojmë akoma pranë saj që të ndahen shpenzimet për secilin veç e veç dhe pastaj dimë kujt t'i drejtohem dhe si t'i drejtohem.

Prandaj, nga të gjitha ato që u thanë edhe më parë, kërkohet sidomos nga Qeveria, edhe pse s'qenka Qeveria këtu. Jo – jo, s'është Qeveria, sepse në shqyrtimet buxhetore, qoftë të harxhimeve qoftë të projekteve duhet të marrë pjesë e tërë Qeveria, sepse Ministri nuk mund t'u dalë zot këtyre çështjeve dhe të dihet çka ka bërë ky i kulturës, ky i arsimit ose ai tjetri. Prandaj do të duhet të ishin këtu në përgjigje e caktuar.

Prandaj, kërkohet që të jetë transparente ndaj deputetëve, që përmes një raporti më detajizuar t'i njoftojë deputetët me projektin, me objektet investive kapitale, të cilat janë paraparë të realizohen.

Të njoftoj Kuvendin me vendimet e nxjerra nga Qeveria që kanë pasur implikim buxhetor, dhe a janë shoqëruar këto vendime me deklarata financiare.

Ta njoftoj Kuvendin a ka bërë marrëveshje mirëkuptimi me të gjitha organizatat buxhetore që krijojnë të hyra sipas nenit 5. Dihet se kur bëhen memorandume të mirëkuptimit duhet të njoftohet Kuvendi edhe me përmbajtjen e memorandumit edhe me atë se sa është në përputhje me ligjin përkatës.

KRYETARI: Gani i keni kaluar edhe 2 minuta

GANI KOCI: Edhe dy minuta e ndoshta e përfundoj.

Rekomandoj që të ndërpriten të gjitha abuzimet me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës: Të respektohet maksimalisht Ligji i menaxhimit të financave publike dhe në këtë rast kërkoj që ky Kuvend të formojë një komision dhe të hetojë të gjitha shpenzimet që janë bërë në këtë gjashtëmujor ministrisë - Qeverisë të Kosovës. Do të thotë një komision që të hetojë dhe bëjë një raport tjetër për këto shpenzime të këtij gjashtëmujori. Të miratohet udhëzimi për koeficientët në Shërbimin civil. Kemi laramani të ndryshme atje dhe ka pasur një projekt për nivelizim të pagave. Të caktohen kriteret për largimin e shërbyesve civil, jo kujt t'i teket dhe si t'i teket në emër të mungesës të buxhetit. Të zvogëlohen shpenzimet enorme që quhen telefonata, karburante, darka, dreka, ndeje të natës e të ditës.

Dhe krejt në fund uroj që kjo Qeveri sa më shpejt të largohet, sepse e meriton që të shkojë.

KRYETARI: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi, le përgatitet deputeti Naser Osmani

SELVIQE HALIMI: Ju faleminderit.

Zoti Kryetar uroj që të mos i bashkëngjitësh edhe ti Qeverisë duke i shkelur ligjet siç ishte rasti i shkeljes së Ligjit kundër diskriminimit.

Se do të kemi shpenzime joreale dhe shpenzime të tekeve në Qeverinë e Kosovës, kjo do të ndodhë derisa Qeveria të mos e marrë një hap dhe të hartoj listën standarde të shpenzimeve qoftë për vijën buxhetore, mallra dhe shërbime, qoftë për vijën buxhetore shpenzime kapitale.

Asnjë qeveri nuk mund të tolerojë dhe nuk duhet të tolerojë, që të gjitha shpenzimet të shkojnë sipas tekeve me çmime se çfarë i ofrojnë kompanitë në investime kapitale apo edhe me shpenzime për mallra dhe shërbime se çfarë ju teket ofertuesve. Andaj, Qeveria është dashur ta bëjë një hapë të tillë tashmë.

Gjithashtu jemi në saje të monopolit të Ligjit për menaxhimin financave publike dhe përgjegjësi. Kurse, sa i përket Buxhetit të konsoliduar të Kosovës, ne në vazhdimësi jemi duke mos i respektuar ligjet e miratuara nga ky Kuvend dhe duke moslejuar edhe formimin e fondeve të tjera siç është ai i Bujqësisë, eko-fondi dhe stopimin total të Ligjit për sigurime shëndetësore.

Për të mos u lëshuar më tepër, unë kisha kërkuar nga Ministri i Arsimit që fatbardhësisht tash është këtu, Ministri i Financave, që në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë, si kërkesë urgjente të shtroj mundësinë e zbatimit të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm me ç'rast Qeveria e Kosovës obligohet që të sigurojë tekstet shkollore për arsimin fillor, dhe të mos ndodhë që nxënësve tanë t'u mohohet e drejta elementare në arsim, e drejtë kjo e mbrojtur jo vetëm me ligjet tona, por edhe me Konventën ndërkombëtare dhe të largohen nga procesi mësimor për mungesë të teksteve shkollore. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Naser Osmani

NASER OSMANI: Ju faleminderit Kryetar.

Desha të ndalem vetëm te pozicioni i përfolur shumë të investimeve kapitale, që shpresoj që edhe Ministri i Financave do ta bëjë edhe një herë sqarimin sepse, si po duket, krejt nuk e kanë kuptuar që në gjashtëmujorin e parë vetëm fillojnë punimet e realizimit të investimeve kapitale dhe është fjala vetëm për pagesën e kistit të parë të fazës së parë të projekteve dhe që dikur kah fundi i vitit kur të përfundojnë projektet bëhen pagesat, pagesat përfundimtare dhe do ta kemi në raportin vjetor përfundimtar pasqyrat definitive të realizimit të projekteve, të atyre projekteve që janë aprovuar këtu në Kuvendin e Kosovës, por jo nga të gjithë deputetët.

Sa i përket rënies apo pse është realizuar me përqindje të vogël, e që po kritikohet Qeveria, unë dua për korrektësi t'i tregoj edhe disa tregues pikërisht për investimet kapitale te komunat ku qeverisë PDK-ja. Për shembull:

- në Gllogovc, për 6 muaj janë realizuar 9.8%, (investimet kapitale gjithnjë),
- në Lipjan 6.9%,
- në Shtime 6.0%,
- në Malishevë 0.0%,
- në Skenderaj pak më mirë 19.6% dhe
- në Kaçanik 14.8%.

Po dua me t'iu tregoj kolegëve të mi të opozitës, që këta nuk janë indikator të saktë, këto vlerësime se sa janë realizuar projektet si në institucionet e Qeverisë të nivelit qendror, ashtu edhe të nivelit komunal. Presim raportin përfundimtar dhe do të kemi fjalë të tjera. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Nuk ta ka përmend emrin. Fjalën e ka zoti Jakup Krasniqi.

(Deputetja, reagon prej vendi, pa kyçje të mikrofonit)

KRYETARI: Nuk është përmend emri juaj.

(Reagime)

KRYETARI: Fjalën e ka Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Zoti Kryetar, të nderuar deputetë, Unë nuk kisha ndërmend ta marrë fjalën, sepse mendoj që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike këtij buxheti të harxhuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2006, i ka bërë një analizë profesionale, dhe kisha përgëzuar deputeten Hadërgjonaj për qasjen profesionale ndaj shpenzimeve buxhetore të gjashtëmujorit të dytë.

Dola që të them se nuk është në nderin e këtij Parlamenti që me këtë nivel të përgjegjësisë t'i qasemi buxhetit të harxhuar, bile jo vetëm të keqmenaxhuar dhe të keqshfrytëzuar por mendoj që edhe të vjedhur në forma të ndryshme dhe derisa kështu trajtohet buxheti, sigurisht që nuk do ta ketë gjendje më të mirë as zhvillimore, as materiale, as arsimore dhe as shëndetësore në Kosovë.

U tha se po keqpërdoret sidomos zëri për çështje kapitale. Mirë, nëse Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, ka dashur ta keqpërdor paaftësinë e

Qeverisë për të shfrytëzuar buxhetin për çështje kapitale, atëherë pse Qeveria në Raportin e saj nuk e ka cekur cilat objekte kapitale kanë filluar në tremujorin e parë dhe vazhdojnë edhe në këtë vit edhe në vitet tjera. Cili objekt ose cila rrugë ka filluar në gjashtëmujorin e parë dhe cila duhet të vazhdon edhe në gjashtëmujorin e dytë, dhe pastaj edhe në vitin në vazhdim.

A kemi diçka të tillë në Raportin që ka ofruar Qeveria dhe Ministria? Në fund të fundit, ky nuk është raport vetëm i Ministrisë. Është raport edhe i Qeverisë. Asnjë nga këto nuk i kemi. A mund të themi se kemi transparencë në shfrytëzimin e buxhetit? Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk mund të thotë këtë. Nëse dikush ka marrë për obligim dhe për detyrë ta mbrojë jotransparencën në shfrytëzimin e parasë publike, nëse dikush ka marrë përgjegjësi dhe detyrë për të mbuluar keqmenaxhimin dhe keqpërdorimin e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës, është një çështje tjetër. Ne nuk duam të jemi pjesë e këtyre mbulimeve të keqmenaxhimit dhe të keqshfrytëzimit të Buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe të parasë publike.

Prandaj, ne i jemi qasur që nga fillimi me seriozitet çështjes së buxhetit. Ne ashtu, siç nuk e dimë mbi cilët kritere është bërë buxheti i Kosovës. Ne nuk e dimë as mbi të cilat kritere po shfrytëzohet Buxheti i konsoliduar i Kosovës. Vetëm një kriter e dimë që është shfrytëzuar për ta bërë Buxhetin e konsoliduar të Kosovës - kriteri për kokë të banorëve. Megjithatë, është kriter i pamjaftueshëm për të bërë një buxhet. Do të duhej të përdoreshin edhe kriteret tjera. Jo të gjitha vendet në Kosovë gjatë 60 viteve të fundit janë trajtuar njësoj. Jo të gjitha vendet në Kosovë gjatë 20 viteve të fundit kanë qenë të lëna në harresë. Jo të gjitha vendet në Kosovë kanë pasur shkatërrime në përmasa të barabarta të luftës.

Prandaj, asnjë nga këto kritere, nuk janë shfrytëzuar. Ka vazhduar politika e vjetër e favorizimit të disa anëve dhe e diskriminimit të anëve, që për 60 vite kanë qenë të diskriminuara. Dhe sot, kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa del dhe i merr dytri komuna më të varfra të Kosovës që janë dashur të jenë të privileguara nga Qeveria e Kosovës për t'u ndihmuar ndërtimi dhe rindërtimi i atyre dy dhe më shumë komunave. Por po them, e atyre dy komunave që u zunë në gojë.

Kjo tregon nivelin e papërgjegjesisë që e kemi ne si përfaqësues të qytetarëve. Ne e di që jemi përfaqësues të partive të veçanta për të ardhë në Parlament dhe për të ardhur në Qeveri, por kur të vijmë në Parlament dhe në Qeveri kemi përgjegjësinë ndaj të gjithë qytetarëve, pa përjashtim kush i cilës komunë është, dhe pa përjashtim kush i cilës parti politike është.

Ne, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, dëshirojmë që kjo praktikë të ndërpritet. Ne presim që kjo praktikë të ndërpritet edhe nga qytetarët e Kosovës dhe ne përfaqësuesit, e sidomos të opozitës, dëshirojmë që edhe në pozitë asnjëherë mos të veprojmë si pozita e deritashme. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Gani, i ke pasur 14 minuta dhe shpenzuar më tepër. Për replikë mund ta keshë vetëm një minutë. Gani Koci një minutë e ka.

GANI KOCI: Unë do të marrë shembull veç Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit. Ka pasur 900 mijë euro për mirëmbajtjen e urave. Sa ura i ka mirëmbajt? Do të thotë 14%. Rehabilitim të rrugës, 10 milion e 900 mijë euro. Ku janë, të cilat rrugë janë rehabilituar? Sinjalizim, shuma prej 500 mijë eurove. Të cilat rrugë, dhe si është gjendja e sinjalizimit të rrugëve?

Projekte në bashkëpunim me komunat, janë 3 milion. Sa janë ato projekte dhe cilat kanë filluar dhe janë realizuar ose sa prej tyre janë realizuar? Ndërtime të reja të rrugëve, janë 8 milion e 460 mijë euro. Sa rrugë të reja kanë filluar? Rruga ka mund të fillohet me 1 shkurt, me 1 mars, me 1 prill, me 1 maj, sepse Ligji i prokurimit publik e jep këtë mundësi. Nga vetë fakti, që e thash atje më parë, se 10 ditë pas miratimit duhet të dorëzohen të gjitha projektet. Nuk janë bërë këto. Dhe shumë, e shumë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Safete Hadergjonaj një minutë.

SAFETE HADERGJONAJ: Shpresoj se nuk do ta marr asnjë minutë. Për hir të opinionit jam e obliguar të them se në komunën e Malishevës nuk është shfrytëzuar buxheti 0% siç tha kryetari i Komisionit, por është i shpenzuar për shpenzime kapitale 50.1%. Prandaj desha vetëm për hir të opinionit t'ju informoj që është shpenzuar për investime kapitale 50.1%.

Kurse sa i përket kësaj që po debatohet, mua mbetet vetëm edhe një fjalë të them: kjo Qeveri le të mbahet në mend që është një ndër qeveritë më të korruptuara të rajonit, të Evropës dhe më gjerë.

KRYETARI: Ju faleminderit. Deputeti Naser Osmani e ka fjalën

NASER OSMANI: Për hir të vërtetës, si kryesues i një Komisioni, që është funksional për këtë që po debatohet. Ky është Raporti i përkohshëm i buxhetit. Faqe 26, te komunat është 0,0 dhe le ta ofrojë dhe sheh kamera. Realizimi është zero zero dhe ne deputetët i referohemi dokumenteve që neve na paraqiten.

(Polemikë, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Mos ndërhyini, ju lutem.

NASER OSMANI: Nga ana tjetër, gjatë aprovimit, nuk është diskriminuar asnjë komunë, përkundrazi e vetmja komunë që ju ka rritur granti deri më tash në Kosovë, është Komuna e Malishevës dhe është komuna që është privilegjuar e nuk është e vërtetë që është diskriminuar, sikur që nuk është diskriminuar asnjë komunë tjetër. Është ajo çështja për atë që tha edhe ministri edhe unë, në mënyrën se...

(Ndërprerje nga gjegjia)

KRYETARI: Ju faleminderit. Zoti Ministër e keni fjalën. Safete Hadergjonaj, një minutë dhe do të jetë e fundit për diskutim.

SAFETE HADERGJONAJ: Për hir të objektivitetit, kryetari iu ka referuar shënimeve të Mamushës, sepse Malisheva i ka për pasuritë jofinanciare të shpenzuara 50.1%.

Të lutem shikoje Raportin financiar më me kujdes dhe do ta shohësh se janë shpenzimet e Malishevës, shpenzime kapitale, sepse aty shihen edhe rezultatet konkrete dhe në terren, prandaj mos i pësjtjell me Mamushen, të lutem.

KRYETARI: Ju faleminderit. Naser Osmani, një minutë,

NASER OSMANI: Plus, plus je femër, dhe duhet me qenë më korrekte këtu ndaj kolegëve dhe ndaj deputetëve. Nuk mund të sillesh në këtë mënyrë.

Fjala është për Malishevë 0.0%, Mamusha e ka realizimin 4.0%. Këto janë dokumente. Ti këqyre fillimin se nuk ki lidhje....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit. Ministri Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit shumë, zoti Kryetar.

Çështja e parë që dëshiroj të prezantoj këtu është: Çka duhet të përmbaj Raporti fiskal periodik ose final? Dhe, menjëherë ju udhëzoj që te shihni faqen 5 të Raportit, të cilin ju e keni marr. Do ta shihni se cili nen i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë obligon, dhe pasqyrën përballë do ta shihni çka kemi dhënë në Raport. Nuk është raport për ndërtimet fizike as të rrugëve as të shkollave. Është Raport për shpenzimet fiskale, të hyrat dhe shpenzimet fiskale në periudhën e dhënë.

Ju lutem shumë. Dëshiroj që në parim të përgjigjem vetëm në ato çështje që kanë të bëjnë me Raportin.

Ministri i Financave, në Raport nuk ka prezantuar dhe nuk ka dëshiruar të fyejë askënd as në Kuvend, as në Kosovë në përgjithësi. Atyre që niveli i edukatës ua lejon te fyejnë një Qeveri dhe një Kuvend, le të shkojnë më tutje sepse ua lejon niveli i edukatës. Mirëpo, nuk jemi në gjendje dhe nuk do të dëshirojmë që të përgjigjemi në ato çështje që nuk kanë të bëjnë me Raportin. Ju lutem shumë.

Sa për Administratën tatimore, ju them këtu me përgjegjësi që Administrata tatimore... Ju lutem shumë unë ju dëgjova me kujdes, niveli i kulturës thotë me dëgjuar me kujdes. Administrata tatimore e Kosovës, në vitin 2007, ka pasur për obligim që të grumbullojë 118 milionë euro dhe nga 140 milion që ka pasur për obligim dhe në 6 muajt e parë ka realizuar 118 milion. Pra ka realizuar gati 100% obligimin vjetor dhe me mburrje them që kemi një Administratë tatimore shumë të shëndosh dhe shumë të efektshme.

Kërkoj falje nga përfaqësuesi e ORA. Unë nuk kam pasur njohuri se materiali është shpërndarë me gabim teknik. Kopjen që unë e kam, nuk ka gabim teknik. Po besoj që mund të jetë. Dëshiroj të kërkoj falje publikisht – është gabim teknik. Materialit në parim nuk i mungon asnjë faqe por mund t'ketë rrjedhë ajo dhe thjeshtë më vjen keq për këtë gabim.

Çka mund të them për këtë periudhë? Mund të them se Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Qeveria për 6 muajt e parë të këtij viti ka grumbulluar 106 milion euro më tepër sesa parashikimet e buxhetit për këtë periudhë. Kemi pasur, po ashtu, kursime substanciale të cilat sillen në 2.3 milion euro nga pagat dhe mëditjet, për të cilat këtu dëgjova shumë akuza të pabaza, krejtësisht të pabaza.

203 milion euro Qeveria i ka marrë me rishikim nga kategoria e pagave dhe i ka rishpërndarë me proces të rishikimit buxhetor si kursime në periudhën gjashtëmujore.

Nga mallrat dhe shërbimet. Nga 70 milionë euro që kanë qenë të parapara për 6 muaj, janë shpenzuar vetëm 50 milion, që do të thotë në një formë kemi 20 milion euro nënshpenzime në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Do të thotë i është kushtuar një vëmendje shumë e theksuar në kategorinë e shpenzimeve, ku mund të akuzohet dikush për shkujdesje ndaj parasë publike. Dhe ajo që duhet të them, është se nuk mundet Qeveria me paguar kistet e investimeve kapitale në qoftë se ato nuk ndodhin vetëm për hir që të pasqyrojmë se kemi bërë shpenzime. Ka rregull në ndërtimin e Buxhetit që nuk lejon me paguar asnjë kist pa e marrë situacionin e punëve të kryera. Krejt bota e dinë që në shpenzimet kapitale në periudhën e gjashtëmujorit të parë gjithmonë ka nënshpenzime, sepse procedurat kërkojnë një kohë dhe e marrin një kohë por pjesa e dytë e vitit gjithmonë është më e efektshme dhe shpenzimet e zënë dinamikën e paraparë.

Më vjen keq, ne jemi ma të dobët në pjesën e shpenzimeve kapitale dhe atë nuk e kemi fshehtë, kemi kërkuar që të gjejmë forma për ta evituar këtë dobësi dhe shpresoj që në këtë vit do të jemi shumë më të vëmendshëm

Dhe ajo e fundit që dua ta them, është se në qoftë se ndokush nuk din diçka, nuk do të thotë që nuk ka ndodhur në realitet. E kam fjalën për zotëri Kocin, sepse na i kemi informatat, i kemi të dhënat dhe ata që dëshirojnë me t'i dinë ato, mund t'i marrin kurdo që janë të interesuar.

Nuk shkruajmë në Raport ato që nuk i kemi obligim në bazë të Ligjit për t'u shkruar. Ju lutem shumë. Dhe, në qoftë se kemi pasur të hyra 106 milion euro më shumë se dinamika e paraparë, ka rregulla në ndërtimin e buxhetit. Nuk mund Qeveria, në qoftë se ka realizuar më tepër të hyra t'i ndajë ato, sepse nuk i ka pronë private. Ekziston procedurë në bazë të cilës edhe propozohen, diskutohen dhe miratohet shpenzimi i mjeteve qoftë si e hyrë mbi planin, qoftë si suficit në fund të vitit.

Ju kërkoj që këtë Raport ta përkrahni dhe ta inkurajoni Qeverinë, sepse në fund të vitit do ta kemi një gjendje shumë të shëndoshë financiare, një bazë monetare të shtetit që s'e ka pasur kurr dhe do të mundemi të hyjmë në pavarësi shumë të sigurt pa asnjë problem. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI:: Ju faleminderit. Urdhëro Gani, një minutë.

DEPUTETI GANI KOCI: Zoti Ministër, e kuptojmë shumë qartë çfarë është një raport fiskal i shpenzimeve brenda 6 mujorit, por këto shpenzime nuk kanë ndodhur në hënë as në kosmos por kanë ndodhur në Kosovë dhe ka ndodhur në çështje të caktuara, në veprime të caktuara. Dhe në qoftë se këto shpenzime nuk i shoqëroni edhe me emërtim se ku i keni shpenzuar dhe pse i keni shpenzuar, është një mangësi e vet këtij raporti.

Ne në Komision kemi kërkuar së paku një informacion, një makro-informacion për të gjitha shpenzimet kapitale, projektet që keni filluar, kur keni filluar dhe cilën fazë të realizimit të tyre janë. Dhe ju nuk e keni bërë këtë, do të thotë ka qenë kërkesë e Komisionit. Bile keni thënë se nuk kemi ose s'i japim gjërat e tilla apo s'kemi mundësi. Dhe tash thoni, urdhëroni mundeni me i pa të gjitha. Ose keni gënjyer atëherë, ose po gënjeni tash.

KRYETARI: Kisha dëshiruar që ta tërhiqni këtë fjalë të fundit.

Ju falënderoj të gjithëve për kontributin që keni dhënë.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, si pikë e 17-të:

- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të Bordit Drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës

Qeveria i ka propozuar Kuvendit për emërim të kandidatit për anëtar të Bordit Drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarit në Bordit Drejtues të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës dhe ka rekomanduar që të radhitet për shqyrtim në Seancën plenare.

Propozimi i Qeverisë dhe rekomandimi i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve.

Ministri Shatri, mund ta merrni fjalën në emër të Kryeministrit. Urdhëroni.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit zoti Kryetar.

Në bazë të Rregullores mbi Autoritetin Qendror të Bankave, një anëtar të Bordit Mbikëqyrës të Autoritetit Qendror e propozon Ministri i Financave, një anëtar tjetër e propozon Qeveria e Kosovës.

Kohë më parë, nëtarin e parë ky Kuvend e ka marrë në shqyrtim dhe e ka aprovuar, kurse tani Qeveria ka ardhur me propozimin për anëtarin tjetër të Bordit.

Ju kisha kërkuar që anëtarin e Bordit të propozuar nga Qeveria ta përkrahni sepse kompletimi i Bordit të Bankës Qendrore, është një hapë në marrjen e kompetencave në Autoritetin Qendror të Bankave, sepse e kompletojmë Bordin me anëtarë vendor dhe është si pjesë të veçantë kërkesë e Fondit Monetar që institucionet të cilat kanë kaluar në kompetencë të institucioneve vendore të kompletohen me struktura menaxhuese.

Për anëtarin e Bordit ju janë ofruar të dhëna të mjaftueshme, Qeveria e ka arsyetuar propozimin dhe kërkoj që ta miratoni. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Ftoj kryetarin e Komisionit për buxhet dhe financa Naser Osmanin ta marrë fjalën.

NASER OSMANI: Zoti Kryetar,

Ne e kemi shqyrtuar në mbledhjen e rregullt të Komisionit për buxhet dhe financa dhe si rekomandim e kemi bartë që të vendosë Kuvendi. Edhe atë që e tha Ministri Shatri qëndron plotësisht. Ne i kemi pasur dy rekomandime më herët, të cilat për shkak të konfliktit të interesave janë kthyer nga Përfaqësuesi Special zoti Rycker, dhe konsiderojmë që ky propozim është i qëlluar pasi që personi në fjalë vetëm që një kohë të gjatë është anëtar i Bordit dhe cili është në ngjarje lidhur me çështjet e financave dhe sistemin bankar në përgjithësi. Prandaj, unë rekomandoj që të votohet. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Përfaqësues të grupeve parlamentare nuk donë ta marrin fjalën? A dëshiron kush? Jakup Krasniqi, urdhëroni.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar kolegë,
Paraprakisht lus propozuesin dhe shërbimet profesionale të Kuvendit t'na e përpilojnë një informatë se si janë koordinuar punët, kush ka qenë i angazhuar në ndryshimin e Rregullores së ish BBK-së dhe a kanë pasur mandat për këtë, meqenëse, me sa dimë as Kuvendi as komisionet përkatëse nuk e kanë pasur në shqyrtim qoftë edhe për mendim këtë Rregullore, pasi kjo është e drejtë e rezervuar e UNMIK-ut.

Të nderuar kolegë,
Nëse është e vërtetë se kjo Rregullore nuk i përngjanë asnjë ligji të bankave qendrore, por është fryt pazaresh për interesa personale dhe politike qoftë e grupeve politike vendore, qoftë të interesave të menaxherit që të koncentrojë pushtetin. Si mundemi ne sot, si Parlament, t'i legjitimojmë këto parregullsi?

Sidoqoftë, Rregullorja aktuale parasheh që propozimet e anëtarëve të Bordit i aprovon Kuvendi. Do të thotë, qoftë ato vendore, qoftë ndërkombëtare, me aprovimin e Kuvendit i emëron PSSP-ja. Unë nuk di, që dy anëtarë ndërkombëtar, që janë propozuar dhe as menaxheri ndërkombëtar për të cilët pra nuk kemi dhënë pëlqim. E vërtetë është se drejtorin menaxhues për një periudhë e zgjedh PSSP-ja, por me pëlqimin tonë. Ne nuk kemi dhënë pëlqim për këtë.

I përfoluri, që e drejton sot këtë - ndërkombëtar, për mua është i jashtëligjshëm, pasi Kuvendi nuk ka dhënë pëlqimin për këtë.

E kuptoj se mbase është vepruar kështu për të mos krijuar vakum institucional, mirëpo a nuk duhet vepruar njëllor edhe me kryetarin e Bordit.

Të nderuar kolegë,
Ne kemi hyrë gati në zgjedhje. Përse të gjithë kjo ngarendje për t'i uzurpuar bordet, dhe në këtë rast Bordin me mandat jetëshkurtër për shkak se pas zgjedhjeve, ju e dini do të nxjerrim ligjin për bankat qendrore të Kosovës. Unë nuk e kuptoj këtë ngarendje për post nëse qëllimi i vetëm ka qenë eliminimi i kryetarit të deritashëm.

Dhe në fund, të nderuar kolegë,
Ju e dini se me kandidimin e Isa Mustafës kandidat për komunën e Prishtinës, ai nuk mund të jetë më anëtar i Bordit të Bankës Qendrore. Pra Banka mbetet me tre anëtarë.

Në këtë situatë, ne duhet të mendojmë mirë se si do ta zgjidhim këtë problem. Ju garantoj se me artime nuk mbahet Banka Qendrore e Kosovës.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike propozon që të shtyhet shqyrtimi i kësaj pike të rendit të ditës dhe të përgatitet për një seancë tjetër ku do të diskutohet në pako kjo problematikë tepër e rëndësishme për Bankën Qendrore të Kosovës.

KRYETARI: Ju faleminderit. Përfaqësuesi i LDK-së, profesor Gashi

ALUSH GASHI: Ju faleminderit zoti Kryetar i Kuvendit.
Mua më vjen mirë se këtu kuptohet që Isa Mustafa do të zgjidhet kryetar i Komunës, se është me të vërtetë kandidat i mirë. Ajo se çka do të ndodhë me pozitën e tij në Bord, është e rregulluar me Ligj, ai sigurisht i kryen edhe ato dy punë.

Ne si Grup Parlamentar e kemi mirëpritur një propozim të shkëlqyeshëm që e ka bërë Qeveria për zotëri Gazmend Luboteni. Ne na shtyn biografia e tij e pasur profesionale dhe jetësore që ta mbështesim për këtë pozitë. Njëkohësisht marrim parasysh edhe analizën që e ka bërë Komisioni për Buxhet dhe Financa për kandidatin në fjalë, dhe ne si Grup do ta votojmë që të jetë anëtar i Bordit të Bankës së ardhshme Qendrore. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Gjylnaze Sylja e ka fjalën.
Replikë dëshiron a? Atëherë, një minutë. E ka fjalën zoti Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Se si do të vendosin qytetarët e Kosovës e të Prishtinës, do të jetë çështje e tyre. Unë nuk kam problem me kandidatin e ofruar, do të thotë me emër të përvetshëm. Problemi është të shkeljet e ligjeve dhe të rregulloreve në fuqi dhe të procedurat e parregullta, me të cilat, vërtet duhet të merret më seriozisht ky Parlament.

KOLË BERISHA: Ju faleminderit. Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit zoti Kryetar.
Grupi Parlamentar i Aleancës, si gjithnjë, është natyrisht për respektimin e rregullave dhe zbatimin e tyre. Funksionimi i bankës gjithashtu është shumë i rëndësishëm dhe sidomos i Bankës Qendrore, dhe ne nuk guxojmë të lëmë hapësirë të mosfunksionimit për shkak të mungesës së Bordit. Ajo çka ne sot shqyrtojmë, është propozimi i anëtarit të Bordit Drejtues të Autoriteti Qendror Bankar të Kosovës dhe sipas SIVI-së që e kemi të propozuar nga Qeveria, është e qartë se kemi të bëjmë me një profesionist dhe njohës të mirë të sistemit financiar dhe bankar.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës do ta votoj. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit. Teuta Sahatqiu

TEUTA SAHATQIJA: I nderuari Kryetar,
Duke pasur parasysh që Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës, është një institucion i një rëndësie të veçantë, dhe duke pasur parasysh që kompletimi i Bordit të këtij institucioni e ka rëndësinë. Gjithashtu në favor të kësaj shkon edhe SIVI-ja dhe përgatitja e kandidatit. Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha këto Grupi ynë parlamentar do të votojë për kandidatin në mënyrë që të kompletohet Bordi dhe të funksionojë si duhet Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës.

KRYETARI: Ju faleminderit. Vendimin e Qeverisë së Kosovës e keni marrë më parë.
Pra, po e vë në votim propozimin për kandidatin, Gazmend Luboteni.

Në sallë janë 69 deputetë.
Votojmë me elektronikë, votojmë tash!
Me 50 vota për dhe 4 kundër, zgjedhet kandidati Gazmend Luboteni.

Ju faleminderit për kontributin.

(Mbledhja përfundoi në orën 15:50)